
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti V (XIX) - Nr. 20 (173) ISSN: 2305-655X

SHKËNCË ISLAME | SOCIOLOGJË | PSIKOLOGJË | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

20

2017

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI V (XIX) 2017, NR. 20 (173)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2017

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI V (XIX), korrik, gusht, shtator 2017 nr. 20 (173)

Nën kujdesin e: H. Skender Bruçaj

Drejtör: Dorian Demetja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, rektor, Universiteti Bedër
Prof. Dr. Ayhan Tekines, dekan, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Prof. Dr. Rahim Ombashi, dekan, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, dekan, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Prof. Dr. Qazim Qazim, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti Bedër
Dr. Adem Balaban, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Universiteti Bedër
Dr. Atakan Derelioglu, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, UET
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
Dr. Matilda Likaj, Universiteti Bedër
Dr. Xhemal Seferti, Jordani
PhD. Cand. Ali Zaimi, drejtör, Medreseja e Tiranës
MS/MA Fatos Kopliku, Washington, DC, SHBA
MA. Ramadan Shkodra - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë

Kryeredaktör: Dr. Genti Kruja

Redaktör: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi /
Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Sarandë, 1936

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al
www.zaninalte.al

Përmbajtja

Studime

1. Të mësuarit e normave civile në medresetë e Shqipërisë II,
**Prof. Asoc. Dr. Gentiana Skura, Universiteti i Tiranës, Dr. Robert Gjedia,
Universiteti “Marin Barleti”, Dr. Genti Kruja, Universiteti “Bedër”**
.....5
2. Thirrja islame ndër shqiptarë në ambientin konkret gjeokulturor e gjeopolitik
dhe të postmodernizmit,
Dr. Milazim Krasniqi, Universiteti i Prishtinës, Kosovë24
3. Shkencizmi – Kali Modern i Trojës,
Fatos A. Kopliku, M.S., Washington DC, SHBA40

Histori

4. Korpusi i mbishkrimeve osmane në Tepelenë dhe Delvinë,
Dr. Mehmet Tütüncü, Haarlem, Hollandë57
5. Një vështrim historik mbi librin “Historia e pashallarëve shqiptarë në
Perandorinë Osmane” të Syrja bej Vlorës, Pjesa e I,
Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, QSA, Tiranë69

Gjeografi

6. Kontributi i El-Khvarizmit dhe Ibn Fadlanit në zhvillimin e shkencës së
gjeografisë,
M.sc. Artan S. Mehmeti, Prizren, Kosovë.....92

Gjuhë-Letërsi

7. Poemë satirike, që lexohet për vlerat semantike, gjuhësore e stilistike,
artistike e letrare,
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër98

Mjekësi

8. Ushqimet dhe barnat, të lejuara dhe të ndaluara, përballë zhvillimeve të shekullit XXI,

Ilir Akshija, M.D., M.Sc., Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
.....108

Shkenca Komunikimi

9. “Drita Islame” - një shkëndijë e dritës së fesë islame në Shqipërinë paskomuniste,

Dr. Qani Nesimi, Myfti i Tetovës, Maqedoni128

Personalitet

10. H. Ibrahim Kaduku135

Retrospektivë

11. Mëshira Hyjnore ka mbulue çdo gjë,

Hysni Hoxha144

12. Abstracts in English148

13. Rregullat e shkrimit156



Të mësuarit e normave civile në medresetë e Shqipërisë II

Prof. Asoc. Dr. Gentiana Skura, Universiteti i Tiranës

Dr. Robert Gjedia, Universiteti “Marin Barleti”

Dr. Genti Kruja, Universiteti “Bedër”

Abstrakt

Kurrikula e edukimit qytetar në arsimin parauniversitar zhvillohet me anë të lëndëve “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetari” dhe synon formimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave qytetare te nxënësit e këtij cikli arsimor, duke u mbështetur fort te filozofitë, praktikat e mira dhe modelet e qytetarisë evropiane dhe botës demokratike në veçanti, ku në thelb të tyre mbeten të drejtat dhe përgjegjësitë individuale, zbatimi i ligjit, kujdesi ndaj mjedisit, e drejta për punësim, siguria njerëzore dhe bashkëjetesa në komunitet. Përmbajtja e lëndëve të përmendura më lart nuk prek asnjë informacion ose praktikë edukimi, që lidhet me çështje të mësimit dhe edukimit fetar. Gjithashtu ky edukim ka një vend të posaçëm në kurrikul, që është i mjaftueshëm për të realizuar synimet dhe kompetencat e dëshiruara për nxënësit, kur kemi parasysh sasinë e orëve, peshën specifike të fushës kurrikulare, por edhe të lëndëve të mirëfillta të formimit qytetar, që zhvillohen në të tria ciklet e arsimit parauniversitar, e krahasuar edhe me kurrikulat e sistemeve arsimore evropiane.

Medresetë zhvillojnë kurrikulën zyrtare për ciklet e arsimit parauniversitar, por gjithashtu kanë dhe pjesën e kurrikulës me orientim fetar, e cila edhe kjo miratohet nga Ministria e Arsimit.

Lëndët fetare janë integruar në kurrikulat zyrtare të medreseve në mënyrë të tillë që të jenë mbështetëse edhe të tematikave të trajtuara nga lëndët e edukatës qytetare. Megjithatë njeriu që jeton në sistemin demokratik ka shumë përputhje me besimtarin (pavarësisht përkatësisë fetare), tematikat e përbashkëta të këtyre lëndëve janë të shumta.

1.1.1 Kurrikula e edukimit fetar për qytetarinë

Programet mësimore të edukimit fetar që zbatohen në medrese

Medresetë gëzojnë statusin e shkollave jopublike dhe i zhvillojnë veprimtaritë e tyre sipas dispozitave¹ dhe rregulloreve zyrtare, të përcaktuara prej Ministrisë së Arsimit në Republikën e Shqipërisë. Programet mësimore, që zbatohen në shkolla, marrin fillimisht miratimin e kësaj ministrie, pastaj vihen në zbatim, çka mundëson që nxënësit e medreseve të kenë të drejta dhe detyrime të barabarta me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët shkollohen në shkollat e tjera publike a jopublike të vendit.

Medresetë zhvillojnë kurrikulën zyrtare për ciklet e arsimit parauniversitar, por gjithashtu kanë dhe pjesën e kurrikulës me orientim fetar, e cila edhe kjo miratohet nga Ministria e Arsimit.

Lëndët fetare janë integruar në kurrikulat zyrtare të medreseve në mënyrë të tillë, që të jenë mbështetëse edhe të tematikave të trajtuara nga lëndët e edukatës qytetare. Meqenëse njeriu, që jeton në sistemin demokratik ka shumë përputhje

me besimtarin (pavarësisht cilës fe i përket), tematikat e përbashkëta të këtyre lëndëve janë të shumta.

Lëndët fetare që zhvillohen në medresetë e ciklit 9-vjeçar dhe atij të mesëm të lartë janë “Kur’ani Famëllartë - Komentimi i tij”, “Tradita profetike dhe Kultura Islame”, “Njohuri Besimi e Kulture Islame”, “Njohuri të Adhurimit Islam”, “Modul Profesional: Civilizimi Islam”, “Njohuri të Traditës Profetike dhe të Predikimit”, “Besimi”, “Edukatë Islame”.

Ato luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e attributeve, që kërkon formimi i një qytetari të mirë, të dobishëm, aktiv dhe kontribuues për veten dhe shoqërinë. Më poshtë paraqiten tematikat e përgjithshme dhe temat e përbashkëta të lëndëve fetare, që synojnë një formim qytetar, si:

- Identiteti kombëtar, njohja e kulturave dhe respekti ndaj tyre
- Bashkëjetesa në komunitet dhe respekti për të gjithë njerëzit
- Respekti për vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore
- Respektimi i ligjeve të vendit ku jetojmë, zbatimi i tyre me rigorozitet, si dhe përçimi i këtij mesazhi tek të tjerët

1. VKM, Nr. 654, të datës 29.11.1995 për funksionimin e Medreseve (burime arkivore në KMSH).

- Të drejtat e njeriut dhe përgjegjësitë
- E drejta e votës dhe respekti ndaj përfaqësuesve të çdo niveli
- Vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe mbarë botërore
- Të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian dhe mbarë botëror
- Mirinformimi i nxënësve rreth negativiteteve të ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës
- Sigurimi dhe formimi i kohezionit shoqëror dhe drejtësisë sociale
- Rëndësia e arsimimit, studimit të vazhdueshëm dhe leximit
- Shëndeti dhe ruajtja e tij
- Shfrytëzimi i drejtë i kohës së lirë dhe interesimi ndaj leximit
- Pastërtia në përgjithësi, pastërtia vetjake dhe ruajtja e mjedisit
- Virtytet e punës dhe e drejta e punës
- Ruajtja e sigurisë dhe të qenët garant për stabilizimin e saj në shoqëri
- Sigurimi i të drejtës për informim, të drejtës së fjalës dhe të drejtës së zgjedhjes individuale e shoqërore

Këto lëndë synojnë të formojnë besimtar dhe qytetar të mirë. Një individ, që ruan në maksimum marrëdhënien me Krijuesin e tij dhe njeriun. Një njeri që respekton normat e ligjit dhe të moralit, atdheun dhe shoqërinë ku jeton, njeh të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, tolerant, dialogues, garantues i paqes dhe rendit, punëtor, i dobishëm, aktiv dhe kontribuues për veten dhe shoqërinë.

Me të dhënat që janë përfshirë nga Drejtoria e Arsimit në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, si dhe në analizën e programeve mësimore, që janë përdorur gjatë vitit mësimor 2015-2016, të cilat vijojnë të përdoren edhe në vitin mësimor 2016-2017, vërehet se kemi të bëjmë me tri programe të ndryshme të formimit fetar, të miratuara nga institucionet përkatëse, të cilat ruajnë këtë numër dhe si mbështetje e politikave fleksible të Ministrisë së Arsimit dhe KMSH-së. Më poshtë janë paraqitur vetëm lëndët me përmbajtje fetare, sa orë janë të shpërndara në programin javor, si dhe sasinë e orëve të përcaktuara përgjatë gjithë vitit. Për të dhëna të mëtejshme, mund të shqyrtohen programet mësimore, që përfshihen në shtojcën e këtij studimi.

TABELA I. SHPËRNDARJA E LËNDËVE FETARE QË JEPEN NË ARSIMIN E MESËM NË MEDRESETË E TIRANËS, KAVAJËS, KORÇËS, ELBASANIT DHE BERATIT

Nr.	Lëndët fetare	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Total
1	Kur'ani Famëllartë - Komentimi i tij	3 orë/javë	2 orë/javë	2 orë/javë	7 orë/javë
2	Njohuri të besimit	2 orë/javë	2 orë/javë	2 orë/javë	6 orë/javë
3	Tradita profetike dhe Kultura Islame	-	4	-	4 orë/javë
Total		5	8	4	17 orë/javë

Shpërndarja e orëve për lëndët me përmbajtje fetare në medresetë e Tiranës, Kavajës, Korçës, Elbasanit dhe Beratit, përgjatë tri viteve, është gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë) orë. Ndërkohë që raporti i këtyre orëve me totalin e orëve (111 orë) të të gjitha lëndëve mësimore rezulton 15.31 %.

TABELA II. SHPËRNDARJA E LËNDËVE FETARE QË JEPEN NË ARSIMIN E MESËM TË MEDRESESË SË SHKODRËS

Nr.	Lëndët Fetare	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Total
1	Kur'ani Famëllartë - Komentimi i tij	2 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	4 orë/javë
2	Njohuri Besimi e Kulture Islame	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	3 orë/javë
3	Njohuri të Traditës Profetike e Predikim	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	3 orë/javë
4	Njohuri të Adhurimit Islam	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	3 orë/javë
5	Modul Profesional: Civilizimi Islam	-	-	1 orë/javë	1 orë/javë
Total		5 orë/javë	4 orë/javë	5 orë/javë	14 orë/javë

Orët gjithsej të lëndëve fetare të shpërndara në tri vite shkollore në medresenë e Shkodrës janë 14 orë. Ndërkohë që raporti i orëve të lëndëve me përmbajtje fetare me orët mësimore gjithsej (96 orë) është 14.5 %.

TABELA III. SHPËRNDARJA E LËNDËVE FETARE QË OFROHEN NË ARSIMIN E MESËM NË MEDRESENË E DURRËSIT

Nr.	Lëndët fetare	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Total
1	Kur`ani Famëlartë - Komentimi i tij	1 orë/javë	2 orë/javë	1 orë/javë	4 orë/javë
2	Njohuri Besimi e Kulturë Islame	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	3 orë/javë
3	Njohuri të Traditës Profetike e Predikim	1 orë/javë	1 orë/javë	-	2 orë/javë
4	Njohuri të adhurimit islam	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	3 orë/javë
Total		5 orë/javë	4 orë/javë	3 orë/javë	12 orë/javë

Orët gjithsej të lëndëve fetare të shpërndara në tri vite shkollore në medresenë e Durrësit janë 12. Ndërkohë që raporti i orëve të lëndëve me përmbajtje fetare me orët mësimore gjithsej (96 orë) është 12,5 %.

TABELA IV. SHPËRNDARJA E LËNDËVE FETARE QË JEPEN NË ARSIMIN 9-VJEÇAR NË MEDRESENË E TIRANËS

Nr.	Lëndët fetare	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9	Total
1	Kur`ani Famëlartë	2 orë/javë	2 orë/javë	2 orë/javë	2 orë/javë	8 orë/javë
2	Besimi	2 orë/javë	2 orë/javë	2 orë/javë	2 orë/javë	8 orë/javë
Total		4 orë/javë	4 orë/javë	4 orë/javë	4 orë/javë	16 orë/javë

Mësime të fesë përmbajnë vetëm programet e medreseve të Tiranës dhe Shkodrës (medreseja e Korçës është e licencuar, por nuk është aktive), ku ofrohet arsimi 9-vjeçar. Shpërndarja e lëndëve fetare në katër vite të arsimit 9-vjeçar në medresenë e Tiranës është 16 orë. Ndërsa raporti i tyre me tërësinë e orëve (138 orë) të të gjitha lëndëve është 11.59 %.

**TABELA V. SHPËRNDARJA E LËNDËVE FETARE QË
JEPEN NË ARSIMIN 9-VJEÇAR NË
MEDRESENË E SHKODRËS**

Nr.	Lëndët fetare	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9	Total
1	Kur'ani Famëllartë	4 orë/javë	4 orë/javë	3 orë/javë	3 orë/javë	14 orë/javë
2	Besimi	4 orë/javë	4 orë/javë	3 orë/javë	3 orë/javë	14 orë/javë
3	Edukatë Islame	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	-	3 orë/javë
	<i>Total</i>	9 orë/javë	9 orë/javë	7 orë/javë	6 orë/javë	31 orë/javë

Shpërndarja e lëndëve fetare në katër vite të arsimit 9-vjeçar në medresenë e Shkodrës bëhet në gjithsej 31 orë. Ndërsa raporti i këtyre tridhjetë e një orëve me tërësinë e orëve (135 orë) të mësimin është 22.9 %.

Përfundime

Formimi qytetar me anë të kurrikulës së lëndëve jofetare në të 7 medresetë realizohet nëpërmjet 17 lëndëve, të cilat janë të njëjta në disa medrese, por lëndë të ndryshme, që merren drejtpërdrejt me edukimin islam janë 9, të tilla si:

1. “Kur’ani Famëllartë - Komentimi i tij”
2. “Tradita profetike dhe Kultura Islame”
3. “Njohuri Besimi e Kulture Islame”
4. “Njohuri të Adhurimit Islam”
5. “Modul Profesional: Civilizimi Islam”
6. “Njohuri të Traditës Profetike dhe të Predikimit”
7. “Besimi”
8. “Edukatë Islame”

Duke shqyrtuar tematikat e përgjithshme të edukimit qytetar nëpërmjet lëndëve fetare, vërehet se ajo është e njëjtë me një pjesë të tematikave të kurrikulës së qytetarisë në lëndët jofetare, por më e kufizuar në përmbajtje për çështje si: “Pushteti, autoriteti, qeverisja”, “Kultura”, “Proceset natyrore dhe shoqërore”, “Ndërrvarësia njerëz-vende-mjedise”, “Kronologjia, ndryshimi, vazhdimësia” dhe “Prodhimi, shpërndarja, konsumi”.

Tematika e lëndëve fetare trajton çështje që lidhen thelbësisht me moralin fetar si: besimi, higjiena personale, kujdesi ndaj mjedisit, ndaj vetes, ndaj të tjerëve dhe moshës së tretë, respektimi i të drejtave dhe i rregullave shoqërore, por prek deri diku edhe dimensionin evropian të qytetarisë.

2. Të Dhënat Sasiore të Studimit

3. Të dhëna demografike

Referuar të dhënave sasiore, rezulton se 60% vijnë nga zonat rurale dhe 40% nga zonat urbane. Ndërkohë, mesatarja e përgjithshme e nxënësve që jetojnë në konvikt, për medresetë, është 55.7% e nxënësve. Më konkretisht në një renditje të fundit (dhjetor 2016) të medreseve se ku ka më shumë nxënës konviktore, sipas përqindjeve, ato variojnë: Referuar këtyre të dhënave shohim një raport të përafërt mbi shpërndarjen demografike të nxënësve.

Nr.	Shkolla	Numri i nxënësve (2016-2017)	Nr. i nxënësve konviktore	% (afërsisht)
1	Tiranë (Djem)	178	58	33
2	Tiranë (Vajza)	238	76	32
3	Kavajë Djem)	121	105	87
4	Kavajë (Vajza)	137	108	79
5	Korçë (Djem)	112	98	88
6	Korçë (Vajza)	159	149	94
7	Elbasan	144	85	59
8	Shkodër (djem)	425	71	17
9	Shkodër (vajza)	643		
10	Durrës	105	1	0.9
11	Berat	77	52	68
Total		2339	732	55.77

2.1. Perceptimi i drejtuesve mbi kurrikulën dhe edukimin

Siç u theksua më lart, për qëllimin e këtij studimi u kryen intervistat me 10 drejtuesit e medreseve në periudhën shtator-tetor 2016. Nga përgjigjet rezulton se 4 prej tyre i përkasin grupmoshës 23-30 vjeç, 3 grupmoshës 31-44 vjeç; dhe 3 nga drejtuesit rezultojnë 56 vjeç e lart. Për sa i përket gjinisë, 7 prej drejtuesve janë meshkuj dhe 3 femra. Në lidhje me kualifikimin e tyre, të dhënat tregojnë se 5 drejtues janë me arsim universitar dhe 5 të tjerët, (nga të cilat 2 janë të gjinisë femërore) me arsimin pasuniversitar.

23-30 vjeç	31-44 vjeç	45-55 vjeç	56 vjeç e lart
4	3	-	3

Nga intervista e realizuar me drejtuesit rezultoi se **edukimi/formimi qytetar ka të gjithë hapësirën dhe peshën e tij në kurrikulën shkollore, që zbatohet e mbështetet edhe nga formimi fetar.**

2.1.1 Qëndrimet e drejtuesve se si e shohin lëndën teologjike në raport me edukimin qytetar

- Qëndrimet qytetare ndaj ushqyerjes ku faktet shkencore përputhen me traditën e Kur'anit.

- Qytetaria është pjesë e aspektit fetar

- Tematikat e shëndetit, rëndësia e arsimit, përgjegjësitë ndaj komunitetit, kujdesi për mirë ushqyerjen, çështje që lidhen me familjen, si bazë e shoqërisë, problemet e dhunës dhe divorcit, gjejnë trajtime në qytetari dhe në edukimin fetar dhe kanë shumë pika takimi. Trajtohen të dyja vlerat universale të individit dhe të shoqërisë

- Ndhimjnë njëra-tjetrën, sepse, që të jesh një fetar i mirë, së pari duhet të jesh një qytetar i mirë dhe anasjelltas

- Në trajtimin e çështjeve të shoqërisë kanë shumë pika lidhjeje

- Etika, normat e individit dhe shoqërisë mund të kombinohen mirë për t'u trajtuar në lëndën e qytetarisë dhe të edukimit fetar

- Feja është fushë më e gjerë se qytetaria dhe parimet e fesë janë bazë për krijimin e qytetarisë

2.1.2 Qëndrimet e drejtuesve mbi ndikimin e qytetarisë në formimin e personalitetit të nxënësit dhe në formimin qytetar të tij, si qytetar i këtij vendi:

- Jo mjaftueshëm. Shihet si lëndë që duhet kaluar/bërë

- Kjo lëndë ka rol të rëndësishëm në formimin qytetar të individit

- Ka ndikim të fortë në krijimin e sjelljeve që lidhen me familjen, shoqërinë, mjedisin, etj.

- Ka ndikim të rëndësishëm sidomos tek etika dhe komunikimi

- Kjo lëndë ka një program, që formon përgjegjësi për edukatën dhe moralin

- Ndikon në krijimin e vlerave dhe të kuptuarit e themeleve të shoqërisë

- Ndikon ndjeshëm në edukimin e individit

- Ka ndikim shumë pozitiv lidhur me zbatimin e ligjeve, rregullave, mbrojtjen e shëndetit dhe respektimin e të drejtave të tyre

- Ndikon shumë në formimin e personalitetit të nxënësit

2.1.3. Qëndrimet e drejtuesve mbi impaktin e mjedisit shkollor te nxënësit

- Mjediset e shkollave të tyre, si brenda dhe jashtë tyre, janë shumë të mira

- Kanë oborre të pastra, kushte të kënaqshme dhe pastërti

- Kanë mjedise studimi dhe

sportive, brenda shkollave ka mjedise për konferenca dhe për zhvillim aktiviteteve për të gjithë nxënësit

- Kanë konvikte që janë ndërtesa të reja, komode e të pastra

- Mjediset fizike janë të sigurta dhe edukuese

- Kanë laboratorë dhe mjete didaktike të larmishme dhe të mjaftueshme për çdo lëndë ose fushë studimi

- Kanë rreth 24 nxënës për klasë

- Mesatarisht në çdo medrese i takon, që të jetë 1 mësues për 15,4 nxënës

- Kanë klasa të laboratorëve të TIK me pajisje dhe programe kompjuterike të fundit

- Mjedisi ndikon në edukimin e vlerave qytetare për çështjet e kujdesit personal dhe atij të kujdesit ndaj mjedisit

- Ndryshe nga medresetë që kam parë jashtë vendit, gjykoj se ka nevojë për përmirësime të mëtejshme

2.1.4 Komunikimi dhe mjedisi shkollor

Për sa i përket komunikimit me institucionet DAR dhe MAS drejtuesit janë shprehur se kanë marrëdhënie korrekte institucionale dhe reciproke; komunikimi me DAR-in bëhet me anë të korrespondencës së rregullt, javore, për trajnimet, olimpiadat dhe konkurset; ka komunikim të vazhdueshëm për udhëzimet e MAS dhe për marrjen e

njoftimeve të ndryshme; ka raste kur kemi dhe përfaqësues të DAR-it dhe MAS-it në projektet e medreseve; e po ashtu drejtuesit janë shprehur se trajnohen njëjtë, si me programet e trajnimit të shkollave publike dhe këtë e lehtësojnë drejtoritë arsimore të rretheve përkatëse.

Nga intervistat e realizuara brenda institucionit, drejtuesit shprehen se ka një komunikim të mirë, të ngrohtë dhe të vazhdueshëm, si me stafin pedagogjik, prindërit dhe komunitetin. Sipas tyre, ky trekëndësh i marrëdhënieve mësues-mësues, mësues-nxënës, mësues-prind realizohet më së miri. Megjithatë, drejtuesit kërkojnë më shumë përfshirje të prindërve, në vendimmarrje, pjesëmarrje dhe angazhim të pandërprerë. Më poshtë gjenden disa nga opinionet e tyre:

- Ka harmoni, respekt. Komunikimi mësues-nxënës-prind funksionon

- Ka klimë të mirë bashkëpunimi. Biseda e takime periodike me nxënës e prindër

- Ka takime të veçanta me prindërit
- Ka vend për përmirësime
- Përgjithësisht e mirë
- Ka raste të vogla sporadike konfliktuale

- Ka marrëdhënie korrekte. Medreseja është institucion i hapur dhe vlerëson etikën e komunikimit institucional

- Ka marrëdhënie të ngrohtë dhe të shëndetshme

- Medreseja zhvillon 2-3 aktivitete me pjesëmarrjen e detyrueshme të prindërve, si dhe 4-5 aktivitete gjatë gjithë vitit shkollor, ku kërkohet pjesëmarrja e prindërve

- Zakonisht vijnë në mbledhjet me mësuesit për të parë ecurinë, apo progresin e fëmijës

- Kontributi i prindërve duhet të jetë më i madh dhe më i dukshëm

- Prindërit vijnë kryesisht në ceremonitë fetare dhe në panaiet, që organizon medreseja

Opinion i drejtuesve mbi degët më të parapëlqyera të nxënësve, që diplomohen nga medresetë, të cilat renditen sipas rëndësisë, janë:

- Degët e informatikës, të elektronikës, të inxhinierisë informatike

- Degët e inxhinierisë së ndërtimit, inxhinierisë industriale, inxhinierisë mekatronike, inxhinierisë elektrike dhe degës së gjeoburimeve

- Degët e infermierisë dhe më pas dega e mjekësisë

- Dega për ekonomist dhe administrim biznesi

- Dega e drejtësisë

- Dega për mësues të arsimit parashkollor

Mesatarja e përgjithshme e nxënësve, që vazhdojnë shkollimin e lartë është 96% për të gjitha medresetë. Ndërsa në një renditje

të 7 medreseve lidhur me përqindjet e nxënësve që vijnë shkollimin e lartë, ato variojnë:

1. Tiranë 100%
2. Shkodër 99%
3. Elbasan 97%
4. Kavajë 96 %
5. Korçë 95,5 %
6. Durrës 95 %
7. Berat 90 %

Ndërkohë mesatarja e përgjithshme e nxënësve të diplomuar, që vazhdojnë shkollimin e lartë për teologji, është 5.8% për të gjitha medresetë për vitin 2015-2016. Kjo e dhënë tregon që shkollat fetare sot, ndikojnë më tepër në formimin e lëndëve ekzakte, ka një tendencë shumë të vogël për ndjekjen e studimeve fetare. Kjo thyen një stereotip të fortë në opinionin publik mbi qëllimin dhe vizionin e këtyre shkollave.

2.2. Perceptimet e mësuesve mbi kurrikulën dhe edukimin

Në studim morën pjesë mësues të lëndës së qytetarisë dhe lëndëve të besimit në të gjitha medresetë e Shqipërisë.

Nga anketimi rezulton se shumica e mësuesve janë të një moshe të re, nga ku del se nga moshat 23-30 vjeç janë 19 vetë, ose rreth 61.3 %, më pak del se janë në moshat nga 45-55 vjeç, 2 vetë, ose

6.4 %, si dhe në moshat 31-44 vjeç, 6 vetë, ose 19.3 % dhe 56 e lart, 4 vetë, ose 12.9 %.

Nga këto, 19 mësues janë meshkuj (rreth 61.3 %) dhe 12 mësuese femra (rreth 38.7 %).

2.2.1 Arsimimi i të anketuarve

21 prej tyre janë me arsim të lartë universitar (67.7 %), ku prej tyre 12 janë meshkuj dhe 9 femra, 8 mësues kanë mbaruar studimet pasuniversitare (ose 25 %), ku 5 janë meshkuj dhe 3 femra dhe 1 mësues (mashkull) ka kryer edhe studimet për doktoraturë.

2.2.2 Shpërndarja e mësuesve sipas cikleve

Nga pyetja “**Në cilin cikël të Medresesë jeni mësues?**”, 5 prej tyre janë në ciklin i mesëm i ulët (klasat 6-9, ose 16 % e totalit), 24 janë në ciklin i mesëm i lartë (klasat 10-12, ose rreth 77 % e totalit), ku 1 prej tyre është mësues në të dyja ciklet, ndërsa 2 prej tyre nuk i janë përgjigjur pyetjes.

Pyetjes, “**Si mësues i Medresesë, a zhvilloni ju veprimtari të planifikuara në orën mësimore që synojnë formimin e aftësive të mëposhtme**”, 26 prej tyre i janë përgjigjur “po”, ose rreth 84 %, ndërsa 5 prej tyre nuk i janë përgjigjur.

Ndërsa aftësi të klasifikuara si më poshtë, mësuesit e anketuar i janë përgjigjur sipas një rezultati të tillë:

•aftësi për të punuar në grupe - **23 vetë**

•aftësi për t’i zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore - **24 vetë**

•aftësi për të kuptuar dhe zbatuar përgjegjësitë individuale në marrëdhënie me të tjerët - **17 vetë**

•aftësi për të krijuar qëndrime etiko-sociale - **18 vetë**

•aftësi për të zhvilluar të menduarit kritik dhe krijues - **23 vetë**

•aftësi për të mirëmenaxhuar informacionet e ndryshme - **13 vetë**

•aftësi për të menaxhuar rrjetet sociale dhe komunikimet on-line - **9 vetë**

Ajo që vihet re nga qarkimi i aftësive nga ana e mësuesve është se 23 prej tyre (ose 74 %, d.m.th. shumica), kanë aftësi për të punuar në grupe, aftësi për të zhvilluar të menduarit kritik dhe krijues dhe aftësi për t’i zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore, kjo e fundit ka numrin dhe përqindjen më të lartë, 24 vetë, d.m.th. 77.4 %). Ndërsa 18 prej tyre (ose 58 %) kanë edhe aftësi për të krijuar qëndrime etiko-sociale, 17 vetë (ose 54.8 %) kanë aftësi për të kuptuar dhe zbatuar përgjegjësitë individuale në marrëdhënie me të tjerët, 13 vetë (ose rreth 42 %) kanë aftësi për të mirëmenaxhuar informacionet e ndryshme. Kurse vetëm 9 veta (ose

29 %) kanë aftësi për të menaxhuar rrjetet sociale dhe komunikimet online, që përbën dhe përqindjen më të ulët. Po ashtu, 29 % e tyre, apo një e treta janë shprehur se i kanë të gjitha këto aftësi. **Nga përpunimi i të dhënave vërejmë që nxënësit aftësohen të punojnë në grupe, të zgjidhin konfliktet, të përfshihen në pjesëmarrje qytetare, si dhe vlera të rëndësishme në lidhje me informimin dhe komunikimin.**

Pyetjes **“A zhvillonin projekte kurrikulare me nxënësit dhe klasat ku jepni mësim, që trajtojnë tema të edukimit qytetar?”**, 17 prej mësuesve të anketuar i janë përgjigjur “po”, d.m.th. 54.8 %, 9 i janë përgjigjur “jo”, d.m.th. 29 % dhe 5 prej tyre nuk i janë përgjigjur pyetjes. Pavarësisht qëllimit të shkollës, orëve teologjike, nga kontaktet, vëzhgimet, pyetësorëve, ne vërejmë, se lëndët shoqërore, lëndët e karakterit shoqëror, zënë një hapësirë të konsiderueshme në kurrikulën e këtyre shkollave.

Pyetjes **“A zhvillonin veprimtari jashtëshkollore/ekstrakurrikulare në shkollën tuaj me fokus formimin qytetar?”**, 22 prej tyre janë përgjigjur “po”, d.m.th. rreth 71 %, ndërsa 5 prej tyre “jo”, d.m.th. 16 %, ndërsa 4 prej tyre nuk i janë përgjigjur, ose 11.7 %.

Pyetjes 8, ku thuhet se **“Nëse jeni mësues i lëndëve të edukimit/formimit qytetar apo i shkencave**

shoqërore, lutemi, qarkoni se cilat nga metodat/teknikat e mëposhtme, mësimore, përdorni më shpesh në orët mësimore”, 22 vetë, ose rreth 71 % përdorin diskutimin, 21 vetë, ose 67.7 % përdorin kryesisht shpjegimin, ndërsa vetëm 4 vetë përdorin studimet e rastit dhe po kaq i bie, ose thënë në përqindje rreth 13 % përdorin shpjegimin, punën në grupe, studimet e rastit, punën individuale, diskutimet, paraqitje të punëve të nxënësve me anë të TIK, punë me projekte, punë kërkimore dhe lexim i pavarur. Siç vihet re, nxënësit e medreseve në një pjesë të konsiderueshme të studimeve të tyre merren me punë kërkimore, punë individuale dhe punë në grup. Kjo është një nga metodat më bashkëkohore të nxënies në shkolla.

Më konkretisht mund të shihen si vijon:

- A. Shpjegimi - **21 vetë**
 - B. Punë në grupe - **18 vetë**
 - C. Studime rasti - **4**
 - D. Punë individuale - **18 vetë**
 - E. Diskutime - **22 vetë**
 - F. Paraqitje të punëve të nxënësve me anë të TIK - **10 vetë**
 - G. Punë me projekte - **18 vetë**
 - H. Punë kërkimore - **11 vetë**
 - I. Lexim i pavarur - **12 vetë**
- Dhe 1 person ka shtuar - “të mësuarit në bashkëpunim”.

Mjetet didaktike dhe mësimore, që kanë shënuar mësuesit e anketuar të lëndëve të edukimit/formimit

qytetar, apo të shkencave shoqërore janë shënuar si më poshtë:

- Libra artistikë
- Gazeta
- Revista
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Pyetjes, **“Si mësues i edukimit qytetar, a i vlerësoni nxënësit tuaj për atë që ata përfaqësojnë ose shfaqin”**, si p.sh: *besimi, gjinia, origjina, niveli ekonomik, nevojat e veçanta, niveli i tij/i saj* në të nxënë, mënyra e të veshurit, komunikimi personal dhe ndërpersonal në klasë, demonstrimet e sjelljeve të tij/të saj konfliktuale ose problemet që mund të krijojnë në mësim (kundërshti, përdorim fjalori jokorrekt), etj., 13 prej tyre, ose rreth 42 % janë përgjigjur “po”, 8 prej tyre, ose rreth 26 % janë përgjigjur “jo” dhe 9 prej tyre nuk janë përgjigjur, ose 29 %. Mësuesit i vlerësojnë nxënësit në mënyrë të përgjithshme dhe jo vetëm në njohuritë e tyre për lëndët.

2.3. Perceptimi i nxënësve mbi kurrikulën dhe edukimin

Një nga qëllimet parësore të shkollës shqiptare mbetet edukimi qytetar, proces që përfshin krijimin te nxënësit e njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave qytetare në mënyrë që ata të jenë të aftë të jetojnë dhe të përballojnë demokracinë.

Për këtë arsye në kuadër të këtij studimi u kryen 505 pyetësorë me nxënës të të shtatë medreseve.

Pyetësori u shpërnda në mënyrë të rastësishme në çdo klasë, në të dyja ciklet mësimore (Arsimi i mesëm i ulët AMU) dhe (Arsimi i mesëm i lartë AML). Pyetësori përbëhej nga dhjetë pyetje një pjesë e të cilave kishte qëllim evidentimin e raportit të edukimit qytetar në medrese.

- Nxënësit e anketuar sipas qyteteve janë: 96 nxënës ose 19% e të anketuarve në Tiranë, 25 nxënës ose 5%, Durrës, 111 nxënës ose 22% e të anketuarve nga Shkodra, 49 nxënës, ose 10% e të anketuarve nga Elbasani, 32 nxënës, ose 6 % e të anketuarve i përkasin medresesë së Beratit, 68 nxënës ose 13% nga medreseja e Korçës, 80 nxënës ose 16% e të anketuarve i përkasin medresesë në Kavajë dhe 44 nxënës ose 9% e të anketuarve kanë preferuar të mos e shënojnë qytetin.

- Nga nxënësit e anketuar 242 janë vajza (48 %) dhe 263 janë djem (52 %).

- Në pyetjen se si e vlerësojnë shkollën e tyre, 339 prej nxënësve e vlerësojnë “shumë e mirë”, 114 nxënës e vlerësojnë “e mirë”, 36 nxënës e vlerësojnë “mesatare” dhe 16 nxënës “e dobët”.

Ndërkohë, nëse vëmë re nga të dhënat, duket se djemtë janë më të kënaqur me shkollën e tyre. Numri i tyre është më i lartë se numri i vajzave në përgjigjet “shumë e mirë” dhe “e mirë”. Nuk shohim ndonjë dallim gjinor mbi perceptim e tyre për mjedisin e shkollës.

- Në pyetjen se çfarë mendimi kanë për mësuesit e tyre, 93.8 % e nxënësve të anketuar kanë mendim shumë të mirë dhe të mirë për to. Kjo tregon se në 7 shkollat, në të cilat është zhvilluar anketa, ka mësues që vlerësohen në nivele të larta nga nxënësit. Edhe në ndarjen gjinore, që i është bërë kësaj pyetjeje, rezulton se është thuajse i njëjtë numri i djemve dhe vajzave që kanë mendime pozitive për mësuesit e tyre. Janë vetëm 3 nxënës, që nuk kanë mendim fare të mirë për mësuesit e tyre, por 3 nxënës nga 505 është një shifër të pakonsiderueshme, vetëm 0.06 %. Sigurisht duhet një analizë pak më e detajuar, se përse këta nxënës kanë këtë mendim, por nuk ishte ky qëllimi i pyetësorit.

- Po ashtu, nxënësit kanë mendime përgjithësisht pozitive kur pyeten për mjediset e shkollës, ku mësojnë. 271 nxënës ose 53.6% kanë mendim shumë të mirë për shkollën e tyre. 30% ose 154 nxënës kanë mendim të mirë për mjediset shkollore.

-Duhet theksuar se 14.2 % e të intervistuarve mendojnë se mjediset në shkollat e tyre kanë nevojë për përmirësim.

- Nga anketimet e bëra me këtë target grup vërejmë se nxënësit e preferojnë lëndën e Edukatës qytetare ose e Qytetarisë në shkollat

e tyre. Nga përgjigjet rezulton se 92.6% e nxënësve e pranojnë se lënda zhvillohet në shkollën e tyre. Lënda e Edukatës qytetare zhvillohet në të 7 medresetë e marra në studim.

- Nxënësit janë pyetur për mendimin që kanë për mësuesit që japin lëndën e Edukatës qytetare ose të Qytetarisë. Mendim shumë të mirë kanë 71.8 % (363 nxënës) dhe mendim të mirë kanë 22.3% (113). Kjo është pozitive për mësuesit e këtyre shkollave. Ata që kanë mendimin *disi të mirë* dhe *aspak të mirë* janë vetëm 5.7% (29 nxënës). Kjo tregon se, megjithëse ka një përqindje të mësuesve të formuar në shkenca të tjera, sërish vlerësimet e këtyre mësuesve të lëndëve të edukatës qytetare, nga ana e nxënësve, janë të larta, gjë që përputhet me pohimin e drejtuesve të medreseve, të cilët më lart theksojnë se një pjesë e mësuesve të lëndëve të edukatës qytetare mund të mos jenë me formimin përkatës, por janë mësues me përvojë.

- Nga 505 nxënës të anketuar kemi vetëm 10 të pakënaqur me mësuesit e tyre. Këta të pakënaqur ndahen në mënyrë të barabartë 5 vajza dhe 5 djem. Janë pak më shumë djemtë me mendim *disi të mirë* 13 me 6 vajza, por duhet theksuar se numri i djemve është pak më i lartë. Djemtë janë ata që japin më shumë vlerësime për mësuesit, 201 djem dhe 44 prej tyre kanë *mendim të mirë*. Ndërsa te

vajzat, 69 prej tyre japin mendim *të mirë* për mësuesit dhe 162 japin mendim *shumë të mirë*. Kur dalim në analizën sipas klasave, shohim që klasa e 11 ka pakënaqësi të vogla ndaj mësuesve, 30.1 % e kësaj klase (11) ka mendim të mirë për mësuesit e tyre, duhet theksuar se 9 nxënës kanë mendim disi të mirë dhe 7 prej tyre aspak të mirë.

- Nxënësve iu kërkuar mendimi nëse njohuritë që kanë marrë në lëndën e Edukimit qytetar apo Qytetarisë trajtojnë apo lidhen me aspekte fetare. Përgjigjet janë interesante, rreth 36.4% mendojnë se kjo lëndë ka ndikim *disi apo shumë* në lidhje me aspektet fetare. Në total ata që mendojnë se ka ndikim: pak, disi, shumë janë 51.8%, që do të thotë se janë pak më shumë se gjysma e të anketuarve, janë 48.2% e nxënësve ose 243 nxënës, që mendojnë se kjo lëndë nuk ka aspak ndikim në lidhje me aspektet fetare.

Në ndarjen sipas vajzave dhe djemve, mund të themi se janë në shifra të njëjta me një dallim të lehtë ku djemtë janë më skeptikë dhe mendojnë që kjo lëndë ka ndikim. Vajzat janë më tepër të mendimit që ka më pak lidhje me njohuritë fetare.

- Nxënësve iu është kërkuar që të rendisnin, sipas pëlqimeve të tyre, disa nga temat që janë trajtuar në lëndën e Edukimit Qytetar ose Qytetarisë. Në klasën e 6 janë

67.5 që vendosin në vend të parë: Komuniteti, shërbimet në komunitet. Më pas ndiqet me Komuniteti në nevojë me 18 nxënës, që e kanë përzgjedhur si temë dhe shërbimet, institucionet, që është përzgjedhur nga 17 nxënës, kjo është si shumë e një totali prej 37 nxënës të anketuar.

Në klasën e 7 dy vendet e para me mbi 50% i zënë zakonet, tradita, ligjet dhe normat, të ndjekura nga diskriminimi, që e kanë përmendur 10 nxënës.

Në klasat e 8-ta dhe të 9-ta nuk kanë dhënë tema, të cilat i kanë diskutuar. Nga 30 nxënës të anketuar në këto dy klasa, 11 prej tyre thonë se nuk bëjnë dhe nuk e dinë nëse e bëjnë këtë lëndë ndaj dhe s'kanë dhënë tema.

Në klasën e 10-të janë plot 100 nxënës që kanë përmendur ligjet nga 120 në total. 48 prej tyre kanë përmendur Kushtetutën, dhe 22 prej tyre Kodin Civil Penal. Këto janë temat më të diskutuara për këtë klasë. Kjo shifër është shumë interesante, pasi tregon se nxënësit kanë interes për ligjet dhe kushtetutën e vendit, dhe se këtyre temave iu është kushtuar rëndësi e veçantë.

Në klasën e 11-të kemi në plan të parë familjen, me 94 nxënës nga 156 të anketuar, e dyta vjen adoleshenca, si temë me 65 nxënës dhe e treta mbrojtja e mjedisit me 58 nxënës të anketuar. Këto janë tre temat më të diskutuara, por ka edhe shumë të tjera në këtë klasë.

Në klasën e 12-të kemi “si të ushqehemi” temë kryesore me 60 nxënës, gjysma e klasës të ndjekur nga “piramida ushqimore” dhe “adoleshenca”.

Siç vihet re, nxënësit e klasave të ndryshme janë nisur pikë së pari nga temat e trajtuara për vitin e tyre. Kjo përputhet qartë me temat që trajton edukata në klasa të ndryshme.

Konkluzione

1. Filozofia e medreseve të Shqipërisë, edukimin e ka parë nga tri kënde të gërshetuara mes vete: human-psikologjik, kombëtar-social dhe universal. Në ciklet arsimore të medreseve, sot, shkencat islame mësohen bashkë me shkencat natyrore, sepse ai e rekomandon qartë lidhjen e besimit me shkencat natyrore, përjashtim bën vetëm teoria e evolucionit, e cila bie ndesh edhe me të gjitha besimet fetare, të cilat njohin krijimin nga Zoti si origjinë të gjallesave.

2. Kurrikula e edukimit qytetar në arsimin parauniversitar zhvillohet nëpërmjet lëndëve “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetari” dhe synon formimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave qytetare te nxënësit e këtij cikli arsimor, duke u mbështetur te praktikat e mira dhe modelet e qytetarisë evropiane. Përmbajtja e lëndëve të përmendura më lart nuk prek asnjë informacion ose praktikë

edukimi, që lidhet me çështje të mësimit dhe edukimit fetar.

3. Medresetë zhvillojnë kurrikulën zyrtare për ciklet e arsimit parauniversitar, por, gjithashtu, kanë edhe pjesën e kurrikulës me orientim fetar, e cila miratohet nga Ministria e Arsimit.

4. Lëndët fetare janë të integruara në kurrikulat zyrtare të medreseve në mënyrë të tillë, që të jenë mbështetëse edhe të tematikave të trajtuara nga lëndët e edukatës qytetare. Tematikat e përbashkëta të këtyre lëndëve janë të shumta.

5. Formimi qytetar me anë të kurrikulës së lëndëve jofetare në të 7 medresetë e ciklit 9-vjeçar dhe atij të mesëm të lartë realizohet nëpërmjet 17 lëndëve, të cilat janë të njëjta në disa medrese, por lëndë të ndryshme, që merren drejtpërdrejt me edukimin islam janë “Kur’ani Famëlartë - Komentimi i tij”, “Tradita profetike dhe Kultura Islame”, “Njohuri Besimi e Kulture Islame”, “Njohuri të Adhurimit Islam”, “Modul Profesional: Civilizimi Islam”, “Njohuri të Traditës Profetike dhe të Predikimit”, “Besimi”, “Edukatë Islame”.

6. Këto lëndë synojnë të formojnë besimtarë dhe qytetarë të mirë. Një individ, që ruan në maksimum marrëdhëniet me Krijuesin e tij dhe njeriun; por njëkohësisht, që respekton normat e ligjit dhe të moralit, atdheun dhe shoqërinë ku jeton, njeh të drejtat dhe

përgjegjësitë e tij, tolerant, dialogues, garantues i paqes dhe rendit, punëtor, i dobishëm, aktiv dhe kontribuues për veten dhe shoqërinë.

7. Duke shqyrtuar tematikat e përgjithshme të edukimit qytetar nëpërmjet lëndëve fetare vërehet se ajo është e njëjtë me një pjesë të tematikave të kurrikulës së qytetarisë në lëndët jofetare, por më e kufizuar në përmbajtje për çështje si: “Pushteti, autoriteti, qeverisja”, “Kultura”, “Proceset natyrore dhe shoqërore”, “Ndërvlerësit njerëz-vende-mjedise”, “Kronologjia, ndryshimi, vazhdimësia” dhe “Prodhimi, shpërndarja, konsumi”.

8. Tematika e lëndëve fetare trajton thelbësisht çështje, që lidhen me moralin fetar si: besimi, higjiena personale, kujdesi ndaj mjedisit, ndaj vetes, ndaj të tjerëve dhe moshës së tretë, respektimi i të drejtave dhe i rregullave shoqërore, por edhe dimensionin evropian të qytetarisë, normat e të cilit nuk bien ndesh me parimet islame në përgjithësi.

9. Edukimi nëpërmjet lëndëve fetare zë një vend të konsiderueshëm në kurrikulën, që zbatojnë medresetë.

10. Edukimi qytetar ka të gjithë hapësirën dhe peshën e saj në kurrikulën shkollore, që zbatohet në medrese dhe mbështetet edhe nga formimi fetar.

11. Mesatarja e përgjithshme e nxënësve, që vazhdojnë shkollimin e lartë është 96% për të gjitha medresetë.

12. Mesatarja e përgjithshme e nxënësve të diplomuar që vazhdojnë shkollimin e lartë për teologji apo studime fetare është 5.8% për të gjitha medresetë për vitin 2014-2015. Kjo tendencë tregon, që shkollat fetare sot, ndikojnë më tepër në formimin e lëndëve ekzakste.

13. Degët më të parapëlqyera të nxënësve, që diplomohen nga medresetë janë: degët e informatikës, të elektronikës, të inxhinierisë informatike, inxhinierisë së ndërtimit, inxhinierisë industriale, inxhinierisë mekatronike, inxhinierisë elektrike dhe degës së gjeoburimeve, mjekësi, ekonomi, drejtësi, mësues të arsimit parashkollor, shkenca komunikimi, etj.

14. Pavarësisht qëllimit të shkollës, orëve teologjike, nga kontaktet, vëzhgimet, pyetësorëve, ne vërejmë, që lëndët e karakterit shoqëror, zënë një hapësirë të konsiderueshme në kurrikulën e këtyre shkollave.

REKOMANDIME

1. Tematikat dhe çështjet e përbashkëta të formimit qytetar, që trajtojnë këto dy gruplëndësh (fetare dhe jofetare) duhet të merren parasysh nga mësuesit e qytetarisë dhe nga vetë medresetë për t'u trajtuar në njërën nga këto gruplëndësh mësimore, për të mos pasur mbivendosje dhe përsëritje të tyre.

2. Duke pasur parasysh se medresetë

janë shkolla, ku merret edhe një përqindje e caktuar e lëndëve fetare islame, rekomandojmë futjen në kurrikulë të një lënde apo të paktën moduli, e cila flet për historinë e feve dhe dialogun ndërfetar, ku të jepen shembuj dhe argumente konkrete të historisë së dialogut ndërfetar përgjatë historisë në botë, e sidomos në Shqipëri, në mënyrë që nxënësit e medreseve t'i përftojnë këto njohuri të rëndësishme nëpërmjet teksteve shkollore, duke i shoqëruar edhe me aktivitete dhe veprimtari me shkollat e komuniteteve të tjera fetare në vendin tonë.

3.DAR-et të mundësojnë trajnime të planifikuara enkas për mësuesit e medreseve rreth koncepteve dhe praktikave të qytetarisë.

4.Mësuesit e edukimit qytetar duhet të kenë kualifikimin e duhur. Po ashtu, duhet të llobohet që lëndët e edukimit qytetar dhe Qytetarisë të kenë vëmendjen e duhur nga ana e shkollës dhe nxënësve. Nëse duam të përgatisim qytetarë të denjë të këtij vendi, por jo vetëm, duhet t'i kushtojmë vëmendje më të madhe formimit qytetar.

5.Po ashtu, rekomandojmë, që medresetë të jenë më të hapura për publikun e të mos konsiderohen vetëm si shkolla fetare, por po ashtu edhe si shkolla, të cilat, në radhë të parë, kanë si fokus edukimin e individit qoftë moral, ashtu edhe shkencor. Kjo do të ndikojë në uljen e paragjytimeve dhe stereotipin, që shkollat fetare përgatisin vetëm teologë.

Bibliografia:

- Balla, Xhemal (2010), "Haxhi H. Mahmut Dashi, jeta dhe vepra 1873-1961", Tiranë: West Print
- Basha, Ali M. (2011), "Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)", Tiranë
- Kruja, Genti, (editor), (2014), "Rregullore mbi Medresen e Myslimanve", Zani i Naltë, vëllimi i parë, vitet 1923-1924/-1925, botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, Tiranë
- Kutlu, Adil, (2016), "Perceptimi i prindërve lidhur me edukimin fetar në Shqipëri: rasti i medreseve", Tezë doktrature, UET, Tiranë
- Vuçiterni, Salih, "Nji pergjigje Z. Hafis Xhaferit", Kolana "Zani i Naltë, Vëllimi i Dytë, vitet 1926-1927-1928, botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, 2015: 274-275.
- Zaimi, Ali & Kruja, Genti (editorë), (2014) "Katalog i Veprimtarisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, botimet KMSH, Tiranë

Dokumente:

- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Dokument i MAS. 2014.
- Shkresë zyrtare e MAS datë 07.10.2014, me Nr.6608/1 prot. “Miratim i planeve mësimore të medreseve” drejtuar Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH)
- VKM, Nr. 654, të datës 29.11.1995 për funksionimin e Medreseve (burime arkivore në KMSH)

Webliografia:

- <http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-1-5.pdf>
- <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-1-5.pdf>
- <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-6-9.pdf>
- <http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2014/10/Udhezues-per-gjimnazin-Varianti-i-fundit.pdf>
- <http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/#feature3>
- <http://www.asa3.org/ASA/education/options/public.htm#rel>
- http://gainpeace.com/index.php?option=com_content&view=article&id=108:what-is-islams-view-about-education-science-and-technology&catid=54:catidebliografi=54&Itemid=108
- http://www.coe.int/t/dg4/education/minlang/Inviting_God_into_the_Classroom_Prof._Robert_Nash_College_of_Education_and_Social_Service_at_Vermont.A_case_for_religion_in_public_schools
- <http://www.uvm.edu/~uvmpr/vq/VQFALL01/religion.html>
- <https://www.aarweb.org/sites/default/files/pdfs/Publications/epublications/AARK-12CurriculumGuidelines.pdf>

Thirrja Islame ndër shqiptarë në ambientin konkret gjeokulturor e gjeopolitik dhe të postmodernizmit

Dr. Milazim Krasniqi
Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Abstrakt

Njeriut vetmitar e të tëbujësuar bukur shumë, egoist e nihilist, dubet t'i ofrohet një prezantim dhe interpretim i besimit fetar islam, që do të jetë si ofertë e fuqishme ngushëlluese e shpëtimtare. Pra, ofertë e cila nuk e injoron gjendjen reale të tij, ofertë që është dashamirëse e atraktive, që ia tërheq vëmendjen me butësi; që i ndihmon të mos fundoset në batakun e zhgënjimit, që i ofrohet si një varkë shpëtimi.

Gjithsesi, botëkuptimi postmodernist për botën tashmë është imponuar dhe po bëhet dominues edhe në mesin e gjeneratave të reja të shqiptarëve. Prandaj, dubet të njihet si botëvështrim e si gjendje, në tërësinë e vlerave dhe të kundërbënieve të tij, nga boxballarët e dijetarët myslimanë, në mënyrë që të jenë efikas në komunikim me publikun (xbematin) që ka prejardhjen nga kjo sferë. Në të kundërt, edhe jeta e tyre fetare do të përfshihet gjithnjë e më shumë nga improvizimet, nga spontaniteti, nga cektësia dhe më vonë nga indiferenca. Ashtu do t'i hapet një mundësi e re deislamizimit të shqiptarëve, por kësaj radhe jo në rrethanat e terrorit totalitar, si në regjimin komunist, po në rrethanat e lirisë, ku elitat fetare e kanë hequr komunikimin me njerëzit, për shkak të paafësisë së tyre që të orientohen si dubet në realitetet e reja gjeopolitike, kulturore e shoqërore.

Nxitjen për këtë meditim, lidhur me format se si duhet të prezantohet e interpretohet Islami dhe se si mund të bëhet thirrja për Islam në kohën postmoderne, e mora nga dy raste identike të ndodhura brenda një jave, në dy xhami të ndryshme të kryeqytetit tonë, Prishtinës. Dy myezinë të këtyre dy xhamive, djem të rinj, të veshur si të gjithë të rinjtë e tjerë prishtinas, pasi thirrën ezanin dhe falën namazin vullnetar, nxorën celularët dhe po kontrollonin me vëmendje, ose ndonjë portal, ose profilet e tyre në rrjetet sociale. Të dy dukeshin shumë të përqendruar në punën që bënin me celularët e tyre, edhe pse herë pas here vëzhgonin të tjerët, që të dinin se kur do e përfundonin të tjerët namazin vullnetar, që ta thërrisnin ikametin për të hyrë në namazin e obligueshëm. Nga eleganca me të cilën ata po i kryenin këto dy punë, në të njëjtën kohë, më lindi ideja se këtë mënyrë kombinimi të ezanit dhe namazit vullnetar me kontrollimin e përmbajtjeve në celular, para ikametit dhe namazit të obligueshëm, ata e praktikonin shumë shpesh. Ata, patjetër, kishin njëfarë lidhshmërie nëse jo varësie ndaj medias, internetit, qoftë edhe në intervale kaq të shkurtra kohore, disa minutëshe. Natyrisht, për mendimin tim, kjo mënyrë veprimi nuk do të thotë aspak mungesë devotshmërie ndaj namazit e ndaj besimit fetar.

Jo. Por, kjo do të thotë se format intensive të komunikimit në internet, në kohën tonë, janë gjithëpërfshirëse, pra, i përfshijnë edhe të rinjtë, që janë praktikues të rregullt të namazit, madje edhe myezinët. Kjo do të thotë se, nën ndikimin e ndryshimeve teknologjike, kulturore, sociale e mediatike, praktikisht ne kemi ndryshuar, ose po ndryshojmë, që të gjithë. Mua, shpesh, gjatë namazit në xhami, më bezdis dilema se a e kam fikur celularin apo jo, që do të thotë se ndikimi i tij është evident edhe nëse është i fikur. Pra, po ndryshon sjellja jonë, botëkuptimet tona, raportet tona, me mundësi ndryshimi edhe të disa shtresave të botëkuptimeve dhe madje të identiteteve tona. Kisha një nxitje të mëparshme për të ngritur këtë çështje i mbështetur edhe në përmbajtjet e shumë ligjëratave të hoxhallarëve nëpër xhami, në YouTube dhe në televizione.

Duke dëgjuar një numër të konsiderueshëm ligjëratash të tyre edhe gjatë këtij muaji të Ramazanit, në mediat vizive, shoh se shumica e tyre vazhdojnë t'i kultivojnë stilet e vjetra të ligjërimit, ligjërime të tejzgjatura, monotone, disa prej tyre edhe me ngritje toni e gati me britma, po përgjithësisht jo atraktive për t'u dëgjuar aq gjatë. Në tërë këtë punë vihet re një paradoks: shfrytëzohet bukur shumë media për vënien në pah të ligjëratave, prezantimin dhe interpretimin nga ana e hoxhallarëve e vlerave të besimit islam, e edhe të

thirrjes në Islam, por kjo bëhet me mënyra të vjetruara të ligjërimit. Po të shfrytëzohej me efikasitet kjo hapësirë e gjerë mediatike, rezultatet në edukimin e besimtarëve dhe të thirrjes së besimtarëve të rinj në Islam, do të mund të ishin impulsive. Ja pse: në universitet, gjatë një viti akademik, në një lëndë, mbahen tridhjetë ligjërata (nga pesëmbëdhjetë në secilin semestër.) Nëpërmjet një numri të tillë ligjëratash studentit i krijohet mundësia të kalojë provimin, pra, i mundësohet të avancojë në rrugën e formimit të vet akademik. Me aq sa kam vënë re, vetëm gjatë Ramazanit, një kanal i vetëm televiziv në Kosovë transmeton më shumë se tridhjetë emisione me intervista me hoxhallarë e dijetarë të besimit islam. Po të ishin këto intervista dhe ligjërata në nivelin e duhur, ato do të ngrinin esencialisht ndër vite njohuritë e besimtarëve për fenë e tyre, por edhe do të shndërroheshin në një nxitës për t'u afruar besimtarë të rinj. Pra, për disa vjet, do të mund të arrihej një efekt i përafërt me atë të tre vite studimesh, e pakta, studime në distancë. Por, me sa kuptoj, nuk ndodh ashtu.

Vit pas viti nga hoxhallarët, në ato emisione, trajtohen tema të njëjta, përsëriten narracione të njëjta, me terma të njëjtë, me monotoni të njëjtë. Madje, disa nga këto ligjërata tingëllojnë shumë monotone, si derset e dikurshme të improvizuara në odat e katundit, prandaj, nuk

mjafton të kesh hapësirë në medie, por puna është si ta shfrytëzosh atë hapësirë me efikasitet, në pajtim me natyrën e saj dhe nevojat e publikut.

Në televizion njësi matëse për reklamim është sekonda, prandaj natyra e televizionit kërkon narracion të shkurtër dhe ekspresiv, të shoqëruar nga imazhe dinamike e jo narracione të gjata e imazhe monotone. Mund të thuhet se komunikimi i hoxhallarëve dhe dijetarëve islamë me publikun, nëpërmjet mediave, është në ekspansion, gjë që gjithsesi është pozitive, por pa u gjetur ende mënyra adekuate e komunikimit, në pajtim jo vetëm me natyrën e mediave, por edhe me pritshmërinë e publikut, i cili sot është krejtësisht i ndryshëm nga publiku i para tridhjetë viteve. Ky publik, i përbërë, në shumicën absolute, nga të rinjtë, është pjesë përbërëse e publikut dhe e rinisë që shfrytëzon arritjet e teknologjisë dhe gëzon favorët që ofron koha postmoderne, në aspektin e afirmimit të lirisë së individit dhe të realizimit të ambicieve të tij. Për këtë arsye, këtij publiku, jo vetëm në media, por as në ligjëratat në xhami, nuk mund t'i flitet me stilin e dikurshëm, me të cilin u është folur baballarëve tanë.

Publiku i sotëm ka dy cilësi krejtësisht të tjera: *e para*, të rinjtë tanë janë shumë të avancuar në komunikim dhe përdorimin e mediave për forma komplekse të komunikimit dhe *e dyta*, kanë informacione alternative

për besimin e vet fetar, të cilat i vjelin nga burime e gjuhë të tjera, pra, nuk mbështeten vetëm në ligjëratat konkrete të hoxhallarëve tanë. Me një fjalë, kërkesat e tyre ndaj ligjëratave e narracioneve, që dëgjojnë nga hoxhallarët tanë, janë shumë më të larta nga sa, realisht, u ofrohen prej tyre. Personalisht kam dëgjuar me dhjetëra herë komente dëshpëruese nga djem të rinj ndaj ligjëratave që mbahen të xhumave nëpër xhami, po edhe ndaj ligjëratave që transmetohen në mediat vizive. Nuk duhet të anashkalohet fakti se Kosova, fjala vjen, ka popullsinë me moshën më të re në Evropë, që do të thotë se kjo popullsi e pranon më shpejt ndryshimin dhe kërkon përshtatje me realitetet e reja teknologjike, kulturore e shoqërore. Pra, jemi në një botë konkrete, e cila ka ndryshuar shumë dhe në të cilën, nëse duam të jemi të suksesshëm në komunikim, përkatësisht në mision, duhet të përshtatemi me realitetin. Sikundër që gjuha në të cilën u flitet njerëzve, duhet të jetë gjuhë të cilën ata e kuptojnë (fjala vjen gjuha shqipe për shqiptarët), po ashtu edhe mënyra e kumtimit duhet t'u përshtatet aftësive të njerëzve konkretë për ta kuptuar, nevojave dhe pritshmërive të tyre. Nëse njerëzve u flitet në një gjuhë të cilën ata nuk e kuptojnë, (fjala vjen, nëse u flitet shqiptarëve në gjuhën mandarine) ata nuk marrin asnjë informacion, asnjë mesazh. Pra, edhe nëse u

kumtohet në mënyrë joadekuate me aftësitë, nevojat dhe pritshmëritë e tyre, është njësoj, sepse ata nuk arrijnë ta marrin informacionin e as mesazhin. Pra, ajo që synohet është që komunikimi i hoxhallarëve dhe dijetarëve të bëhet në mënyrë të tillë që të përshtatet me aftësitë, nevojat dhe pritshmëritë e publikut, ndërsa vetë besimi ynë fetar, në formë të Shpalljes Hyjnore, i tillë ka ardhur dhe është i panegociueshëm. Ai paraqitet gjithmonë ashtu si është, sepse Shpallja paraqet besimin e kornizuar qartë, ndërsa mundësitë e secilit person për ta përqafuar, përjetuar e praktikuar besimin, janë individuale, të veçanta. Natyrisht, mundësitë tona të kufizuara nuk e ndryshojnë aspak kornizën e formësuar nga Shpallja. Ajo mbetet unike, e panegociueshme, ofertë dhe mundësi për secilin, por, prezantimi, interpretimi dhe komunikimi, krahas faktit që duhet të balancohet me aftësitë, nevojat dhe pritshmëritë e publikut, duhet të avancohet edhe në pajtim me mundësitë e teknologjisë dhe të dijes në përgjithësi.

Faktikisht, interpretimet e njerëzve për Shpalljet Hyjnore janë dhe varen edhe më tutje nga gatishmëria dhe kapaciteti i secilit person, nga stadi i zhvillimit kulturor, shkencor e shoqëror, pra varen nga faktorë brendafetarë, por edhe jashtëfetarë. Fjala vjen, një besimtar i sinkertë dhe i ditur në kohën e Ibrahimit (pagja e Zotit

qoftë mbi të), ka mundur të ketë sinqeritet të fortë në besim, por në të njëjtën kohë ka pasur deficit të dijeve në sferat kulturore, shkencore e shoqërore krahasuar me një besimtar të ditëve sotme. Ai stad i kulturës, shkencës dhe shoqërisë, ka mundur ta stimulojë që ai të përqendrohet më shumë në besim, pasi ofertat nga sferat e tjera të jetës kanë qenë të varfra.

Ndërsa në kohën tonë postmoderne, një besimtar i sinqertë dhe i ditur, është nën presionin e madh të dijeve nga fushat e teknologjisë, kulturës, nga shkenca dhe dinamika e jetës shoqërore. Ky lloj presioni, krahas mungesave që mund të ketë në edukimin, mirëfilli, fetar, mund ta shpërqendrojë në raport me besimin fetar, mund t'ia relativizojë pasionin besimor. Në këtë rast, mund të ketë paqartësi edhe mbi interpretimin e Shpalljeve Hyjnore nga ana e tij, sepse ai disponon edhe arritjet në fushat e njohjes e të dijes shkencore, disa prej të cilave janë edhe problematike.

Për këtë arsye, është e domosdoshme që hoxhallarët dhe dijetarët e fesë, krahas respektimit të gjendjes diturore e fetare, në të cilën janë ata që i dëgjojnë/pasojnë, duhet të jenë konkurrues në përdorimin e teknologjisë dhe të komunikimit nëpërmjet medias, në njohjen e arritjeve kulturore e shkencore, njohjen e problemeve shoqërore, për të pasur ndikim

pozitiv mbi publikun/xhematin që është i ekspozuar ndaj paqartësive dhe dilemave.

Nëse këta individë do të arrinin këtë nivel, me punën e tyre ata do të mund të zbusnin presionin psikologjik e kulturor, që ushtrohet në këtë kohë mbi besimtarët, por edhe mbi njerëzit në përgjithësi. Nëse jo, atëherë ata do ta vazhdojnë monologun, por ndikimi i tyre te besimtarët, njerëzit dhe në shoqëri do të vijë duke u zbehur. Do t'u mbetet në publik i paktë, pjesa jokreative dhe jodinamike e xhematit, ata që janë më shumë të prirur drejt rutinës dhe mësimëve dogmatike. Faktikisht, për momentin, raportet e tyre me xhematin, kanë arritur në këtë stad, janë formale, pa ndikim esencial. Thënë thjesht, përdorimi i mënyrave të vjetruara të interpretimit e të thirrjes, të periudhave kur ka qenë një mënyrë tjetër jetese, me të tjera nivele të dijeve shkencore, me struktura të tjera të organizimit të shoqërisë, mund të mos funksionojë. Madje, mënyrat e vjetruara të interpretimit të Shpalljeve Hyjnore, mund të prodhojnë fanatizëm fetar me derivatet e tij, ekstremizmin dhe terrorizmin, ose abstenim nga përpjekja për të pasur një jetë aktive fetare. Pra, duhet pasur parasysh se stadi kulturor dhe shoqëror në të cilin jetojnë njerëzit, u krijon atyre disa mundësi brenda të cilave jetojnë, mendojnë e besojnë. Kjo duhet pasur parasysh e të respektohet fort nga

dijetarët fetarë, nga ata persona që janë të angazhuar për interpretimin e besimit fetar, për organizimin e jetës fetare të besimtarëve, për thirrjen e njerëzve në besimin fetar.

Koha jonë, kjo që quhet gjendja posmoderne, këtë gjë e kërkon edhe më shumë. Është një gjendje kontradiktore në vetvete. Është gjendje e mundësive të shumta të individit, e shpërthimit të pasioneve individuale, e krizave të brendshme të individit, familjes dhe shoqërisë, e krizave të identiteteve, duke përfshirë edhe identitetin kombëtar e fetar. Pra, është një gjendje kontradiktore e kaotike, që, në mënyrë figurative, mund të përfytyrohet me një udhëkryq pa shenja komunikacioni, pa semaforë. Prandaj, gjithsecili duhet të provojë ta gjejë vetë drejtimin e vet. Nëse dikush i vjen në ndihmë, duke i ofruar shërbimin që të gjejë drejtimin e duhur, ai mund të arrijë sukses. Por, për ta arritur atë sukses, vetë ofruesi i shërbimit duhet të jetë i përgatitur dhe ta dijë se në cilat forma ta ofrojë shërbimin e tij.

Kjo metodologji pune, që duhet të realizohet në një gjendje kontradiktore e kaotike kulturore e shoqërore, si në një udhëkryq pa semaforë e pa kurrfarë shenjash, duhet të kihet parasysh e të vlerësohet me prioritet nga hoxhallarët dhe nga dijetarët islamë shqiptarë. Kjo për arsyen e thjeshtë se ne, shqiptarët, ka shekuj që jemi me shumicë myslimane, por jetojmë

në zemër të Evropës, që do të thotë se jetojmë në një ambient ndërmjet besimit fetar islam dhe kulturës evropiane perëndimore. Jetojmë në një kryqëzim rrugësh të besimeve e të civilizimeve. Në këtë ambient tonin shqiptar kanë pasur ndikimin e vet lëvizjet e mëdha fetare, filozofike, artistike, shkencore e shoqërore, që nga Krishterimi i hershëm, shizma e Kishës, Kryqëzatat, Humanizmi e Renesansa (Rilindja), Iluminizmi e Romantizmi e deri te revolucionet politiko-ideologjike të fashizmit e të komunizmit. Në këtë ambient kontradiktor, feja islame dhe vlerat kulturore nuk kanë ecur dorë për dorë, nuk e kanë mëkuar e as mirëkuptuar njëra-tjetrën. Meqë feja islame është trajtuar si e huaj në truallin evropian, të paktën që nga shekujt XII-XV, kur u luftua dhe madje u çrrënjos prezenca dhe sundimi mysliman nga Sicilia e nga Spanja, atëherë është e sigurt se edhe në trojet arbërore-epiro-shqiptare, kjo fe u trajtua si e huaj, që nga fillimi.

E vërteta është se, deri sa jetuan nën Perandorinë Osmane, shumica myslimane e shqiptarëve nuk e kanë ndjerë shumë presionin kulturor të Perëndimit ndaj tyre për shkak të përkatësisë së tyre islame. Fakti që kultivuan letërsi shqipe me alfabet arab, ngritën një jetë sociale urbane me parashenjë islame në shumë qytete shqiptare, është dëshmi se ata për një kohë u ndien komod brenda

besimit të vet, duke krijuar edhe vlera kulturore të vetat, në pajtim me besimin e shumicës. Megjithatë gjendja ka qenë edhe atëherë kontradiktore, në njëfarë shkalle: të krishterët shqiptarë e kishin afnitetin drejt kulturës evropiane, ndërsa, në të njëjtën kohë, e ndienin presionin e fesë islame, ndërsa myslimanët shqiptarë e ndienin njëfarësoj presionin e kulturës evropiane, por në të njëjtën kohë e gëzonin komoditetin e përkatësisë fetare me sunduesin perandorak.

Megjithatë, kur dolën jashtë ombrellës së Perandorisë Osmane, në kuadër të Luftës së Parë Ballkanike (1912-1913), të gjithë shqiptarët së bashku, myslimanë e të krishterë (këta katolikë e ortodoksë) iu ekspozuan gjenocidit të shteteve të krishtera ballkanike, pikërisht me sloganin se po dëboheshin, se po vriteshin myslimanët, që në truallin evropian trajtoheshin si "*corpus alieni – trup i huaj*".

Duke jetuar të diskriminuar në trojet e veta ballkanike-evropiane, ata shqiptarë myslimanë që i mbijetuan gjenocidit të viteve 1912-1913, u detyruan të kalonin nëpër një proces të dhunshëm vërtetizimi (konvertimi përfundimor¹), që në fakt ishte tentativë për deislamizimin e tyre të plotë. Brenda këtij procesi, që është një version i maskuar i Rekonkuistës, u mbitheksua përkatësia kulturore evropiane

1. Shënim i redaksisë.

dhe u minimizua e u injorua në maksimum përkatësia fetare islame e shumicës së shqiptarëve. Vetëm si pasojë e këtij deformimi kulturor-fetar-ideologjik, mundi të fitonte ideologjia komuniste ndër shqiptarë, në vitet dyzet të shekullit XX; kurrësi ndryshe. Po të ishte ruajtur substanca islame në jetën sociale të shumicës së shqiptarëve, po të ishte ruajtur ekuilibri mes besimesh fetare ndër shqiptarë, komunizmi nuk do të kishte triumfuar kurrë. Pra, komunizmi triumfoi si vazhdim i procesit të islamofobisë përkatësisht të deislamizimit të shoqërisë shqiptare, duke e zënë këmbën e vërtetizimit (konvertimit përfundimor) të dhunshëm. Më pas regjimi komunist në Shqipëri tentoi të zbatonte një projekt të çmendur për zhdukjen e të gjitha besimeve fetare në Shqipëri, duke e shpallur Shqipërinë shtetin e parë ateist në botë. Edhe në Jugosllavi pati tentativa për zhdukjen e shqiptarëve dhe të besimit të tyre dominues, atij islam, si përmes konfiskimit të pasurive të komuniteteve fetare, burgosjeve dhe eliminimit të prijësve fetarë, e deri te akordimi i shpërnguljes së shqiptarëve myslimanë në drejtim të Turqisë, e më larg.

Pas gjithë këtyre përvojave të tmerrshme, ku në luftë për çrrënjosjen e Islamit ndër shqiptarë, u përdorën edhe kultura e ideologjia, sot shqiptarët myslimanë janë të hutuar, ndonëse jetojnë në shoqëri ku

është e proklamuar dhe e garantuar liria e besimit të tyre fetar. Duke jetuar në zgrip të ekzistencës biologjike për më shumë se një shekull, shqiptarët myslimanë nuk kanë arritur të krijojnë qëndrueshmërinë e elitave fetare dhe as të ndjekin një interpretim të besimit fetar islam, më të përshtatshëm me realitetin e tyre të dyzuar kulturor e fetar, duke qenë evropianë autoktonë dhe në të njëjtën kohë edhe komb me shumicë myslimane, mu në zemër të truallit evropian. Ky është një rast *sui generis*, vërtet. Tashmë në truallin evropian është edhe një komb me shumicë myslimane, boshnjakët, por për aq sa boshnjakët janë një komb, është një komb i ri, ende në formim dhe madje komb pa shtet të vetin, ndërsa ne shqiptarët, edhe jemi komb më i vjetër, edhe zotërojmë, formalisht, dy shtete në truallin evropian; natyrisht jemi një komb i përbërë nga myslimanë e të krishterë, që kanë konsensus për identitetin dhe vlerat kombëtare. Prandaj, themi se edhe në këtë rast hoxhallarët dhe dijetarët myslimanë ndër shqiptarë, duhet të jenë prijtarë të metodologjisë së interpretimit të Islamit e të thirrjes në Islam, në këtë botë konkrete e komplekse shqiptaro-evropiane, si në aspektin gjeokulturor e gjeopolitik, ku përkatësia definitivisht është brenda Perëndimit, ashtu edhe të frymës postmoderne, që po bëhet mbizotëruese në botëvështrimin kulturor të shqiptarëve të sotëm.

Natyrisht që ekzistojnë edhe modele të tjera kulturore e mënyra të tjera jetese nëpër botë (kineze, indiane, iraniane, etj.), por ato janë të largëta për ne shqiptarët, aq sa, për t'i përvetësuar e praktikuar ato, duhet një lloj azili kulturor e social. Gjeokultura dhe gjeopolitika e kanë vulosur në këtë kontekst fatin tonë kulturor e politik dhe ne nuk kemi pse tentojmë të hyjmë në konflikt me fatin tonë me asnjë lloj azili, me asnjë lloj eksperimentimi. Jemi evropianë, nën ombrellën e NATO-s dhe në vorbullën e rrëmujës kulturore e sociale që provokon globalizmi. Një komb i vogël si yni, nuk ka fuqi që ta ndalojë këtë trend, prandaj i duhet të përshtatet, duke provuar që të ruajë sa më shumë ekuilibrat e vet të brendshëm. Nëse do të kemi sukses në ruajtjen e ekuilibrave të brendshëm, si komb evropian, me shumicë myslimane, ku kultivohet seriozisht harmonia fetare, në ndonjë fazë të mëvonshme të konsolidimit, kombi ynë mbase edhe do të mund të prodhojë vlera mikse kulturore e sociale, nëpërmjet të cilave do të mund të sugjerohej sinteza e vlerave kulturore e sociale e këtyre dy civilizimeve të mëdha, Islamit e Krishterimit.

Ky vizion duket tepër optimist për ta prodhuar një komb si ky yni, por e pamundur nuk është, nëse do t'i frynte në shpinë një erë e fuqishme e koekzistencës paqësore të këtyre dy civilizimeve.

Ne shqiptarët do të mund të ishim shembull i mirë i funksionimit të një kombi, i cili ka brenda vetes në harmoni dy besimet e mëdha fetare, Islamin e Krishterimin, dhe kultivon vlera kulturore e sociale, si një sintezë të harmonisë së vet. Nëse kjo do të arrihej, shqiptarët do të rehabilitoheshin përfundimisht, me një identitet kulturor, social, fetar e nacional pa kontradikta brenda vetes. Hipotetikisht, shansi ekziston. Kjo edhe për arsye se, sikundër është e njohur, në përvojat fetare të shqiptarëve gjatë gjithë këtyre shekujve, interpretimi dominues ka qenë brenda shkollës së moderuar hanefite. Ndonëse pas rënies së regjimeve komuniste, ka pasur oshilacione dhe imponim edhe të interpretimeve më dogmatike e më militante., (s)Suksesi fillestar i shkollave radikale e ka burimin te fakti se, ato shkolla, më së shumti, rekrutuan personat që janë produkt i deislamizimit komunist, por edhe i gjendjes postmoderne, individë familjesh të çmoralizuara, individë të vetmuar, të frustruar e të varfër, pjesëtarë familjesh pa tradita të ngulitura fetare, madje edhe ish narkomanë. Individë të tillë janë të predispozuar për lëvizje ekstreme në jetën e tyre personale, për shkak të dështimeve dhe të paafësisë për të pranuar durimin si botëvështrim esencial islam për jetën. Interpretime të tilla radikale dhe rekrutimet e një numri pjesëtarësh në ato

organizime, u pritën me shqetësim jo vetëm nga shumica e komunitetit mysliman shqiptar, por edhe nga shtetet (Kosova e Shqipëria) dhe nga aleatët strategjikë të shqiptarëve, gjë që përkohësisht e ka frenuar si zhvillim. Për një triumf afatgjatë mbi interpretime të tilla radikale të Islamit ndër shqiptarë, duhet një strategji gjithëpërfshirëse e komunitetit mysliman shqiptar dhe shtetit. Pra, duhet një bashkërendim dhe një qartësi, sepse në procesin e frenimit të kësaj lëvizjeje, ka pasur edhe gabime. Por, tradita e gjatë e Islamit tolerant ndër shqiptarë, paraqet gurthemel të fortë për sukses kundër radikalizmit e ekstremizmit.

Fatkeqësisht, ka pasur edhe tentativa që të shfrytëzohej lufta kundër ekstremizmit, si pretekst për ta rikthyer presionin mbi fenë islame ndër shqiptarë. Kjo, veçanërisht, ka ndodhur në Kosovë. Kësaj radhe e inkurajuar dhe e sponsorizuar nga shtete e agjenci joshitetërore të botës perëndimore e të realizuara nga qeveritë e Kosovës. Por, kjo qasje ishte shumë e gabuar dhe e rrezikshme, sepse ajo mund të ushqente, pikërisht, ekstremizmin. Fatkeqësisht, islamofobia e mëkuar në Perëndim, për të luftuar Islamin në truallin e vet, por edhe në botën myslimane gjithandej, tashmë ka legalizuar, deri në njëfarë mase, terminologjinë dhe masat e veta shtrënguese edhe në Kosovë. Por, ka filluar të japë disa shenja të vogla

se nuk do të radikalizohet më tutje, ndonëse paqartësitë janë pezull. Për këto rreziqe, hoxhallarët dhe dijetarët myslimanë shqiptarë e kanë edhe si mision shtesë që ta bëjnë dominues e të pakonkurrueshëm interpretimin e moderuar të Islamit ndër shqiptarë, që të mos lënë hapësirë, që lufta kundër rasteve e dukurive të ekstremizmit, të shfrytëzohet si pretekst për luftë kundër fesë islame ndër shqiptarë.

Fryma integruese dhe universale e Shpalljes Hyjnore duhet të jetë dominuese në botëvështrimin fetar të shqiptarëve në përgjithësi, sepse tashmë jemi në një botë të globalizuar. Realizimi me sukses i këtij misioni kërkon përgatitje shumë më solide akademike të këtyre njerëzve, në pajtim me traditën dhe me rezultatet e dijeve të verifikuara shkencore, si dhe të vlerave universale kulturore.

Në rastin e shqiptarëve, krahas problemeve që kanë ardhur për shkak të paragjykimëve ndaj myslimanëve në truallin evropian dhe që kanë shkaktuar pasoja të rënda, duhet pasur parasysh edhe një realitet i ri gjeopolitik. Ndryshimet e mëdha gjeopolitike, kulturore e sociale kanë ndikim të ndjeshëm në fatet e kombit shqiptar, pra edhe në mënyrën e të kuptuarit të fesë dhe të praktikimit të saj. Futja nën influencën direkte të SHBA-ve, NATO-s dhe të Bashkimit Evropian, tashmë është fakt i kryer. Shqipëria është anëtare e NATO-s, ndërsa Kosova ka prezencë

ushtarake të NATO-s, me mandat sigurimin e integritetit të saj. Kjo do të ketë efekte të gjata, të shtrira në kohë në gjithë jetën e shqiptarëve, gjë që duhet të analizohet me kujdes edhe nga aspekti i perspektivës së jetës fetare. Brenda kësaj ombrelle gjigande të sigurisë dhe brenda këtij formacioni gjigand kulturor, shqiptarët duhet të fillojnë ta gjejnë veten dhe vendin e tyre të ri.

Pra, jo vetëm koha në të cilën jetojmë, koha postmoderne, por edhe përkatësia gjeopolitike e kulturore e plotë e Perëndimit, duhet të analizohen e të kuptohen sa më realisht. Cila është e ardhmja e identitetit nacional shqiptar në këtë gjendje postmoderne dhe në këtë botë të globalizuar, ku shqiptarët tashmë janë të integruar në NATO e në BE? Cila është e ardhmja e identitetit fetar të myslimanëve shqiptarë, në një botë ku dominon sekularizmi, pluralizmi, konsumerizmi, hedonizmi dhe ku është aktive islamofobia? Si duhet të kultivohen e të mbrohen vlerat identitare, nacionale e fetare, të ekspozuara ndaj presioneve asimiluese dhe neutralizuese? Më e rëndësishmja në këtë mes: njeriu i sotëm shqiptar, ky bartës konkret i këtyre identiteteve, në çfarë gjendje emocionale, intelektuale, ideologjike e fetare është dhe në çfarë gjendje do të jetë në të ardhmen? A është ende në ndonjë fazë të modernizmit, apo është futur tashmë në pellgun e

përjetimit postmodernist të botës, sikundër të qenët nën ombrellën e NATO-s? Këto pyetje nuk kanë ende përgjigje të qarta.

Shqiptarët me fatin e tyre jetësor dhe me dashjen e vet janë brenda kulturës evropiane, janë brenda strukturave perëndimore, por ende nuk e kanë stabilizuar identitetin e tyre në këto realitete të reja kulturore e gjeopolitike. Ende nuk e dinë se a do të mbeten shqiptarë, apo do të lëvizin drejt identitetesh të reja, fjala vjen, kosovarë, që është një projekt mjaft i sponsorizuar. Ende nuk e dinë se a do t'i nënshtrohen ndonjë procesi të konvertimit, për të cilin po ashtu ka projekte nga agjentë të ndryshëm.

Dijetarët që merren me interpretimin e ideologjisë kombëtare, por edhe ata që merren me interpretimin e besimit fetar islam, duhet t'i njohin këto realitete e këto zhvillime, këto tendenca e këto projekte. Ata duhet ta dinë se si duhet të pozicionohen vetë dhe bashkëkombësit e tyre në këto procese. Më konkretisht, ata duhet ta dinë jo vetëm me kë kanë të bëjnë, por edhe kujt po i flasin, sepse ai që i dëgjon, myslimani i sotëm shqiptar, është i ekspozuar edhe ndaj ideve e projekteve të tjera. Audienca e tyre është nën shumë presione dhe në një proces të shpërbërjes permanente, si pasojë e gjendjes postmoderne, në rend të parë. Prandaj, ka rëndësi të madhe mënyra e komunikimit me

shqiptarët dhe besimtarët e sotëm shqiptarë, të cilët janë të traumatizuar nga e kaluara dhe potencialisht të manipuluar nga oferta e tashme në botën postmoderne. Këta shqiptarë dhe këta besimtarë myslimanë, nuk janë më ata të dikurshmit, pjesëtarë të familjeve të mëdha patriarkale, pjesëtarë të fiseve, që kalonin kolektivisht nga një fe në një tjetër. Këta shqiptarë e besimtarë tashmë janë me shumicë absolute individë të hutuar, persona të vetmuar, shumë herë të tjetërsuar në botën e konsumit dhe të hedonizmit agresiv. Këta persona tashmë nuk tërhiqen nga narracione të mëdha për kombin, historinë, besimin. Kujtesa e tyre po vjen duke u tkurrur, në të shumtën e rasteve nuk e kalon kufirin e historive dhe informacioneve të raportuara në mjetet e komunikimit masiv gjatë një dite. Këta persona mund të lexojnë ose të dëgjojnë ndonjë rrëfim, ligjëratë, histori, nëse u serviret në mediat e tyre të preferuara, ose nëse aksidentalisht ndeshin në to. Pra, thirrja tashmë duhet të bëhet mediatike, e jo vetëm në xhami, ose në komunikim privat. Sikundër që tashmë flitet për kulturë mediatike, duhet të flitet edhe për “fe mediatike”, në kuptimin që ajo, hapësirën kryesore të manifestimit, sot e në të ardhmen, e ka në media, në televizione, në portale, në platforma, në blogje, në rrjete sociale. Kjo do të thotë që hoxhallarët e dijetarët, ata që interpretojnë besimin dhe që ftojnë

në besim, duhet të jenë të aftësuar për përdorimin adekuat të medias, për pasimin e përmbajtjeve fetare në media, në pajtim edhe me aftësitë, pritshmërinë dhe mundësinë e këtij publiku (xhemat) të ndryshuar, në këtë botë të ndryshuar. Fjala vjen, në fakultetet e studimeve islame do të duhej të kishte departamente për studimin e marrëdhënieve me publikun dhe për edukimin mediatik. Nga mënyra se si vihen relacionet me publikun dhe nga mënyra si përdoren mediat në këtë komunikim, varet shumë edhe rezultati i thirrjes.

Shqiptarëve të sotëm myslimanë, të cilët janë të përfshirë në mënyrën postmoderniste të përjetimit të botës, nuk mund t'u ofrohet interpretim fetar dhe thirrje me metoda të shekujve të kaluar. Tashmë dominon përjetimi postmodernist i botës, me të gjitha konsekuencat e veta. Prandaj, për rast të veçantë, si ky yni, duhet të ketë edhe metodologji të veçantë të komunikimit fetar, nga ana e hoxhallarëve dhe dijetarëve islamë, nëse synohet suksesi. Disa nga specifikat e përjetimit postmodernist të botës, që duhen pasur para sysh gjatë komunikimit të hoxhallarëve dhe dijetarëve e thirrësve në Islam, janë edhe këto:

1. Shumica e njerëzve sot janë të vetmuar, ose pjesëtarë të familjeve të vogla, me qasje minimale edhe në grupe reale të referimit. Këta persona, prandaj, janë shënjestër shumë e përshtatshme për

komunikim, për thirrje në besim. Puna me grupe të vogla, ku mund të ketë bashkëbisedim, pyetje e përgjigje dhe diskutime kritike, është shumë më efikase sesa puna me grupe të mëdha, ku nuk ka komunikim të dyanshëm e as mundësi të diskutimeve kritike. Suksesi i madh i gazetarisë së revistave, që realizohet si bashkëbisedim intim, në stilin “Një me një” mund të jetë i përshtatshëm për këtë formë komunikimi. Pra, individit, ose grupit të vogël i komunikohen elementë të besimit fetar islam, si bashkëbisedim intim, si bisedë miqësore, si përvojë “mes nesh”. Njeriu i kohës sonë, më të shumtën i mbyllur në vete, i tëhuajësuar dhe në presionin e informacioneve sensacionale dhe të ngjarjeve stresuese, mund të ndihet më i lirshëm në një kontakt të këtillë, në një komunikim më miqësor, më vëllazëror. Ky individ i vetmuar, të cilit i mungon në një masë të madhe familja dhe rrethi i gjerë shoqëror, mund të afrohet më lehtë me informacionet mbi besimin fetar dhe të mirat e tij, me anën e një komunikimi intim, miqësor e vëllazëror. Meqë ai zakonisht është në një krizë latente të identitetit, njëkohësisht është edhe në kërkim të shpjegimeve për gjendjen e tij, si përpjekje për të shpëtuar nga përthellimi i krizave, por edhe si ngushëllim. Nëse i afrohen narracione adekuate me gjendjen dhe pritshmërinë e tij, ky person

mund të koncentrohet e të dëgjojë, gjë që është provë për njeriun e kohës postmoderne, të cilit i mungon durimi që gjërave t'u shkojë deri në fund, ose thjesht të dëgjojë rrëfimet monotone deri në fund. Nëse nuk ka interaktivitet, nëse nuk i jepet mundësia të bëjë pyetje e të shprehet, po lihet që vetëm të dëgjojë, ai thjesht do largohet. Por, nëse i jepet mundësia të shprehet, ai edhe mund të dëgjojë deri në fund, po ashtu me më shumë shans që boshllëku i tij të fillojë të mbushet me narracionin e ri, që natyrisht i duket si një varkë shpëtimi.

2. Interpretimi postmodernist i botës nga ana e dijetarëve perëndimorë, ka rezultuar deri në lëkundjen e bindjes së mëhershme evrocentriste dhe raciste, sipas së cilës kultura perëndimore ishte dominante ndaj të tjerave. Kjo qasje tashmë është e kontestuar dhe realisht e deplasuar nga shumica e dijetarëve perëndimorë. Ky lloj diskutimi mund të përdoret për afirmimin e universalizmit islam, si kundërpeshë ndaj globalizmit me markë evrocentriste. E ardhmja është në komunikimin dhe bashkëjetesën paqësore të kulturave e të besimeve fetare, e jo në dominimin e një kulture e një besimi, duke e imponuar me forcë. Liria e zgjedhjes është e shpallur nga Zoti dhe ajo duhet të respektohet në çdo rast. Edhe përdorimi i disa koncepteve fundamentale të strukturalizmit,

sikundër janë konceptet për “strukturat e thella të arsyes”, që sipas Klod Levi Strosit janë të njëjta te të gjithë njerëzit e te të gjitha racat, qasja tejhistorike, etj., do të ndihmonin në thyerjen e barrierave psikologjike ndaj besimit islam, që të mos përjetohet si besim i huaj, arab, turk, lindor, etj. Lëkundja e këtyre stereotipave të njeriu shqiptar, do të hapte mundësi reale që ai të dëgjojë me kureshtje të rilindur narracione të këndshme për të vërtetën e fesë islame.

3. Fryma postmoderniste e ka relativizuar shumë narracionin për mitologjinë dhe për historinë, për kulturën nacionale, për kombin dhe nacionalizmin, por edhe për besimet fetare. Në këtë rast do të duhej të gjendej mënyra e të ndahej narracioni për fenë nga meganarracionet e tjera. Kjo për arsyen e thjeshtë (se) besimi fetar ka qenë viktimë kryesore e modernizmit dhe e produkteve të tij, meganarracioneve të mitologjisë e historisë kombëtare, të kombit e të nacionalizmit. Besimi fetar në përgjithësi, e feja islame në veçanti, ka pësuar nga agresioni i ideologjive të mëdha imperialiste e nacionaliste. Feja duhet të kërkojë rehabilitimin e vet në hapësirën ku po shpërbëhen këto meganarracione, por, duke u shndërruar në ofertë të lirë, si një narracion ngushëllues e shpëtimtar për njeriun e kësaj kohe, e jo si një ultimatum kërcënues e shantazhues hoxhallarësh, që në jo pak raste

kërcënojnë me ndëshkime e me xhehenem, bukur ngjashëm me priftërinjtë që dikur kërcënonin besimtarët me shkishërim. Duhet të jetë e qartë: ofertat ultimative të fesë nuk pinë ujë në botën postmoderne. Ofertat e reja mund të jenë efikase nëse janë adekuate me gjendjen emocionale, mentale e kulturore të njerëzve dhe nëse ofrohen në atë mënyrë që ta përballojnë me sukses pritshmërinë dyshimtare dhe analizën kritike.

4. Meqë në botën tonë të sotme, këtu në truallin evropian, secili individ e ka mundësinë që të marrë informacione nga më shumë burime dhe nga më shumë se një gjuhë, me anën e mediave dhe internetit, kjo do të thotë se ligjëratat me tematika islame dhe thirrjet në Islam, duhet të jenë të standardeve, që të jenë konkurruese me ofertat e tjera. Nëse ligjëratat dhe thirrjet bëhen me metoda të që u ka kaluar koha, fjala vjen, me emocionalitet të lartë, me mistifikime gjoja filozofiko-fetare, me narracione që nuk gjejnë recipientë, atëherë dështimi është i sigurt, sepse njëra nga tiparet e postmodernizmit është rrënimi i kufijve ndërmjet kulturës elitare dhe asaj masive, ndërmjet elitës dhe masës. Produktet e komunikimit postmodernist janë të përziera, me stil më të thjeshtë, me imazhe efektive dhe pa sforcime emocionale. Njeriu i sotëm tashmë është familjarizuar me këto produkte

në letërsi, në muzikë, në politikë, në media, gjithkund. Nëse thirrja fetare nuk e ka parasysh këtë realitet, ajo mund të hasë në vesh të shurdhër. Dhe nëse moskomunikimi vazhdon më gjatë, pasojat mund të jenë të rënda, ngase tashmë gjeneratat e reja nuk e kanë të rrënjësuar besimin fetar në fëmijëri dhe as identitetin nuk e kanë të ngulitur e të varur nga familja e nga fisi, si në të kaluarën. Mjafton të shkaputet nga besimi një gjeneratë dhe mund të gjendemi në terrenin e një shoqërie ose të një kombi të defetarizuar përkatësisht të deislamizuar. Prandaj, duhet punë më e madhe e hoxhallarëve dhe e dijetarëve myslimanë, që të jenë konkurrues në komunikim, duke pasur në vëmendje këtë publik specifik, e jo të mbeten si relikte të së kaluarës, që ngjallin ose ironi, ose neveri. Rreziku tjetër, e kundërta e deislamizimit, mund të jetë radikalizimi, nën mësimet që njerëzit e rinj shqiptarë mund të marrin nga interneti, përkatësisht nga shkolla të huaja radikale, në mungesë të mësimëve korrekte e të moderuara nga hoxhallarët dhe dijetarët shqiptarë.

5. Tashmë betejat kryesore të të gjitha fushave të aktiviteteve njerëzore po zhvillohen e do të zhvillohen në media. Aftësimi i hoxhallarëve dhe dijetarëve të fesë islame për komunikim në media, me standardet e komunikimit virtual, është domosdoshmëri. Ligjëratat

e gjata bajate në YouTube, në të ardhmen mund të bëjnë më shumë dëm se sa dobi. Prandaj, duhet qasje e re në media, si në mediat tradicionale ashtu edhe në mediet virtuale dhe në rrjetet sociale. Përvoja që pata në dy xhami të kryeqytetit me myezinët, që menjëherë pas ezanit dhe namazit vullnetar nxorën celularët dhe po lexonin a shikonin gjëra në ta, është tregues i qartë. Prandaj, mund të thuhet se mediat janë fushëveprimi i së ardhmes edhe për thirrje në besim. Meqë është kështu, atëherë hoxhallarët dhe dijetarët myslimanë duhet të aftësohen që t'i përdorin mediat për punën fisnike të edukimit dhe të thirrjes në besim dhe të braktisin praktikën e deritashme të ligjëratave të gjata, si përralla, të cilat audienca nuk ka durimin t'i dëgjojë deri në fund. Taktika "Merre ose lëre", të cilën e aplikojnë shumica e hoxhallarëve tanë, është arrogante dhe e dëmshme. Ligjëratat në të ardhmen duhet të jenë të shkurtra, mbresëlënëse, interaktive, me ironizime të lehta për historinë dhe mitologjinë, me citime strikte e pa shumë komente të citateve nga Kur'ani Famëlartë, me shembuj mbresëlënës nga aktualiteti, për t'i afirmuar veprat e mira e për të denoncuar veprimet e dëmshme, etj.

P ë r m b l e d h t a z i :
postmodernizmi me tërësinë e vlerave dhe kundërthënieve të veta filozofike, kulturore, etike, politike e shoqërore, realisht është

shndërruar në një botëvështrim specifik mbi botën në të cilën jetojmë. Meqë në kontinentin tonë është bërë gjithëpërfshirës, duke u bërë simbiotik me globalizmin, pothuajse është e pamundur që besimet fetare, pra edhe besimi islam, të mbetet jashtë ndikimit të tij. Mënyra hedoniste dhe konsumeriste e jetesës, produktet specifike artistike e kulturore, ndikimi i hallakatur i mediave, qëndrimet nihiliste ndaj institucioneve politike e sociale, krizat e identiteteve fetare e nacionale, bëjnë presion direkt mbi psikën dhe besimin e njeriut që jeton në këtë realitet gjeopolitik, kulturor e shoqëror. Prandaj, këtij njeriu vetmitar e të tëhuajësuar bukur shumë, egoist e nihilist, duhet t'i ofrohet një prezantim dhe interpretim i besimit fetar islam, që do të jetë si ofertë e fuqishme ngushëlluese e shpëtimtare. Pra, ofertë e cila nuk e injoron gjendjen reale të tij, ofertë që është dashamirëse e atraktive, që ia tërheq vëmendjen me butësi; që i ndihmon të mos fundoset në batakun e zhgënjimit; që i ofrohet si një varkë shpëtimi.

Gjithsesi botëkuptimi postmodernist për botën tashmë është imponuar dhe po bëhet dominues edhe në mesin e gjeneratave të reja të shqiptarëve. Prandaj, duhet të njihet si botëvështrim e si gjendje, në tërësinë e vlerave dhe të kundërthënieve të tij, nga hoxhallarët e dijetarët

myslimanë, në mënyrë që të jenë efikas në komunikim me publikun (xhematin) që ka prejardhjen nga kjo sferë. Në të kundërt, edhe jeta e tyre fetare do të përfshihet gjithnjë e më shumë nga improvizimet, nga spontaniteti, nga cektësia dhe më vonë nga indiferenca. Ashtu do t'i hapej një mundësi e re deislamizimit

të shqiptarëve, por kësaj radhe jo në rrethanat e terrorit totalitar, si në regjimin komunist, po në rrethanat e lirisë, ku elitat fetare e kanë hequr komunikimin me njerëzit, për shkak të paaftësisë së tyre që të orientohen si duhet në realitetet e reja gjeopolitike, kulturore e shoqërore.

Shkencizmi – Kali Modern i Trojës

Fatos A. Kopliku, M.S.
Washington DC, SHBA

Abstrakt

Sinqeriteti e qëllimet e mira, në vetvete, nuk janë garanci e komunikimit të dobishëm dhe mbrojtja e fjalëve të librave hyjnorë e profetëve nga sulmet me prapavijë materialiste e agnostike nuk mund të bëhet me anë të një shkence e teknologjie si ajo e Perëndimit modern, që adopton një prapavijë filozofike që parimisht s'e njeh, ose edhe e kundërshton Zotin si Burimin prej nga çdo gjë merr ekzistencë e jetë. Njoburitë e sotme shkencore mund të integrohen e interpretohen në një botëvështrim me qendër Hyjnoren, diçka që ka ndodhur me mjaft sukses në të kaluarën, jo vetëm të Islamit, por edhe traditave të tjera autentike religjioze. Shkencizmi, prapavija filozofike e shkencës moderne, është me të vërtetë një Kalë Troje që, kur sillet brenda mureve të fortesës së besimit, përfundimisht, bëhet shkak i dobësimit, në mos shkatërrimit të saj. Nëse me raste vihet re një ton alarmi mes rreshtave të këtij shkrimi ia vlen të kujtojmë se edhe Cassandra nuk i paralajmëroi trojanët me pëshpëritje për gjëmen që Kali i Trojës do të sillte. Kur bie zjarr askujt nuk i mbetet hatri nga tingujt e alarmit apo thirrjet e zjarrfikësve. Megjithatë, krabasimet ndalojnë këtu, sepse ky nuk është as i pari e as i fundit shkrim që tërheq vëmendjen mbi rrezikun e depërtimit të shkencizmit në religjion dhe – ndryshe nga Cassandra, së cilës trojanët s'i vunë vesh dhe e quajtën të çmendur – tanimë ka jo pak autorë myslimanë, e jo vetëm, që kanë filluar me kohë kritikën e botëkuptimit shkencist nga perspektiva intelektuale e shpirtërore tradicionale.

Ky shkrim përqendrohet në dallimin thelbësor mes shkencës dhe shkencizmit dhe argumenton se, në mungesë të ndërgjegjësimit ndaj këtij dallimi, shkencizmi është kthyer në një kalë Troje, që jo rrallë është sjellë me dëshirën e vullnetin e dinjitarëve të fesë brenda mureve të saj. Falë mungesës së kritikës ndaj kësaj prapavije filozofike, që i rri përfund shkencës moderne, ka lindur një vrull e zell për vërtetimin e teksteve të shenjta, duke iu referuar zbulimeve shkencore, shoqëruar ndërkohë nga një neglizhim e mungesë njohurish të interpretimit tradicional të tyre ndër shekuj. Mes shumë pasojave të depërtimit të shkencizmit në fëmijë është shpërbërja e botëkuptimit të normave tradicionale të gdhendura nga hiri hyjnor dhe lindja e përhapja e fundamentalizmit. Në shkrim përqendrohem më shumë te Islami, por ky është një fenomen global dhe paralelet janë aty qoftë për Krishterimin, qoftë për religjionet e tjera.

Kur fizikani Carl Sagan, një nga autorët më popullarizues të shkencës në vitet '80, solli shembullin e dragoit në garazh,¹ përnjëherësh u pa nga shumë skeptikë, agnostikë e ateistë si një nga argumentet më të qarta që demonstrojnë absurditetin e besimit në Zot. Shembulli është ky: Një mik na thotë se ka një dragua në garazh. "Na e trego", i

themi. Shkojmë te shtëpia e tij dhe miku ynë hap garazhin, por është bosh. "Ku është dragoi?", pyesim. Miku na thotë se dragoi është i padukshëm. "Epo mirë", themi, "të hedhim pak pluhur në dysheme të shohim gjurmët". "Dragoi rri në ajër", na e kthen miku. Atëherë ne sugjerojmë të përdorim rreze infra të kuqe të dallojmë nxehtësinë e zjarrit që lëshon dragoi. "Zjarri i tij është i padukshëm e pa nxehtësi?", përgjigjet miku. "Le të përdorim spruco!", themi ne. "Dragoi nuk është material", ia kthen miku... e kështu me radhë. Nuk ka ndryshim, përfundon Sagan-i, mes një dragoi të padukshëm, jomaterial, që lëshon zjarr të padukshëm e jo të nxehtë, dhe një dragoi që s'ekziston fare. Është e natyrshme të çuditemi se pse kaq shumë njerëz të kthjellët e të arsyeshëm ushqejnë iluzione të tilla të ngjashme, shton Sagan-i, pa dyshim duke iu referuar besimeve në Zot.

Të ekspozuar ndaj argumenteve të tilla, jo pak njerëz ose humbin fenë, ose e mbajnë atë, duke hequr dorë nga gjetja e një përgjigjeje të denjë, shpesh duke u mbyllur në një guaskë mbrojtëse, ose përpiqen të ruajnë besimin, duke u përpjekur të tregojnë se librat e tyre të shenjtë konfirmohen nga zbulimet shkencore! Sipas një tjetër fizikani, Wolfgang Smith, kjo s'është për t'u habitur, pasi shumica e njerëzve, përfshirë këtu edhe jo pak shkencëtarë, nuk e bëjnë dallimin

1. Carl Sagan, *The Demon-Haunted World: Science as a Candle in the Dark* (New York: Ballantine, 1996), ff. 169-188. Argument i ngjashëm është ofruar edhe nga Bertrand Russell në vitin 1952.

thelbësor mes shkencës e *shkencizmit*.² Shumë s'janë të vetëdijshëm se kjo e fundit është ideologji bazuar mbi një prapavijë filozofike, e ndërtuar mbi presupozime, të cilave nuk u hetohet vërtetësia – ato merren si të vetëkuptueshme.

Baza mbi të cilin i tërë argumenti i Sagan-it qëndron janë pikërisht dy presupozime tipike shkenciste: *shkenca moderne bazuar në metodën eksperimentale shkencore është qasja që na jep tablonë e vetme të besueshme të realitetit, dhe se gjërat, materia, përbëjnë realitetin*. Këto deklarata nuk janë shkencore pasi ato janë arbitrare; në rastin më të mirë janë presupozime të një botëkuptimi të caktuar filozofik, ose thjesht opinione; nuk ka provë as fakt që i mbështet ato. Ata që sjellin “prova” si të Sagan-it kundër feve, ose nuk janë të ndërgjegjshëm që një qasje e tillë, bazuar mbi metodën shkencore, është krejtësisht e papërshtatshme, ose ky fakt nuk i shqetëson. Me këtë metodë mund t'i mohohen vlerat kollaj filozofisë, letërsisë e poezisë, artit, apo shkencave sociale,³ p.sh., pasi vërtetësia e tyre s'mund të demonstrohet duke u vënë nën mikroskop; as me spruco, me rreze X apo infra të kuqe, as me eksperimente. Ndërsa, me të drejtë, një qasje e tillë nuk shihet si

e vlefshme për letërsinë apo artin, çuditërisht, kur vjen puna te fetë, kërkesa që ato t'u nënshtrohen metodave empirike eksperimentale shihet si legjitime nga disa.

Megjithatë, realitetet për të cilat fetë flasin janë thelbësisht cilësore, jo sasiore. Ashtu si mirësia, bujaria, apo trimëria, ose talentet në art e muzikë, ato s'mund të kapen me rrjetën e metodës shkencore pasi i përkasin një rendi tjetër; është disi sikur të përpiqemi të masim lartësinë e një lisi në gradë Celsius! Sado të perfeksionojmë termometrat ata janë të papërshtatshëm për të matur diçka si lartësia. Sado të përsosim teknologjinë, ajo nuk mund të masë diçka si poezinë, artin, mirësinë, bukurinë... e aq më pak diçka si religjionin. Pretendimi dhe qëndrimi shkencist ngulmon në të kundërtën dhe arrin në përfundimin se, duke iu kthyer shembullit të dragoit të Sagan-it, përderisa ekzistenca e dragoit nuk kapet nga asnjë aparaturë, atëherë me shumë gjasë dragoi nuk ekziston, që mund të ri-frazohet në “përderisa Zoti nuk mund të gjurmohet me asnjë aparaturë, atëherë me shumë gjasë nuk ekziston!”

Duhet pasur parasysh se, dragoi, në shumë kultura, përfaqëson bashkimin e dy natyrave, tokësore dhe qiellore. Shpesh dragonjtë paraqiten si zvarranikë (kafshë tokësore) që kanë krahë e fluturojnë (cilësi e zogjve, ose qiellore), kështu duke qenë simbole të shpirtit (*nefs, anima*) njerëzor, i cili sipas kozmologjisë së

2. Shih Wolfgang Smith, *Science and Myth: What We Are Never Told* (CA: Sophia Perennis, 2010), f. 2.

3. Alan F. Chalmers, *What Is This Thing Called Science?* 3rd ed. (Cambridge: Hackett Pub. Co., 1999), f. 250.

shumë traditave religjioze është diçka e ndërmjetme mes baltës e frymës hyjnore (*ruh, spiritus*).⁴ Pra, në varësi të ngjashmërisë me zvarranikët apo me zogjtë, dragonjtë, në legjenda e mitologji, mund të jenë të mirë ose të ligj, ashtu si shpirtrat e njerëzve mund të jenë të mirë apo jo në bazë të afrisë së tyre me cilësitë e ulëta të tokës apo virtytet e larta të qiellit. Mirëpo Sagan-i e ka sjellë shembullin e besimit në dragonj me qëllim për të demonstruar se s'ka ndryshim nga besimi në Zot. Duke e bërë këtë ai tregon indiferencë ose një mungesë njohjeje qoftë edhe minimale të gjuhës së simboleve, e pranishme kjo në çdo traditë religjioze, ndërsa e trajton simbolin literalisht si një objekt empirik. Kësisoj argumenti i tij nuk refuzon dragoin, si është kuptuar tradicionalisht, por refuzon konceptin e dragoit empirik, diçka me të cilën do të ishte dakord çdo komentues tradicional i një teksti të shenjtë. Në mënyrë të ngjashme, argumenti hedh poshtë ekzistencën e Zotit si realitet empirik, diçka që prapë çdo komentues tradicional do të ishte dakord. Çfarë ata nuk do të ishin dakord është njehsimi i realitetit empirik me vetë Realitetin, me Zotin si të tillë, siç mendon Sagan-i e të tjerë si ai.

Botëkuptimi premodern në

4. Shih René Guénon, *Fundamental Symbols: The Universal Language of Sacred Science*, trans. Alvin Moore Jnr. (Quinta Essentia, 1995); Martin Lings, *Symbol and Archetype: A Study on the Meaning of Existence* (Quinta Essentia, 1991).

përgjithësi, përfshirë atë islam, karakterizohet nga një transparencë metafizike dhe një hierarki e ekzistencës. Realiteti empirik, bota materiale është më e rënda, më e largëta nga Origjina, por çdo gjë në të është thjesht një pasqyrim i zbehtë i realiteteve sipërore, apo qiellore, të cilat janë më afër Realitetit prej të Cilit gjithçka buron, pra vetë Zotit.⁵ Më thjesht mund të thuhet se tokësorja, materia, është botë e dukshme, ndërsa ajo qiellorja e padukshme⁶, e cila është shumë më e madhe e më e vërtetë sesa ajo e dukshme.

Është e njohur historia e arkitektit gjenial, që ndërton një kryevepër pallat ose tempull për një mbret shumë të fuqishëm. Pasi kryhet tempulli, mbreti e vret arkitektin, ose ia pret duart (ka versione të ndryshme të historisë), që ai të mos ndërtojë diçka më madhështore për një tjetër mbret. Mirëpo, sado mizor

5. "Si lart, ashtu edhe poshtë" ose "Si në Qiell ashtu edhe në Tokë" është parim që gjendet edhe në shkrimet hermetike. Shih kreun me titull 'Hermes and the Hermetic Writings in the Islamic World' të Seyyed Hossein Nasr, *Islamic Life and Thought* (NY: State University of New York Press, 1981).

6. Sipas kozmologjisë islame ka një hierarki të botëve të padukshme, diçka që haset edhe në ato të religjioneve të tjera. Shih William C. Chittick, *Shkencë e Kozmosit, Shkencë e Shpirtit: Përshtatsia e Kozmologjisë Islame në Botën Moderne* (Tiranë: Zemra e Traditës, 2011); Seyyed Hossain Nasr, *Introduction Into Islamic Cosmological Doctrines: Conceptions of Nature and Methods Used for Its Study by the Ikhwan al-Safa, al-Biruni, and Ibn Sina*, rev. ed (NY: State University of New York Press, 1993).

veprimi i mbretit, çfarë nënkuptohet është se, ky veprim shtyhej nga bindja se, realiteti i dukshëm, në këtë rast tempulli, sado madhështor qoftë, është më pak real sesa tempulli në mendjen e arkitektit, realiteti i padukshëm. Realiteti i këtij tempulli s'para shterohet, e arkitekti, nëse jepet mundësia, gjithmonë mund të ndërtojë një tempull edhe më madhështor. Me përjashtim të botëkuptimit modern, kjo bindje është e gjithëpranishme në çdo botëkuptim tradicional, pavarësisht nga religjioni që e gdhend.⁷ Sipas kozmologjive tradicionale, përfshirë atë islame, realiteti i padukshëm, i pakapshëm e i paqasshëm nga shqisat, është gjithmonë më real e më i paanë sesa ai i dukshmi, dhe jo e kundërta, siç presupozohet nga Sagan-i në argumentin e tij. Përveç doktrinave të religjioneve, vlen të përmendet se edhe Sokrati i konsideron njohuritë që marrim nga shqisat inferiore dhe jo gjithmonë të qëndrueshme,⁸ diçka që konfirmohet edhe nga shkencëtarë-filozofë sot si Alan F. Chalmers, siç do ta shohim dhe më poshtë, apo fundja edhe nga çdo mjeshtër i arteve marciale të Lindjes së largët.

7. "Qytetërimi modern i Perëndimit shfaqet në histori si një anomali e vërtetë: nga të gjithë qytetërimet që pak a shumë njihen nga ne, ky qytetërim është i vetmi që është zhvilluar përgjatë linjave krejtësisht materiale." René Guénon, *East and West*, trans. Martin Lings (NY: Sophia Perennis, 2001) f. 11.

8. Platoni, *Faedo*, 65.

Për të shpjeguar realitete që ndryshe nga ato sasiorët janë të pamatshme për nga vetë natyra e tyre, shkencizmi i redukton ato në sinjale neuronesh, kombinime molekulash, flukse jonesh... d.m.th. s'ka ndonjë ndryshim thelbësor mes mirësisë e ligësisë, inteligjencës e budallallëkut, bukurisë e shëmtisë; është thjesht çështje organizimi të fijeve indore e metabolizëm qelizash, dyndje enzimash e struktura receptorësh, apo ndryshime të gradientëve molekularë. Doemos shpjegime të tilla reduksioniste janë kritikuar⁹ pasi rrafshojnë çdo dallim cilësor: zhurma e një sharre me korrent dhe simfonia e 9^{të} e Bethovenit nuk mund të reduktohen thjesht në grumbuj tingujsh. Ka pasur të tjerë, si psikiatri Karl Stern, që e kanë konsideruar një pikëpamje të tillë si çmenduri, jo "në kuptimin e sharjes zhargone, por në kuptimin teknik të psikotikut... një pikëpamje e tillë ka shumëçka të përbashkët me aspekte të caktuara të mendimit skizofren".¹⁰

Shkenca dhe Shkencizmi

Ku dallon shkenca nga shkencizmi? Shkenca moderne është një qasje ndaj natyrës, përfshirë edhe

9. Shih p.sh. Arthur Koestler dhe J. R. Smythies (red.), *Beyond Reductionism* (Boston: Beacon, 1971), ose Ernst Friedrich Schumacher, *A Guide for the Perplexed* (New York: Harper and Row, 1977).

10. Karl Stern, *The Flight from Woman* (New York: Farrar, Straus and Giroux, 1965), f. 290.

njeriun, një formë e organizuar dijeje. Fizikani Alan F. Chalmers thotë se sipas konsensusit popullor në media e literaturë ajo bazohet në tre presupozime: (1) faktet janë të identifikueshme nga vëzhgues të kujdesshëm e asnjans, (2) faktet i paraprijnë teorive dhe janë të pavarura prej tyre, (3) faktet përbëjnë një themel të besueshëm për dije shkencore. Aplikimi i *metodës eksperimentale shkencore*, thelbi i të cilit është eksperimenti i kontrolluar, mundëson identifikimin e hipotezave të vërteta nga ato jo të vërteta. Shkencizmi është një botëkuptim, një vijë filozofike, që i konsideron këto pohime si të vërteta absolute dhe shton se metoda eksperimentale e shkencës moderne është qasja që na jep tablonë më të besueshme, në mos të vetmen të besueshme, të realitetit dhe se i gjithë realiteti përbëhet nga materia. Mirëpo, asnjëri nga këto tre pohime nuk mund të mbrohen si shkencore pa u kufizuar dhe modifikuar mirë, na thotë fizikani Chalmers.¹¹ Duhet të nënvizojmë se shumë nga kritikantët ndaj shkencizmit dhe përpjekjet për ta ndarë atë nga shkenca kanë ardhur nga vetë shkencëtarët, rasti i fizikanit Chalmers është një prej tyre.

Le të ndalemi te presupozimet duke filluar nga i pari: *faktet janë të identifikueshme nga vëzhgues të kujdesshëm e asnjans*. Që ky pohim të jetë i saktë

duhet të modifikohet më tej duke shtuar se njohuritë prapavijë janë thelbësore. Një student mjekësie në vitin e parë, sado i kujdesshëm të jetë, do të vërejë më *pak* fakte në diagnozën e një pacienti të dhënë sesa pas pesë vitesh studim, qoftë ajo edhe e njëjta diagnozë. Jo se faktet janë shtuar, por prapavija e njohurive të studentit tashmë është rritur. Nuk është pra thjesht çështje interpretimesh të ndryshme nga këndvështrime të ndryshme dhe vëzhgimi të imtë të fakteve. Kjo vlen jo vetëm për shkencën e mjekësisë; p.sh., sado imtë të vëzhgojë një njeri i zakonshëm, ai zor se është i aftë të dallojë vlerën e vërtetë mes disa gurëve të çmuar – patjetër duhet një argjendar me përvojën e njohurinë e duhur.

I kthehemi presupozimit të dytë: *faktet i paraprijnë teorive dhe janë të pavarura prej tyre*. Edhe ky pohim ka nevojë për modifikim që të mund të mbrohet. P.sh., nëse themi se ndryshimi mes ADN-së dhe ARN-së qëndron në faktin se molekula e parë ka strukturë në formë gërsheti (*double-helix model*) dhe ka monomerin timinë si pjesë përbërëse, ndërsa e dyta ka strukturë lineare dhe ka uracilin në vend të timinës – këto fakte nuk kanë domethënie jashtë konteksti, në këtë rast biologjisë molekulare. Pa njohur mirë këtë disiplinë, fakte të ngjashme as mund të identifikohen e as konfirmohen. Ia vlen të përmendet edhe një tjetër shembull: në vitin 1774 Joseph Priestley

11. Shih Chalmers, *What is this thing called Science?*, kreu I; Huston Smith, *Why Religion Matters: The Fate of Human Spirit in an Age of Disbelief* (HarperCollins, 2009), kreu IV.

në kushte eksperimentale nxehu oksidin e kuq të merkurit dhe izoloi një gaz që sot e quajmë “oksigen”. Por, as vetë Priestley nuk e “dinte” këtë; ai thjesht kishte zbuluar “ajër të deflogjistonuar”,¹² sipas teorisë që mbizotëronte në atë kohë. Për zbulimin e oksigjenit, izolimi i gazit në epruvetë që i pamjaftueshëm. Duhej një teori e përshtatshme, në bazë të së cilës ky fakt mund të identifikohet dhe interpretohet; disa vite më pas Lavoisier-i ndërtoi një teori të tillë dhe vetëm atëherë oksigjeni u bë një “fakt shkencor”. Konteksti s’është i domosdoshëm veç për teoritë shkencore: një term i thjeshtë si “*arbitri dha 11-metërsb*” s’do kishte kuptim në vitet 1700 p.sh., kur s’kishte lindur akoma futbollli, ose në një lojë tenisi. Një fakt i tillë ka domethënie vetëm nëse është brenda kontekstit përkatës, në këtë rast një lojë futbollli, e cila vjen me rregullat e terminologjinë e vet. Si rrjedhojë, kushti i grumbullimit të fakteve për formulimin e teorisë është i pamundur të përmbushet, përkundrazi, mund të themi se faktet e vëzhgimet shkencore mund të formulohen dhe kanë kuptim vetëm në kontekstin e prapavijës disiplinore e teorike.

Presupozimi i tretë thotë: *faktet përbejnë një themel të besueshëm për dije shkencore, ose se shkencë bazohet*

në fakte. Pohime të tilla krijojnë përshtypjen se faktet rriten në pemë e presin veç shkencëtarët që t’i vjelin. Mirëpo s’është aq e thjeshtë. Edhe ky presupozim duhet modifikuar pasi ekzistojnë plot shembuj që dëshmojnë të kundërtën. “Toka është e palëvizshme” është një fakt që mbështetet nga vëzhgimet, thotë Chalmers. Por nuk ndodh që nëse kërcejmë toka të na rrëshqasë nën këmbë. Sot e dimë se toka rrotullohet rreth vetes e rreth diellit, pavarësisht se ne nuk e vëzhgojmë apo përjetojmë diçka të tillë. Në fakt themi e do të vazhdojmë të themi se “lind e perëndon dielli”, sepse është lëvizjen e diellit që përjetojmë, jo të tokës që rrotullohet rreth diellit. Është prapavija e njohurive, në këtë rast teoria e inercisë, ajo që na mundëson gjykimin nëse vëzhgimet tona, si “toka nuk lëviz”, janë të vlefshme. Me një fjalë faktet nuk mund të jenë vetvetiu themele të dijes shkencore; ato janë gjithmonë të mbarsura me një teori e botëkuptim të caktuar.

Është e qartë se asnjëra nga presupozimet bazë shkenciste nuk qëndrojnë të formuluar në atë mënyrë. Megjithatë joshja e botëkuptimi shkencist, me parulla si “shkenca bazohet në fakte”, qëndron te siguria që u ofron njerëzve, nënkuptuar nga palëkundshmëria e fakteve dhe e shkencës që i interpreton ato. Shkencizmi nuk premtim shpëtim, siç do ta formulonte një teolog, por

12. Shih Smith, *Science and Myth*, f. 8. Sipas teorisë së flogjistonit, formuluar rreth vitit 1667 nga Johann Joachim Becher dhe Georg Ernest Rahl, ai ishte elementi që çlirohet nga djegia.

ofron një të ardhme ku shkenca ka zgjidhur çdo problem dhe njerëzit jetojnë në paqe të plotë. Kjo nuk është përveçse aspirata vertikale për parajsën e kthyer në një shpresë horizontale për një shoqëri utopike. Opinione të tilla të rehatshme mund të mbahen vetëm në mungesën e plotë të çdo lloj përpjekjeje për t'u verifikuar vlefshmërinë presupozimeve e pretendimeve të tilla. Kjo mungesë pikëpyetjesh e përpjekjesh është e mundur ngase shkencizmi është i gjithëpranishëm në media e arsim, duke gdhendur, në mos imponuar, një botëkuptim ku postulatet shkenciste nuk vihen në dyshim. Në mënyrë paradoksale kjo mungesë është e përbashkët ndër shumë ateistë, agnostikë, e popullarizues të shkencës nga njëra anë, edhe mes jo pak klerikëve e besimtarëve të feve të ndryshme nga ana tjetër. Të dyja palët presupozimet shkenciste i marrin si të mirëqena; të dyja palët në shkallë të ndryshme, me ose pa vetëdije, ndajnë botëkuptimin shkencist.

Natyre apo Model i Natyrës?

Ndërkohë nënvizojmë se autori vetë ka vite përvojë në kërkime shkencore në gjenetikë e biologji molekulare dhe synimi i shkrimit nuk është kritikë ndaj shkencës si e tillë – ajo ka vendin, aplikimet dhe kufijtë e saj – por ndaj shkencizmit si botëkuptim e prapavijë filozofike: shkenca dhe shkencizmi nuk janë e

njëjta gjë. Dikush mund të dyshojë nëse një kritikë e tillë ia vlen. Mirëpo pasojat e neglizhimit të një kritike të tillë kanë qenë, e mbesin, serioze jo vetëm për fetë e besimtarët, por për njerëzimin – qoftë në rang individual apo shoqëror.¹³ Mes shumë autorëve që kanë shkruar mbi shkencizmin, veçojmë historianin më të madh amerikan të religjioneve, Huston Smith (v. 2016), i cili e konsideronte gjendjen aq serioze saqë emëroi veten, jo pa humor, si qen roje ndaj shkencizmit.¹⁴ Në veçanti për fetë depërtimi i mendësisë së shkencizmit është atrofizues, siç rrëfen më poshtë autori Titus Burckhardt:

Së fundmi, m'u dha rasti të bisedoja me një nga përfaqësuesit më të shquar të kulturës islame në qytetin e lashtë të Fezit. Ruajtës besnik i urtisë tradicionale, i zoti në shkencat e së jashtmes (*el-dhahir*) dhe së brendmes (*el-batin*), aristokrat në gjak dhe shpirt, dinjitoz e gati madhështor në mantelin e tij të bardhë, ai s'i hëngri fjalët teksa më tregoi se si e shihte mendësinë e bashkëkohësve:

“S’ka dyshim se njerëz të devotshëm, soditës e madje eulijā’ të vërtetë ekzistojnë akoma,

13. Shih Fatos A. Kopliku, A na duhet më feja?, *Zani i Naltë*, nr. 12, ff. 18-35 (2015); Sejfid Husein Nasr, *Njeriu dhe natyra, kriza shpirtërore e njeriut modern*, shqip. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2013); Bryan Appleyard, *Understanding the Present: Science and the Soul of Modern Man* (NY: Anchor Pub., 1994).

14. Smith, *Why Religion Matters*, f. 66.

sepse Pejgamberi ka thënë që, në bashkësinë e tij, do të ketë edhe sot një bërthamë njerëzish të përndritur. Por, sa për atë që e quajmë kulturë islame, të them të drejtën një gjë e tillë nuk ekziston më në këtë vend.” Natyrisht, ai po ekzagjeronte, ngase vetë prania e tij vërtetonte të kundërtën. “Si ka ndodhur kjo?” - e pyeta. “Avionët na i kanë nënshtruar mendjet”, - m’u përgjigj ai, me buzë në gaz.

Ai po shihte qartë; mirëpo ky kapitullim i kulturave tradicionale karshi teknologjisë moderne nuk kufizohet si dukuri te bota islame; ai është i përgjithshëm dhe duket më sheshit në vendet e krishtera, ku po gërryen vetë fenë. Çdo ditë bëhemi palë e ndonjë kompromisi të ri, një lëshimi të ri nga dinjitarët kishtarë “për t’iu hapur” botës moderne, diçkaje thelbësisht agnostike dhe praktikisht antifetare. Shkenca që shpiku makinerinë gëzon prestigj aq të jashtëzakonshëm, saqë shumë joshen në të pranuarit se është e drejtë, madje edhe në fushat ku ajo mbetet qartësisht jokompetente. Është pikërisht sikur ajo të ketë zaptuar çdo mendim objektiv që mund të ketë njeriu modern, duke i lejuar kampit tjetër - fetarit - vetëm argumentin e besimit të vet subjektiv.¹⁵

Me fjalët “avionët na i kanë nënshtruar mendjet” urtari maroken

shumë qartë i bën një diagnozë mentalitetit të bashkëkohësve të tij, diagnozë e vlefshme në fakt për pothuajse çdo popull e bashkësi që është përballur me shkencën moderne. Kjo e fundit gëzon shumë prestigj sot, por burimi i këtij prestigji nuk është se doemos na ofron një tablo më besnike të botës, por falë teknologjisë moderne, falë aplikimeve të saj, falë “avionëve”.¹⁶ Dikush mund të protestojë se shkenca moderne vërtet na jep tablo më besnike të botës ose natyrës se një apo dhjetë shekuj para. Një qëndrim i tillë anashkalon ose s’e bën fare dallimin mes natyrës dhe modeleve të saj që shkenca ofron; ajo nuk na jep një tablo të mirëfilltë të realitetit. Fizikani Stephen Hawking e shpreh qartë: “[s]ipas nesh, nuk ka tablo ose koncept të realitetit të pavarur nga teoria. Në vend të saj adoptojmë atë çka quajmë realizëm model-bazuar: ideja që një teori fizike ose tablo e botës është një model (përgjithësisht i një natyre matematikore) dhe një komplet rregullash që bashkojnë elementet e modelit me vëzhgimet. Sipas realizmit model-bazuar, s’ka kuptim pyetja nëse modeli është i vërtetë, por vetëm nëse përputhet me vëzhgimin”.¹⁷ Kujtojmë se, edhe

16. Për një diskutim të gjerë të efektit të teknologjisë në botën islame shih Sejjid Husein Nasr *në bisedë* me Muzaffer Ikbali, *Islami, Shkenca, Muslimanët dhe Teknologjia*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2010).

17. The (Elusive) Theory of Everything. Stephen Hawking, Leonard Mlodinov në

15. Parathënie nga Titus Burckhardt për librin *Ideale dhe Realitete të Islamit*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2010) nga Sejjid Husein Nasr.

modeli gjeocentrik përputhet me vëzhgimin e përvojën tonë në tokë, por kjo nuk e bën atë të vërtetë, në kuptimin absolut. Çuditërisht, teoritë moderne shkencore shihen e trajtohen si absolute nga shumë njerëz meqë përputhen me vëzhgimet e faktet, duke harruar se këto të fundit nuk mund të interpretojnë vetveten, por interpretohen gjithmonë në varësi të modelit ose botëvështrimit në fjalë.

Ky botëvështrim shkencor i latuar nga mekanizmi Njutonian është kritikuar me kohë, dhe ia vlen të përmendim kritikën e Johann Wolfgang Goethe-s, i cili shkencën e shihte si diçka thelbësisht cilësore, një *theoria* në kuptimin origjinal, që do të thotë “pamje” e jo formulim abstrakt apo model matematikor. Sipas tij, kjo shkencë ofronte një dije intuitive që përfitohej nga soditja e objektit ose dukurisë në fjalë, pasi ajo është e mbarsur me kuptim.¹⁸ Mund të thuhet se ai e shihte një dukuri si shenjë, *ajeh* ose *vestigia Dei*, nëse përdorim terma islame e të krishtera. Goethe refuzoi ta reduktojë dukurinë në mekanizëm, sepse për të dukuria ose objekti nuk është thjesht shuma e pjesëve, qëndrim ky i mekanizmit Njutonian, baza e botëkuptimit të shkencës moderne. Ai madje thotë se ky botëkuptim na pengon të kuptuarit e vërtetë të natyrës, diçka që e shpreh edhe në

vargjet e Faust-it: *Mister i gjallë me dritë e diell / natyra është, s’lejon kush ta zhbulojë / me e detyrue s’ka levë as vidhë / t’ma hapë çka ajo don të ma mbulojë*,¹⁹ ku “levat” e “vidhat” janë aplikimet e teknologjisë që burojnë nga botëkuptimi mekanistik i bazuar në modele. Nëse mund ta thjeshtojmë, Goethe thotë se përparësi ka njohja e pozicionit të akrepave të orës për të kuptuar kohën, qëndrimi mekanistik ngulmon se rëndësia qëndron tek ingranazhet e zemrekut të sahatit, aq sa, në ekstrem, thotë se vendosja e akrepave s’ka kuptim, sepse diçka si ora s’ekziston fare. E sollëm shembullin e Goethe-s, sepse botëkuptimi i tij është i ngjashëm me atë tradicional islam, të krishterë, e çdo qytetërimi botëror të lindur e rritur nga një shpallje hyjnore, pavarësisht vendit e kohës.

Assesi nuk po nënkuptojmë se i duhet kthyer shpina shkencave e njohurive moderne si fizika, kimia, biologjia e me radhë. Qytetërimi islam, që herët në ngjizjen e vet, integroi njohuritë e grekëve e egjiptianëve të lashtë, sabejve, persëve, indianëve në një botëkuptim të gdhendur sipas parimeve që rrjedhin nga *tenhidi*. Ndryshe nga ç’mendojnë akoma disa, Islami nuk qe thjesht një urë mbi të cilën dituria e antikitetit kaloi në Evropën e Mesjetës, pasi, siç thotë një studiues, “asnjë ide, teori, ose doktrinë nuk hyri në kështjellën e mendimit islam

The Scientific American, vol. 303, no. 4, ff. 68-71, October 2010.

18. Shih Smith, *Science and Myth*, ff. 163-169.

19. Johann Wolfgang Goethe, *Fausti*, shqip. Pashk Gjeçi (Tiranë: Çabej, 2008), pjesa I.

pa u myslimanizuar më përpara...”, e çfarëdo që s’mund të përputhej me botëkuptimin islam “u largua nga arena e jetës intelektuale islame ose u shty krejtësisht në periferi të tablosë së shkencave islame”.²⁰ Është e mundur, në mos detyrë, që shkencat e teknologjia perëndimore të përvetësohet, pavarësisht nevojave politike e ekonomike, jo verbërisht siç ka ndodhur e ndodh akoma, por duke u shqyrtuar e filtruar në bazë të një botëvështrimi të mirëfilltë të nxjerrë nga tradita e stërpsur intelektuale e Islamit.²¹ Hapi i parë është dhe mbetet kritika thelbësore e shkencës moderne e prapavijës së saj filozofike – përfshirë idetë e “izmat” e importuara nga Perëndimi modern, shpesh të pagëzuara si ‘islame’ falë interpretimeve jashtë konteksti të Kur’anit – nga këndvështrimi universal islam.²² Theksojmë

ndërkohë se ka një lidhje direkte mes depërtimit të shkencizmit dhe rritjes së ekstremizmit, temë kjo që kërkon shtjellim në vetë.²³

Të kesh opinion të mirë për Zotin

Sa përkohë në të vërtetë modelet e shkencës me natyrën? Kjo s’është pyetje që bëhet shpesh pikërisht ngaqë “avionët na i kanë nënshtruar mendjet” – teknologjia na ka hipnotizuar. Meqë fizikanët, inxhinierët e biologët e sotëm na kanë dhënë një mori aparaturash e ndërtesash të mahnitshme, atëherë çfarëdo që na thonë për botën duhet të jetë e saktë. Mirëpo nëse do të ishte e vërtetë nuk do të kishim herë pas here zëvendësim apo riciklim të teorive. Kjo s’do të thotë se shkencëtarët e inxhinierët flasin gjeputa, por thjesht se modelet e teoritë, që ata kanë për strukturën e natyrës dhe mënyrën si funksionon ajo, janë e mbesin modele, dhe jo rrallë kanë pasaktësi. Lind pyetja se si është e mundur që avionët

20. Seyyed Hossain Nasr, *Islamic Science: An Illustrated Study* (World of Islam Festival Pub. Co., 1976), f. 9.

21. Shih Nasr, *Islami, Shkencat, Muslimanët dhe Teknologjia*, kreu VII.

22. Të shihet Titus Burckhardt, *Mirror of the Intellect*; Osman Bakar, *Tawhid and Science, Essays on the History and Philosophy of Islamic Science* (Kuala Lumpur: Secretariat for Islamic Philosophy and Science, 1991); nga S. H. Nasr shih *Njeriu dhe natyra, kriza shpirtërore e njeriut modern, Islamic Science: An Illustrated Study, The Need for a Sacred Science* (NY: State University of New York Press, 1993); shih revistën gjysëmjetore *Islam & Science*, red. Muzaffar Iqbal; dhe Rais Ahmad, S. Naseem Ahmad (red.), *Quest for New Science* (Aligarh: Center for Studies in Science, 1984). Po ashtu veprat e filozofit Sejjid Muhammed Nakib el-Attas,

veçanërisht *The Positive Aspects of Tasawwuf: Preliminary Thoughts on an Islamic Philosophy of Science* (Kuala Lumpur: Islamic Academy of Science, 1981).

23. Të shihet Joseph E. B. Lumbard (ed.), *Islami, Fundamentalizmi dhe Traditimi i Traditës*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Shkup: Logos-A, 2016); Diego Gambetta, Steffen Hertog, *Engineers of Jihad: The Curious Connection Between Violent Extremism and Education* (NJ: Princeton University Press, 2016).

fluturojnë, aparaturat funksionojnë e ndërtesat të qëndrojnë nëse teoritë shkencore nuk janë pa të meta. Kjo do të ishte pyetje e shtruar jo mirë pasi nuk njih dallim mes teknologjisë e shkencës, e për shumë njerëz në fakt ato konsiderohen e njëjta gjë.

Piramidat e Egjiptit ose ato të Meksikës, p.sh., përveç se maja të arkitekturës së njerëzimit, janë kryevepra nga pikëpamja teknologjike, aq sa edhe me teknologjinë e sotme prapë nuk mund të ndërtojmë vepra të tilla. Teknologjia e egjiptianëve dhe majave e aztekëve të lashtë ishte e bazuar në shkencat e lashta të atyre qytetërimeve, të cilat kishin një botëkuptim thelbësisht të ndryshëm nga ai i shkencës moderne. Zakonisht sot i shohim teoritë e modelet shkencore të qytetërimeve premoderne si të mangëta, ose të pasakta, por mrekullohemi me arritjet e tyre. D.m.th., e ndajmë kollaj teknologjinë që përdorën nga botëkuptimi shkencor që ata kishin. Këtë ndarje çuditërisht nuk e bëjmë me teknologjinë e shkencës moderne, dhe falë arritjeve teknologjike shkenca moderne përfton një prestigj të padiskutueshëm, dhe po çuditërisht shkencave të lashtësisë s'i jepet ndonjë meritë pavarësisht arritjeve të tyre teknologjike. Nëse suksesi i teknologjisë sot shihet si provë e vërtetësisë së botëkuptimit të shkencës përkatëse, atëherë, sipas kësaj vije logjike, duhet t'i shohim shkencat e lashtësisë si të vërteta

në sajë të suksesit të teknologjisë së tyre. Ndërsa nuk ngurrojmë t'ia atribuojmë suksesin e teknologjisë shkencës moderne, çuditërisht nuk i njohim shumë merita shkencave të lashtësisë për arritjet teknologjike të tyre, jo pak prej të cilave nuk i kemi kuptuar e arritur akoma; fjala bie si u ndërtuan piramidat e Egjiptit apo qytete si Machu Pichu në Peru. Ky është qëndrim arbitrar e jo objektiv; aq gjë duhet të jetë e qartë.

Të hipnotizuar nga teknologjitë, pasuar nga një kompleks inferioriteti, e pjesërisht për të shmangur akuzat se feja nuk është në kundërshtim me shkencën moderne, disa klerikë e besimtarë jo vetëm që nuk kanë ngurruar, por kanë ngulmuar t'u drejtohen zbulimeve shkencore si prova për librat e shenjtë.²⁴ Në fakt, ka pasur një përhapje të një literature të tillë në botën islame, ku veçanërisht është shumë i njohur libri i Dr. Maurice Bucaille-it, *Bibla, Kur'ani dhe Shkenca*.²⁵ Në përfundim të librit, Dr. Bucaille e pranon Kur'anin dhe refuzon Biblën si fjalë hyjnore bazuar mbi përputhjen e tyre me faktet shkencore. Silogizma ndjek

24. Shih esenë 'Komenti shkencor mbi Kuranin' nga Muzzafar Iqbal në *Study Quran: A New Translation and Commentary*, S. H. Nasr (ed. in chief), C. K. Dagli, M. M. Dakake, J. E. B. Lumbard, (gen. ed.); M. Rustom (as. ed.), (NY: HarperCollins, 2015), ff. 1680-1693.

25. Maurice Bucaille, *The Bible, The Qur'an, and Science: The Holy Scriptures Examined in the Light of Modern Knowledge*, tr. Alastair D. Pannell (IL: Kazi Pub, 2003), botuar fillimisht në frëngjisht në vitin 1976.

këtë trajektore: (1) shkenca është e vërtetë, (2) Kur'ani përputhet me shkencën, (3) atëherë Kur'ani është i vërtetë. Kjo nuk është mënyra se si literatura klasike e tradicionale myslimane në shekuj i është qasur Librit Hyjnor, në fakt krejt e kundërta. Ky është qëndrim në thelb shkencist, sepse merr si absolute faktet shkencore, ndërsa neglizhon krejtësisht ekzgjegizat tradicionale të shkrimeve të shenjta të të dy feve.

Me pak kujdes problemi bëhet i qartë pa filluar mirë. Në çastin kur dikush thotë se “edhe shkenca e ka vërtetuar” këtë varg biblik apo kur'anor, në atë çast ai ose ajo ka nënkuptuar shkencën si realitet absolut e të padiskutueshëm, dhe duke iu referuar asaj si të këtillë kërkon të vërtetojë mesazhet e shkrimeve të shenjta e të profetëve. Por të qenët absolut është diçka që myslimanët, e besimtarët e çdo feje në përgjithësi, tradicionalisht e kanë rezervuar ekskluzivisht për Zotin, jo për shkencën, teoritë e paradigmën e së cilës ndryshojnë, ose hidhen poshtë e zëvendësohen, herë pas here.²⁶ Absurditeti i një situatë të tillë qëndron në faktin se kërkohet

të vërtetohet mesazhi i librave e të dërguarve të Zotit, që është Realitet Absolut, me anë të një realiteti jo të tillë, shkencës. Me ose pa vetëdije, në atë çast besimtari apo kleriku e trajton shkencën si realitet më vete, të pavarur prej Zotit. Me terma islamë kjo quhet *shirk*, që do të thotë “të bashkëndash, të bësh dikë pjesëtar, t'i bësh dikujt partner”.²⁷ *Shirku* i hapët, adhurimi i idhujve fizikë, kurohet relativisht kollaj, kurse *shirku* i fshehur – në këtë rast, trajtimi i realiteteve fragmentare të shkencës si absolute – është shumë më i vështirë të pikaset e të ndreqet. Këtu sfida qëndron se si të sillen, jo veprimet, por mendimet në pajtim me *teuhidin*, diçka që pengohet nga zelli për “fakte” shkencore, simptomë kjo e depërtimit të mentalitetit shkencist. Në librin *Vizioni i Islamit*, prof. Murata dhe prof. Chittick e përmbledhin situatën me këto fjalë: “Njerëzit nuk mund ta aktualizojnë formën e tyre hyjnore dhe do të bien në *shirk*, në shkallën që vëmendja e tyre largohet nga Fjala Hyjnore”.²⁸

Tendenca për të sjellë “fakte shkencore” në mbrojtje të fesë vazhdon edhe kur njohuritë në lidhje me disiplinën në fjalë janë të kufizuara. Shkrime e kumtesa të tilla nuk janë sporadike, por fatkeqësisht periodike, e duhet të trajtohen kryesisht si fenomene sesa si problem i një autori, gazete, apo

26. Njohuritë minimale mbi zhvillimet e historinë e shkencës moderne katër shekujt e fundit mjaftojnë për të hedhur dritë mbi natyrën e shkencës e teoritë shkencore që ndryshojnë e zëvendësohen herë pas here. Shih veprën tashmë klasike nga Thomas Kuhn, *The Nature of Scientific Revolution* (University of Chicago Press, 1962), ku trajtohen zhvendosjet e paradigmave shkencore në disiplina të ndryshme.

27. Sachiko Murata, William C. Chittick, *Vizioni i Islamit*, shqip. Sokrat Ahmataj (Tiranë: Albpaper, 2008), f. 113.

28. *Po aty*, f. 407.

libri të vetëm. Prandaj e shohim si pavend adresimin me citat specifik në këtë rast, pasi do të ishte e ashpër, në mos e padrejtë, një kritikë e një besimtari të singertë që zgjedh ta mbrojë Librin e besimin e vet në këtë mënyrë. Në njërin prej tyre thuhej se shkencëtarët kishin zbuluar se toka prodhon antibiotikë, që do të thotë është e pastër – fakt ky që mbështet një thënie të Profetit se toka i është bërë truall për adhurim dhe për pastrim!²⁹ Por, një argument i tillë nuk qëndron. Antibiotikët janë mjaft efikasë ndaj baktereve pasi u shkatërrojnë muret qelizore ose u bllokojnë metabolizmin, por mbi 99% e baktereve nuk shkaktajnë infeksione, përkundrazi, ato janë të dobishme, madje të domosdoshme për jetën e njerëzve,³⁰ kafshëve, bimëve, e vetë tokës. Një tokë pa baktere nuk mund të marrë “frymë”, ajo do të “asfiksohej”. Cikli i azotit, pa të cilin jeta në tokë, siç e dimë, nuk do të ekzistonte, do të reduktohej shumë, në rastin më të mirë, ose do të ndalonte fare. Kjo ngaqë gazi i azotit fiksohet kryesisht nga baktere (*rhizobia*) që jetojnë në rrënjët e disa bimëve, të cilat nëse

do të zhdukeshin nga antibiotikët e tokës, siç pretendohet në shkrim, do të pamundësonin fiksimin e azotit nga gjendja gazore, parakushti për transformimin e integrimin e tij në lëndë organike. Megjithatë, zelli për të “vërtetuar” thënien e Profetit mbi pastërtinë e tokës duket se ka triumfuar mbi shqetësimin minimal të autorit në lidhje me vlefshmërinë e fakteve, përfshirë edhe ngatërrimin në mendjen e tij të pastërtisë me sterilitetin.

Deri diku ky zell për të gjetur mbështetje në shkencë është i kuptueshëm pasi ajo ka prestigj e autoritet të padiskutueshëm sot, dhe natyrisht që jo vetëm bota akademike, por deri edhe industritë e reklamave, e përdorin shkencën për të bindur klientët për superioritetin e origjinalitetin e produkteve të tyre.³¹ Por ky zell, para se të ushtrohet, duhet të gjykohej nga kriteret e parimeve islame³² (në rastin e Kur’anit) sepse Fjala Hyjnore nuk është në rangun e produkteve që ka nevojë të shitet duke bindur myshterinjtë e mundshëm. Dijetarët myslimanë, në veçanti, e kanë parë Kur’anin si kriterin me të cilin kanë gjykuar vlefshmërinë e diturive në fusha nga më të ndryshmet; në fakt një nga emrat e Kur’anit është

29. *Sahib al-Bukhārī*, 335.

30. Njerëzit përdorin antibiotikë për të luftuar infeksione bakteriale, dhe çdo mjek e di se antibiotikët do të zhdukin të gjithë bakteret në trup, të dobishmit e të dëmshmit bashkë. Pas trajtimit me antibiotikë pacientëve u dobësohet sistemi imunitar pikërisht pasi bakteret e dobishme janë eliminuar, dhe kjo është periudhë kritike për ta.

31. Chalmers, *What is this thing called Science?* Hyrje.

32. Në një tjetër shkrim, një tjetër autor kishte gjetur mbështetje për teorinë e evolucionit në shkrimet e Mulla Sadrës e Rumit, të cilët i paskan marrë këto ide nga Kur’ani!

Furkan, që do të thotë kriter. Në çastin kur thuhet, siç deklarohet jo rrallë, se shkencëtarët dita-ditës po mrekullohen nga Kur’ani, sepse shkenca vërteton vargje të tij, ky titull kur’anor i mvishet shkencës – ajo tani është kthyer në *furkan*, kriteri për dallimin e së vërtetës nga e pavërteta. Ky është një qëndrim i huaj për një botëkuptim të rrënjësor në *teuhid*, kryeparimin islam, e në kundërshtim me rregullat e kortezisë shpirtërore islame (*edeb*), që këshillojnë besimtarin ose besimtaren që të kenë gjithmonë një opinion të mirë për Zotin.

Ç’do të thotë kjo? Marrim shembullin e historisë së konvertimit në Islam të eksploratorit francez Jacques Cousteau, pasi ai dëshmoi takimin e ujërave që nuk përzihen dhe iu tregua se kjo dukuri është e rrëfyer në Kur’an. Është histori e përsëritur shpesh, pavarësisht se është përgënjeshtuar nga fondacioni Cousteau dhe familja e tij.³³ Edhe sikur kapiteni Cousteau me të vërtetë do të kishte pranuar Islamin, është vështirë të shpjegohet se çfarë mund të ishte arsyeja që Zoti lejoi 14 shekuj të kalojnë pa asnjë besimtar, apo edhe eulija, të kuptojë vargjet që aludojnë për ujërat që nuk përzihen pasi kanë një barrierë mes tyre (shih Kur’an 18:60, 25:53, 27:61, ose 55:19-20) dhe ia

33. Përgënjeshtrimi është bërë nga Didier Cerceau i Fondacionit Cousteau me datë 2 nëntor, 1991, kur Cousteau ishte gjallë, dhe është ndjekur nga një tjetër deklaratë e vetë familjes Cousteau.

shfaq kuptimin rëndom një detari në shekullin e XX-të (pse jo një detari në shek XIX, XVIII, ose XII?). Nëse dikush do të kishte njohuritë minimale mbi komentimet madhore mbi domethënien e “dy deteve” zor se do i kishte kushtuar vëmendje më shumë se kalimtare interpretimit sipërfaqësor të vargjeve të tilla. P.sh., prof. Hugh Talat Halman nga Central Michigan University pak vite më parë botoi një studim mbi 300 faqesh me temë takimin e profetit Musa (Moisi) me Khidrin, profetin e gjelbër. Libri³⁴ sjell pjesë nga tre komentime klasike nga Kushejrūn (v.1072), *Rāḡhibān Baklūn* (v.1209), dhe Kāshānīu (v.~1330) vetëm mbi vargjet kur’anore 18:60-82 që flasin mbi ngjarjet fill pas takimit të tyre aty ku takohen detet (*maxhma’ al-bahrajn*). Uroj që lexuesi do të ma lejojë sugjerimin që ata vetë të gjejnë rastin për të krahasuar domethëniet nxjerrë nga historia me kapiten Cousteau-në³⁵ me ato që këta tre ekzegjetë, pa përmendur shumë të tjerë, kanë nxjerrë nga këto vargje – lexuesi le ta gjykojë cilat interpretime i japin hakun këtyre vargjeve.

Gjithashtu vetë Kur’ani thotë se askush s’e prek Librin *përveç të*

34. Hugh Talat Halman, *Where the Two Seas Meet: The Qur’anic Story of al-Khidr and Moses in Sufi commentaries as a Model of Spiritual Guidance* (KY: Fons Vitae, 2013).

35. Sidoqoftë e vërteta rreth kapiten Cousteau-së, ka rëndësi që interpretimi është tipik për sa i përket frymëzimit e zellit për zbulime shkencore që gjenden në Kur’an.

dëlirësuarve (56:79), varg që dijetarë si Ibn ‘Axiha (v. 1809) e kanë komentuar se askush s’duhet ta prekë Kur’anin përveç atyre me abdes (të pastruarit ritualisht) dhe se askush nuk do të depërtojë në kuptimet e Kur’anit përveç atyre me zemër të dëlirësuar.³⁶ Imam Ghazzālū (v. 1111) në *magnum opus*-in e tij *Ringjallja e Shkencave të Fesë (Ihyā’ Ulūm al-dīn)* shkruan se “kuptimi i brendshëm [i Kur’anit] është i veluar, falë autoritetit të madhështisë e fuqisë së tij, nga aspekti i brendshëm i mendjes së lexuesit, përveç se kur është e dëlirë nga çdo njollë dhe e përndritur nga drita e madhërimit dhe pënderimit. Ashtu si çdo dorë s’është e denjë ta prekë kapakun e librit, po ashtu jo çdo gjuhë është e denjë t’i këndojë gërmat, e jo çdo mendje e aftë t’i rrokë kuptimin.”³⁷ Nëse ngulmojmë se veç shkencëtarët i qasen e kuptojnë më mirë Kur’anin, duhet që ata të bëjnë përjashtim nga parakushti i dëlirësisë, – diçka që nuk e shohim në Kur’an e as në komentimet tradicionale – ose që duhet të jenë zemërdëlirë nga natyra. Në këtë rast, me të drejtë lind pyetja se pse u dashka që njeriu të besojë një Zot që nga një anë udhëzon ritualet, kultivimin e virtyeteve sipas këshillave kur’anore e profetike, ndërsa në anën tjetër ia shfaq sekretet e Librit të Tij shkencëtarëve – *a priori* zemërdëlirë

– jomyslimanë, agnostikë e ateistë, të cilët nëse besojmë deklaratat e disave, “po mrekullohen dita-ditës me Kur’anin”. (!)

Dikush mund të thotë se Zoti është Zot dhe bën çfarë të dojë e ia shfaq shenjat e Tij kujt të dojë. Ajo është e vërtetë, por ka edhe disa gjëra që Zoti “s’mund” t’i bëjë, nëse është e mundur një shprehje e tillë, pasi Ai i ka parashkruar Vetes së Tij Emrat e Bukur (*‘esmā’ al-Husnā*); Zoti është I Gjithëfuqishëm (*al-Kādir*), por s’mund të jetë kapriçioz, Ai është I Drejtë (*al-‘Adl*) e jo arbitrar, Ai është I Urtë (*al-Hakīm*), por s’mund të jetë leshko. Vështirë të thuhet se Zoti po e tregon Veten e Tij si të Urtë nëse besojmë se Zoti i ka lënë të gjithë mysli-manët në errësirë vetëm që vargjet e Librit të Tij të kuptohen e vërtetohen pas 14 shekujsh nga shkencëtarë, të cilët nuk janë mysli-manë, ose nuk besojnë fare në Zot. Me një fjalë, të ngulmosh në vërtetimin e librave hyjnorë nga shkencëtarë e teori shkencore na sjell në një situatë ku mund të hidhet dyshim mbi Urtësinë e Tij. Kësaj i thonë të mos kemi opinion të mirë për Zotin, diçka me peshë madhore për ekzgjete tradicionale si Ibn ‘Arabi: “Nëse do të mbahen përgjegjë për interpretimet e tyre, interpretuesit e Kur’anit do duheshin kujdesur natyrshëm për ta interpretuar librin siç i ka hije autorit. Ibn ‘Arabiut i pëlqen të citojë thënien hyjnore (*hadith kudsī*) të përcjellë nga Profeti: “Unë jam

36. Cituar nga *The Study Quran*, f. 1327. Shih edhe ‘Fjalë e Zbritun, Gjuhë e Naltsueme’ nga Fatos A. Kopliku në *Zani i Naltë*, vol. 16, ff. 30-44 (2016).

37. Cit. *po aty*.

me opinionin e shërbëtorit Tim për Mua, ndaj le të ketë opinion të mirë për Mua!” Atyre, që kanë opinion të mirë për Zotin, do t’u jepet e mira prej Tij, ashtu siç do të gjejnë belà ata, që kanë opinion të keq për Të: *Ata, që mendojnë keq për Zotin, do t’i godasë rrota e keqe e fatit (48:6).*³⁸

Përfundime

Singeriteti e qëllimet e mira, në vetvete, nuk janë garanci e komunikimit të dobishëm dhe mbrojtja e fjalëve të librave hyjnorë e profetëve nga sulmet me prapavijë materialiste e agnostike nuk mund të bëhet me anë të një shkence e teknologjie, si ajo e Perëndimit modern, që adopton një prapavijë filozofike që parimisht s’e njeh, ose edhe e kundërshton Zotin si Burimin prej nga çdo gjë merr ekzistencë e jetë. Njohuritë e sotme shkencore mund të integrohen e interpretohen në një botëvështrim me qendër Hyjnoren, diçka që ka ndodhur me mjaft sukses në të kaluarën, jo vetëm të Islamit, por edhe traditave të tjera autentike religjioze. Shkencizmi, prapavija

filozofike e shkencës moderne, është me të vërtetë një Kalë Troje, që kur sillet brenda mureve të fortesës së besimit, përfundimisht, bëhet shkak i dobësimit, në mos shkatërrimit të saj. Nëse me raste vihet re një ton alarmi mes rreshtave të këtij shkrimi ia vlen të kujtojmë se edhe Cassandra nuk i paralajmëroi trojanët me pëshpëritje për gjëmën që Kali i Trojës do të sillte. Kur bie zjarr askujt nuk i mbetet hatri nga tingujt e alarmit apo thirrjet e zjarrfikësve. Megjithatë, krahasimet ndalojnë këtu, sepse ky nuk është as i pari e as i fundit shkrim që tërheq vëmendjen mbi rrezikun e depërtimit të shkencizmit në religjion dhe – ndryshe nga Cassandra, së cilës trojanët s’i vunë vesh dhe e quajtën të çmendur – tanimë ka jo pak autorë myslimanë³⁹, e jo vetëm, që kanë filluar me kohë kritikën e botëkuptimit shkencist nga perspektiva intelektuale e shpirtërore tradicionale. Shpresojmë që ky të jetë një kontribut modest në këtë vazhdë.

39. Shih shënimin 22, si edhe *Science and the Myth of Progress*, ed. Merhdad Zarandi (IL: World Wisdom, 2003), Gjithashtu shih nga Wolfgang Smith, *Science and Myth*, dhe *The Wisdom of Ancient Cosmology: Contemporary Science in Light of Tradition* (VA: The Foundation for Traditional Studies, 2009); dhe nga Huston Smith, *Why Religion Matters*.

38. “William C. Chittick, *Ibn ‘Arabî: Trashedes i Profetëve*, shqip., parath. & shën. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2012) f. 140.

Korpusi i mbishkrimeve osmane në Tepelenë dhe Delvinë

Dr. Mehmet Tütüncü

Qendra Botërore e Kërkimeve për Gjuhën Turke dhe Arabe,
Haarlem, Hollandë

Abstrakt

Ky është një studim dhe botim rreth mbishkrimeve osmane në jug të Shqipërisë, të përcaktuara si zona ndërmjet Vlorës dhe kufirit grek. Gjatë viteve të fundit janë zbuluar shumë mbishkrime të reja (kryesisht të varreve), nga studiues të huaj dhe vendës. Mbishkrimeve të njohura nga literatura (Evliya Çelebi dhe të tjerë) u janë shtuar këtu edhe mbishkrimet e reja të zbuluara. 25 mbishkrime nga kjo zonë, të cilat datojnë nga viti 1542 deri më 1897, vijnë këtu si pjesë e Korpusit të mbishkrimeve osmane në Shqipëri. Mbishkrimet janë studiuar në kontekstin e tyre historik dhe kulturor. Ato përmbajnë informacione në lidhje me aktivitetet në fushën e ndërtimit, jetën dhe kulturën të zonës së cilës i përketin gjatë shekujve të sundimit osman në Shqipëri.

Fjalë kyçe: Osmane, mbishkrime, Shqipëria.

1. Hyrje

1.1 Korpusi i mbishkrimeve osmane në Shqipërinë Jugore (mbishkrimet e varreve dhe themelet në Tepelenë dhe Delvinë)

Tabela 1. Inventari i mbishkrimeve Vendi Data

Tepelenë, Xhamia e Kalasë 1819 E.S
Delvinë, Gurvarri 1240 Hixhri - 1824-25 E.S

Delvinë, Gurvarri
Xhermëhallë, 1315
Hixhri -1897 E.S

Tepelenë, Gurvarri i komandantit të ushtrisë së Ali Pashait Pa datë

Lufta e Tepelenës, Prevezës dhe Korfuzit Pa datë

Delvinë, Grafit në Xhaminë e Gjin Aleksit Pa datë

Delvinë, Grafit në Xhaminë e Gjin Aleksit Pa datë

Tabela 2. Mbishkrimet publikohen në vijim sipas qyteteve ku janë gjetur

Delvina	5 mbishkrime
Tepelena	3 mbishkrime

2. Tepelenë

Tepelena është një vendbanim i vogël malor. Ajo u themelua nga osmanët në 1482, si një fortesë për

të kontrolluar shtigjet dhe rrugët. Tepelena u bë e njohur si vendlindja e Ali Pashë Tepelenës, Vezirit të Janinës, i cili, në fund të shekullit të 18-të dhe në fillim të shekullit të 19-të, e futi të gjithë Shqipërinë e Jugut dhe pjesën më të madhe të Greqisë kontinentale nën sundimin e tij. Kalaja është ndërtuar më 1820 dhe ka mbetur e papërfunduar. Ekzistojnë 2 mbishkrime të cilat mund të gjenden në Tepelenë dhe që i referohen Ali Pashës dhe veprimtarisë së tij. 3 mbishkrimet në vijim u zbuluan dhe fotografuan nga z. Auron Tare, i cili na i ka ofruar bujarisht këto foto për studimin tonë (Fig. 19).

Guri i varrit të Bimbashit të Ali Pashait

هوالباق
بر مراد ايدا بهدر
دنياه مثلئ نادر
تبه دلتئ على •اشا
افندمرك بيك باشه سئ

Huvel Baki

Bir Murad ede Bahadır

Dünyada ismi nadir

Tepedelenli Ali Paşa

Efendimizin Binabaçısı

Ai është i vetmi i Gjallë

Dhe jep lumturi për të gjithë

Ai nuk ka të tjerë të krahaseshëm

Koloneli i Ali Pashait të Tepelenës

[vdiq]. [Mbishkrim 38 x 24 cm]

Ky gur varri është i një personi emri i të cilit ka humbur, por nga teksti i ruajtur ne mund të lexojmë se ai ishte oficer i Ali Pashë Tepelenës, i cili kishte krijuar një shtet gjysmë-autonom në Janinë. Ai kishte shërbëtorët dhe oficerët e tij. Ky person e përcakton veten si «kolonel i ushtrisë së Ali Pashës». Kjo është një dëshmi e karakterit autonom dhe autoritar të Ali Pashës.

Mbishkrimi i fragmentit (të një ndërtese) i ruajtur pjesërisht

کامکار * افرین صد افرین
ک ابتادا * برتزه قوزر
کوهرلر ظهور * احمد محمد
بدن دم * ک

*Allah ey vezîr-i kâmgâr Aferin sad
(binlerce) aferin...*

*devlettir ki der ceng-i ibtidâ Brevezge-i
korfu [...]*

*hususâ bu bahr-i gevherler zühûr
Ahmed-i Muhammed...*

hayra

Ky mbishkrim i fragmentuar (38 x 33 cm) (Fig. 20) duket shumë i vjetër. Duke gjykuar nga stili, ndoshta ai mund të jetë i periudhës së Sulejmanit të Madhërisëm dhe Betejës së Prevezës (28 shtator 1538).

Tepelenë: Mbishkrim në greqisht që daton në vitin 1819

Ky mbishkrim i famshëm është shkruar me shkronja greke dhe arabe. Ai përmban emrin e Ali Pashës dhe vitin 1819. Përveç kësaj, ai paraqet pamjen qendrore të xhamisë. Mbishkrimi është raportuar nga Machiel Kiel dhe ndodhej në hyrje të Kalasë së Tepelenës (cit. Machiel Kiel, 2013 f. 475-479).



Fig. 19. Gurvarri i bimbashit të Tepelenës Fig. 20. Mbishkrimi i Tepelenë Prevezës



Figura 21. Mbishkrimi në greqisht dhe osmanisht në kalanë e Tepelenës

3. Delvina

E themeluar si kryeqendra e një sanxhaku, dikur ajo ishte një qendër administrative dhe ushtarake. Numri i madh i veprave monumentale: kështjella, xhamia, teqeja Halveti, Hamami dhe teqeja Bektashi na kujtojnë të kaluarën e saj të lavdishme. Në Delvinë gjenden disa mbishkrime, kryesisht varresh, por gjithashtu edhe disa mbishkrime në portikun e xhamisë së “Gjin Aleksit.” Mbishkrimet e vogla janë disa lutje dhe vargje të thjeshta të pelegrinëve, të cilët vizitonin këtë vend të rëndësishëm. Delvina ishte edhe qendër e dervishëve Halveti, sekt i cili u përhap në drejtim të Shqipërisë, rreth vitit 1530/937 nga Jakub Efendiu, i cili pat ndërtuar një teqe në Vlorë. Por ndodhet edhe një teqe bektashiane në zonën Xhermahalle të Delvinës. Pjesa më e madhe e Delvinës është djegur menjëherë pas luftërave ballkanike dhe gjatë Luftës së Parë Botërore nga banditë grekë. Për një përshkrim më të hollësishëm të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të Delvinës shihni dy artikuj të shkëlqyer shkruar nga Gianclaudio Macchiarella (Macchiarella, 2012a, 2012b; Macchiarella, Tütüncü 2012).

Teqeja e Baba Azizit Delvinë (1173/1759-1760)

Mbishkrimi më i vjetër në Delvinë ndodhet në Teqenë e Babait (Fig 22.):

Teqeja e dytë e Delvinës, e njohur nga vendasit si teqeja e Baba Azizit, duket të jetë e lidhur me valën e parë të misionarëve Halveti në fund të shekullit të 16-të. Teqeja e Bektashinjve ndodhet në drejtim të kthesës, e ndërtuar në anë të shkëmbit të thepisur konik të kalasë. Teqeja e Bektashinjve ishte e lidhur me një mulli uji, që tani ndodhet nën rrënojat pranë mureve rrethuese dhe lumit. Dy tyrbet në kopsht janë ende në këmbë; njëra e mbuluar me çati me tjegulla, dhe ende e ruajtur në gjendje të mirë, e cila mbart cenotafët e pesë dervishëve; ndërsa tjetra relativisht e rrënuar dhe pa çati në pjesën më të madhe të saj. Teqeja e Bektashinjve ka qenë e konceptuar fillimisht si një enklavë e vogël, e mbrojtur nga mure dhe pemë të mëdha me portë kryesore në anën e lumit, përmes një korridori të harkuar në zonën e tyrbes (Macchiarella, Tütüncü 2012, f. 551).

Aty ndodhet një mbishkrim, i cili nuk është publikuar më parë. Për fat të keq, mbishkrimi është me ngjyrë të bardhë dhe për shkak të cilësive

kaligrafike, është mjaft i vështirë për t'u deshifruar. Unë e kam lexuar pjesërisht mbishkrimin dhe datën, e cila i takon vitit 1173 Hixhri, pra 1759-1760 E.S. Ky është mbishkrimi i dytë më i vjetër i periudhës osmane që ka mbijetuar (më i vjetri është mbishkrimi i Sulejmanit [nr. 1] në Vlorë, i cili daton që nga viti 1542). Mbishkrimet e tjera (nr. 2-5) janë të dëmtuara.

Delvina Baba Aziz Tekkesi 1173 = 1759/1760 Satir 1 : Nedir bu Resûlullah(?)

*Satir 2: Bu kâfidir.....
uşşâkım.....
ra'nâ...*

*Satir 3:.....olup ol
feth-i ebvâb-i safâ*

Satir 4: Sanma kim sahib

*Satir 5: Bu ali alâmâtî..
nâir olup her daim mele'-i a'la*

*Satir 6:.....şehsüvâr-i
kahramân-i âlemin*

*Satir 7: şâh-sûret sâfî-sûret ol
Hâzret-i Muhtâr Paşa*

Sene 1173



Figura 22. Mbishkrimi në Teqenë e Baba Azizit, Delvinë

Mbishkrimi i gurit të varrit në Xhermahalle, Delvinë (1211)

Ky gur varri që daton nga viti 1796/1797 është varri më i vjetër i Korpusit tonë. Ai ndodhet në teqenë Xhermahalle dhe është në emër të Ahmedit, i cili vdiq më 1211. Për fat të keq, mbishkrimi është mjaft i dëmtuar për të pretenduar një lexim të plotë (Fig. 23).

دریغا کیم فنadan ایلدی رخلت افندی احمد مطر او
بکابا افتخار ادوب بهشت عزمینه طوتدی یول
معتادی امر بالمعروف هر دم

Sene 1211 = 1796/1797

*Dirîgâ kim fenâdan eyledi riblet
efendi Ahmed-i mîr ol Bekâya ıftihâr edüp
bibîçî azmine tutdu yol m u ' t â d i (?)
emr-i bi'1-ma'rûf idi herdem*



Figura 23. Mbishkrimi i gurit të varrit në Xhermahalle, Delvinë (1211/1796)



Figura 24. Mbishkrimi i gurit të varrit në Xhermahalle, Delvinë (1240/1824)

a. Mbishkrimi i Gurvarrit Shejh Emin Efendi Xhermahalle, Delvinë (1240/1824)

تاريخ وقت مرحوم
و غفور له جنتمكان
الشيخ امين افندي
ابن مصطفى ابو بكر
دلوينوي رويح•ين الفاتخا
سنة ١٢٤٠

*Tarih vefat merhum
We gafur Cennetmekan
Al-shaykh Amin Afandi
ibn Mustfa abu Baker
Devhinevi ruhîyçîn Al fatiha
sene 1240*

Ky mbishkrim është thyer???, por është i ruajtur pothuajse plotësisht (Fig. 24). Ai jep datën e vdekjes së një shejhu lokal, që ishte nga Delvina, shejh Emin efendiu, i biri i Mustafa Ebu Bekrit. Ai vdiq në 1240/1824. Ai ishte një shejh nga Delvina dhe me sa duket kishte drejtuar kuvendin e Xhermahalles.

Mbishkrimi është i botuar (cfr. Macchiarella 2012, fq. 15-16).

b. Gurvarri i vitit 1315

*Kydy Yazık pençe-i mevt
Tarib-i dar-i fena oldu ufiil itdi beden
Aglasun mader-ii eb ya da getirdkeçe beni
Sene 1315*

Unë jam mbërthyer nga kthetrat e vdekjes, mjerisht!

Trupi im është tretur duke e lënë këtë botë kalimtare

Le të brengosen babai dhe nëna ime për kujtesën time.

Viti 1315 = 1897

Mbishkrimi është vetëm një fragment dhe pjesa e sipërme me vargjet hyrëse dhe emrin e të ndjerit janë fshirë (Fig. 25).

c. Grafite të Xhamisë “Gjin Aleksi” Rusan

Grafite nga xhamia në Rusan

*Kim bir alime ikeram ederse Allahda ona
ikram eder.*

من اكرام عالما اكرم الله تعالى

Zoti do t'i ndihmojë njerëzit të cilët ndihmojnë një dijetar [njeri të shkolluar].

كعبة العشاق بشد اين مقام
هرکه ناقص امد ايد جاشد تمام



Figura 25. Mbishkrimi në gurin e varrit në Xhermahalle, Delvinë 1315/1897



Figura 26. Xhamia "Gjin Aleksi", Rusan, Delvinë

Ky vend u shndërrua në Qaben e të dashuruarve [Sufive], të cilët vinin këtu me të meta dhe bëheshin pastaj njerëz të përkryer (Fig. 26).

يا محمد يا علي يا عمر يا حسين يا حسن يا ابو بكر يا مسطفي

Ya Muhammed Ya Ali Ya Ebu bekr Ya Umar Ya Osman ya Huseyin Ya ebubekr Ya Mustafa

Oh Muhammed, Oh Ali, Oh Ebu Bekër, Oh Umer, Oh Osman, Oh Hysejn Oh Mustafa.

Duçse zülfünden arak? zemheri? yar canan üstüne Güya çebnem? Düşen? en berk-i? [...] üstüne

Nëse nga flokët tuaja bie nga si [...] Ajo bie në një Handan Berki.

4. Libohova

Libohova është një vendbanim i vogël, por i rëndësishëm në një kala pranë Gjirokastrës, e ndërtuar në vitin 1809 nga Ali Pashë Tepelena, për arsye se ai ishte martuar me një anëtare të klanit të Libohovës. Motra e tij Schinşah është varrosur në fshatin Libohovë. Në varrezat e familjeve të Libohovës, bëjnë pjesë varret më të bukura në Shqipëri nga periudha osmane, të cilat janë të ruajtura mjaft mirë. Ne kemi zgjedhur 5 varre, të fotografuara nga z. Auron Tare (Fig. 27).

a. Gurvarri i Ahmed Bej (1278 / 1861-1862)

Një nga mbishkrimet më të gjata të varrezave të Libohovës, i cili është edhe më i vjetri, është mbishkrimi në Fig. 28. Mbishkrimi është i vitit 1278, por ai është i dëmtuar dhe ndotur aq shumë sa ishte e pamundur të lexohej

dhe deshifrohej plotësisht. Vetëm emri i personit të vdekur Ahmed bej dhe data e vdekjes së tij (1278), mund të lexohen.

b. Gurvarri i zonjës Rejhan (1283/1867)

Mbishkrimi i dytë nga Libohova i është kushtuar një gruaje me emrin Rejhan, e cila thuhet se ka qenë nga Kazaja (qarku) Çam (Çamëria) (Fig. 29). Vdekja e saj gjithashtu thuhet se ka ardhur përmes martirizimit (Sehadet Devlet). Ajo është «Nëna e Husejin Efendiut». Ne nuk qemë në gjendje të identifikonim as atë e as djalin e saj. Ky gur varri është unik dhe i rëndësishëm për shkak se ai përbën të vetmin varr të një gruaje, të cilin ne kemi qenë në gjendje të identifikonim.

Hüvelbaki

nuş edüb çam-i kazadan şerbeti
eyledim fani cihandan uzleti
kalmadı vaktim vasiyyet edeyim
verdi hak bana şehadet-i devleti
garibe idim bu vakt ey şah kim
Hakka gurbetimle buldum rahmeti
Hüseyin efendinin validesi
Reyhan ruhuna fatiha
fi 22 s sene 1283



Figura 28. Mbishkrimi i Varrezës së Familjes Libohova nga viti 1278

Figura 29. Guri i varrit i zonjës Rejhan

Unë kam pirë Sherbet (Shurup)
në zonën Çame (të Çamërisë)

Kam ikur nga kjo botë e sotme

Nuk kam kohë të lë një testament
sepse

Allahu më ka dhuruar gjendjen e
shehadetit (Martirizimit)

Unë kam qenë njeri i vetmuar
(garibe) më përpara o Shahu im

Unë kam gjetur në këtë vend (në
mërgim) mëshirën e Allahut

Rejhan nëna e Husejin Efendiut

Fatiha për shpirtin e saj.

22 Shevaal 1283 (27 shkurt 1867)

c. Gurvarri i «... i biri i Ali efendi Shemsi Hoxha»

Mbishkrimi i tretë nga Libohova është gjithashtu i dëmtuar dhe ne kemi një foto shumë të dobët për ta lexuar atë plotësisht (Fig. 30). Ne mundëm ta deshifronim mbishkrimin vetëm pjesërisht. Ai është varri i Shemsi Hoxhës, i cili ka vdekur në 1287.

1. Boyle buldum bu civan alinin bir zıllbuda 2....

3. ...

4. Çün ezelden bôyle takdim eylemiş ol hüda

5. Merhum cennetmekan Firdavs açıyan eçraf

6. ... *Şefendi bin Âli*
7. *Şemsi hoca rubuna fatiha sene 1287*
Kështu ka vendosur Perëndia,
I ndjeri fisnik ... efendi i biri i Aliut,
destinacioni i të cilit do të jetë parajsja,
të këndojmë një Fatiha për jetën e tij.
Viti 1287 (1871/72)

d. Guri i varrit i Maliq Pashës

Mbishkrimi i katërt nga Libohova është ai i një personaliteti mjaft të rëndësishëm (Fig. 31). Është varri i Maliq Pashës, i cili ishte mjaft i njohur në atë zonë. Ai e kishte prejardhjen nga familja e Arsllan Pashës nga Yanya (Janina) dhe i ati kishte qenë në ushtrinë e Ali Pashës dhe kishte shërbyer si ruajtës i thesarit. Ai vdiq më 1893. *Mbishkrimi nuk është shkruar edhe aq lehtë, por gdhendur në një gur të zezë bazalt.*

*Ab minelmev
Vezir şehid Yanyah arslan
Pasan sülalesinden ve tepe
delenli Ali paşanın
müştir-i ordusu ve hazinedari
(mer)hum begin ogullarından Rumeli
Beglerbegi payelulerinden Malik
Paşanın rubuna Fatiha
sene 1309*

Figura 30. Mbishkrimi në varrezat e familjes Libohova. Mbishkrim nga viti 1287 (1871/72)

Figura 31. Mbishkrimi në varrezat e familjes Libohova. Mbishkrim nga viti 1309



Nga familja e vezirit dhe martirit Asllan Pashës së Janinës dhe Gjeneralit të ushtrisë së Ali Pashë Tepelenës dhe djalit të të ndjerit hazinedar [bartës i thesarit] dhe Bejlerbegut [Komandanti i komandantëve] të Rumelisë Maliq Pasha. Këndoni një Fatiha për shpirtin e tij. Viti 1309/1893.

Në ‘Sicili Osmani’ një gjë e tillë është konfirmuar nëpërmjet informacionit të mëposhtëm: Maliq Naili Pasha është shqiptar. Ai ka jetuar një jetë të gjatë dhe atij i është dhënë titulli bejlerbeg i Rumelisë. Ai ishte 85 vjet kur vdiq në Janinë me 5 Ramadan 1309 (23 mars 1893). Trupi i tij me sa duket më pas është transferuar në Libohovë dhe është varrosur atje. Në Kujtime të Ali Kemalit kemi informacion të mëtejshëm rreth Malik Pashës dhe Libohovës.

Nga fundi i muajit shtator 1862, Guvernatori i Përgjithshëm pat vendosur të ndërmerre një udhëtim nëpër Shqipëri. Ai m’u lut ta shoqëroja dhe unë isha shumë i kënaqur që m’u dha një mundësi e tillë për të vizituar përsëri vendin tim të lindjes pas tetë vitesh mungesë. Pra, pasi lamë Janinën, fillimisht shkuam në Voshtinë, një qytet i vogël, që ishte kryeqendër në rrethin e Pogohisë, në vijën kufitare midis zonës shqiptare dhe greke. Ndërsa ne ishim

atje, Malik Pasha, nipi i famshëm i Shanishahut, motrës së Ali Pashës së Janinës, erdhi për të vizituar Akif Pashën dhe e ftoi atë në shtëpinë e tij në Libohovë, e cila atëherë ishte një fortesë e ndërtuar që nga koha e gjyshe së tij. Ne përputhje me rrethanat, ne shkuam atje të nesërmen, dhe u larguam dy ditë më vonë drejt Gjirokastrës. (Aksut, Ali Kemal 1944, f. 237)

e. Gurvarri i Safet beut, bir i Maliq Pashës

Mbishkrimi i fundit nga Libohova është në emër të Safet beut, bir i Maliq Pashës (Fig. 32). Ai ishte kryetopçu [Topçubashi] i ushtrisë perandorake. Data e vdekjes së tij nuk është e dukshme në fotot që kemi marrë.

Ab Minelmev

Malik Paşa hazretlerinin

Mahdumu rikab-i humayun

topçubashlarından rifatlu

Abd Muhammed Saffet bek

Efendinin ruhuna fatiha sene...

Oh i vdekur,
Këndoni Fatihanë për shpirtin e tij
Të Muhammad Safet Bej Efendiut,
Të birit të Shkëlqesisë Maliq Pashës,
dhe komandantit perandorak të topçinjve.

5. Përfundim

Këto 25 mbishkrime nuk duken shumë për rreth 400 vjet të sundimit osman në Shqipëri. Sigurisht, ka pasur shumë më tepër të tilla, por, fatkeqësisht, përgjatë viteve, me sa duket ato kanë humbur ose janë shkatërruar. Megjithatë, ajo që ka mbetur dhe ato që kemi publikuar janë një kontribut i rëndësishëm për kulturën dhe historinë e Shqipërisë së Jugut. Shpresojmë se më shumë mbishkrime do të dalin në dritë në të ardhmen, veçanërisht varre, të cilat janë ende të pazbuluara ose të fshehura në vende të ndryshme. Unë do të desha të falënderoj drejtorin e Agjencisë shqiptare të bregdetit, të nderuarin Auron Tare dhe Prof. Gianclaudio Macchiarella, të cilët kanë dhënë një ndihmesë të madhe dhe na kanë ndihmuar të gjejmë e të studiojmë mbishkrimet osmane në Shqipërinë e Jugut.

Figura 32. Mbishkrimi në varrezat e familjes Libohova (Safet bej)



Bibliografia

Dankoff, Robert; Elsie Robert (eds.) (1999). *Evlîya Çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*. The relevant sections of the *Seyahatname* botuar me përkthim dhe hyrje, vëll. 4. Leiden; Boston; Koln: Brill Academic Pub.

Frashëri, Gjergj; Dashi, Sulejman (1987). Zhvillimi i arkitekturës islamike shqiptare të xhamive (Probleme të periudhizimit). *Monumentet*, 2, fq. 51-76.

Macchiarella, Gianclaudio (2012a). Delvina, Albania: A Sufi Architectural Enclave. Në: Cret Ciure, Fiorina; Nosilia, Viviana; Pavan, Adriano (bot.), *Multa & Varia: Studi offerti a Maria Marcella Ferraccioli e Gianfranco Girardo*. Milano: Biblion, fq. 9-32.

Macchiarella, Gianclaudio (2012b). Delvina: a Mystic Architectural Enclave. *Türk Donemi Kazıları ve Sanat Tarihi Araştırmaları Sempozyumu* (Eskişehir, Turkey, 19-21 October 2011).

Macchiarella, Gianclaudio; Tütüncü, Mehmet (2012). «Delvina Kitabeleri». *Gjatë punimeve të konferencës* (Eskişehir, Turkey, 19-21 October 2011), pp. 549-558.

Kiel, Machiel (1990). *Ottoman architecture in Albania (1385-1912)*. Istanbul: Research Centre for Islamic History, Art and Culture.

Kiel, Machiel (2013). «Tepelene, Türkiye Diyanet Vakfı». *İslam Ansiklopedisi*, vëll. 40, fq. 475-479.

Tütüncü, Mehmet (2006). *Turkish Jerusalem (1516-1917), Ottoman Inscriptions from Jerusalem and Other Palestinian Cities*. Haarlem.

Aksut, Ali Kemalî (1944). *Sultan Aziz'in Misir ve Avrupa seyahati*. Istanbul: Ahmet Sait Oğlu Kitabevi.

İslam Ansiklopedisi (2011), 40. Cilt, Tanzimat-Teveccüh. *Ankara*.

Një vështrim historik mbi librin “Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane” të Syrja bej Vlorës

Pjesa e I

Dr. Hasan Bello
Instituti i Historisë, QSA, Tiranë

Abstrakt

Libri i Syrja bej Vlorës¹ “Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane” është një përpjekje modeste për të hedhur dritë mbi një numër të konsiderueshëm personalitetesh, të cilët kanë jetuar, vepruar dhe kontribuar në një shtet perandorak, pjesë e të cilit ishin edhe shqiptarët për pesë shekuj.

Në këtë libër jepen të dhëna me karakter të përgjithshëm, të cilat për hir të së vërtetës, sot mund të qubën të tejkaluara për ata studiues që do të merren me hulumtimin e thelluar të periudhës osmane. Ndërsa për lexuesit e pasionuar të historisë, ato përbëjnë një kontribut të vyer, me informacion pak ose aspak të njohur. Autori shpalos të dhëna me interes për emra të njohur dhe të panjohur nga historiografia shqiptare. Ndoshta për faktin se për këto personalitete, në vend të arsyes, ka mbizotëruar paragjykimi.

Ky libër në dorëshkrim është shkruar në gjuhën osmane dhe së bashku me përkthimin

1. Mbi jetën dhe veprimtarinë e Syrja bej Vlorës nuk po zgjatemi për arsye se autorë si Hasan Kaleshi, Eqrem bej Vlora dhe sidomos botuesi i kujtimeve të Syrja bej Vlorës “Shqipëria pas osmanëve 1912-1920” nga osmanishtja në gjuhën turke Prof. Abdülhamit Kırmızı, në parathënien e këtyre kujtimeve, ka shpalosur një punim serioz ku veprimtaria e këtij personaliteti përshkruhet në mënyrë të detajuar. *Shih: Avlonyalı Süreyya Bey, Osmanlı Sonrası Arnavutluk*, Istanbul: Klasik Yayınları, 2009.

në gjuhën shqipe gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit-Tiranë.² Ai ka 144 faqe në osmanisht dhe 52 faqe në gjuhën shqipe, të cilat janë përkthyer nga orientalisti Jonuz Tafilaj. Në inventarin e hartuar nga përgjegjësi i sektorit të dorëshkrimeve turke në arkivin historik, orientalisti Haki Sharofi, shkrubet data e marrjes në dorëzim të këtij përkthimi 26 qershor 1963.³ Ndërsa për kohën se kur është shkruar nga Syrja bej Vlora, ende nuk kemi asnjë të dhënë.

Megjithëse ky përkthim në dorëshkrim është në dialektin verior dhe përmbante një sasi të konsiderueshme gabimesh, ne jemi përpjekur që të ndërhyjmë vetëm aty ku ishte domosdoshmërisht e nevojshme. Kjo, sepse dialektet së bashku me përkthimet e realizuara në një periudhë të caktuar janë një pasuri e jashtëzakonshme dhe mbajnë vullën e kohës. Por nga ana tjetër, për t'i ardhur në ndihmë lexuesit, vitet e kalendarit hënor i kemi konvertuar në kalendarin diellor, duke i vendosur ato në kllapa, pa e prekur origjinalin. Aty ku ka pasur ndonjë term historik osman jemi përpjekur që t'i shpjegojmë me shenjë (*) në nëntekst. Ndërsa për disa personalitete, për të cilët ekzistojnë datëlindjet, viti i vdekjes dhe koha se kur kanë shërbyer si kryeministra, ato i kemi vendosur në kllapa.

2. AQSH, F: S.Vlora, D. 9.

3. Po aty.

Hyrje

Perandoria Osmane ishte një shtet multietnik, ashtu sikurse ishin edhe dy perandoritë romake (Roma e Vjetër dhe Bizanti). Në këtë perandori ekzistonte një veçanti cilësore e quajtur osmanizëm dhe një grup njerëzish të quajtur osmanë.⁴ Qytetari i këtij shteti, që nga lindja e deri në vdekje, ishte anëtar i familjes së tij, i komunitetit fetar dhe i grupit etnik ku ai bënte pjesë.

Në periudhën klasike, e cila përfshinë vitet 1300-1600 për të qenë pjesë e administratës osmane,

ishte kusht që, në një formë apo në një tjetër, të ishte i lidhur me dinastinë dhe t'i përkisje fesë zyrtare. Por, me modernizimin e Perandorisë Osmane, e sidomos pas Reformave të Tanzimatit (1839) ku qytetarëve u sigurohej barazia para ligjit, pavarësisht përkatësisë fetare, vihet re një pjesëmarrje akoma më e madhe e individëve jo myslimanëve në administratën shtetërore. Tani, ata i hasje në çdo nivel e në çdo gradë, duke e folur dhe shkruar gjuhën osmane me po aq korrektësi, saç flisnin edhe gjuhët perëndimore.⁵ Duke pasur parasysh,

4. İlber Ortaylı, *Imparatorluğun En Uzun Yüzyılı*, İstanbul: "Timaş", 2008, s. 67.

5. Gülnihal Bozkurt, *Gayrimüslim Osmanlı Vatandaşların Hukuki Durumu (1839-1914)*, Ankara: "Türk Tarih Kurumu Basımevi",

se një pjesë e tyre kishin studiuar në shkollat e huaja, brenda dhe jashtë perandorisë, falë njohurive të marra në këto institucione, pjesa dërrmuese e diplomatëve osmanë vinin pikërisht nga kjo shtresë.⁶ Edhe rasti i këtyre pashallarëve nuk bën përjashtim, ata megjithëse ishin shqiptarë, myslimanë, katolikë, etj., gëzonin po të njëjtat privilegje si çdo nënshtetas tjetër osman. Madje, krahasuar me shumë nëpunës të tjerë të perandorisë, siç do të shihet dhe më poshtë, këto personalitete çmoheshin dhe vlerësoheshin me titujt më të lartë të shtetit osman.

Libra të ngjashëm me këtë libër të Syrja bej Vlorës mbi jetën dhe biografinë e personaliteteve osmane kanë shkruar edhe autorë të tjerë. Madje, ne jemi të mendimit se me disa prej tyre duhet të jetë konsultuar edhe Syrja bej Vlora. Si burim relevant, përveç librave, këtyre autorëve i ka ardhur në ndihmë edhe një drejtori e posaçme e krijuar në Stamboll. Kështu, me zgjerimin dhe modernizimin e administratës osmane, lindi nevoja për krijimin e një zyre, e cila do të merrej me

jetëshkrimin nëpunësve të saj. Për këtë, në vitin 1879 u themelua një komision i veçantë (Sicill-i Ahval Komisyonu) i cili deri në vitin 1909⁷, pra relativisht brenda një kohe të shkurtër, arriti të grumbullojë informacion për 92.000 nëpunës, në gjithsej 201 defterë. Të dhënat kanë karakter të përgjithshëm, mbi vendlindjen, nivelin arsimor, gjuhët e huaja që zotëronte personi, funksionet, gradat, medaljet dhe titujt e fituar gjatë karrierës administrative ose ushtarake.⁸ Shumica e nëpunësve, fillimisht e ka shkruar personalisht biografinë e vet dhe më pas ia ka paraqitur atë komisionit, anëtarët e të cilit e kanë plotësuar duke ndjekur ecurinë.

Një kontribut të madh për këtë nismë ka dhënë historiani dhe juristi i njohur i Perandorisë Osmane Ahmed Xhevdet Pasha, sekretar dhe përkthyes i të cilit ka qenë, për një kohë të shkurtër, edhe rilindasi ynë i shquar Pashko Vasa. Prandaj, dosja e parë me të dhënat personale mban pikërisht emrin e Ahmed Xhevdet Pashës.⁹

1989, s. 153-169.

6. Sinan Kuneralt, Bir Osmanlı Diplomatı – Kostaki Musurus Paşa, *Belleten*, nr. 3, Ankara: 1970, s. 429; Adnan Şişman, *Tanzimat Döneminde Fransa'ya Gönderilen Osmanlı Öğrencileri (1839-1876)*, Ankara: "Türk Tarih Kurumu Basımevi", 2004, s. 54; Cengiz Orhonlu, *Osmanlı Devletinde Tercümanlık*, Ankara, "Türk Tarih Kurumu Basımevi", 1975, s. 5-6.

7. Güldem Sarıyıldız, *Sicill-i Ahval Komisyonunun Kuruluşu ve İşlevi (1879-1909)*, İstanbul: 2004, s. 23-24.

8. *Başbakanlık Osmanlı Arşivi Rehberi*, İstanbul: "T.C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı", 2000, s. 240.

9. Talip Mert, *Sicill-i Ahval Defterleri ve Buna Dair Yayımlanan Nizamnameler*, *Arşiv Araştırmaları Dergisi*, nr. 2, İstanbul: 2000, s. 97.

Nga hulumtimet paraprake në arkivin e Perandorisë Osmane na rezulton se ekzistojnë afërsisht rreth 1500 autobiografi të personaliteteve me origjinë shqiptare. Kjo, sigurisht vetëm për periudhën midis viteve 1879-1909.

Gjithsesi libri i Syrja bej Vlorës, i cili mund të jetë shkruar në vitet 20-30-të të shek. XX-të, përbën një kontribut të çmuar historiografik për kohën.

Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane

nga Syrja bej Vlora

1. Ajas Pasha
2. Lutfi Pasha
3. Kara Ahmed Pasha
4. Ahmed Pasha
5. Koxha Sinan Pasha
6. Ferhat Pasha
7. Hasan Pasha
8. Hasan Pasha (Ohri)
9. Hysejn Pasha (Mere)
10. Tabanijasi Mehmed Pasha
11. Kemankesh Mustafa Pasha
12. Kara Murad Pasha
13. Tarhanxhu Ahmed Pasha
14. Arabaxhi Ali Pasha
15. Dalltaban Mustafa Pasha
16. Halil Pasha
17. Memish Pasha
18. Mustafa Naili Pasha
19. Ferid Pasha
20. Mirahor Eljaz beu
21. Hamza Beu
22. Ahmed Pasha
23. Ferhad Pasha
24. Turhan Bej
25. Dervish Çelebi
26. Hafiz Ahmed Pasha
27. Hasan Pasha
28. Hasan Pasha
29. Muhji Bej
30. Mustafa Efendi
31. Bajram Pasha
32. Omer Pasha
33. Koçi Bej
34. Maksut Pasha
35. Bektash Aga
36. Ibrahim Uzun Pasha
37. Hasan Pasha
38. Kanakxhi Hasan Pasha
39. Hasan Aga Çollaku
40. Ahmed Pasha
41. El'haxhi Zulfikar Pasha
42. Mustafa Pasha
43. Koxha Halil Pasha
44. Abdurrahman Pasha
45. Sulejman Pasha
46. Adem Pasha
47. Ejup Pasha
48. Bektash Mehmet Pasha
49. Bejli Hysejn Pasha
50. Kapllan Mehmed Pasha
51. Xhaferr Pasha
52. El'haxhi Ali Pasha
53. Osman Pasha
54. Ibrahim Pasha
55. Ebu Beqir Pasha
56. Hasan Pasha
57. Rexhep Pasha
58. Kurd Mehmed Pasha
59. Ahmed Pasha (Dervishi)
60. Ahmed Pasha

Ajas Pasha (1483 Vlorë – 13.7.1539 Stamboll): Mbasi Shqipnia u ba pjesë e Perandorisë Osmane filluan të dalin prej saj, ashtu si nga vendet e tjera, njerëz me vlera shtetnore që i banë shërbime të mëdha mbretënisë e popullit (në tekst përdoret fjala “komb”, por Perandoria Osmane s’përbahej prej një kombi, por prej shumë kombesh, prandaj përdora fjalën “popull”-J.T.). Ma i pari ndër shqiptarët, që xuni ma të naltën seli të mbretënisë, Sadriazemllëkun*, qe Ajas Pasha. Ky person shërbeu n’Endurunë** ndër detyra të ndryshme, deri sa hypi në fron Javuz Sulltan Selimi. Mbrapa hyni në mes të dijetarëve të Birunit*** me gradë t’Agallëkut, deri sa në pak kohë arrijti me pasë gradën e agajit (komandant) të Jeniçerëve 923 h (1517). Në ekspeditën e Egjiptit u ndodh pranë sulltan Selimit dhe për hirë të guximit, të zotësisë e të disa propozimevet që bani, propozimet të cilat tue u dukë t’arsyeshme e t’urta dhanë përfundime të mira, fitoi simpatinë e sulltanit sa që mrapa u emenue Bejlerbej i Kastamonusë 925 h (1519). Mbasi hypi në fron sulltan Sulejmani, u ba Bejlerbej i Anadollit 926 h (1520) dhe pasi shtypi kryengritjen Xhanberdi Gazaliut**** dhe e vrau këtë u transferue vali në Sham për randësinë që kishte ky vend, deri sa më në fund erdhi si Bejlerbej në Rumeli. Në këtë funksion qëndroi pak kohë dhe, si shpërblim të meritave të tij, u suell

në Stamboll 929 h (1522) me gradë të vezirit të tretë, tue u naltësue ma vonë n’atë të vezirit të dytë. Prap u ndodh me sulltanin n’ekspeditë kundra Rusisë, bani edhe këtu shumë shërbime, por s’dihet se si, ra në mëni të sulltanit, humbi gradat dhe u zmbraps, por mandej u fal, tue iu kthye kështu gradat e funksionet. Mori pjesë n’ekspeditë të Moldavisë ku u përpoq me çdo mënyrë dhe si ndër lufta ashtu dhe të tana çështjet e lidhuna me funksionet e tija zyrtare dhe dha shërbimet e tij deri sa u çque me të drejtë në Kubbe-Vuzerasë*****. Kështu mbas një jete shërbimesh besnike, hypi në selinë e kryeministrit, në vend t’Ibrahim Pashës, i cilësue në këtë seli prej një periode të gjatë katërmëdhjet vjet, gjatë vdekjes së pa pritun në vitin 942 h (1535).

Ajas Pasha në këto pozita ma të nalta të mbretënisë punonte me drejtësi pa i ba kam kërkujtë. Në të tretën vjet të funksionit të tij si kryeministër vdiq prej murtajës, që në formë epidemie ra në Stamboll. E vetmja e mbetë e këtij njeriu, i drejtë, i urtë e bamirës qe emni i tij që arrijti deri më sot ndër veshë tanë me emnin e lagjes “Ajas Pasha”, në Stamboll, mbi Kabatash, në një kodër përballë detit, qe prirja e tij ndaj seksit femnor.

*Në periudhën klasike të Perandorisë Osmane Sadr-ı âzam quhej personi që kryente detyrat më

të larta administrative pas sulltanit. Me modernizimin e aparatit administrativ ky emërtim u sinjifikua me postin e kryeministrit.

****Enderuni** ishte pjesa e brendshme e oborrit perandorak. Ai u themelua në periudhën e sulltan Muratit II (1421-1451) dhe shërbeu si një shkollë për përgatitjen e kuadrove të lartë të perandorisë që merreshin si devshirme nga vise të ndryshme.

*****Biruni** ishte pjesa e jashtme e oborrit perandorak. Nëpunësit e Birunit merreshin me zgjidhjen e problemeve të ndryshme të shtetit osman.

******** Në vitin 1421 Xhanberdi Gazaliu në kohën që ishte Bejlerbe i Shamit u rebelua ndaj sulltan Sulejmanit.

*******Kubbe Vuzera** ishte organi më i lartë ekzekutiv që në këtë periudhë sinjifikohej me qeverinë osmane.

Lutfi Pasha (1488 ? – 27.3.1564 Dimetoka): Autorët osmanë e qesin prej Shkodre, ndësa Hammer* e tregon Vlonjat. Arriti me këcye deri në seli kryeministore. Qe vali në Sham, dhe mandej u suell në Stamboll si shpërblim të meritave të tij në punë, me gradë Kubbe-Vuzera. Mori pjesë në një ekspeditë kundra Venedikut. Qe dhëndërr i sulltan Selimit I.

Lutfi Pasha erdhi si kryeministër në vend të Ajas Pashës, qe njeri me

kulturë. Qe shumë i ndershëm. I preu organin gjenital një grueje që e diktoi në kurvëri. Bile, kjo vepër e egër e tij arriti sa m'u bisedue dhe në Saraj të sulltanit dhe veçanërisht me gjet kundërshtim tek e shoqja e tij, motra e sulltan Sulejmanit. E Lutfi Pasha, në hov të nervozitetit, që asht një cilësi shpirtnore e shqiptarit, mësyeni të shoqen e cila mundi t'i shpëtoj në saj të xharijeve dhe agallarëve të haremit që hynë ndërmjet. Por kjo ngjarje shkaktoi pushimin e tij, mbas tri vjetësh të shërbimit të tij si kryeministër (13.7.1539 - prill 1541). I larguem prej jetës politike u tërhoq në Dimetokë (Edrene) dhe këtu u mor me studime, dhe shkroi disa vepra. Vdiq në vetmi në vitin 1564, Hammer-i flet me mburrje për të, për aktivitetin e tij kulturorë.

*Jozeph von Hammer (1774-1856) historian austriak, diplomat dhe specialist i problemeve të Lindjes. Ai është autor i një studimi disa vëllimesh mbi historinë e Perandorisë Osmane.

Kara Ahmed Pasha (? – 28.9.1555 Stamboll): U muer me harem si zakoni që ishte atëherë dhe në pak kohë përparoj ndër nëpunsina të ndryshme derisa mbeti aga (komandant) i jeniçerëvet, Bejlerbej i Rumelisë dhe mandej në kohë të sulltan Sulejmanit u suell në Stamboll me gradën vezir. Fitoi dy lufta: Kundër Persisë e kundër

Austrisë në Temeshvar*, sa që ma mbrapa u thirr “Hero i Temeshvarit”. Në një kryengrite të jeniçerëvet u emnue kryeministër (6.10.1553-28.9.1555). N’ushtri vuni qetësi. Për shkak t’intrigavet të rivalëve të tij u dënue me vdekje dhe u ekzekutue në vitin 962 h (1555). Qe një vezir i patundun, i drejtë e inteligjent.

*Temeshvar - qytet në pjesën perëndimore të Rumanisë, sot mban emrin Banat.

Ahmed Pasha (1492 Shqipëri – 24.4.1580 Stamboll): Në kohë të sulltan Sulejmanit u ba Kapëxhë-Bash (një gradë n’oborr Mbretnorë, si shambelan sot-J.T.). Jeniçeri-agasë (Komandant i Jeniçerëvet), Bejlerbej i Anadollit, Bejlerbej i Rumelisë, Kubbe-Vuzera dhe ma në fund kryeministër (11.10.1579 - 28.4.1580). Në pikëpamje dijenije qe mesatar. Vdiq në vitin 1580.

Koxha Sinan Pasha (1520 – 3.4.1596): Në kohë të sulltan Muradit të III e Mehmedit të III (1577-1610) pesë herë u ba kryeministër, mbasi për deri sa arriti këtu pati funksione të ndryshme shtetnore. Mori pjesë dhe ndër shumë luftra tokësore e detare. Vdiq në vitin 1596.

Ferhat Pasha (? – 1595 Stamboll): I dashur nga Haremi-Humajun*, pati një mbas një kto funksione: Kapëxhë-Bash,

Mirahor** i parë dhe aga i jeniçerëvet. Mbasi u pushue një herë u muer prap në shërbim si Bejlerbej i Rumelisë dhe u thirr në Stamboll me gradë vezirniye. Mbasi u pushue dhe një herë, ma mrapa u emënue si kryeministër (1.8.1591 – 4.4.1592). I emnuem si Serdar*** në luftën kundër Vllahisë, kur po ndiqte një urë mbi Danub u pushue befas. Në vend që me u kthye në Stamboll, u mshef në çiflikun e vet që kishte aty afër, por mandej doli, sepse ndërmjetësuen për të Kajmekani i Stambollit Ibrahim Pasha dhe nana-mbretneshë. Me gjithë këtë, u ekzekutue. Qe një person aktiv e trim. U ekzekutua në vitin 1595.

*Në turqishten osmane Harem-i Hümayun. Këtu e ka fjalën për familjen perandorake osmane.

**Mirahor quhej personi i cili kujdesej për kuajt e oborrit perandorak.

***Kryekomandant.

Jemishçi Hasan Pasha (? – 4.10.1603 Stamboll): Në vitin 984 h (1576) hyni në grupin e Zylyfli Ballaxhivet (një repart ushtarak), mandej me rend u ba Kapëxhllar-Ket’hudasë, Cashneqir-Bashë, Kapëxhë-Bash e Jeniçeri-agasë; Vezir e kryeministër (10.7.1601 – 24.9.1603). Në vitin 1012 h (1603) iu pre koka.

Hasan Pasha (? – 20.5.1622): Është djalë i një spahiu prej Ohri. Karriera e tij fillon me një shërbim në kopshtin mbretnor, mandej emnohet aga i jeniçerëvet, Bejlerbej i Rumelisë, Kubbe-Vuzera e ma në fund kryeministër (9.3.1621 – 17.9.1621). U vra në një kryengritje që shpërtheu në Stamboll, ku pat gjetë vdekjen dhe vetë sulltan Osmani II, në vitin 1031 h (1622).

Hysejn Pasha Mere (? – korrik 1624 Stamboll): Erdhi në Stamboll dhe punoi si gjellëbamës, iu qas Sturxhi Mehmed Pashës dhe u ba kryegjellëbamës i tij. Mandej u regjistruë si spahi. Kohët e turbullta që vazhdojshin në Perandori, favorizojshin aventurierët guximtarë me u futë ndër shërbime qeveritare. Një ndër këta qe dhe ky Hysejn aga. Dalë kadalë nisi të bëj karrierë, çaush, Sokak-Silahdar, Agnam-Enimi, Kapëxhë-Bash, Kauxhullar Ket’hudasë, Mirahor i dytë, vali i Misirit e ma në fund kryeministër (13.6.1622 – 8.7.1622 dhe 5.2.1623 – 30.8.1623). U ekzekutue kur hypi në fron sulltan Muradi IV, në vitin 1033 h (1624). Qe një tiran dhe pa një edukatë të shëndoshë*.

*Mbiemri i Hysejn Pashës “Mere” i ishte vendosur nga urdhri që ai jepte për t’ju prerë koka personave që ai e shikonte të arsyeshme. Hysejn Pasha ishte i vetmi kryeministër që nuk dinte turqisht, prandaj urdhrat i

jepte në gjuhën shqipe, siç ishte edhe fjala “mere” ose merrjani kokën.

Tabanijasri Mehmed Pasha (? Tashllëxha – 1639 Stamboll): Erdhi në Stamboll për të kërkue jetesën dhe u vendos pranë Haxhi Mustafa agait, aga i Stambollit, me ndërmjetësimin e të cilit dhe për hirë të zellit, të besës e t’inteligjencës së vet nisi karrierën e tij si Myteferrika. Kapëxhëllar-Ket’hudasë, Mirahor, vali i Misirit dhe ma në fund, në vjetin 1041 h (1632) kryeministër (18.5.1632 – 2.2.1637). Tue pasë këtë funksion të fundit, u ngarkue edhe me shërbime tjera. Por, viktimë e një intrige u burgos dhe pak më mbrapa iu pre koka 1049 h (1639).

Kemankesh Kara Mustafa Pasha (Vlorë ose Elbasan ? – 31.1.1644 Stamboll): Ardhurin i ri në Stamboll u fut nën sjetulla të Kara Hasan agës dhe me rekomandim të tij hyni mdis t’oficeravet të Jeniçerëvet si çorbaxhi për zotësinë që kishte në të hudhun të shigjetave. Në pak kohë u ba Kull-Ket’huda, Sekban-Bash e aga i Jeniçerëvet. Në këtë cilësi vuni rregull e disiplinë në oxhak te jeniçerëvet dhe riorganizoi këtë ushtri që kishte fillue të dalë dore. Në vitin 1048 h (1638) u emënuë kryeministër (23.12.1638 – 31.1.1644) për meritat e tija që iu çmojshin fort prej sulltanit. Flij e një intrige iu pre koka në vitin 1053 h (1644). Njeri aktiv, la shumë vepra, si medrese, xhami, hamam e tjera.

Kara Murad Pasha (1611 – 19.8.1655 Hama-Siri): Mbasi pati nëpunësina të ndryshme, dy herë u emënue kryeministër (21.5.1649 – 19.8.1650 dhe 11.5.1655 – 19.8.1655). Dhe ky qe ndër asi aventurierësh guximtarë që koha i favorizonte. Por trimnija e tij qe shkak që pati pozita të nalta. Ia doli me fitim ndërrmarrjeve që morri ne luftën e Gjiritit dhe kundër venedikasvet që kishin rrethue Stambollin me flotë të tyne. Kur për të tretën herë dha dorëheqjen si kryeministër dhe po shkonte në Sham, i emënuem atje, si vali, vdiq rrugës.

Tarhonxhu Ahmed Pasha (? – 21.3.1653 Stamboll): Është prej Mati. Ardhun i ri në Stamboll, dhe kur Silahdari* mbretnorë Musa agai po shkonte n'ejale të Misirit, dhe Ahmed agai u bashkue me të. I dalluem për zell e besnikëri, pati nëpunësina të ndryshme deri sa u ba kryeministër në vitin 1062 h (1652). Ma në fund nga intrigat e shokëveve iu pre koka. Me gjith se analfabet qe një administrator trim e i besës.

*Silhdar ishte personi i cili kishte si detyrë mbrojtjen dhe përkujdesjen e armëve të pallatit sulltanor.

Arabaxhi Ali Pasha (? Ohër – 1693 Rodos): Është nga Ohri. Mbiemnin e ka Behadrizade. Qe i karrierës s'ilmijes*, por mrapa mori punësina shtetnore të ndryshme

deri sa në vitin 1103 h (1691) u ba kryeministër (19.8.1691–27.3.1692). Në vitin 1104 h (1693) iu pre koka. Qe njeri i dijtun por zemërak e i egër për natyrë, vese këto që i atribuohen karakterit nervoz të kombit shqiptar.

*Me termin Ilmiye (Ilmiye) quhej klasa e dijetarëve dhe e hoxhallarëve të nivelit më të lartë të Perandorisë Osmane.

Dalltaban Mustafa Pasha (? Manastir – 27.1.1703 Stamboll): Mbasi pati funksione të ndryshme dhe ushtarake, në vitin 1113 h (1702) iu dha vula e kryeministrit (4.9.1702 – 24.1.1703). Kishte një natyrë të çuditshme si të çuditshme ishin dhe punët që dilshin nga dora e tij. Iu ndërroi veshjen gravet myslimane, kristjane e çifute, urdhënonte me iu dhanë njëmij shkopinj atyne që bajshin një fjalë të vogël. Kujtonte se me terror rregullohen punët. Por me këto vepra shkaktonte ankime të shumta kundra tij. Mbrenda një kohe të shkurtë 4 muejsh ç'prej se u emënue kryeministër u pushue, u burgos dhe mbas tri ditësh iu pre koka, tue iu konfiskue edhe pasunija.

Halil Pasha (? – 1733 Gjirit): Është prej Elbasani. Erdhi në Stamboll te vëllau i tij Sinan aga, që ishte Bostanxhibash* dhe me intervenim të tij u shkruie n'Oxhak (n'ushtri të jeniçerëve-J.T.). Si shërbeu ndër funksione të ndryshme,

u emënue Serdar** dhe kryeministër (5.8.1716 – 26.8.1717). Vdiq në vitin 1146 h (1733), tue qenë në një moshë ma se tetëdhjetë vjeç. Kishte natyrë dervishi, modeste e fetar. Por njëkohësisht një dijetar shteti bamirës. Afër trembëdhjetë muej qëndroi si kryeministër.

*Bostanxhibashi (Bostancıbaşı) ishte kryekopshtari i pallatit sulltanor, njeriu që merrej me përkujdesjen e pjesës së jashtme të pallatit dhe me kalimin e viteve edhe me mbrojtjen e tij.

**Serdari ishte kryekomandant në ushtrinë osmane.

Memish Pasha (? – 8.7.1809 Sakëz Adasë): Memish Pasha që zuri vendin si kryeministër (19.11.1808 – 1.1.1809) mbas ngjarjes tragjike të vdekjes të Alemdarit në kohën e sulltan Mahmudit, pati ardhë tue qenë ende i ri në Stamboll dhe tue pasë një shërbim të disa personaliteteve, mësoi pak me këndue e me shkruë, ndërsa titulli “agë” që kishte, iu shndrue në “efendi”. Pasi pati disa funksione, iu dha grada e vezirnisë bashkë me vulën e kryeministrit. Por tue mos qenë i zoti me i ardh rreth një funksioni kaq me rëndësi, mbas dyzet ditësh t’emënimit u pushue, iu mor grada e vezirnisë dhe u internue një herë në Bursa e prej këtu i internuem u transferue në Sakëz, ku dhe vdiq. I pazoti në punë, i pafat, i butë dhe i drojtun për t’i ba keq kujt.

Mustafa Nail Pasha (1798 Polenë - 1871): Mustafa Nail Pasha, i cili njihet me emnin Gjirithi pse pat ndej në Gjirit si vali gati tridhet vjet, asht i biri i Ismail Beut, parësi e Bilishtit të Korçës. Në vitin 1242 h (1826) u emënue vali në Gjirit, ku u përpoq me vu qetësi në këtë vend ku qetësia ishte prishun nga brigandazhi i vendsavet. Ia arrijti me i sigurue ishullit qetësinë dhe shtini në dorë Haxhi Mihalit, shefin e rebelëve. Në saj të zotësisë së tij shpëtoi Gjiritin, megjithse i blloquem nga flota ndërkombëtare. Në vitin 1256 h (1840) u ba vezir e myshir* dhe u emënue kryeministër (6.8.1857 – 22.10.1857). Qe i zoti i punës, besnik e trim. Shum i pasun, por dhe në këtë përpjestim bujarë sa me u ba legjend bujaria e tij.

*Myshir ose marshall ishte grada më e lartë në ushtrinë osmane.

Ferid Pasha (1851 Vlorë – 1914 San Remo): Prej Vlore njeri me kulturë. I shërbeu mbretërisë në funksione të ndryshme. Më 12 janar 1318 h (1902) u emënue kryeministër (15.1.1903 – 22.7.1908). Qe dhe antar i Senatit e Ministër i Brendshëm. Vdiq në vitin 1914.

Mirahor Eljaz beu (? Panarit - 1512 Korçë): Eljaz beu që njihet si themelues i Korçës, ka lind në Panarit, një ndër katundet e Përmetit.

Në ekspeditën kundër Shqipnisë të Muradit II, hyni në shërbim të tij, u ba mysliman dhe si nën mbretënimin e këtij Padishahu ashtu dhe nën atë të pasardhësit të tij Muhamedit II. Pati shkollë, nëpunësina të ndryshme, tue marrë pjesë edhe në rrethimin e Stambollit. Një xhami afër Jedi-Kul'le-s (Stamboll), që tue qenë kishë e shndroi ai si t'atillë me leje të Padishahut mori emnin Xhamija e Emir-Ahurit ose Xhamija e Kishës. Për mbi këtë asht një Dergjali (Teqe) Synbylishë. Pushtuesi i Stambollit Mehmeti II, për besnikëri e zotsi të tij e emënoi si Llalla (kryekujdestar-J.T.) të djalit të tij Bajazidit II. E kur hypi ky në fron, iu dha titulli Mirahor (princ i stallavet, një titull ndere i naltë në Perandorinë Osmane-J.T.), dhe kështu me këtë u ba i njohun në histori të mbretënisë. Mirahur beu i cili gëzoi kaq tepër simpatinë e sulltanit, u ba dhe një ndër favoritët e tij tue iu falë disa katunde si maliqane (domene) disa katunde në vendlindjen e tij. Eljaz beu por sa u kthye n'atdhe të tij bleu një kishë që ishte e ndërtueme në një vend fort të bukur të domenës së tij dhe e shëmbi këtë tue ngrehë në vend të saj një xhami e aty afër një ndërtesë dhe një imaret'hane (haspie). Me ngrefjen e këtyne ndërtesavet vuri themelet e qytetit të Korçës. Mbrapa u emënuë vali në Janinë dhe pati disa funksione të tjera shtetnore. Domenin e vet si dhe vlijte-in (kujdestarinë e vakufetve) ua la djemëvet të tij, kështu që edhe

sot administrohen, kjo domenë e këto vakufe nga bejlerët e Korçës që janë trashëgimtarët e tij.) Eljaz beu konsiderohet nga vendasit si një shejt. Në popull ka nxanë vend një legjendë si mbas të cilës kur sulltan Bajazidi e ka nderue tue shti në radhë të favoritëve të tij, e ka urdhënue me marrë një kalë prej stallavet perandorake dhe i ka premte se do t'ia njihte si pronë të tij private ato toka që do t'i shëtiste ai me kalë mbrenda një afati të caktuem. Eljaz beu mer një mushkë të shpejtë dhe bredh ndër tokat e dëshirueme, por, si mbaron qarkullimin mushka pëlcet e bahet mbrapa gurë tue i dalë ujët curil nga kurriza. Afër Korçës ka vërtetë një gurë, në këtë trajtë, nga i cili, gadi në mes del një ujë mineral i bardhë si shkum. Këtë gurë populli i vendit e mer për mushkën e Eljaz beut që plasi e u gurzue. Këtë legjendë krijoi përgjasim i gurit me mushkën dhe kjo kaloi gojë në gojë ndër brezni të ardhme nga mbrapa. Eljaz beu vdiq në vitin 917 h (1512) dhe u varros në një tyrbe që qe ndërtue apostafat në Korçë. Ma i madhi ndër dy djemt e tij, Ajna beu ra dëshmor në luftë të Bagdatit. Një xhami afër Jeni Kapësë në Stamboll mban emnin e tij. (Ky përshkrim biografik u përkthye *at literam*, mbasi ban pjesë integrale të historisë së qytetit të Korçës-J.T.)

Hamza Beu: Është nipi i të famshmit Skandërbeg. Tue qenë edhe në moshë të re u muer peng bashkë me vëllanë at botë që qe

marrë peng Skëndërbeu; u edukue në saraj mbretnor dhe këtu u ba Islam Hamza beu i edukuem si mysliman, në të cilin mishnoheshin gjith aftësitë, iku nga saraj mbretnor bashkë me Skëndërbenë, dhe në fuqitë ushtarake që organizoi ky, bashkë me të marrë komandën nga shkakun se ushtarët osmanë nuk ishin mësue me luftë ndër vende malore, ata psojshin disfatë, nër të cilat kishte rolin e vet pozitiv edhe Hamza beu. Por, shkak ambicjesh, Hamza beu nuk e pa t'udhës të qëndrojë ma në Shqipni e pranë ungjësve të vet, dhe u paraqit e kërkoi strehim te sulltan Mehmeti, i cili nën komandë të tij e t'Evrenos-zade-Isa beut çoi në Shqipni një fuqi prej 40.000 kalorësish. Të parat ndeshje u kryqëzuen me sukses të tyne dhe Skëndërbeu u shtrëngue me u tërhjek në Lezh që ishte nën sundim të Venedikut. Por Skëndërbeu për hirë të aftësive e të dredhive të tija, fitoi ma në fund ndër këto luftime të përgjakshme që u zhvilluen midis dy ushtrinave, Isa beu ra i vraun e Hamza beu rob. Padishahu kërkoi nga Skëndërbeu t'ia kthente Hamza benë kundrejtë një shpërblimi. Skëndërbeu nuk deshti njëherit t'ia lironte, por Hamza beu premtoi se por sa t'arrinte në Stamboll do të merrte të shoqen e fëmijtë dhe do të kthehej. Atëherë Skëndërbeu e liroi. Por Hamza beu pak mbas liritimit vdiq, e premtimi i tij mbet pa u çu në vend. Por simbas një konjekturë që

mund të përligjet Hamza beu duket se bani këtë premtim për t'i shpëtue kularit të robnisë; pse, në kryeqytet e nën roje si do t'ishte ai, nuk ishte punë e lehtë t'arratisej bashkë me familjen. Por Skëndërbeu e liroi atë për të mos egërsue sulltan Mehmetin, në fakt kishte bindjen dhe sepse ai nuk mund t'i sillte ndonjë dam. Pra Skëndërbeu ia pranoi propozimin sulltanit e para se nuk do të humbte gjë nga lirimi dhe e dyta se për kokë të tij do të jepeshin të holla. Kështu mundi Hamza të jetë bej.

Ahmed Pasha (? – 1524 ?):

Në moshë të vogël hyni në saraj mbretnorë dhe arriti shkallë shkallë me pasë funksione të ndryshme deri sa me funksion të agait (komandant) të jeniçerëve, u bashkue me dijetarët e Birunit (në Birunë hyjnë tanë ata që dolën nga pallati me funksione të alta-J.T.). Për shërbime të mira e zellë që tregon në luftë të Bagdatit u ba Bejlerbej i Rumelisë e mandej hyni në radhë të Kubbe-Veziravet. Mrapa shkoi si vali në Misir. Këtu desht me sigurue për vehte autonominë e Misirit, por në kryengritjen që bani u mund, iku dhe iu pre koka. Në këtë vepër u mbiquejt "hain" (tradhtar-J.T.), me të cilin propozim hyni në histori: Tradhëtar-Ahmed Pasha. Qe njeri guximtar dhe do të përfitonte prej tij të mos që kryenaltë e ambicioz.

Ferhad Pasha (? – Tetor 1595 Stamboll): Vezir i dy sulltanëve, i Javuz Sulltan Selimit dhe i Kanuni Sulltan Sulejmanit, Ferhad Pasha, i edukuem në saraj u ba agai jeniçerëve dhe mandej Bejlerbej i Rumelisë për shërbimet që bani në të shuem të një kryengritje n'Anadoll, e cila gati pat marrë përpjestime të rrezikshme për Perandorinë, e mbrapa Bejlerbej i Shamit. U tregue i guximshëm në ekspeditën kundra Hungarisë dhe si shpërblim u emënu kryeministër (1.8.1591 – 4.4.1592 dhe 16.2.1595 – 7.7.1595). Në fund për veprimet arbitrare e t'egra që zhvilloi në popull në lidhje me funksionet që pati, iu pre koka, pa u marrë para sysh hirin që gëzonte prej sulltanit. Qe një ndër vezirët shumë i zoti.

Turhan Bej: Hyri në shërbime të Perandorisë dhe shkallë shkallë pati arritje ndër funksione të ndryshme, deri n'Janinë (dinjitar shteti). Në Delvinë u emnue Bej (guvernator). Vdiq në vitin 960 h (1552). Qe njeri bamirës, në Malkadra la shumë vepra bamirësie.

Dervish Çelebi: Në vitin 987 h (1579) u ba Reisulkittab (si ministër i Jashtëm sot-J.T.); por tue mos qenë i zoti sa duhej u pushue.

Hafiz Ahmed Pasha (Hadëm): Vali në Qipro, mandej me gradë vezirrije vali në Misir në vitin 998

h (1589), në vitin 1003 h (1594) vali në Bosnje. Në vitin 1006 h (1597) pushohet pse humbë një luftë në Danub. Por tue u marrë vesht se nuk kishte pasë faj, emënohet Kubbe-Vezir, zëvendës kryeministër. Vdiq në vitin 1022 h (1613). Qe njeri bamirës dhe la vepra bamirësie.

Hasan Pasha (Allaxha-Etli): Shkallë shkallë arriti ndër funksione shtetnore, në vitin 1001 h (1592) Bejlerbej i Kanizhes, në vitin 1008 h (1599) Bejlebej i Belgradit, në vitin 1012 h (1603) Bejlerbej i Erzurumit. Vdiq në vitin 1013 h (1604). Qe njeri trim e luftëtar.

Hasan Pasha: Në pak kohë, për zotësinë që tregoi në çdo punë që iu lëshue në dorë, mbrrijti deri në Jemerallëk. Në vitin 994 h (1585) me gradë Bejlerbeu u dërgue në Jemen, për 10 vjet që ndej këtu siguroi aneksimin e këtij vendi me perandorinë dhe rregulloi Jemenin, tue lanë përshtypje të mira ndër vendas dhe tue fitue kështu simpatinë e Padishahut, i cili në shpërblim të meritavet të tija e emënoi atë vali në Misir. Hasan Pasha dhe këtu ndej ma se 10 vjet, dhe kjo kohë e funksionit të tij qe për të e ndritun dhe për Misirin e dobishme. Tue e pasë kënaqë Padishahun sukseset e Hasan Pashës në çdo shërbim që ju besue, Padishahu e ftoi në kryeqytet me funksionin e naltë si Kubbe-Vuzera. Vdiq mbas gjashtë muajsh

që erdhi në Stamboll. Qe trim, bujar, modest e sidomos trim. Është i varrosun në varrezat e xhamisë Alikë Ali Pasha në afërsi të Çenberlitashit.

Muhiji Bej: Muhiji bej erdhi i vogël në Stamboll me qëllimin që të lehtësonte vuajtjet e jetesës që kishin randue në vendin e vet dhe hyri në Marinë ku provoi zotësinë e tij deri sa sulltani për meritat e tij e emënoi Bej në Tarabullus (Tripoli). Por s'dihet për ç'arsye, u pushue, u ftue në kryeqytet dhe u emënue në Tersane*. Por ky dizgrac nuk e demoralizoi, punoi, kreu detyrat e veta ndaj atdheut, dhe ma në fund tue i çmue zelli e puna u emënue Bejlerbej i Rodosit në vitin 1018 h (1609) dhe korri sukses në punë. Vdiq heroikisht në një luftim detar.

*Tersane ishte vendi ku riparoheshin anijet e flotës ushtarake osmane në Stamboll.

Mustafa Efendi: Është prej Horpishit të Kosturit që shkon në Korçë. Ka studiue në Stamboll në medrese, prej ku ashtë diplomue. Kur ishte imam e hatib në një xhami të Qemlikut, vazhdonte mësimet e nalta teologjike. Në vitin 1010 h (1601) për kulturë e za të bukur që kishte u suell në Stamboll si imam në xhaminë që kishte ndërtue Xherrah Ahmed Pasha. Në vitin 1015 h (1606) u emënue si imam i pallatit mbretnor. Në vitin 1024 h (1615) iu

dha grada honorare Anadolli pajesi. Vdiq pa kalue akoma një vjetë mbasi u nderue në këtë gradë. Vdekja e tij dëshpëroi shumë kend, ndër këta dhe vetë Padishahun. Qe i dijtun, me moral të naltë e bujar. Kishte prirje dhe për poezi. Ka lanë vepra të shkrueme për histori e fe.

Bajram Pasha: Tue e pasë provue zotësinë e vet të jashtzakonshme ndër shumë lufttra ku mori pjesë, arrijti në gradën e komandantit dhe në vitin 1021 h (1612) u emënue Bejlerbej i Bosnjes. U pushue një herë por prap u emënue po n'atë ved, mbasi bani shërbime në luftë në vitin 1024 h (1615). Vdiq në Bosnje në vitin 1036 h (1626). Qe i zellshëm, luftëtar e trim.

Omer Pasha: U dërgua në një luftë kundër persianëve, por tue pasë nxanë këta më parë pritrat strategjike, u thye keqas në një ndeshje që pati dhe tue lanë gjithë bagazhet në dorë t'armikut mori rrugën e Mosulit. Serdari (gjeneralizmi) i zemruem si nga kjo mundje ashtu dhe nga shenjat e disfatës që u duken dhe ndër anë tjera, ia preu kokën në vitin 1038 h (1628).

Koçi beu (? - 1650): Është nga Korça. Në moshë të re ka ardhë në Stamboll dhe ka hye në saraj si aga e mbrapa ka mbrijtë në funksionin e Odabashit. Simbas zakonit t'atëhershëm Oda Bashi kishte

gjithmonë takim me Padishahun, në shërbim të cilit ishte direkt. Kështu dhe Koçi beu me këtë cilësi piquej kur ishte nevoja me sulltan Muradin IV, pushtuesin e Bagdatit, dhe i tërhiqte këtij vrejten zotnija e zgjuarsija e tij. Ajo kohë ishte ma e turbullta ku punët e mbretënisë shkojnë keq. Mbreti ishte i vogël kur hypi në fron e nevoja e donte që punët e perandorisë t'administroheshin prej nanës Mbretëreshë. Kjo gjendje ndikonte ndër veprime të shtetit, të cilat në fakt ishin ç'thurë, e mbështjellimet që kishin fillue shumë kohë më parë në këtë kohë sidomos ishin shtue. Mbrapa sulltan Murati arrijti moshën madhore dhe filloi me rregullue punët e mbretërisë me dorën e tij të çelikut. Por punët nuk ndreqeshin kurrësesi dhe kryengritjet ndiqnin njëra-tjetrën. Në këtë kohë, në pallat të sulltanit ra rrufeja dhe këtë fatkeqsi e ndoqi vdekja e trishtueshme e princave mbretnorë. Kryengritjet e anarkia në punët qeveritare, të zeza këto që pasojshin njana-tjetrën, kishin ngjallë në këdo dyshime për ekzistencën e perandorisë dhe këto ngjarje morale ma tepër se material kishin forcue këtë dyshim. Qe Koçi beu i cili i jetonte vetë këto kohë dhe kishte formue bindjen se vazhdimi i kësaj gjendjeje do t'a shtynte në shkatërrim perandorinë, pa nevojën, i shtyem nga besnikëria, me ia parashtrur Padishahut gjendjen ashtu lakuriq siç paraqitej me anë të

një projekti ku shpjegonte me prova e dokumenta shkaqet që mbajnë në këmbë një perandori si dhe ato që e tërheqin rrëshane kahë gremina 1041 h (1631), tue dhanë kështu edhe recetën si mund të shpëtonte ajo nga kjo greminë. Pushtuesi i Bagdatit (sulltan Murati IV) këtë projekt, shkruar me një gjuhë fort të qartë dhe vërtetë me një zotësi, e lexoi me atë vrejte e kujdes që meritonte dhe, për ma tepër, mori iniciativën e zbatimit të tij. Ky zbatim do t'i sillte mjaft të mira shtetit e popullit, sikur sulltan Murati të mos kishte mbetë akoma nën mëninë e hakmarrjes kundra atyne fëmijëve të përbuzjeve, përpara të cilave ishte ndodhë në fillim të hypjes së tij në fron ose sikur të ndodheshin në midis vezirëve të ministrave persona të kalibrit të madh sa me zbutë qëndrimin e egër e bile të pa nevojshëm t'atij monarku. Në rast të tillë, fatkeqsitë e s'ardhmes do të ngjajshin ndryshe nga ato që u vërtetuen. Por mjerisht, s'ndodhi kështu, e ky mbret kapidan vdiq e shkoi në një moshë fort të re. Vdekja e Muratit IV e pikëlloi në zemër Koçi benë; sepse ky n'atë Sovran shihte virtyte që do të kontribuojshin në shpëtim të perandorisë, e frikësonte atë për ma tepër e meta e fuqisë mendore e princit trashigimtarë Ibrahimit. Por u ba ç'u ba, Ibrahim i hypi në fron. Koçi beu i cili sido qoftë, kishte ngulë kambë m'e ngrejtë perandorinë nga gremina drejtë së cilës po rrokullisej, nuk rrinte der

kryq, megjithse nëpunësia e naltë që kishte; kështu i paraqiti edhe sulltan Ibrahimit një projekt të ri, mbasi ia kishte marrë fjalën ma përpara për një gja të tillë. Dhe në këtë projekt Koçi beu shtronte mendime mjaft me rëndësi dhe i çfaqte krejt haptas pikat që i dukeshin të nevojshme për shpëtimin e mbretënisë, që për të ishte kryeqëllim. Veç çka se ky Padishah nuk ishte n'atë shkallë zotësie sa m'e shpëtue perandorinë n'atë fatkeqsi ku kishte ranun. Dhe ata që mbajshin në dorë frenat e shtetit, ishin njerëz të mallkuem që s'mendojshin tjetër veç me hangër shoqishojnë. E Koçi beu i ngratë prekej thellë në shpirt kur shihte se dëshirat e tij s'po realizoheshin. Por në fund vdekja e shpëtoi këtë që të ia arrinte me ditë mjerimet që kishte përpara. Koçi beu nuk pati një punë fort të naltë shtetnore. Preukupacioni i tij qe m'u dhanë mbas ditunije. Ditunija më njen anë e mendja e tij e mprehtë n'anë tjetër e stërvitën atë ndër punë politike ma fort se ata që mbajshin në dorë frenat e shtetit. Në projektet në fjalë, ai e ka provue në kulm këtë zotësi. Mjerish i dyti ndër kto projekte nuk ekziston, ndërsa i pari fatbardhsisht ka arrijtun ndër duer tona për me dhanë një ide mbi stilin që ka përdorë në projektin e vet të parë. Koçi beu dhe mbi mendimet që ai ka shprehë n'atë projekt, po japim këtu tekstualisht pak rreshta të projektit, për ata që s'kanë dijeni mbi ekzistencën e tij:

“... shkurt, padrejtësia që po i bahet sot shtetasvet të vorfën nuk asht ba në asnjë kohë, n'as një klimë e n'as një vend. Po t'i bahet kujt një padrejtësi në një vend të botës islame, në ditën e Gjygjit të Amshuem mbretnat kanë për ty pyetur për të, e jo ministrat e tij. Nuk mundet të përgjigjet mbreti përpara Zotit se këtë punë ia kam pasë lanë në dorë ministravet. Vaji e dënesat e viktimavet shuejnë vatrë. Lotët e syvet të të shtypunëvet mbasi botën në vijë të mjerimit. “Me të pafetë qëndron në kambë bota, me padrejtësi jo”. Drejtësia të zgjat jetën. Rregullimi i gjendjes së të varfënvet u siguron parajsën mbretënvet. Këto fjalë që po i them nuk janë të mijat, janë fjalët e Ulemavet e të Shejhlerëvet. Në mos besoni, pyetni ata. Gjendja kështu qëndron. Fundi: urdhnëni i përket lumnueshmit sulltanit t'em”.

Maksut Pasha: Është nga Prizreni. Me radhë u ba Defterdar-Ket'huda, Mirahur, vali në Dijarbakër e mandej në Misir. Në vitin 1054 h (1644) iu pre koka. Qe një njeri modest e bujar. Pati një farë soj ditunije. Të mos qe përkdhelë nga padronët e vet dhe të mos qe futë në një mënyrë ekstreme ndër disa punë që nuk i përkitshin, mund t'i shërbente mjaft perandorisë.

Bektash Aga: Bektash aga me qëllim që të siguronte gjallnesën erdhi në Stamboll, hyni n'Oxhak të

Jeniçerëvet dhe këtu shkallë shkallë përparoi deri sa u ba Aga i Jeniçerëvet në vitin 1051 h (1641). Mbas dy vjetësh doli në pension. Zaten s'kishte nevojë ma për nëpunësi, se kur ishte në Oxhak të Jeniçerëvet kishte ba pare shumë dhe ishte ba mjaft i pasun. Në fakt shpenzime nuk kishte shumë dhe ishte dorë rrudhë. Në fund, u përzie në një kryengritje ku gjet vdekjen, tue iu pre koka në vitin 1061 h (1650).

Ibrahim Uzun Pasha (? – 1683 Hungari): I dalun nga oxhaku i Jeniçerëvet u ba Kukull'Ket-Huda e në 1075 h (1644) aga i Jeniçerëvet. Mori pjesë në luftën e Gjiritit dhe për shërbime që bani këtu, u emënue Kajmekam i Stambollës në 1078 h (1667). Qe vali në Budin e në Bosnje dhe kudo tregoi zotësi të madhe dhe ku ndodhi, për pak kohë vuni rend e qetësi. Kur Kara Mustafa Pasha, kryeministër vendosi me i ra Austrisë 1093 h (1682), Ibrahim Pasha e kundërshtoi, jo pse trembej prej lufte, por sepse qeveria s'ishte e pregatitun për një ndërrmarrje të tillë. Me gjithë këtë Këshilli Perandorak vendosi për luftë. Ibrahim Pasha u nis dhe rrethoi Vjenën bashkë me Kara Mustafa Pashën, i cili ishte komandant. Vjenezët u mbrojtën, Kara Mustafa u kthye, pse s'ndigjoi me mësyje si propozojshin komandantët e tjerë. Kara Mustafa Pasha mendonte m'e marrë Vjenën me uri e jo me mësymje se në këtë rasë Vjena do të

plaçkitez e Kara Mustafa Pashës s'do t'i rinte gja për vedi. Kara Mustafa Pasha për me mbulue fajin e vet për këtë disfatë ia veshi Ibrahim Pashës, dhe shtini e i preu kokën tue qenë ky në moshën 90 vjeç.

Hasan Pasha: Është prej Dibre. Në saj të suksesevet që tregoi në çdo punë që ju ngarkua, mbrijti në pak kohë me hye në rend t'Jeniçerëvet dhe për trimninë që provoi ndër lufta të ndryshme u emëruë rojtar i Ujvarit me pajë të Bejlerbeut 1095 h (1683). Qe dhe Bejlerbej i Rumelisë. Kur u thye Kara Mustafa Pasha përpara Vjenës, Hasan Pashës që ishte në kala t'Ujvarit iu prenë rrugët gjithkohë prej austriakëve dhe ushtria e tij ngeli pa buk e pa municione. Hasan Pasha me gjithë ushtri shpoi rrethimin tue dalë e tue sulmue austriakët, por mbet i vramun si ky si një pjesë e madhe e shokëve të tij në vitin 1096 h (1684).

Hasan Pasha (Kanakxhi): Ende tue qenë i ri erdhi në Stamboll për të fitue bukën dhe i mbrojtun prej musahib (titull funksioni në pallat-J.T.) Mustafa Pashës u ba qehaja i këtij. Në vitin 1092 h (1681) me cilësi Kankxhiu shkoj Mytesarrif në Çermen e në 1094 h (1682) Bejlerbej i Kanizhës; mbrapa u transferue në Sajda. Vdiq në vitin 1098 h (1687).

Hasan Aga (Çollaku): Ka hye në moshë të re në Oxhakë të Jeniçerëve të Zagaxhi-bash e 1095 h (1683) Kull-Ket'huda. Shkruan se ish i smuet e nuk kish fuqi t'i shërbente shtetit, u pushue mbas një vjeti, por me qenë se u shërue u muer prap në shërbim, dhe u gradue si aga i Jeniçerëve në vitin 1097 h (1685). Por i smuem prap, u nxuer në pensjon e mbas pak kohe vdiq.

Ahmed Pasha (Burunsız-i pahunda-J.T.): I edukuem në Oxhakë të Jeniçerëve, u emënuë një herë Kull-Ket'huda e mandej dy herësh Sekban-bash*. Tue pasë kundërshtue ekspeditën e Vjenës, u qit në pension. Por u mor prap në shërbim me ndërmjetime në Kandjes. Megjithatë ishte i ndaluem shitja e drithit ndër vende armike, iu shiti Gjenezizvet 40.000 akë grunë nga një flori (s'dihet sa ish vlefte e kësaj monedhe-J.T.) aken. Sulltani i irrituar nga kjo vepër e tij, dha urdhën të vritej, dhe u vra.

*Sekbanbash-i ishte një garnizon ushtarak i lidhur me korpusin e jeniçerëve. Në rastet kur komandanti i jeniçerëve nuk ndodhej në Stamboll, ai ishte i ngarkuar me detyrën e mbrojtjes së qytetit.

El'Haxhi Zulfikar Pasha: Në vitin 1080 h (1669) Kull-Ket'huda, në vitin 1085 h (1674) sekbanbash, ku qëndroi 9 vjet. Në vitin 1094 h (1682) u gradue aga i jeniçerëve.

Tue pasë shërbye mirë në detyra që pati, pa kalue dhe dy vjet arrijti m'u ba Kubbe-Vuzera, shkallë kjo ma e naltë ndër funksionet e shtetit. Por në atë kohë tue pasë marrë randësi ishulli i Sakëzit (Kio) dhe Kandja, u dërgue atje një mbas një si rojtarë në vitin 1098 h (1686). Në vitin që shkojë atje ushtria që ruente kalanë e Kandjes organizoi një revoltë kundra komandantave të vet, kështu që i vrau këta të gjithë, ndër të cilët dhe El'Haxhi Zulfikar Pashën.

Mustafa Pasha: Mbasi hyni në shërbimin qeveritar, në vitin 1100 h (1688) u emënuë Allaj Beg i krahut të majtë e mbrapa mytesarraf i Allaxha Hisarit; mbrapa, pa kalue dhe një vjetë, u gradue Bejlerbej i Rumelisë. Mustafa Pasha, u pa se po i çmohet shërbimi vendosi m'u sakrifikue tue dhanë ma në fund jetën në luftë në vitin 1102 h (1690).

Koxha Halil Pasha: Një kohë të gjatë qe komandant i ushtrivet në Bosnje. Mandej Bejlerbej i Tarabullus Shamit, serasqer i Moresë me rang vezirniye, serdar në Hungari në luftën kundra Austrisë në vitin 1102 h (1690). Së dytit herë prapa serasqer në More, ku qëndroi 4 vjet e mandej doli në pensjon nga shkaku i moshës së kalueme. Pa kalue dhe shumë kohë në pension vdiq.

Abdurrahman Pasha: Hyni i ri n'ushtri t'jeniçerëvet dhe në vitin 1079 h (1668) u emënue aga i kësaj ushtrie. Megjithse disiplina ishte prishun në këtë ushtri, Abduhrrahman Pasha kreu me sukses detyrën e tij dhe si shpërblim në krye të gjashtë vjetëve si aga i Jeniçerëvet, u emënue vali i Bagdatit tue iu pasë qenë dhanë dhe grada e vezirnisë. Prej këtui transferue në një detyrë ma me rëndësi, vali i Misirit në vitin 1087 h (1676) e në vitin 1092 h (1681) u transferue vali në Bosnje. Abduhrrahman Pasha, në za për trimni, u emënue ma mbrapa rojtar (komandant garnizoni) në Kamenicë, mbas dy vjetësh vali në Budin, kryeqendër e Hungarisë, vali në Halep, tue pasë dhe gradën e serdarit të Hungarisë, në vitin 1097 h (1685) për së dytit herë vali i Budinit ku edhe u vra në vitin 1098 h (1686).

Sulejman Pasha: Qe emënue bej i vilajetit, e mandej rend mbas rendi mytesarif në Shkodër, në Ersekë, në Delvinë dhe në Elbasan. Kudo u tregue besnik dhe i zellshëm, deri sa, në vitin 1107 h (1695) u emënue vali i Rumelisë me gradë vezirniye, mandej komandant garnizoni në Tamishvar e në Nish. I qitun në pension nga mosha e kalueme, vdiq mbas dy vjetësh.

Adem Pasha: U emënue Sevendatë-Bashbogu (komandant i rojës së shtigjevet-J.T.), në vitin 1106

h (1694) mytesarif në Ohër, në vitin 1107 (1695) në Elbasan e në 1112 h (1700) në Delvinë.

Ejup Pasha: E para nënpunsi e tij Ket'huda pranë Koxha Halil Pashës, mbrapa me ndërmjetësi të zotënisë (të padronit) të tij u emënue Kapëxhë-Bash. Mandej Mirmiranë, serasqer në More me gradë vezirniye e vali në Selanik. Mbas dy vjetësh vali në Anadoll e prej këtui në Konjë. Vdiq në vitin 1113 h (1701-1702) tue qenë në këtë vend. Qe trim e i zoti në punë.

Bektash Mehmed Pasha: Si hyri në shërbim të shtetit, u fut në rradhë të ylemavet, dhe u dallue sidomos në shërbimet që bani n'anë të Bosnjes. Përherë u ndodh ndër kufij dhe mori pjesë personalisht ndër të ndeshuna (luftime) që vazhdojshin pa pushim dhe gjithmonë, me pjesmarrjen e tij luftimet përfundojshin me fitim për osmanllijtë. Kudo i kishte sigurue vehtes nderim, kështu që, ma në fund, Stambolli dëshroi t'a gradonte dhe prandaj u thirr në kryeqytet dhe u emënue rojtar (komandant garnizoni) në Jallovë ku ndei disa vjet e mandej u gradue vali në Janinë në vitin 1108 h (1696). Mbas një viti mori pjesë në lufte të Sitnes ku edhe u vra në vitin 1109 h (1697). Qe trim e njëkohësisht dashamirës i shtetit.

Bejli Hysejn Pasha: Hyni në pallat perandorak dhe direkt në shërbim të sulltanit. Pak më vonë u emënue Kahvexhi-bash, por dëshira e tij qe me i shërbye mbretnisë ndër fusha lufte. Kështu gjeti rastin me i marrë pëlqimin sulltanit, i cili e emënoi aga (komandant) i kavalerisë në vitin 1090 h (1679). Mbrapa, në vitin 1098 h (1686) Bejlerbej i Tarabullus Shomit, në vitin 1100 h (1688) mytesarraf në Qengri, në vitin 1102 h (1690) Bejlerbej i Shehrizarit. Vdiq në vitin 1106 h (1694). Qe shumë zemrak, prandaj kur e deshti nevoja me punue me egërsi ia doli qëllimit e humbi aty ku duhej butësi e xhentesë. Ky karakter i tij rridhte nga injoranca që kishte.

Kapllan Mehmed Pasha: I njohun për trimninë e tij të jashtëzakonshme, të cilën e provoi ma në fund tue dhanë jetën, Kapllan Mehmed Pasha qe i klasës së pasanikëvet e të fisnikëvet që thirreshin “ajanë” (notabël). Ishte një sistem që kishte provue shteti osman me marrë në shërbim persona të tillë, të cilëve iu ishte provue besniknija. Ky sistem i solli të mira dhe të liga perandorisë, sepse shpesh njerzit e arrijtun me pasë influencë nga përkrahja që kishin e përdorën këtë influencë në dobi të tyre e në dam të perandorisë. Por Kapllan Mehmed Pasha qe ndër ato që i përkiteshin kategorisë së parë, kështu i bani perandorisë shërbime

të mëdha. Qe muhafëz (rojtari) në Vlonë dhe Mirmiranë dhe ma në fund u vra në luftë të Seutenës (?) në vitin 1109 h (1697).

Xhafer Pasha: Pinjoll i një familje të njohun e fisnike mori pjesë si vullnetar ndër shumë lufta kur erdhi në moshë me kapë pushkën. Kudo u dallue për trimninë e tij, e cila i siguroi një famë sa që si shpërblim iu dha mutesarrafliki i Vlonës me gradën Mirmiranë. Si në luftë u tregue i zoti dhe n’administratë, kështu u emënue me gradën Bejlerbej i Rumelisë në vitin 1102 h (1690). Mbas një viti u dërgue në sanxhak të Qastendilit, ku qëndroi pesë vjet e mandej iu dha valilleku i Rumelisë në vitin 1108 h (1696). Në vitin 1109 h (1697) u vra në luftë.

El’Haxhi Ali Pasha: Ndër dinjitarët më në za. Për zellë e trimni të tregueme, si pat hye në radhë të dinjitarëvet qe emënue mytesarraf i Hersekës. Në vitin 1105 h (1693) ra rob në luftë, por mandej i liruem në vitin 1114 h (1702) u emëruet mytesarraf në Karasi, mandej në Qastendil, mbrapa vali në Nigebollu (Nikopolis) e ma në fund rojtari n’Ajne Bahti (Sepanti) në vitin 1123 h (1711) del në pension dhe pa kalue shumë kohë vdes në Midili (Mitelenë).

Osman Pasha: Ardhun në moshë të re në Stamboll u fut në Oxhak të Jeniçerëve, dhe dalëkadale tue iu çmue zelli e besnikërija iu dha grada e Zagarxhi-bashit, mandej në vitin 1114 h (1702) Kull'Ket'huda e pa kalue një vjet aga i jeniçerëve mbrapa, tue iu njoftë zotësia e urtësia iu dha grada e vezirnisë. U emënue vali në Sham, tue pasë në ngarkim dhe imaretin e Haxh'xhit. U pushue prej këtu dhe qëndroi në pushim në Tarabullus Sham 7-8 vjet, mandej u emënue vali i Anadolit. Mbas një vjet shërbim u pushue prej këtu e, tue qenë në moshë të kalueme, u nxorr në pension me dëshirë të tij. Banoi në Bursa ku dhe vdiq. Ishte i zoti ndër punë shtetnore, puntorë dhe besnik. Dy herë që u pushue, nuk erdhi në kryeqytet, por preferoi me banue në provincë, pse e shihte se në Stamboll jeta e tij ishte në rrezik, nga shkaku se nuk u vinte veshin urdhnave të Stambollës që iu dukshin pa vend.

Ibrahim Pasha: I përkrahun prej patriotit të tij Dalltaban Mustafa Pashës që qe kryeministër, arriti m'u ba Ket'huda i tij. Një kohë ra në disgrace bashkë me patronin e tij, por tue u reabilitue ma vonë, u ba Silahdar aga e në pak kohë aga i Spahivet. Mbrapa Bejlerbej i Selanikut e mandej i Sajdas në vitin 1119 h (1707). Në vitin 1122 h (1710) u pushue, e mbas pesë vjetëve që ndej i pushuem, në vitin 1127 h (1715) u emënue vali në Shehri'Zor,

ku dhe vdiq. Megjithse jo aq i zoti në punë shtetnore, prap iu doli me sukses shumë punëve që ia mori mendja se i kryente.

Ebu Beqir Pasha (Deli- i marri-J.T.): I ardhun në moshë të re në Stamboll, hyni në Oxhak të Jeniçerëve dhe shkallë shkallë, por me kadale u ba Kull'Ket'huda. Mbas një kohe që u pushue, u muer prap në shërbim dhe u emënue Sekban-bash në vitin 1123 h (1711), e mbas dy vjetësh aga i Jeniçerëve. Tue qenë fort idhnak punonte në krye të vet e kjo natyrë e tij i shkaktoi që të mos mbahej në detyrë si aga, dhe në krye të katër muajvet u dërgue në Qastendil si Mirmiranë e mbas një viti në sanxhak të Qelisit e mbrapa në Billiqe, ku dhe vdiq i vram në vitin 1127 h (1715). Për trim e guximtarë se kish shokun; por tue qenë i rreptë në punë shtetnore, filluen bota t'a quejnë me mbiemnin "i çmendun".

Hasan Pasha: Është djali i Mustafa bej Matjanit. Tue pasë banue qysh i vogël në Ejub (asht një lagje në Stamboll-J.T.), u thir Ejubli. Në fillim, nën hije të Kara Mustafa Pashës nga i cili përkrahej arrijti t'emënohet aga i Enderunit, prej ku u fut në Saraj si Çakëxhi-bash i Miri-alem tue u qitë në pensjon në vitin 1105 h (1693). Në hypjen në fron të sulltan Mustafajt II u emënue Ket'huda i Kapëxhivet me gradë "Rumeli pajesi". Në vitin 1109 h

(1697) vali në Bosnje e mbrapa në Baba Dag. Mandej në vitin 1110 h (1698) muhafiz n'Edrene, prej këtu vali në Halep, mbas një viti në Reka, në vitin 1113 h (1701) serasqer në Bagdat, mbas një kohe të Dijarbakër, në Shehrizor, në Bagdat vali, ma vonë në Kastamonu dhe prap në vitin 1116 h (1704) vali në Bagdat. Kjo nëpunësi në të cilën qëndroi njëzet vjetë i siguroi Hasan Pashës një emën e një famë të përjetshme; sepse tue shtrur në një anë beduinët, n'anë tjetër u muer me rivendosjen e qetësisë dhe për hirë të kësaj qetësie e shpjeg vendin prej lumtënije në lumtuni. Sidomos pushtimi i Qermanshakut ia dyfishoi famën. Vdiq në Bagdat në vitin 1136 h (1723), tue ba me qatë madh e të vogël përpara kësaj tragjedie. La shumë vepra bamirsie.

Rexhep Pasha: Ardhë i ri në Stamboll, u fut në saraj perandorak dhe i zgjuejt për natyrë, përparoi deri sa arrijti m'u ba Ket'huda i visarit perandorak. Por sa i siguroi vehtes në këtë mënyrë një pozitë të naltë në mes të personaliteteve t'Endurunit (të Sarajit), dëshroi të ketë një shërbim ndër provincë, dëshirë e cila iu muer parasysh, tue u emënuë vali i Dijarbakërit me rangun e vezirnisë në vitin 1119 h (1707). Si ndej këtu tri vjet, në vitin 1122 h (1710) u ba vali i Vanit, në vitin 1123 h (1711) i Sivasit e në 1124 h (1712) i Trabzonit. Një mend u transferue shpesh nga

një vend në një tjetër, por këto transferime nuk ngjajtën për ndonjë ankim që bahej kundra tij, por për kundra sepse qeveria shihte nevojën m'e çue aty ku randësia e punës paraqitej ma imperative. Krushqia që bani me sulltanin asht prova e çmimit të meritavet të tij të ndrituna. Por dhe mbas kësaj krushqie, ai prap u shpue nga një vend në tjetrin, deri sa në vitin vitin 1128 h (1715) vdiq në Sivas ku kishte nëpunsinë ma të mbrame si vali. Rexhep Pasha qe një personalitet bujar, drejtonjës, i matun e trim e sidomos, gja që në kohë të tij shihej rrallë, mprojtës i rajes (raje ka dy kuptime, edhe i krishtenë dhe shtetas-J.T.). Sa qe gjallë emni e fama e tij u përhapën n'Anadollë, bile në të tanë perandorinë sa që kushdo u përul përpara kësaj figure të nderueme.

Kurd Mehmed Pasha: Si fitoi famë në vend të vet (Shqipni-J.T.) si serqerde (ka dy kuptime: shef i një bande dhe komandant trupash të parregullta-J.T.) u bashkue si vullnetar me ushtrinë perandorake në ekspeditën kundra Austrisë e Gjermanisë dhe u gjykue tue pasë korre gjithëkohë suksese sikurse do të shërbente në këtë luftë e ashtu dhe mbrapa, iu dha nga qeveria grada e Mirmiranllëkut, bashkë me arpallëkun e sanxhakut të Bouzokut. Mbrapa iu dha sanxhaku i Manisës në vitin 1115 h (1703) e mbas katër vjetëvet që qëndroi në këtë vend, për

suksese që korri edhe ndër punët t'administratës ashtu si në luftë, u emënue në sanxhak të Akshehirit i ngarkuem edhe me dalë në luftë 1123 h (1711). Në vitin 1127 h (1715) muhafis i Shkodrës dhe i Ulqinit. Në këtë funksion të fundit u emënue për ma tepër dhe Bash-Bug (titull komandam-J.T.). Tue pasë fitue në këtë kohë një luftë kundra Venedikut. Sulltani çfaqti në një anë kënaqsinë e tij të jashtëzakonshme ndaj tij dhe n'anë tjetër e dërgoi në luftë që u hap kundra Iranit. Dhe këtu si gjetiu, i siguroi vehtes suksese dhe ma në fund, në vitin 1138 h (1725), u emënue mytesarif i Dukagjinit. U dallue si me trimni ashtu dhe me zell e besnikri.

Ahmed Pasha (Dervishi): Është agë e parësi e Shqipnisë dhe tue pasë shërbye e tue pasë tregue zellë ndër lufta të ndryshme, si shpërblim iu dha grada e mirmiranit dhe u emënue në vitin 1157 h (1744) mytesarraf i Prizrenit e mbas një vjeti i Dukagjinit. Vdiq në këtë vend.

Ahmed Pasha: I biri i Sadik agës, ajanë i Kosturit të sanxhakut të Korçës. Në moshë të re, në vitin 1114 h (1702) erdhi në Stamboll ku studioi me ndërmjetësinë e Hasan agës, nga akrabat e tij. Hasan agaj, në vitin 1126 h (1714) shkoi në Hixhaz

(Meke) si Surre-Emiri (asht person që dërgohej në çdo vjet prej sulltanit me dhurata në Meke, për ata që shërbejshin në varrin e profetit-J.T.) dhe më këtë mision e shoqëroi edhe Ahmed Pasha. Hasan aga vdiq në Meke e Ahmed Pasha i dëshpruem u kthye në Stamboll (në këtë kohe ky qe i ri e titullin Pashë e mori vonë-J.T.); e me ndërmjetësi të një miku u emënue nëpunës finance në Sakëz. Në vitin 1143 h (1730) me këtë cilësi u transferue në More e në vitin 1144 h (1731), kryetarë i bashkisë së Stambollit, mandej Mutbah-Emini (shef i kuzhinavet-J.T.) e Shiir-Emin (shef i drithnavet-J.T.). Në vitin 1148 h (1735) u ba Ruznamexhi (nëpunës që mbante shënim hyrjet dhe daljet e financës-J.T.), mbas një kohe që u largue prej këndej, prap u suell në këtë post në vitin 1154 h (1741). Mbas tri vjetëve u emënue Defterdar (financier-J.T.) i ushtrisë së Korsit. Në vitin 1159 h (1746) prap Ruznamexhi. Po në këtë vit me gradë vezirniye u emënue vali në Sivas dhe u dërgue edhe në Iran, me funksion të shtuem, si ambasador. Në të kthiem prej këndej, në vitin 1161 h (1748), u ba vali në Bagdat e mbas një pushimi të shkurtër vali në Marash. Vdiq këtu në vitin 1162 h (1749). Qe njeri i urtë dhe bamirës, cilësi kjo që e provoi me ndërtim çezmesh, etj.

Kontributi i El-Khvarizmit dhe Ibn Fadlanit në zhvillimin e shkencës së gjeografisë

M.sc. Artan S. Mehmeti, Prizren, Kosovë

Abstrakt

U lind në rajonin persian të quajtur Chorasmia. Në këtë kohë ky rajon i takon Uzbekistanit. El-Khvarizmi ishte një matematikan, astronom, astrolog, gjeograf, etj.

Si shkencëtar u rrit në kohën kur punoi në Shtëpinë e Urtësisë në Bagdad. Kjo shtëpi ishte një qendër shkencore e cila merrej me përkthimet dhe hulumtimet e teorive shkencore dhe filozofike, e në veçanti të atyre greke. Në këtë qendër, gjithashtu, kryheshin hulumtime në fushat e ndryshme shkencore dhe fetare, si dhe mbahej mësim për studentet e rinj.

Kontributi i El-Khvarizmit, në fushën e gjeografisë së mesjetës ishte i madh. Ai i korrigjoi dhe i sistematizoi hulumtimet e Ptolomeut, duke i përdorur rezultatet e gjetura gjatë hulumtimeve të tij.

Ibn Fadlan lindi në vitin 877. Ai ishte një udhëtar i shekullit të X – të, i cili ishte dërguar si sekretar i ambasadës së Kalifatit të Abasidëve nga Bagdadi në Mbretërinë e Vollgës Bullgare. Ai është i njohur edhe si shkrimtar, historian, udhëtar dhe gjeograf.

Muhammad bin Musa el-Khvarizmi (780 – 850)

U lind në rajonin persian të quajtur Chorasmia. Në këtë kohë ky rajon i takon Uzbekistanit. El-Khvarizmi

ishte një matematikan, astronom, astrolog, gjeograf, etj.

Si shkencëtar u rrit në kohën kur punoi në Shtëpinë e Urtësisë në Bagdad. Kjo shtëpi ishte një qendër shkencore e cila merrej

me përkthimet dhe hulumtimet e teorive shkencore dhe filozofike, e në veçanti të atyre greke. Në këtë qendër, gjithashtu, kryheshin hulumtime në fushat e ndryshme shkencore dhe fetare, si dhe mbahej mësim për studentet e rinj.



Figura 1. El-Khvarizmi.

Kontributi i El-Khvarizmit, në fushën e gjeografisë së mesjetës ishte i madh. Ai i korrigjoi dhe i sistematizoi hulumtimet e Ptolomeut, duke i përdorur rezultatet e gjetura gjatë hulumtimeve të tij. Këto hulumtime i botoi në librin me titull “Kitab Surat el-Ard”. Ky libër ndryshe njihet edhe si Gjeografia e el-Khvarizmit. Në këtë libër, Ai formulon një listë prej 2.402 qytetesh, duke iu shtuar edhe koordinatat gjeografike për secilin qytet. Pas një hyrje të përgjithshme,

Ai tregon edhe disa karakteristika gjeografike të këtyre qyteteve. Një dorëshkrim i këtij teksti edhe sot ekziston, por fatkeqësisht hartat nuk janë ruajtur. Shkencëtarët e kohëve moderne arritën që t’i ripunojnë këto harta duke u bazuar nga përshtatimet e dhëna nga el-Khvarizmi. Në shtesën e përmbledhjeve të rëndësishme rreth astronomisë, ai shkruan një libër rreth tabelave astronomike. “Kuarizmit Zij al-Sindhind” është një libër tjetër i tij, që ka të bëjë me vëzhgimet astronomike. Këtë libër el-Khvarizmi e ndan në rreth 37 kapituj. Në këtë libër ai pasqyron përlllogaritjet rreth kalendarit, si dhe përlllogaritjet që ka bërë në fushën e astronomisë. Në këtë libër El-Khvarizmi, gjithashtu pasqyron 116 tabela me të dhëna kalendarike, astronomike, astrologjie, si dhe një tabelë me vlera sine. Ky libër është i pari libër nga një autor mysliman që bazohet në metodat e vëzhgimeve astronomike indiane, e njohur si Sindhind, i cili përmban tabela rreth lëvizjeve të Diellit, Hënës dhe pesë planetëve të njohur deri më tani. Deri në këtë kohë astronomët myslimanë, kishin adaptuar një qasje kërkimore kryesisht të bazuar në vëzhgimet në terren, si dhe bënë përkthimin e veprave të autorëve tjerë jo myslimanë, që të fitojnë sa më shumë njohuri. Pas kësaj, ata vetë zbuluan njohuri të reja dhe shkruan libra për këto njohuri.



Figura 2. Quadrant – i, instrument i përdorur për përcaktimin e kohës, si dhe kohëve të namazit.

El-Khvarizmi bëri disa përmirësime të rëndësishme si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik në ndërtimin e “sundials – orës diellore”, të cilën e trashëgoi nga paraardhësit e tij indianë dhe helenë. Ai formuloi disa tabela, të cilat ndihmuan në shkurtimin e kohës së nevojshme për llogaritjet specifike të kryera përmes “sundials – orës diellore”. Gjithashtu zbuloi orën diellore, e cila më pas u përhap dhe u bë një orë ndërkombëtare, duke e vendosur pothuajse në të gjithë pjesët e Tokës. Nga ajo kohë kjo orë është vendosur nëpër xhami për të përcaktuar kohën, si dhe kohët e namazit. Quadrant-i, është një

instrument tjetër i zbuluar nga El-Khvarizmi në shekullin e IX – të në Bagdad. Edhe ky instrument përdoret për të përcaktuar kohën, si dhe kohët e namazit, i cili mund të përdoret në çdo kohë, në të gjitha pjesët e Tokës. Gjithashtu ky instrument shërben edhe për hulumtime trigonometrike dhe astronomike. El-Khvarizmi shkroi dy libra mbi përdorimin dhe ndërtimin e astrolabes.

Kontributet e tjetra të dhëna zhvillimit të shkencës janë rezultatet origjinale të hulumtimeve të kryera nga ai vetë. Përpunimi dhe përmirësimi i njohurive greke, indiane dhe burimeve të tjera shkencore në fushat e ndryshme si: gjeografi, matematikë, astrologji dhe astronomi. Udhëhoqi punën e 70 gjeografëve, të cilët krijuan një hartë për botën e njohur deri në atë kohë.

El-Khvarizmi, korrigjoi mbivlerësimin e madh të bërë nga Ptolemeu për gjatësinë e Detit Mesdhe të matur nga ishujt Kanaire e deri në brigjet lindore të Mesdheut. Ptolemeu e mbivlerëson atë në 62 shkallë, ndërsa el-Khvarizmi, këtë gjatësi e vlerëson më saktë në rreth 52 shkallë. Ai përshkruan edhe Oqeanin Atlantik dhe atë Indian si organe të hapura të ujit dhe jo tokë e bllokuar nga deti ashtu siç i përshkruan Ptolemeu. Meridiani kryesor sipas el-Khvarizmit ishte në ishujt Fortunate, rreth 10 shkallë në lindje të meridianit të përdorur nga Marinus dhe Ptolemeu. Shumica e

hulumtuesve mesjetarë myslimanë kanë vazhduar ta përdorin si meridian kryesor meridianin e el-Khvarizmit.



Figura 3. Harta e Botës e punuar nga el-Khvarizmi.

Ahmad bin Fadlan (877 – 960)

U lind në vitin 877. Ibn Fadlan ishte një ndbëtar i shekullit të X – të, i cili ishte dërguar si sekretar i ambasadës së Kalifatit të Abasidëve nga Bagdadi në Mbretërinë e Vollgës Bullgare. Ai është i njohur edhe si shkrimtar, historian, ndbëtar dhe gjeograf.



Figura 4. Ibn Fadlan.

Ibn Fadlan më shumë është i njohur për librin e tij, i cili ka të bëjë me përshkrimin e vikingëve të Vollgës, ku në një rast ka qenë dëshmitar okular i ritualit të varrosjes me anë të anijes. Përveç përshkrimeve për vikingët, Ai ka bërë përshkrime edhe për popuj tjerë të ndryshëm, e veçanërisht për popujt turq si: Oghuzes, Pechenegs, Bashkirs dhe Kha-zars. Për një kohë të gjatë, është njohur një version jo i plotë rreth veprës së tij, siç përshkruhet në fjalorin gjeografik të Jakutit (në kapitujt Atil, Bashgird, Bulghar, Khazar, Khwarizm, Rus), botuar më 1823 nga Christian Martin Frähn. Vetëm në vitin 1923 është zbuluar një dorëshkrim nga dijetari turk me origjinë Bashkire i quajtur Zeki Validi Togan, në Kuds Muzeun Astanë, që ndodhet në qytetin Mashhad në Iran. Ky dorëshkrim (Razawi Library MS 5229), i cili daton nga shekulli i XIII – të, përbëhet nga 420 faqe (210 folia), dhe përveç përshkrimeve të tjera gjeografike, ai përmban një version të plotë të tekstit të shkruar nga Ibn Fadlan (faqe 420 – 390). Fragmente të tjera të ruajtura e që nuk figurojnë në MS 5229, janë cituar në veprën e gjeografit persian të shekullit XVI të quajtur Amin Razi në veprën e tij me titull “Haft Iqlim”.

Ibn Fadlani nuk ka qenë gjeograf dhe kjo shpjegon mungesën e përshkrimeve gjeografike në vëzhgimet e tij, si dhe mungesën e

gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike, megjithatë, ai kishte parasysh gjatësinë ekstreme të natës gjatë dimrit dhe gjatësinë e ditës në verë, një fakt ky që e bënte llogaritjen e kohëve të namazit shumë të vështirë. Vëzhgimet e ekspeditës ishin shkruar si një raport për el-Muktedirin. Raporti ishte konciz, i saktë dhe plotë fakte, por ka më shumë se kaq, ajo rrjedh si një histori e gjallë. Vërtetuesi i ekspeditës se tij ka thënë për të: “Ai nuk largohet nga stili prej një autori, dhe nuk është i afërt me traditat e gjeografëve.”

Një nga përshkrimet më të hershme i detajuar për vikingët është gjetur në shënimet e Ibn Fadlanit, të cilat i shkroi pas udhëtimit të tij në Evropën Veriore. Në vitin 921 shkrimtari dhe udhëtar i njohur mysliman Ibn Fadlan ishte dërguar si sekretar i ambasadës së Kalifatit të Abasidëve nga Bagdadi në Mbretërinë e Vollgës Bullgare, që shtrihej nga Deti i Zi deri në Detin Kaspik. Edhe pse misioni i tij ishte për të mbledhur të holla për të ndërtuar një kështjellë, ai në këtë vend bëri përshkrimin e takimit të tij me një grup tregtarësh nga veriu.

Ibn Fadlan i Rus ose Russyyan

Ai ishte një shkrimtar arab i shekullit të X, i cili shkroi të gjitha shënimet të cilat i mbledhi gjatë udhëtimeve të tij në kohën sa ishte

sekretar i ambasadës. Pasi arriti në qytetin Bolgar, Ibn Fadlan shkoi edhe në qytetin Wisu, ku në vëzhgimet e tij, ai shënoi tregtinë që bëhej në mes bullgarëve dhe fiseve lokale finnc. Një pjesë e rëndësishme e të dhënave të Ibn Fadlanit i dedikohen përshkrimit të njerëzve të quajtur rus ose russyyan.

Studimet e shumta të cilat u bënë për identifikimin e rusëve ose varangias, mundësuan që të kuptohet se të dhënat e Ibn Fadlanit të jenë ndër shënimet më të hershme rreth vikingëve. Në shënimet e tij, ruset u shfaqën si tregtarë që dyqanet e tyre i vendosnin afër lumenjve të kampit Bolgar. Ai ata i ka përshkruar si më trup të gjatë si pema e palmës, me flokë bionde dhe lëkurë të kuqërremtë. Ata janë me tatuazhe me figura të thonjve me ngjyrë blu të errët apo jeshile të errët, struktura peme, apo figura të tjera, ku të gjithë burrat janë të armatosur me sëpata dhe thika (shpata) të gjata. Higjienën e ruseve Ibn Fadlanit e përshkruan si të neveritshme (gjithashtu ai vuri në dukje që ata krihnin flokët e tyre çdo ditë), si dhe ata i konsideron si vulgarë dhe pa përvojë. Këto përshkrime të tij ranë në kundërshtim me ato të udhëtarit persian Ibn Rustah. Ai gjithashtu përshkruan në detaje funeralin e një udhëheqësi të tyre (anijen e varrimit

përfshirë sakrificën njerëzore). Disa studiues besojnë se ajo u zhvillua në kompleksin modern Balymer. Ibn Fadlan në përshkrimet e tij vikingët i quajti “fëlliqësira e krijesave të Zotit” me një bukuri akoma më të bukur fizike që kurrë nuk i kishte parë “të gjatë si një palmë e vjetër, biond dhe faqe kuq”, ishte një nga paragrafët e shënuar në shënimet e tij.

Pas rikthimit të tij në Bagdad, ai e shkroi relacionin e udhëtimit të tij. Pjesa përfundimtare që më sa duket tregon kthimin e tij, si dhe jetën e tij të më vonshme është humbur, por fragmentet që kanë mbijetuar i bëjnë informacionet më të jashtëzakonshme dhe disa herë më tërheqës për tu lexuar.

LITERATURA

M.sc. Artan S. Mehmeti, Të kërkuarit e diturisë sipas Islamit, EDUKATA ISLAME nr. 107, Prishtinë 2014,

Dr W. Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R., BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists, Published by: Islamic Medical Association of Malaysia N. Sembilan, (<http://www.social-sciences-and-humanities.com/PDF/Biographies-of-Muslim-Scholars-and-Scientists.pdf>),

Dr. Muhammad Adil Afridi, CONTRIBUTION OF MUSLIM SCIENTISTS TO THE WORLD: AN OVERVIEW OF SOME SELECTED FIELDS

(http://irep.iium.edu.my/8415/1/Contribution_of_Muslim_Scholars_to_the_world.pdf),

https://www.en.wikipedia.org/wiki/List_of_Muslim_geographers,

https://it.wikipedia.org/wiki/Ahmad_ibn_Fadlan,

<http://www.muslimheritage.com/article/ahmad-ibn-fadhlan-northern-europe-survey-his-account-russian-vikings-10th-century>,

<http://www.alrahalah.com/2010/09/ahmad-ibn-fadlan/>,

https://en.wikipedia.org/wiki/Muhammad_ibn_Musa_al-Khwarizmi,

<http://www-groups.dcs.st-and.ac.uk/history/Biographies/Al-Khwarizmi.html>,

Poemë satirike, që lexohet për vlerat semantike, gjuhësore e stilistike, artistike e letrare

Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi
Universiteti Bedër

Abstrakt

Kobët e fundit, si pasojë e bulumtimit profesional, u zbulua në Arkivin e Shtetit në Tiranë një poemë tjetër satirike e publicistit tiranas Hafiz Ibrahim Dalliu. Poeti i shquar i viteve '30, po i ofrohet lexuesit bashkëkohor, falë interesimit të studiuesit Dr. Genti Kruja, sepse komunikimi me autorin kishte mehur, për arsye jashtëletrare, pas përfundimit të Luftës II Botërore. Poema e shkruar në vitin 1922 (?) titullohet "Nji andërr e ime".

Poema satirike e Hafiz Ibrahim Dalliu (1878-1952) ka gjithsej 681 vargje, të shkruara njëshkolonë, me strofa treshe por të pandara.

Tercina është e pandarë nga njëshkolona, me varg dhjetërrokësh, me rimë të përputhur AA për dy vargjet e fillimit, kurse vargu i tretë B, që është tetërrokësh, rimon me vargun e tretë B të tercinës që vjen pas e kështu në vijim.

Daktilografimi është realizuar në 16 fletë me shkronjën "e" në vend të shkronjës "ë", por sidomos mangësitë në vendosjen e shenjave të pikësimit, si dhe cilësia e dobët e daktilografimit paraqet vështirësi në leximin e origjinalit, por jo në vlerësimin e veprës. Objekt i metodës filologjike do të jetë zbulimi i vlerave gjuhësore, që realizojnë komunikimin kontekstual dhe lokal dhe si dokumentim real i ekstremizmit gjuhësor që zuri fill ato kobë.

Fjalët kyçe: semantika, stilistika, gjuha e mjedisit, gnomika, diskursi komik

Hyrje

Shqipërinë e bënë entitet letrar, por menjëherë pas themelimit të shtetit të lashtë shqiptar, u dukën zbrazëtitë humane dhe veçmas ato profesionale të banorëve të tij. Më e dukshme ishte kjo në administratën shtetërore. Sa herë i kthehesh kësaj periudhe kohore, të dalin parasysh figurat e shquara kombëtare që guxuan dhe tërtherën (fjalë e krijuar nga Naum Veqilharxhi për të zëvendësuar huazimin sakrificë, R. O.) veten për të vënë themelet e shtetit. Një pjesë e madhe e tyre u kthyen nga Perandoria e sëmurë, ndaj më tej të shkon në mendje edhe se cilat ishin profesionet e shtetarëve nistorë, cilësia e arsimit të tyre. Të mësuar të drejtoheshin nga të tjerë për periudha kohe të gjata, administrata shqiptare u vu në sprovë të shumta. Idealistët e ardhur, që iu shtuan nëpunësve vendas, për të kthyer ëndrrën në realitet, filluan të shfaqnin zhgënjimet e para. Shoqëria shqiptare, sidomos shtresa e ulët edhe ajo e mesme, prirej nga interesa kryesisht materiale, duke dëshmuar mungesën e një formimi të mirëfilltë dhe të plotë. Interesi material, paraja ishte kthyer jo vetëm në mjet për të jetuar, por në synim, duke lënë në hije tiparet e tjera të nevojshme, pa të cilat nuk mund të mbahej shteti dhe jo më të rritej cilësisht. Kur kthehet në mani, ky mjet shkëmbimi i nevojshëm zhvlerësohet, sepse nuk

i shërben zhvillimit dhe përparimit. E kthyer në fjalë kyç në ligjërimin e kohës, sipas Lumo Skendos, ajo kishte zënë vendin e kryefjalës:

“P.S. Fjala më e përdorur shumë në gjuhët tënë është para

Cilësit e inteligjencës, të karakterit, zotësinë, diturinë, s’e zënë ngoje

Do të them se, mbase i vetëmi vënt në botë ku paraja s’bën para, është Shqipëria.”

Mungesa e motivimit dhe mosvendosja e rregullave të tregut të lirë, shtoi mungesën e rendit dhe të qetësisë, si dhe të një tradite pluraliste, jo vetëm që nuk po ndihnte në zgjidhjen e problemeve, përkundrazi.

Kleriku dhe publicisti

Vepra e parë e botuar nga ky autor titullohet “Grenxat e kuqe të Tiranës”, poemë satirike në vargje, 1915, për të vijuar një heshtje disavjeçare, që domosdoshmërisht ka lidhje me luftërat ballkanike, Luftën e Parë Botërore dhe pasojat e tyre, që përfshinë Shqipërinë dhe veçmas Tiranën, ku jetonte, punonte dhe publikonte autori. Kongresi i Lushnjës, 1920, duket filloi zgjidhjen institucionale të problemeve të rënda. Nis themelimi i shtetit modern shqiptar, që duhej t’i shërbente shqiptarit, i cili në kushtet

e reja rrekej të krijonte ndërgjegjen kombëtare. I bindur se edukimi fetar i shërbente edhe forcimit të identitetit kombëtar, H. Ibrahim Dalliu u kthehet botimeve të shumta. Emri i tij shfaqet në kapakët e librave botuar në vitin 1921: “Texhvidi (Rregullat e leximit të Kuranit)”, “Ilmihali (Mësime të Fesë Islame)”, “Dhanti e Ramazanit”, vepër që u ribotua dhe “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit” (u botuan vetëm 7 xhuze, duke pritur botimin e veprës së plotë). Faktet flasin që ai vijon të punojë e publikojë intensivisht në të dyja lëmitë, ku kishte mundësi më të dukshme.

Në vitin 1922 i kthehet përsëri krijimtarisë artistike të mirëfilltë, duke i dhënë publikut poemën satirike “Dokrrat e Hinit”. Dëmtimin e identitetit kombëtar ai e shihte edhe në përdorimin vend e pavend të huazimeve dhe për këtë ai qesëndiste njerëzit e kafeneve, që sa vinin e shtoheshin në kryeqytetin e saposhpallur, në Tiranë. Diku aty qesëndisja kalon në ironi e deri në satirë, sepse autori zbulon cektësinë në formimin kombëtar të bashkatdhetarit të vet, që synon ta kthejë në qytetar aktiv.

Koha nuk priste, prandaj bashkë me krijimet artistike që ftonin lexuesit t’u jepnin jetë, ka veprimtari të pasur në publicistikë, që e boton si libër më vete: Publicistikë në gazetën “Dajti”, 1924.

Nevoja për shtimin e forcimin e identitetit kombëtar, të forcimit

të sedrës kombëtare që po kalonte natyrshëm gjatë kësaj periudhe në ndërgjegjen kombëtare, i dha forcën e duhur të dalë para lexuesit të etur për këtë lloj problematike me botimin “Patriotizma në Tiranë”, 1930. Krijimi nga ky dëshmitar okular, është njëherazi një fakt me vlerë që zgjon ide të fuqishme. Në kontekstin kulturor dhe socio-politik të kohës lexuesi shqiptar kishte në dorë dhe po e shijonte pamfletin e Hafiz Ali Korçës, Tiranë, 1925, “Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit”. Me fakte tronditëse Korça analizoi gjëmën që do t’i shkaktonte botës zbatimi në jetën shtetërore dhe atë shoqërore i ideologjisë komuniste, duke e parë të pamundur realizimin e tij në Shqipëri. Bashkë me të lexuesi shqiptar kishte përpara idetë e Branko Merxhanit mbi neo-shqiptarismën, të shfaqura qysh në vitin 1929 te gazeta “Demokratia”, që botohej në Gjirokastrë. Çami i krishterë, që kishte mërguar në Turqi, ishte shkolluar në një kolegji britanik në Izmir, duke i plotësuar njohuritë me studime të tjera më të plota filozofike në Gjermani apo Austri, dhe kishte rënë në kontakt me mendësinë perëndimore, që i ecte paralel me atë lindore, të cilën ia mëkoi djepi ku u rrit:

“Qe ndër të rrallët e ditur që u burrërua nëpërmjet mentalitetit të botës lindore e u brumos nëpërmjet diturisë dhe përparimit të botës perëndimore.”

Duke mos mbetur në nivelin e informimit, vëzhgimit, analizës sociologjiko-antropologjike dhe për më tepër në ngujimin e studimeve shkencore që ushqenin përqendrimin e ndrydhur në mefshhtësinë tipografike, Branko Merxhani hodhi në tryezën e diskutimit dhe të analizës dilemën e kohës: Nga Lindja apo nga Perëndimi, si një grishje që e shkaktonte çasti historik, pas lëvizjeve revolucionare që shkaktoi Revolucionin e Tetorit në Rusi, jehona e të cilit po ndihej edhe në Shqipërinë pa klasë punëtore, por ku amplifikimi realizohej nga radikalë naivë, me qasje të majta deri bolshevike.

Oksidentalizmi që mori përparësi krahasuar me termin Orientalizëm, u bë temë kryesore bisedash në kafe Kursal, Berlin apo Bella Venezia, po edhe objekt debatesh, opinionesh dhe analizash në gazetatat e kohës së artë të kulturës shqiptare, që do të mbyllet me përfundimin e luftës. Duke qenë me këmbë në tokë, Dalli u titulloi veprën e vet “Patriotizma”, që do të thotë se e vendos në mes dy ekstremeve, që mund të shkaktonin probleme sociale, atëherë kur duhej më tepër se kurrë qetësi e paqe dhe jo vetëm në Tiranë.

Në vitin 1934 H. Ibrahim Dalli u paraqit lexuesit me kryeveprën e tij “E lemja dhe jeta e të Madhit Muhamed a.s.”, me 6143 vargje, i bindur se edukimi fetar ndih jo pak në forcimin e ndërgjegjes kombëtare, për të cilën kishte nevojë

shoqëria e kohës. Botimi pasohet nga libri “Ç’është Islamizmi”, 1935, një studim i mirëfilltë teorik mbi elementin bazik të kulturës islame, “Islami”, i plotësuar nga dy të tjerët: “Imani” (Besimi) dhe “Ihsani” (Njerzillëku). Dy vjet më pas, 1937, autori i jep lexuesit një vepër tjetër, që pos vlerës teorike mund të përdoret edhe praktikisht prej besimtarit mysliman, “Libri i së falmes”.

Në morinë e botimeve intensive të këtij autori duhet shtuar dhe botimi “Udha Muhamedane” e Muhamed Bergjiviut, përkthim rreth 500 faqesh, që iu dha lexuesit në vitin 1936.

Autoriteti prej shkrimtarit, i fituar mes lexuesve të shumtë, i diktoi themeluesit e institucionit kulturor që u ngjiz fill pas lufte, që ta pranonin si anëtar të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, anëtarësim që nuk e shpëtoi dot nga kalvari i persekutimeve që filluan bashkë me anëtarësimin në të.

Poema e pabotuar

Poema e panjohur prej lexuesit u hulumtua nga studiuesi dhe botuesi Dr. Genti Kruja, i cili vijon të nxjerrë nga harresa e qëllimshme shkrimtarë që duhen lexuar. Materiali i fotokopjuar u përcoll për botim te një revistë, me synimin që të vlerësohet më imtësisht dhe gjerësisht në një punim tjetër më të plotë. Në dosjen e ruajtur në Arkivin

e Shtetit ka një gabim qysh në titull, sepse shkruhet: NJI ANDËRR E IMJA (NJI ANDERR E IME, në origjinal). Të larguarit e megjullës së rënë mbi letërsinë e dënuar me harrim e zhdrukje bëhet pjesë aktive e aktit civilizues të krejt historisë sonë kombëtare, aq më tepër kur vepra ka për autor një të nëmur edhe politikisht.

Poema satirike e Hafiz Ibrahim Dalliu (1878-1952) ka gjithsej 681 vargje, të shkruara njëshkolonë, me strofa treshe, por të pandara. Tercina është e pandarë nga njëshkolona, me varg dhjetërokësh, me rimë të përputhur AA për dy vargjet e fillimit, kurse vargu i tretë B, që është tetërokësh, rimon me vargun e tretë B të tercines që vjen pas e kështu në vijim.

Daktilografimi është realizuar në 16 fletë A4 me shkronjën “e” në vend të shkronjës “ë”, por sidomos mangësitë në vendosjen e shenjave të pikësimit si dhe cilësia e dobët e shtypjes paraqet vështirësi në leximin e origjinalit.

Për këtë vepër artistike në vargje, të pabotuar, mësohet nga botimi enciklopedik 100 personalitete shqiptare të kulturës islame, shek. XIX-XX, botimet KMSH, botimi i tretë, Tiranë, 2015 si dhe nga monografia e studiuesit Xhemal Balla: H. Ibrahim Dalliu, jeta dhe vepra, Tiranë, 2008. I dënuar institucionalisht me heshtim të

dhimbshëm e harrim të qëllimshëm institucional, sepse vitet e fundit të jetës, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Dalliu i shtyu në burg politik, la pas veprën e tij, më së shumti krijime letrare me tharm fetar, që u vunë në shërbim të shkollimit dhe të edukimit me besimin islam shqiptar, studime historike dhe sociologjike si dhe krijimtari e mirëfilltë artistike, kryesisht në vargje.

Poema që botohet për herë të parë, afrohet në kohë me satirën në vargje Dokrrat e Hinit, e botuar në vitin 1922. Koha që nuk po mundte të sillte heroikën e vet, zvarritej me dukuri të kundërta të saj, deri komike, që i jepnin frymëzim satirës e në jo pak fakte letrare, që afrohen me ato historike, edhe groteskut. Pasqyra satirike e kohës sociale dhe politike, zbulon ide morale dhe etike. Qeveria e Xhaferr Ypit, si pasardhëse e asaj të Omer Vrionit dhe e pasuar nga qeveria Ahmet Zogolli, që erdhi në fuqi në janar 1922 dhe drejtoi shtetin e brishtë shqiptar deri më 26 dhjetor të atij viti, kishte sjellë në sofrën e historisë partinë e parë politike, Partia Popullore, që mbështeste bejlerët. Një kundërshti e tipit të oksimoronit, e cila i jep autorit material të bollshëm faktik për të ngjizur subjektin poetik. Në këtë kontekst historiko-social, që prodhon edhe atë artistik, lëvrijnë figura të shumta të historisë, mjaft prej të cilave të rënduara me ngjyra të errëta. Qëndrimi kritik

por dhe mosnjohja e të gjitha fakteve historike, ka sjellë krijimin e personazheve që shkaktojnë humor të zi. Të duket se ka një ngjashmëri me Korbin e E. Poes, që do ta sillte në shqip Fan Noli, sepse ëndrrën ia shkakton një qyqe, që për vetëdijen shqiptare ndjell veç keq.

Në poemën e bukur dhe të fisme ndërthuren historia me imagjinatën, duke krijuar situata që i shërbejnë njohjes së të vërtetës historike, madje dhe që krijojnë mundësinë për jetësimin e saj edhe sot, duke dëshmuar kësajsoj se arti nuk vjetrohet. Figura e ministrit të Brendshëm, që do të jetë Kryeministri dhe më pas Mbreti i Shqipërisë, është dhënë me realizëm, pa ngjyrën e elementeve komike, siç janë dhënë mjediset apo figurat e tjera, që i ka sjellë imagjinata e tij e begatë.

Toposi i kësaj poeme satirike, mbi të cilën veproi hirnjaja e harresës ideologjike, është përdorur si topikë për të bindur lexuesit se jo pak gjëra po shkonin keq e më keq. Pas veprave ku qëllimi kombëtar vihej në themel të çdo synimi, duke filluar pas vitit 1900 e këtej, i ishin dhënë lexuesit krijime të fuqishme, ku mahia, tallja e hidhur, parodia po shpërfaqte pamjen e përgjithshme të realitetit shqiptar. Tematika aktuale i çel udhë shtjellimit të temës që satirizon realitetin politik, me ndikim në atë ekonomik, social, shpirtëror të shoqërisë shqiptare të fillimit të viteve '20.

Kriza e brendshme politike ka kapluar dhe gjunjëzuar popullin shqiptar, Tiranën, Krujën, Elbasanin duke u dëshmuar si institucionale, morale, sociale dhe etike. E njëjta gjendje dëshmohet gjithkund në atdhe:

Si ndo j'zog po neper deget
Her kah Tosket her kah Geget
Mendja ime zue me shkue.

Ministri i Brendshëm, 'po korr fitoret e para', që do t'i shërbenin qetësimit të gjendjes, rendit dhe qetësisë publike. Stabiliteti i rendit del parësor, kurse demokracia vetëm sa pranohet me emra partish: Partia Popullore (Popllore në të folmen e Tiranës). Qetësia po vendoset me dhunë policore, me taksa, që po prodhon poshtërim edhe në ekonomi, edhe në vlera morale. Ndihet përmbysja politike që nuk dihet çfarë sjell, sigurisht jo demokraci (tredhje, fjalë e stilit të ulët e përdorur në poemë).

Hafiz Ibrahim Dalliu nuk fal lëshime apo symbyllje, edhe pse është besimtar e klerik universitar, sepse këtu është krijues që zbulon e jo kurues, shërues plagësh a bari i turmës që pret kujdes e mbrojtje.

Stabiliteti pa demokraci është litar dhe hu, taksa dhe korrupsion. Duhet të dyja, gjykon ai: stabiliteti, paqja sociale, por edhe demokracia, që krijohet e mbrohet institucionalisht.

Simbolika e qyqes që e vë në dialog me shqipën e ndihmon krijuesin të zhvillojë qëndrimin qortues. E ka bindje që duhet të largohet sa më shpejt nga drejtimi i vendit aristokracia feudale, për t'i lënë vendin asaj intelektuale, që kishte nisur të krijohej. Kërkon që të dalin në krye njerëzit që do të shërbejnë, madje përdor terma politike si bolshevikët dhe menshevikët, duke e rreshtuar veten me të parët. Është i bindur se 'burrat e dheut' do të dinë sesi ta udhëheqin popullin drejt Evropës.

Udhëtimi imagjinar nëpër ferrin shqiptar e vë në kontrast me një mjedis përrallor, në të cilin jeton administrata e lartë, e porsa vendosur në kryeqytetin e ri. Me anë të enumeracionit autori jep gjendjen e nderë që kanë krijuar shtetarët e papërgjegjshëm.

Autorit i bie në sy se ka filluar të mos respektohet kontributi i krijuar prej rilindësve, që mundën të vendosnin në themel të së ardhmes sedrën kombëtare. Dyshon në vlerat e krijuara nga vendimet e Kongresit të Lushnjës, që nuk po arrijnë të zbatohen institucionalisht.

Duke pasur njohuri juridike e kushtetuese, e ndjen që Statuti (Kushtetuta) i pazbatuar apo i zbatuar keq paraqet rrezikshmëri. Asambleja nuk po arrin të zbatohet në bazë, sepse katër këshillat e krijuara, nuk japin siguritë e duhura.

Këshilli i Naltë përbëhet nga

Ymer Vrioni, Sotir Peci, Refik Topija dhe Ndoc Pistoli. Për mendimin e autorit "Tjeret shkruajnë kta i vulosin".

Po kështu mosbesues është dhe për nivelin profesional, moral e intelektual të qeverisë së Xhaferr Ypit, që asokohe quhet Këshilli Veprues. Aq i shqetësuar është sa nuk i rëndet të thotë se ndonjë ministër ngjan me majmunin, si fytyrë, duke e rënduar llojin e fjalëve që përdor. I tillë është edhe parlamenti i vendit, i përfaqësuar me opozitën që 'fliste pak', si fakt për të treguar gjendjen e tij reale. Mundohet të shpërthejë qelbin e mbledhur në thellësi të shpirtit kur thotë zbulimin dhe e mbyll mendimin me vargun ironik, ku duhet menduar e kundërta, si lloj i komizmit:

Lumte na per Parlament

Është i shqetësuar deri dhe prej organizimit të institucioneve fetare, prej përfaqësimit intelektual që nuk po arrin të udhëheqë me idetë e tij...

Llafazanëria po arrin kulmin. E nisur me anën heroike, gjithçka po përfundon me anën e vet komike. Në vend të betejave për të vendosur popullin në pushtet, do të ketë spektakle që vetëm kurdisen e pastaj nuk sjellin zgjidhje, por mysibet (fatkeqësi të mëdha, gjëma). Çuditësh kur lexon se deri dhe autori që e stilizon veten si të djathtë, merr në mbrojtje me përdëllimtari dhe patos,

nëpërmjet një fjalori agresiv, veprime të dhunshme, të cilat krijojnë dhe një mendësi të tillë. I ngjashëm ky me frenezinë (ngasje tërbimi) që u pa në shtypin shqiptar të viteve '20, kur Avni Rustemi, 'Aj far Avniut', vrau në Paris Esat Pashë Toptanin.

Kjo duket ishte gjendja e formimit ideologjik të kohës, ndaj nuk krijoi iluzione, por një botë që mund të jetë. Këtu është një prej vlerave të shumta të poemës, që porsa iu përcoll publikut për lexim. Si njeri i letërsisë, Dalliu ka operuar me 'idealin e së ardhmes', ndërkohë që politika është mekanizëm i mjeteve të së sotmes. Autori dokumenton një aleancë 'zagarësh' në kasaphanën e kohës, që përsëritet si 'aleancë qelbësirash' në kohën e ardhshme. Është po ai zhgan i neveritshëm që bën zëvendësimin e heroikes me satiriken, duke i mbetur si rezultat kënga shpëtimtare, ajo që vdes e fundit.

Ibrahim Dalliu ngrihej mbi vullkanin politik, në përpjekjen për ta ftohur atë magmë, e cila kur kohët të kalonin do të bëhej ndërgjegjja dhe historia e popullit të tij, që është diçka tjetër nga ajo e nëpunësve të lartë, që nuk arritën të krijonin shtet.

Lexuesi bashkëkohor i poemës satirike bie dakord me autorin "per siperfaqen e jo per brendine e premises" që formon silogjizmin e shpërfaqur mes fjalëve kyç: ëndërr, zhgjiëndër, qyqe, pasiguri, muzgëtim, pezmatim, dhunë,

bubullimë, gaddare¹, hata, kobë, tauna, jargë, raki, birrë, vermut, fërnet, shampanjë, konjak, çengi, jezid, zullum, Domuzdovë (për Domosdovë), rebel, xhahil, Libibi (një i marrë në Tiranë), namuz, turi si majmun Sudani, tyleka, fa xhangel, opingaret, spiun, jeniçer, vidhni, rripni, burgimi, gjoba, mysibet, u varren ca persona...

Autori e përgatit atmosferën e kohës dhe nuk kishte si të mos mbaronte po me një gjendje të dhunshme. Gjithçka e realizuar me anë të fjalës, që do të krijonte frymën e kohës që u përcoll gjatë.

Nëpërmjet këtij komunikimi kontekstual kulturor, mësojmë për rolin negativ që luan fjala artistike, në krijimin e gjendjes shpirtërore të banorit të kohës. Edhe për këtë funksion artistik, poema që porsa iu paraqit lexuesit, duhet të lexohet, vlen të lexohet dhe do të lexohet, edhe sot e nesër, për shumë vlera të saj semantike, gjuhësore e stilistike, artistike e letrare në përgjithësi.

Diskursi satirik si diskurs social

Kur u shkrua poema, po të ishte botuar, do të kishte pasur shumë dëgjues dhe sigurisht shumë e më shumë lexues. Tani që iu paraqit lexuesit, ka vetëm lexues që e përjetojnë ligjërimin poetik si të vetmin realitet të mundshëm social, sidomos kur shijojnë vargje:

1. Mashtruese, arab. (shënim i redaksisë).

Ktu filloj burgimi e gjoba
T'pa fajshmit mbare i zu koba
Mysibet mbi mysibet.

Realiteti i zbuluar prej poetit është i dallueshëm prej atij konkret, sepse është virtual dhe sa e sa më i zmadhuar, por gjithnjë shumë personal. Autori është i lirë të hyjë në mjedise të tilla ku nuk ka mundësi të vëzhgosh. Hapësira e lirisë i është bërë e mundur atij për të mbajtur qëndrim kritik shumë të guximshëm. Më shumë se petku i klerikut të ditur dhe të urtë, këtë mundësi ia jep zgjerimi i hapësirave të lirisë në krijimtari. Poema është kthyer kështu në një pasqyrë që zbulon të vërtetën që nuk vjetrohen.

Po të kemi parasysh maksimën e Zigmund Frojdit: “Qytetërimi filloi kur, për herë të parë, një njeri hodhi një fjalë në vend të një guri.”, mund të jemi më të saktë në përcaktimin e rolit të madh që luajti gjuha e krijimeve artistike në krijimin e paqes sociale, apo në të kundërt, aq të nevojshme për atëherë, e gjithmonë. Që shkrimi në shqip po fiton ngjyresa kritike, kjo duhet përshëndetur, por toni i tij do parë me kujdes. Edhe ky personalitet i kohës, bëhet pjesë e mendësisë që po krijohej, në periudhën kur po krijohej ndërgjegjja kombëtare. Nëse kemi parasysh thënien e Abraham Linkolnit se e fiton të drejtën për të kritikuar, ai që ka zemrën për të ndihmuar, kuptohet sesa i madh është ndikimi i realitetit të krijuar mbi realitetin që jetohet.

Jemi përballë një simulakre. Simulakra (njëjës simulacrum), janë kopje të gjërave që nuk ekzistojnë ose nuk kanë origjinal. Jean Baudrillard, një filozof i njohur bashkëkohor, ka argumentuar se simulakra kanë të bëjnë me zëvendësimin e realitetit me simbole dhe shenja, në mënyrë që përvoja njerëzore të jetë produkt i saj. Baudrillard thotë se këto simulakra nuk janë thjesht ndërhyrje në realitet, as ndërhyrje iluzive në realitet: Ato nuk janë të bazuara në një realitet, as nuk fshehin një realitet, ato thjesht fshehin që gjithçka si realiteti, gjithçka reale të jetë përcaktuese mbi të kuptuarit tonë. Simulakra, të cilës i referohet Baudrillard, janë domethëniet dhe simbolizmi i kulturës dhe medias, që ndërton realitetin e perceptuar.

Se sa ndikim pati në krijimin e ndërgjegjes kombëtare, në forcimin e identitetit dhe mbrojtjen e traditës, e dëshmoi ardhmëria. U prish paqja sociale dhe u krijuan kushtet që propaganda e shfrenuar të zëvendësonte komunikimin kulturor, pasojat e të cilit ndihen ende.

Përfundime

Zgjedhjet e kryera për herë të parë në Shqipëri, menjëherë pas Kongresit të Lushnjës, nxorën një qeveri që po rritte varfërinë e dhunën. Ato nuk arritën të jenë një instrument demokracie, por u shfrytëzuan për të marrë pushtet, kur duhej të ndodhte

e kundërta. Roger Sherman, njëri nga etërit themelues të SHBA, ka mbështetur idenë se zgjedhjet janë një mjet për ta lënë pushtetin, jo për ta fituar. Kur veprohet kështu dalin zgjedhjet e duhura dhe shmangen konfliktet. Atje ku fituesit përcaktohen nga shkathtësia apo manovrat e qeverisë dhe jo nga pëlqimi i publikut që voton dalin në pah autoritarizmi, korrupsioni dhe dhuna shtetërore. Ndoshta ajo mendësi punon me mjete edhe për të krijuar dhunën me anë të fjalës, që vihet në të kundërt të funksionit që ka.

Konteksti letrar ku u zhvillua kjo poemë satirike është nacionalizmi, si ideologji e madhe kolektiviste. Porsa kanë heshtur luftërat ballkanike dhe pas tyre Lufta e Parë Botërore. Pas Kongresit të Lushnjës, filloi ngjizja e demokracisë shqiptare, që ka në themel pluralizmin. Nacionalizmi ushtroi dhunë mbi autorin, mbi individualitetin e tij krijues dhe veçantinë e veprës duke lënë si trashëgim një botë që mund të ndodhë, e cila u pranua si kontekst i kohës.

Poema Nji anderr e ime, siç po e mësojnë ata që kanë nisur ta lexojnë, është poemë e veçantë; është krijim i shkruar në kohën e trysnisë së madhe ideologjike, por që i ka shpëtuar asaj trysnie më shumë se ç' ka qenë e mundur dhe se ç'ka qenë e menduar. Vlera e tekstit artistik ngrihet mbi atë të kontekstit letrar lokal, që dallon nga dritarja e Faik Konicës te novela

Doktor Gjilpëra (1924), që jep luftën politike të kohës, kur vepron shteti tragjiko-komik shqiptar. Poema e panjohur është krijimtari artistike që i ka çliruar dogmat e kufizimet e kohës, është poemë ku kryqëzohen kohë, kultura, besime, filozofi, mite, mendësi, është poemë ku ndërthuren realja me fantastiken, ku ndeshen kontrastet e antitezat e fuqishme, ku mbruhën simbole që përcillen në kohë, ku marrin kuptime sipërore e sfidohen njeriu me të gjitha ato që përbëjnë jetën e tij sociale, ëndrra e zhgjëndrra. Ndonëse në kushte të vështira, në këtë poemë ndihet fort përcëllimi i fjalës që vret, ku shijohet thellë idhtësia e urrejtjes, njelmësia e fuqia jetësore e smirës, ku regjet e dërgjet populli 'me pes qint halle ne shpine', ku të rreh padrejtësia e paaftësia po aq sa jeta, ku mallkimi po mundon të mëdhenj e të vegjël, ku liria dëshirohet e duhet më shumë se ëndrra. Me pak fjalë e vërteta që nuk vjetrohet, nuk i jep mundësi mbivlerësimi të kontekstit letrar, sepse mbron vlerën e formës.

Ky rilexim i parë i poemës "Nji anderr e ime", që flinte në arkiv, zbulon edhe shumë të fshehta të artit të H. Ibrahim Dallit, edhe shumë të pathëna e të heshtura të tij, që dalin si nëntekst shumështrësor e që zbulojnë hibridizimin e tij kulturor, që i theksoi ngjyrat e dramës së tij vetjake, por që asokohe iu bë krah në krijimin artistik. Bashkë me to zbulohet edhe rreziku që krijon mendësia kolektiviste, që u

mbars me agresivitet e deri me urrejtje, duke u çelur udhë sistemeve politike ekstreme: fashizmit e komunizmit. Poema shërben si dokument për të provuar sesi fjala artistike mund të krijojë një realitet vrastar, pra të kryejë funksionin e kundërt të atij për të cilin është krijuar. Fjalori agresiv i regjistrit të ulët, që jo pak herë afrohet me stilin funksional të publicistikës letrare, i ndihur kohës historike që do të synonte të vinte në krye të vendit anën ideore mbi vlerat artistike.

Duke i ndihur shpërfaqjes së një bote të irrituar, nuk mundim të gjejmë Tiranën pa plagë, me jetë të zakonshme, ku jetohej, ku ka varreza, xhami, kisha, pazar, klube e vese. Sidoqoftë, duke qenë një personalitet plot impulse njerëzore, që nuk mund të shpersonalizohej, me veprën e vet artistike ai dokumenton se çfarë mund të krijojë gjuha e hakërruar prej fjalorit ideologjik.

Edhe me këtë dokumentim të problemit që krijon një botë,

e cila përjetohej si kontekst lokal e kulturor, poema, së bashku me veprat e botuara, e bëjnë autorin krijues kanonik, sepse me letërsinë e re ushqeje letërsinë e traditës, ndonëse duke i ndihur krijimit të kujtesës ideologjike. Mjegulla e rënë mbi letërsinë e dënuar me harresë, pati dhe një shërbesë konkrete për këtë poemë. Ajo nuk u përdor për t'u mbivendosur konteksti ideologjik mbi tekstin artistik, siç ndodhi me tekste të tjera që ofrojnë deformime në interpretimin e teksteve, sidomos pas Luftës së Dytë botërore.

Botimi i veprës së H. Ibrahim Dalliut në Tiranë, shërbeu në hedhjen e urave midis veprave të krijuara, duke iu larguar letërsisë ishullore që nuk ishte e pakët te ne. Vepra e paraqitur për lexim rrëzon mitin e mosleximit, sepse leximi filologjik prish leximin ideologjik, ndonëse krijimi vijon të anojë më fort kah përmasat e një letërsie misionare.

Bibliografi

- Balla, Xh. (2014) Personalitete të kulturës fetare dhe atdhetare në Tiranë, Tiranë.
- Dizdari, T. (2005) Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe, Tiranë.
- Hamiti, S. (2010) Poetika shqipe, Tiranë.
- Ombashi, R; Kruja, G. (2017) Nji andërr e ime, “Zani i Naltë”, 19, Tiranë.
- Shehri, Dh. (2013) Statusi i kritikës, Tiranë.

Ushqimet dhe barnat, të lejuara dhe të ndaluara, përballë zhvillimeve të shekullit XXI

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”,
Departamenti i Statistikës, Tiranë

Abstrakt

Një literaturë e bollshme flet për hallallin dhe haramin për sa i përket ushqyerjes dhe barnave. Me gjithë ngjashmëritë që mund të ketë me strukturat moderne që përcaktojnë rregulla apo japin rekomandime Islami ruan veçantinë e përbërshme të referimit ndaj Kur'anit. Prandaj lind nevoja e përkthimit të përbërshëm të këtyre rregullave transcendentale në masën e kohës kur jetojmë, detyrë kjo e shkollarëve myslimanë. Ata vendosen ndërmjet Kur'anit dhe detyrimit të interpretimit në kohë reale, duke vendosur kështu dy nivele interpretimi të domosdoshme. Në nivelin më të lartë rregullat e Kur'anit për të lejuarën dhe të ndaluarën kuptohen nga ana e tyre dhe mbeten mjaft abstrakte, duke kërkuar edhe një nivel të dytë, praktik, interpretimi të lehtë për tu kuptuar dhe zbatuar nga qytetarët. Kjo punë e përbërshme në të vërtetë nuk sjell asgjë të ndryshme nga burimi ku merren këto rregulla, por interpretimi i tyre është gjithmonë një sfidë që e sjell koha. Ndër më të rëndësishmet që rezultojnë është rritja e sasisë dhe kohës së përdorimit të barnave dhe ushqimeve me natyrë komplekse ku ndërhyjnë teknologjia. Zhvillimet demografike dhe teknologjike të panjohura më parë kanë sjellë plot risi në krahasim me jetën shumë më të thjeshtë të paraardhësve tanë. Në këtë situatë nuk mund të mohohet mangësia në përgjigjen e organizuar të këtyre sfidave, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme, por me shpresën që jep pasja në duar e një pasurie me vlerë të pafundme si Kur'ani, përballë të cilit na mbetet sprovë për të zbuluar dhe praktikuar. Një vend të pazëvendësueshëm zënë edhe shkollat klasike të mendimit Islam edhe pse disa vendime të tyre kërkojnë të ndryshohen në kontekstin e kohës, por duke ruajtur modelet e tyre të të menduarit si pjesë e ruajtjes së identitetit tonë si vazhdimësi historike e tyre.

Fjalëkyçe: Hallall, haram, barna, ushqime, teknologji, demografi, duhan, mish

Të diskutosh rreth një subjekti menjëherë ke marrë parasysh që e ke kufizuar atë në mundësinë individuale të njohjes dhe shprehjes. E njëjta zbatohet edhe kur diskutohet për *ballallin* dhe *haramin*, megjithëse në pamje të parë duket një temë që i ka marrë të gjitha përgjigjet. Kriteret e përcaktimit të *ballallit* variojnë duke filluar nga më e thjeshta, të tipit kur ka vetëm dy mundësi, p.sh., nëse një ushqim ka apo nuk ka mish derri. Por situata komplikohet kur shkojmë te një mik për drekë. Fillimisht duhet të dimë nëse ushqimi ka apo jo mish derri, së dyti duhet të dimë nëse ka përmbajtje alkooli dhe madje nëse përveç këtyre, e ka blerë me para të marra si ryshfet apo të grabitura, prapë do të përbënte problem serioz. Përgjithësisht situatat janë të llojit të dytë. Situatat e thjeshta zakonisht mund të ekzistojnë në shoqëri rurale ku zakonet e popullatës janë homogjene. Po të kthehemi te konsumi i mishit të derrit, dimë që në Islam, konsumi i tij është i ndaluar dhe lejimi i tij bëhet vetëm në rastin ekstrem të mungesës së çfarëdo lloji ushqimi tjetër, dhe kur jeta rrezikohet seriozisht. Konsumi në këtë rast është minimal, aq sa mjafton për të mbijetuar. Në një fshat ku nuk ka ekzistuar asnjëherë derri nuk ka nevojë fare për të kontrolluar ushqimet e gatuar në këtë aspekt. Një tortë nuk ka të njëjtat kritere të kontrollit për

lejueshmërinë e saj si në fshat, si në qytet. Në rastin e parë nuk ka nevojë për ndonjë diskutim për arsye të pamundshmërisë së përfshirjes të produkteve përbërës me origjinë nga derri. Në rastin e dytë po i njëjti ushqim duhet shmangur patjetër kur xhelatina e tortave mund të jetë me origjinë të dyshimtë. Vetëm po të analizojmë situatën e mësipërme do të shohim që definicionit bazë për *ballallin*, të zbatuar pa sforcim në fshat, menjëherë sapo futemi në qytet, duhet të përballemi me një komplikim madhor të pyetjes, nga çfarë është *haram* në çfarë është *ballall*!

E gjithë kjo duket si lojë fjalësh, sepse në fund të fundit flitet për të njëjtën gjë dhe parimi është i njëjtë, çdo gjë është hallall përderisa të mos provohet e kundërta. Ndryshimi është në mënyrën e përafrimit ndaj çështjes. Në thjeshtësinë e fshatit rregulli është njohja e *haramit* dhe aty mbaron edhe zbulesa, në momentin e njohjes së të ndaluarës të tjerat automatikisht bëhen së paku të tolerueshme për konsum. Ndërkohë në një supermarket njohja e kategorive të *haramit* është vetëm fillimi i vlerësimit të një malli. Blerësi i drejtohet një malli ushqimor nga dy arsye, së pari nga nevoja për të mbijetuar dhe së dyti për plotësimin e nevojave estetike, qoftë kjo edhe vetëm shija e mirë. Në momentin që merr një produkt në dorë e konsideron si mundësisht *ballall* dhe

në vazhdim lexon përbërësit për të përjashtuar elementet e *haramit*. Megjithëse për arsye shpjeguese problemi është thjeshtuar në ekstrem mund të përfundojmë se mënyra e të menduarit në dy situatat e mësipërme është e ndryshme:

- rasti i thjeshtë thotë që nëse nuk është haram hahet,

- dhe rasti i komplikuar thotë që e konsideroj hallall të mundshëm derisa të kontrolloj për të gjithë faktorët që e bëjnë të ndaluar dhe pastaj e konsumoj.

Një arsyetim i ngjashëm është rasti kur hedhim një monedhë dhe nëse nuk është kokë është lek, kategoritë e mundësive janë përjashtuese dhe aty mbaron edhe diskutimi. Por kur shumë faktorë ndërhyjnë në përcaktimin e një fenomeni, atëherë duhet të përjashtojmë jo vetëm mundësinë tjetër si në rastin e parë, po duhet të përjashtojmë ose jo sa më tepër mundësi.

Një arsyetim i tillë mendoj se nuk bie në kundërshtim me Kur'anin. Në perfeksionin e Tij, Kur'ani i tregon me thjeshtësi kategoritë e haramit, por në tërësinë e Tij është i lartësuar dhe i pakapshëm përveç ndonjë shkëndije, e cila është edhe vetë ajo si dhuratë. Do të ishte një shpjegim minimalist nëse e reduktojmë interpretimin vetëm në njohjen e kategorive të *haramit* dhe do të ishte e dëshirueshme interpretimi sa më kompleks me ajete të tjera dhe në

lartësinë e situatës kur jetësohet. Vetë imamët, sipas terrenit ku veprojnë, e trajtojnë sipas xhematit që kanë përballë. Nuk është e vështirë të dallohet kjo në sjelljen e tyre kur i drejtohen xhematëve, që jetojnë në situata përgjithësisht të thjeshta, *imamët* zakonisht mjaftohen me sqarimin e *haramit*. Në shumë ligjërata dëgjon imamin duke folur me një ritëm të tillë, "*haram... haram... haram*". Vlerësimi duke vlerësuar *hallallin* ka disa karakteristika si; kërkon shumë kohë, është specifik për çdo situatë dhe duhet ndjekur rast pas rasti. Megjithatë mund të konkludojmë se në rastet e thjeshta vlerësimi mund të bëhet rast pas rasti ndërsa në prodhimin në masë kërkohet që artikulli të ketë një vlerësim për të gjithë prodhimin. Ndërsa flasim në terma teorikë nuk kemi marrë në studim kategori të tjera të vlerësimit të ushqimeve dhe barnave të tilla si *mekruh* (të papëlqyerat) dhe të tjera.

Një parantezë për duhanin

Konsumimi i duhanit në vendet myslimane filloi në Marok në vitin 1598 dhe dy fetvatë e para që e ndalojnë rezultojnë pas takimit të mbretit të Marokut, Ahmad Al-Mansoor, me dy nga krerët më të lartë religjiozë të mbretërisë në vitin 1602. Gjykimi që përdoret ndaj duhanit thuhet është i ngjashëm me atë ndaj *intoksikantëve dhe substancave*

të dëmshme. Sigurisht që këto fetva nuk arritën ndalimin e konsumit të duhanit, por tregojnë përgjigjen e hershme të korpusit të shkollarëve myslimanë ndaj këtij fenomeni.

Fetvatë moderne janë të shumta dhe në vazhdim Grand Imam Gadul Haq Ali Gadul Haq, nga imamët e mëdhenj të Al-Azharit: “që në fillim të fetvasë përmend dy grupe autoritetesh në lidhje me problemin, shkollarët myslimanë dhe kërkuesit shkencorë, në mungesë të teksteve specifike në lidhje me duhanin në Kur’an dhe në synet. Së dyti studion spektrin e vendimeve që nga lejimi dhe rekomandimi deri në ndalimin e plotë, duke referuar se shkollarët myslimanë i morën këto vendime edhe duke ju referuar qëndrimeve të mjekëve të kohës, pro qofshin apo kundër. Por të gjitha këto vendime ishin të bazuara në një nga parimet e rëndësishme të Fikhut Islam, që gjërat presupozohen të bien në kategorinë hallall përderisa të provohet që janë haram. Raste të imamëve të shkollës hanefite, që e lejojnë në mungesë të teksteve të qarta për ndalimin dhe evidencës për dëmin organik, vazhdojnë me qëndrime të tjera tolerante që e konsiderojnë vetëm të papëlqyeshëm konsumin e duhanit në ambientet e xhamive dhe gjatë leximit të Kur’anit por jo të neveritshëm, pra përgjithësisht, duke iu referuar parimit të mësipërm ligjor dhe dëmit shëndetësor, të njohur, së bashku me dëmin ekonomik. Në

vazhdim fetvaja plotësohet me ajete Kur’anore në mbështetje të ruajtjes së fesë, mendjes, trupit, pasurisë dhe nderit dhe me fakte të evidencës mjekësore rreth dëmit organik të duhanpirjes, duke përfunduar me ndalimin e përdorimit të duhanit.”

Të tjerë shkollarë të njohur si Muhammad Al-Ghazali i shtojnë qëndrimin të mësipërm edhe komponentin e varësisë dhe dëmtimit fetal që shkakton duhanpirja. Duke shpjeguar përgjegjësinë e rëndë të kategorizimit *hallall* apo *haram* por duke parë evidencën shkencore autori merr vendimin dhe e konsideron të ndaluar. Emra të tjerë në këtë referencë janë, Youssef Al-Qaradhawi (Drejtor i Qendrës të Synetit dhe Siras, Universiteti i Katarit), Nasr Fareed Wassil (Myfti i Egjiptit), Abdul Galil Shalabi (Anëtar i Akademisë Islame për Kërkime), dhe të tjerë në këtë material pozicionohen të gjithë në ndalimin e duhanit. Të gjithë titujt në kllapa janë të kohës së referencës.¹ Këtu nuk mund të lë pa përmendur një qëndrim të përmbledhur të Hasan Tahsinit (vd. 1881) për duhanin. Ka shkruar një broshurë dhe i ka kushtuar një kapitull të veçantë në një vend tjetër. Pasi i bën një shtjellim shumëdimensional, gjë që nuk haset sot, thotë ndërmjet të tjerash që: “Dëshira e madhe e duhanpirësve ndaj duhanit bën

1. Al Khayat MH, editor. Islamic ruling on smoking. World Health Organization; 2000.

që ata mos ta ndiejnë dëmin që i shkakton duhani frymëmarrjes dhe zemrës.” Pasi përmend edhe dëmin ekonomik në veçanti kur vjen puna për ta ndaluar rreptësisht nëpërmjet një fetvaje megjithëse thotë që edhe mund të ndalohej rreptësisht duke u bazuar tek arsyet, prapë një fetva e tillë “duhet të marrë parasysh rrethanat dhe të mos e çojë popullin në humnera fetare, prandaj mjaftohemi ta quajmë të papëlqyer”. Një qëndrim që do të ishte i respektueshëm për çdo prijës fetar të shekullit të XXI-të.²

Pse kjo zgjatje për duhanin? Sepse e gjej si subjektin më domethënës të vendimmarrjes për një dukuri të caktuar nga ana e shkollarëve myslimanë, duke u bazuar njëkohësisht në tekste fetare dhe evidencë shkencore. Pirja e duhanit mbetet një subjekt që i ndryshon statusi sidomos nga evidenca shkencore në ndryshim nga alkooli rreth të cilit vendimi është përfundimtar. Qëllimi im në rastin konkret nuk ka të bëjë me lejin apo ndalimin e duhanit, por me metodën e përafrimit që shkollarët myslimanë kanë ndjekur ndaj subjekteve, për të cilat nuk ka tekste të qarta fetare, por evidencë të qartë mjekësore, të paktën në momentin e lëshimit të fetvasë. Barazimi i alkoolit me duhanin në gjykim kërkon një studim të veçantë sidomos duke u

nisur nga ajeti që thotë: **“Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?”**³⁷⁴ Ky ajet merr në konsideratë efekte të alkoolit si hedhja e armiqësisë, pengesa e përmendjes së Zotit dhe largimi nga namazi, që nuk sjell ngjashmëri mes dy substancave për pa kaluar një studim të hollësishëm. **Por nga ana tjetër kushdo që pranon klasifikimin e duhanpirjes si haram mbështetur në kombinimin e teksteve fetare, së bashku me evidencën shkencore, duhet ta bëjë të njëjtën gjë edhe për të gjitha produktet e tjera, ose të kërkojmë metoda të tjera më të sofistikuara.**

Ndërkohë që evidenca mjekësore, herë pas here, ka edhe ndryshime radikale ndaj qëndrimeve të mëparshme. P.sh., marrja e kolesterolit me ushqim është rekomanduar të kufizohet deri në jo më shumë se 300 mg/ditë. Ky rekomandim thuhet të mos merret parasysh në vazhdim duke mos gjetur lidhje të rëndësishme ndërmjet marrjes së kolesterolit nga dieta dhe kolesterolit në serum,

3. Kur’ani, El-Ma’ide 5:91.

4. Të gjitha ajetet e Kur’anit janë marrë nga “Përkthimi me komentim i H. Sherif Ahmetit”, OPGBG – “Rilindja”-Prishtinë, 1990.

2. Tahsini H., Hoxha Tahsini, Vepra 2. 1st ed. Tiranë: Onufri; 2013, f. 198-200.

mbikonsumimi i të cilit nuk paraqet shqetësim.⁵

Në vazhdim diskutimi do të përqendrohet në katër plane, të cilat mendoj se janë edhe sfidat moderne të një platforme interaktive me zhvillimet e kohës; **Ushqimet dhe barnat, teknologjia, përballja nëpërmjet Kur'anit dhe disa aspekte të platformës teorike.**

Ushqimet dhe barnat

Një qëndrim përmbledhës të krahasimit të ushqimeve me barnat mund ta gjejmë te “Hallalli dhe harami në Islam” ku tregohen dy qëndrimet kufi për këtë çështje. Në njërin pol janë të vendosur ata që mendojnë se ushqimet janë të ndryshme nga barnat për sa i përket lejueshmërisë së përdorimit të hallallit në raste ekstreme, duke lejuar ushqimet por jo barnat, dhe grupi tjetër që i konsiderojnë të njëjtë dhe duke zbatuar të njëjtat parime në gjykim për të dy grupet. Zgjedhja në këtë rast bëhet në favor të lehtësimit të përdorimit të tyre, sigurisht si zgjidhje në pamundësi për të gjetur alternativa *hallall*.⁶

5. Dietary Guidelines Advisory Committee. “Scientific Report of the 2015 Dietary Guidelines Advisory Committee.” *Washington (DC): USDA and US Department of Health and Human Services* (2015), 17.

6. Al-Qaradawi Y. *The lawful and the prohibited in Islam (Al-Halal wal Haram fil Islam)*. American Trust Publications; 1999 Jan 30, pp. 27-28.

Këtu gjëja më e rëndësishme dhe me përdorim praktik nga konkluzionet e përmbledhura është që toleranca e përdorimit të ushqimeve të ndaluara në raste ekstreme është më e madhe se ndaj barnave. Nëse për ushqimet nuk ka kontradiktë se mund të përdoren në raste ekstreme, për barnat ekzistojnë dy mendime; pra qëndrimi ndaj barnave është më i rreptë ndërkohë që parimet e gjykimit për ato janë të njëjta. Vetëm kaq do të mjaftonte që ti vendosnim së bashku në të njëjtën kategori, mbi të cilat zbatohen të njëjtat parime gjykimi ndërkohë që diferenca në gjykim mund të jetë e ndryshme.

Ky gjykim vetëm sa do na jepte mundësi për të filluar diskutimin rreth kësaj teme. Barnat dhe ushqimet janë subjekt ndryshimi në kohë dhe kur shikohen në kohë kemi mundësi të themi se ka një histori të tyre ku ato janë diversifikuar. Ushqimet dhe barnat e shekullit të VII-të janë mjaft të ndryshme nga ato që përdorim sot, pa diskutuar diversitetin gjeografik nga një popull te tjetri. Flamurin në këtë vorbull ndryshimesh e mbajnë barnat, ku numri dhe sidomos teknologjia e prodhimit të tyre është rritur në mënyrë të paimagjinueshme, sidomos gjatë shekullit të XX-të dhe duke mbërritur një stanjacion të çuditshëm në shekullin e XXI-të.

Me gjithë këto ndryshime, fatmirësisht, numri i parimeve të përdorshme në gjykim nuk është rritur me numrin dhe ndërlikimet e tjera të këtyre produkteve, por kanë mbetur ato të ardhura së bashku me Pejgamberin a.s. dhe shpalljen, por që kërkojnë tu mvishen këtyre ndryshimeve. Sfida më e madhe mbetet përballja amatoriale. Ka edhe një artificë që e ndryshon nga ushqimi te barnat, por me përmasa shumë të mëdha në pasoja, nëse gjykohet gabim. Në rastin e ushqimeve individi pasi informohet se çfarë dhe kur i lejohet ti përdorë merr një vendim personal, ndërsa në rastin e barnave vendimin e merr mjeku apo farmacisti dhe gjykimi i individit del në plan të dytë, duke hapur një diskutim rreth përgjegjësisë. Megjithëse në pamje të parë përgjegjësia për marrjen e vendimit bie mbi mjekun nuk janë të pazakonta historitë që përgjegjësinë ia mveshin edhe individit që ka pranuar, pavarësisht se e ka bërë pas një rekomandimi mjekësor.⁷

Se si kanë ndryshuar barnat dhe gjykimi ndaj tyre është jashtë mundësive dhe objektivit të këtij diskutimi, por mund të bëjmë një analizë të shkurtër të ndryshimeve që kanë kërkuar dhe mundësuar këtë revolucion teknologjik.

Rritja e jetëgjatësisë sjell shtimin

7. Adh-Dhahabi M. B. The Major Sins (al-kabai'r). Dar Al-kotob Al-Ilmiyah, Beirut, Lebanon, 2009, p. 83.

e sëmundjeve kronike dhe paaftësinë për shkak të moshës. Gjithashtu ndryshimet e stilit të jetesës, drejt një jete sedentare, kanë rritur riskun për sëmundje kronike. Sëmundjet kronike në rritje janë diabeti, artriti, osteoporoza, fibromialgja, dhimbjet e shpinës, sëmundjet kardiovaskulare dhe tumoret, që shoqërohen me dhimbje dhe vuajtje të vazhdueshme, duke u bërë faktorë madhorë të paaftësisë dhe vdekshmërisë. Po të krahasohet struktura demografike e popullatave në kohë është e pritshme që këto sëmundje të kenë rritje në kohën tonë, duke shfaqur rritje të padiskutueshme të sëmundjeve kronike. Gjithashtu sëmundjet kronike bashkëshoqërohen me sëmundje të tjera dhe sidomos me depresionin.⁸ Duke bërë një përmbledhje mund të themi se rritja e jetëgjatësisë me popullatat e mëparshme, pavarësisht dyshimeve që lindin për arsyet e rritjes së jetëgjatësisë, e sigurt është rritja e përdorimit të barnave dhe shfaqja e sëmundjeve shoqëruese, që edhe këto kërkojnë trajtim medikamentoz. Në një paciente kemi parë përdorimin e tetëmbëdhjetë preparateve në ditë në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimi i këtij raporti në favor

8. Morewitz SJ. Chronic diseases and health care: new trends in diabetes, arthritis, osteoporosis, fibromyalgia, low back pain, cardiovascular disease, and cancer. Springer Science & Business Media; 2006 Oct. 16. 1, 20.

të sëmundjeve kronike sjell edhe ndryshimin e trajtimit mjekësor dhe zgjat kohën e marrjes së tij. Mjafton të përmendet fakti se vendet e para si shkaqe të vdekshmërisë në shekullin e XVIII-të i zinin tuberkulozi, kolera dhe dizenteria, ndërkohë që në shekullin e XXI-të kemi mbizotërim të sëmundjeve kardiovaskulare, tumoreve dhe sëmundjeve cerebrovaskulare, këto të fundit me ecuri kronike dhe që kërkojnë trajtim të vazhdueshëm me barna. Gjithashtu ndryshimi i strukturës moshore lidhet drejtpërdrejt me sasinë dhe llojet e barnave të konsumuara.

Një skemë “e vjetër” e zhvillimi të sëmundjes kronike tregon këto etapa; zhvillimet para diagnostikimit, diagnostikimin dhe periudhën fillestare të përshtatjes, fazën kronike të zgjatur dhe fazën preterminale dhe vdekjen deri në pranimin e humbjes nga të afërmit dhe rezolucionin.⁹

Në fazën klinike dhe preterminale merren sasi të mëdha barnash. Studimet tregojnë se konsumi më i madh i barnave gjatë gjithë jetës ndodh në 6 muajt e fundit të saj dhe fenomeni është krejt i ri, me fillesa në shekullin e XX-të. Nga ana tjetër barnat janë komplekse nga aspekti i përbërjes së tyre. Nëse mjalti në formën e tij të thjeshtë quhej një formë mjekimi, sot ai

merret vetëm në formë suplementi, sepse për të njëjtën sëmundje mjekimi është medikamentoz. Po të shikohet sjellja e të sëmurëve kronikë, le të themi të sëmurët e prekur nga patologji malinje, që marrin kimioterapi, mjekimi merr përparësi ndaj ushqimit, i cili del në plan të dytë. Rezultatet e mjekimit dhe efektet anësore, shpeshherë katastrofike, janë një fenomen krejt i ri për shoqërinë tonë, që kërkon një përafrim sa më të shpejtë si nga ana fetare edhe shkencore, përafrim që fillon me përcaktimin e lejimit apo ndalimit të tyre dhe të kategorive të tjera të ndërmjetme nga aspekti fetar. Duket paradoksale që ka fetva të rrepta kundër duhanit, por nuk ka asnjë të tillë për barnat antidepressive, ndërkohë që të dyja veprojnë në sistemin nervor qendror, por këto të dytat me një efekt shumë më të madh. Lënia në kompetencën e mjekut nuk është asgjë më tepër se një justifikim, ndërkohë që fetvatë kundër duhanit janë të bazuara, si në tekste fetare, si në studime që provojnë dëmet e tij si një zinxhir shkak-pasojë. Studimet që provojnë se pirja e duhanit shkakton kancer të mushkërive datojnë që në vitin 1950.¹⁰ Ndërkohë që në mbështetje të luftës kundër duhanit ka rreth 400 fetva dhe një pjesë e tyre e

9. Rolland JS. Chronic illness and the life cycle: A conceptual framework. Family process. 1987 Jun. 1:26(2):203-21.

10. Brownson RC, Bright FS. Chronic disease control in public health practice: looking back and moving forward. Public Health Reports. 2004 May. 119(3):230-8.

përcaktojnë si haram.¹¹ Një pyetje e ndershme është: a janë hallall të gjitha barnat që veprojnë në sistemin nervor qendror?!

Në lidhje me barnat duhet përmendur edhe përdorimi i trajtimeve alternative si plotësues e deri zëvendësues i barnave. Ka një mbivlerësim të këtij fenomeni ndërkohë që nuk arrihet të përfitohet me të vërtetë nga kjo pasuri për arsye të mosnjohjes profesionale. Shpeshherë abuzohet edhe nga autoritete fetare, ndoshta edhe vetëm me qëllimin e mirë për të propaganduar besimin fetar, ose traditat vendore. dhe duke ofruar zgjidhje alternative me pak efekte anësore. E vërteta është që konkurrenca që i bëhet me këto metoda terapive me barna është e përkohshme dhe ndoshta e dëmshme. A jam kundër këtyre metodave? Absolutisht, jo! Jam përkrahës i fuqishëm i tyre, por duhen promovuar njohësit e vërtetë të tyre, që nuk janë të shumtë, sepse përdorimi në mënyrë amatoriale sjell shkatërrimin e efikasitetit dhe ul besimin te këto metoda, duke sabotuar përfitimet e mundshme prej tyre. Ajo që dua të them është që trajtimi joprofesional me këto

metoda çon në rritjen e përdorimit të barnave.

Së fundmi një përshkrim i shkurtër i rritjes së numrit të barnave dhe shitjeve do të shërbente për të vlerësuar njëfarësoj edhe shtimin e rrisqeve me të cilat do të përballen popullatat. Sipas DrugBank, një burim elektronik bioinformatike dhe kemioinformatike, numri i përgjithshëm i barnave në vitin 2017 është 8261, nga të cilat, pjesa më e madhe, përbëhet nga barnat në fazë eksperimentimi, 5019, një potencial shumë i madh i pritshëm për konsumin e barnave. Në këto bëjnë pjesë edhe 94 përbërje të konsideruara si barna nutricionalë, apo ushqime, me efekte të provuara mbi shëndetin, që përdoren edhe si barna.^{12,13} Shifrat e kësaj tregtie në nivel global, për vitin 2015, janë 742 trilion \$ dhe pritshmëritë për vitin 2022 janë 1,121 trilion \$.¹⁴ Një situatë e tillë nuk është e çuditshme duke marrë parasysh rënien e vdekshmërisë foshnjore dhe rritjen e jetëgjatësisë që, duke u kombinuar me zhvillimet teknologjike, sjell këtë rritje të madhe

11. Cigarette smoking fatwa | Dr. Zakir Naik, Question & Answer [Internet]. Zakirnaikqa.wordpress.com. 2017 [cited 29 March 2017]. Available from: <https://zakirnaikqa.wordpress.com/tag/cigarette-smoking-fatwa/>


12. Wishart D. DrugBank: a comprehensive resource for in silico drug discovery and exploration. Nucleic Acids Research. 2006;34(90001):D668-D672.

13. [Internet]. 2017 [cited 26 May 2017]. Available from: <http://www.drugbank.ca>. N.p., 2017. Web. 26 May 2017.

14. EvaluatePharma® World Preview 2016, Outlook to 2022. 9th ed. Evaluate Ltd.; 2017. 2.

të konsumit. Një ndryshim i tillë i strukturës së popullatës ka ndodhur edhe në Shqipëri. Në vitin 1969, vdekshmëria foshnjore ishte 112 për mijë dhe jetëgjatësia ishte 66.5 vjeç, vdekshmëria foshnjore në vitin 2011 kishte rënë në 15,3 për çdo njëmijë lindje. Ndërkohë që në vitin 2014 jetëgjatësia e meshkujve ishte 76.4 vjet dhe për femrat 80.3 vjet^{15, 16}

Fig. 1 Ndryshimi në kohë i balancës në konsum ndërmjet ushqimit dhe barnave



Zhvillimet teknologjike

Zhvillimet teknologjike janë aspekti tjetër që duhet marrë në konsideratë. Një rast krejt i zakonshëm i implikimit të teknologjisë në produktet ushqimore

është prodhimi i sallameve. Nëse mishi është një produkt i thjeshtë natyror, sallamet janë produkte mjaft të sofistikuar, madje edhe po të krahasohen me ato tradicionale. Teknologjia ka ndryshuar që nga forma e përfitimit të lëndës së parë, te përpunimi dhe në fund te ruajtja dhe konsumi. Këtu jemi të detyruar të bëjmë lidhjen me duhanin. Nëse duhani konsiderohet haram, edhe në të dhëna shkencore, a duhet të aplikohet e njëjta metodë për produktet që si pasojë e ndikimit të teknologjisë mund të jenë karcinogjene?!

Gjetja e shkakësisë është një proces jashtëzakonisht i vështirë dhe janë të pakta rastet e njohura të provuara nga mjekësia moderne, ndërkohë që hipotezat, edhe pse të mbështetura nga studime, janë të shumta dhe mbeten hipoteza. Një rast i tillë është edhe konkluzioni i nxjerrë në vitin 2015 se konsumi i mishit të procesuar klasifikohet si “karcinogjen te njerëzit”, kjo bazuar në evidencë të mjaftueshme në lidhje me kancerin kolorektal, ndërsa mishin e kuq si “probabilisht karcinogjen te njerëzit”.¹⁷ Te mishrat e procesuar futen proshutat, salçiqet, hot-dogët, sallamet, mishi

15. Shqipëri Popullsia dhe Dinamikat e saj - Horizonte të reja demografike. 1st ed. Tirana: INSTAT; 2014. 6.

16. Mplakja e Popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri. 1st ed. Tirana: INSTAT; 2015. 1.

17. Bouvard V, Loomis D, Guyton KZ, Grosse Y, El Ghissassi F, Benbrahim-Tallaa L, Guha N, Mattock H, Straif K. Carcinogenicity of consumption of red and processed meat. *Lancet Oncology*. 2015 Dec 1;16(16):1599.

i kripur si dhe mishi në kuti dhe mishrat me salcë të konservuara. Nuk duhet harruar që, përveç këtyre konkluzioneve, edhe cilësia e mishit është faktor i rëndësishëm, ku mishrat e lirë, jo-organikë, me aditivë si nitritet dhe nitratet, nga kafshë të ushqyera me hormone dhe antibiotikë, bëjnë diferencë jo vetëm në shije me prodhimet cilësore, por sidomos në impaktin që kanë te shëndeti i njeriut. Të gjitha këto produkte janë subjekt i teknologjive moderne të përpunimit dhe të substancave shtesë, qoftë për rregullimin e shijes, apo për ruajtje në kohë të gjatë. Përgjithësisht konsiderohen të rrezikshme për kancerin kolorektal. Bëhet fjalë për një sëmundje që megjithëse ka një variacion shumë të madh hasje sipas rajoneve është përgjegjës për rreth 9% të të gjithë kancerave të diagnostikuar.¹⁸ Nga ana tjetër edhe dëmi i duhanit shkaktohet nëpërmjet komponentëve kancerogjenë.¹⁹ Përveç dëmit ekonomik, që për një pjesë të madhe të të pasurve nuk ka pse llogaritet, dëmet e duhanin qëndrojnë pikërisht te karcinogjenët që transmeton në organizëm gjatë konsumit. Fetvatë e marrin këtë të

mirëqenë dhe e përdorin së bashku me tekstet fetare për të vendosur. Një pyetje që nuk duhet ti fshihemi është: a janë të gjithë faktorët karcinogjenë të provuar *haram*?

Përveç konkluzioneve përfundimtare shkencore, duhen diskutuar edhe metodat statistikore që kanë bërë të mundshme nxjerrjen e këtyre rezultateve. Metodatat statistikore të përdorura sot masivisht njihen edhe nga FDA (Food and Drug Administration) për mbështetjen e konkluzioneve eksperimentale. Zakonisht këto vendime mbështeten në konkluzione probabilitare, që do të thotë se një konkluzion pranohet si i vërtetë, pra që mund të ketë një mekanizëm shkak pasojë, dhe jo një ngjarje e ndodhur rastësisht. Edhe në rastet kur pranohet hipoteza mbeten mundësi që, nëse i njëjti eksperiment përsëritet, rezultatet mund të jenë të ndryshme nga ato të cilat i kemi marrë si të suksesshme. Zakonisht përdoret një vlerë $p < 0.05$ për të treguar sinjifikancën statistikore, që tregon edhe se, rezultati, një herë në njëzet raste, mund të jetë i gabuar. Një logjikë e tillë është e njëjtë edhe për testimet më të ndërlikuara.²⁰ Këtu nuk bëhet fjalë për një kundërvënie ndaj rezultatit shkencor nga autoriteti fetar, por vetëm njohja e nivelit të pasigurisë që ofron ky rezultat, në

18. Hagggar FA, Boushey RP. Colorectal cancer epidemiology: incidence, mortality, survival, and risk factors. Clinics in colon and rectal surgery. 2009 Nov;22(04):191-7.

19. Hecht SS. Cigarette smoking: cancer risks, carcinogens, and mechanisms. Langenbeck's Archives of Surgery. 2006 Nov. 1;391(6):603-13.

20. Pena-Rodriguez ME. Statistical process control for the FDA-regulated industry. ASQ Quality Press; 2013 Apr. 11. 81.

ato nivele që ky i fundit ja njeh vetes, sidomos në rastet kur në diskutim është përcaktimi i lejueshmërisë së një produkti.

A duhet të përqëndrohemi te Kur'ani në lidhje me komplikimet e kohës?

‘Juve u janë ndaluar (t’i hani): ngordhësira, gjaku, mishi i derrit, ajo që theret jo në emrin e All-llahut, e furmja, e mbytura, e rrëzuarja, e shpuarja (nga briri i tjetrës), ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta therrni (para se të ngordhë), ajo që është therur për idhuj, dhe (u është e ndaluar) të kërkonit me short fatin. Kjo është mëkat ndaj All-llahut. Tashmë, ata që mohuan, humbën shpresën për fenë tuaj (se do të ndërroni), andaj mos u frikësoni atyre, por Mua të më frikësoheni. Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fë. E kush detyrohet nga uria (të hajë nga të ndaluarat),

duke mos anuar dhe duke mos pasur qëllim mëkatit, All-llahu falë shumë dhe është mëshirues.²¹

Jemi përqëndruar te ky ajet me qëllim marrjen e tij si shembull, duke parë edhe thjeshtësinë me të cilën ka klasifikuar kategoritë e haramit në lidhje me ushqimet shtazore. Në paraqitjen më poshtë kemi treguar në mënyrë skematike këtë fakt.

Shikohet që pasi përmenden fillimisht disa kategori harami me natyrë endogjene, ku ndalesa qëndron në të gjitha rastet si pjesë e natyrës së tyre, pastaj kemi shprehjen “**ajo që theret jo në emrin e All-llahut**” pastaj prapë disa kategori të cilat në vetvete nuk janë haram, por kthehen të tilla nga veprimi i faktorëve të jashtëm, pastaj prapë shprehja “**ajo që është therur për idhuj**”. Kjo na jep mundësinë për ta skematizuar ajetin Kur’anor.

Fig 2. Klasifikimi i ajetit të Kur’anit sipas kategorive të haramit që trajton

21. Kur’ani, El-Ma’ide 5:3.



Nëse do të kërkonim një ndarje të tillë të ngjashme në fushën e mjekësisë do të gjenim ngjashmëri në Klasifikimin Ndërkombëtar Statistikor të Sëmundshmërisë dhe Problemeve të Lidhura me Shëndetin (ICD-10).²² Ky klasifikim përdoret si standard nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe pavarësisht se është ekskluziv për njerëzit, ngjashmëritë në kodifikimin e shkaqeve të vdekjeve janë të pakontestueshme. Në kapitujt XIX dhe XX, që i dedikohen plagëve, dëmtimeve, helmimeve dhe shkaqeve të jashtme të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, mund të gjenden kode siç tregohet në tabelën më poshtë. Kodet T71, W74, Y30 dhe W55 kanë ngjashmëri grupin e termave të përdorur në Kur'an, [e furmja, e mbytura, e rrëzuarja, e shpuarja (nga briri i tjetrës), ajo që e ka ngrënë egërsira]. Ndërsa të gjithë kapitujt e tjerë mund të projektohen në termat e përmendur në pjesën e parë të sures (cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri).

Tabela 1. Pjesë nga Klasifikimi Ndërkombëtar Statistikor i Sëmundshmërisë dhe Problemet e Lidhura me Shëndetin (ICD-10)

Klasifikimi	Ndërkombëtar Statistikor i Sëmundshmërisë dhe Problemet e Lidhura me Shëndetin (ICD-10)
Kapitulli XIX - Dëmtime (plagë), helmime dhe pasoja të tjera të përcaktuara të shkaktarëve të jashtëm. (S00-T98)	
Kapitulli XX - Shkaqe të jashtme të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë. (V01-Y98)	
T71 Asfiksia	
W74 Mbytje dhe fundosje e papërcaktuar	
Y30 Rrëzim, kërcim ose shtytje nga një vend i lartë, qëllim i papërcaktuar.	
W55 I kafshuar ose i sulmuar nga gjitarë të tjerë.	

Po ta thjeshtojmë diskutimin rreth ajetit deri në përcaktimin e dy grupeve të shkaqeve të ndalesës si të brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene), duhet edhe të mendojmë që ndarja nuk është e rastësishme. Grupi i parë ku futen cofëtinë, gjak i derdhur dhe mishi i derrit kanë karakteristika ndalesën që e ka origjinën nga ana mjekësore në vetitë e tyre të brendshme. Cofëtina mund të ketë ngordhur nga vdekje natyrore për shkaqe të brendshme, si sëmundje infektive dhe të tjera por statusin e *haramit* e ka marrë pas ngordhjes, duke e ndarë ekzistencën e kafshës në dy segmente kohore, para

22. International Classification of Diseases [Internet]. World Health Organization. 2017 [cited 29 March 2017]. Available from: <http://www.who.int/classifications/icd/en/>

dhe pas vdekjes, tek e para lejohet dhe tek e dyta ndalohet. Gjaku është pjesë e indit lidhor të kafshëve në fjalë, pra nga e njëjta kafshë ka pjesë që lejohen për ngrënie dhe të tjera jo. Së fundmi është derri, kafshë që i përket familjes *Suidae* të klasës së gjitarëve. Është në të njëjtin rend (*Artiodactyla*) me delet, dhitë dhe gjedhët por i ndaluar për tu ngrënë. Po ti përmbledhim tre ndalesat vërejmë se ndalohen një segment i gjendjeve (cofëtinë), një ndalesë e një segmenti nga organet (gjaku) dhe një segment nga kategoritë e kafshëve (derr). Klasifikimi, aq sa është i thjeshtë për tu njohur dhe respektuar, aq komplikohet nëse fillojmë ta analizojmë, qoftë edhe duke bërë pyetjen, pse! Për shembull, derri është i ndyrë, është një arsye që përmendet në Kur'an, por nuk mund të ndalemi me kaq. Kjo mund të jetë një arsye në planin shëndetësor dhe tashmë është e pranuar por nuk mjafton. Edhe nëse rritja e kësaj kafshe në ambiente plotësisht sterile dhe me ushqim të pastër, nuk do ta bënte ngrënien e saj të lejuar. Por prapë duhet kërkuar për lloje të tjera papastërtie meqenëse ajeti Kur'anor vazhdon të mbetet në fuqi. Grupi tjetër me kafshët e ngordhura nga faktorë të jashtëm nuk është kufizuar në shprehje të tipit, “të ngordhura në mënyrë traumatike” por i ka specifikuar në pesë kategori gjë që të detyron të mendosh që studimi sipas kësaj ndarje do na orientojë në

zbulesa të tjera të dobishme.

Nuk është qëllim i këtij diskutimi të merret me analizë të hollësishme të fenomeneve të *ballallit* dhe *haramit*, jo vetëm se nuk është subjekt i tij, por së pari nga pamundësia profesionale për ta ndjekur nga aspekti fetar këtë çështje dhe për të nxjerrë konkluzione, apo për të marrë vendime. Qëllimi është për të treguar që, në Kur'an, mund të ballafaqohet shumë mirë shkenca moderne dhe të shikohet si në një pasqyrë perfekte për të vlerësuar veten dhe të shikojë mangësitë. Gjithashtu një sure Kur'ani nuk mund të studiohet e shkëputur pa ndjekur marrëdhëniet e saj me pjesët e tjerat të Kur'anit, shpjegimet nëpërmjet hadithit dhe mendimin shkencor Islam, të kohës dhe atë historik. Megjithatë mund të shikohet pa hezitim se mund të gjejmë në Kur'an mundësinë e ballafaqimit me platformat më komplekse moderne, dhe, sigurisht, nëse kemi aftësi, edhe ti korrigojmë e ti çojmë ato përpara.

Do të kufizohem për të mos interpretuar dy format e therjes ‘jo në emër të Allahut’ dhe ‘për idhuj’ por duke hipotetizuar në ruajtjen e ngjashmërisë me ndarjet e tjera në endogjene dhe ekzogjene, ku në rastin e parë ndalesa bëhet ndaj një veprimi të ndaluar me natyrë të brendshme dhe në rastin kur therja bëhet për idhujt, si ekzogjene. Përse përmendet shorti në të njëjtin vend me këto ushqime haram?!

Aspekte teorike

Një problem teorik serioz është edhe ndjekja apo jo e shkollave të caktuara juridike në çështje të *ballallit* dhe *haramit*. Dy ekstremet e përmendura nga Youssef Al-Qaradhawi (Jusuf Kardavi) në librin e tij të famshëm “Hallalli dhe harami në Islam” janë liberalizmi i plotë ndaj kulturës perëndimore dhe të qëndruarit ngurtësisht në përfundimet e një shkolle të caktuar juridike. Qëndrimi i shejhut është i qartë, duke u pozicionuar për moskompromentimin e inteligjencës, duke ndjekur verbërisht një shkollë të caktuar.²³ Mendimi im personal, meqenëse duke marrë përsipër të diskutoj minimalisht një përafrim ndaj *ballallit* dhe *haramit*, që kanë lidhje me ushqimet, është se çfarë komponentësh duhen marrë në konsideratë për të ndërtuar një platformë bashkëkohore, është që shkollat juridike me veçantitë e tyre nuk mund të përjashtohen.

Realiteti i Ixhmasë është që ulematë e një kohe të caktuar me unanimitet bashkohen rreth një qëndrimi të caktuar.²⁴ Ky definicion ka të veçantë futjen e faktorit kohë

dhe po i njëjti autor thotë që, në rast të gjetjes së papërshtatshmërive me tekstet e shenjta, përsëri qëndrimi duhet modifikuar, duke shtuar që edhe vetë shkollari, po të ishte në dijeni, do të bënte të njëjtën. Duke i dhënë Ixhmasë, një mirëkuptim kaq të madh ndërmjet shkollarëve, një funksion kohor, atëherë çfarë mbetet për çështje për të cilat merren vendime duke u mbështetur në qëndrime shkencore vazhdimisht të ndryshueshme. Pra vendosja e një gjykimi në kohën e dhënies dhe mundësia për të gabuar nga shkollarët e kohës, sado e vogël të jetë, duhet marrë parasysh. Megjithatë mundësia e gabimit është kaq e vogël dhe e pamundur të gjendet nga ana jonë, saqë përgjithësisht duhet të fokusohemi te faktori kohë, duke e parë një vendim të caktuar si një *përkthim*, ose shkollarin si një *ndërfaqe* ndërmjet nesh dhe tekstit të shenjtë. Ndërkohë që mund ta gjykojmë qëndrimin si të modifikueshëm në kohë të ndryshme, nuk duhet të humbasim aspektin tjetër të vendosjes së këtij shkollari si interpretues i Kur’anit, që është një mënyrë të menduari, që i ka kaluar të gjitha sprovat e mundshme, përfshirë edhe pamundësinë e këtij personi për të ndryshuar tashmë qëndrim ngaqë ka kaluar shumë kohë.

Shkollat juridike sigurisht që nuk janë të paprekshme nga gabimet. Por duhen dalluar çfarë janë gabime dhe

23. Al-Qaradawi Y. The lawful and the prohibited in Islam (Al-Halal wal Haram fil Islam). American Trust Publications; 1999 Jan. 30. 9.

24. Moulana Ashraf Ali Thaanwi. The principles and codes of law in Hanafi Fiqh. 1st ed. Pakistan: ZamZam Publishers; 2007. 24-28.

çfarë duken si gabime në projektionin e Islamit në kohën e sotme. Kjo është një punë tejet e vështirë, madje në kufijtë e të pamundurës, sepse kërkon vlerësimin dhe në njëfarë mënyre edhe gjykimin e figurave të shkëlqyera të Islamit. Mendoj se të gjykosësh ndryshe, por nga të njëjtat baza fetare, sepse veprohet në një terren socio-kulturor të ndryshëm, është e pranueshme. Nga ana tjetër, gabimi i juristëve të mëdhenj myslimanë është i mundshëm, por me shanse të vogla, prandaj njohja dhe vazhdimi i traditës së tyre, duhet të jetë pjesë e platformës që duhet të krijojmë që në fillim për vendimmarrje. Aftësia dhe mundësia e tyre për të qenë në kontakt me të vërtetën duhet të jenë pjesë integrale e studimit. Nëse një ndryshimi modern të teknologjisë së prodhimit të ushqimeve jemi të detyruar ti bëjmë një analizë dhe të vendosim për vulosjen e tij me termin *hallal* ose *haram*, duhet të kemi parasysh që ky zhvillim i kësaj teknologjie ka ardhur si një proces historik studimi dhe provash të vazhdueshme, ashtu edhe gjykimi jonë duhet të jetë rezultat i reflektimit të një procesi historik mendimi që e ka origjinën tek të vërtetat absolute të Kur'anit. Në të kundërt një fenomeni historik, edhe pse është pastërtisht shkencor, ne i vendosim një arsytim që përjashton në mënyrë arbitrare “vendimet e ngurta të shkollës juridike”, duke humbur kështu në këtë ballafaqim, në

rastin më të mirë, mësimet që mund të përfitohen nga mënyra e tyre e të menduarit dhe, në rastin më të keq, interpretime që nga nxitimi mund ti quajmë të ngurta apo të gabuara për kohën tonë, por po ti studionim me vëmendje në kontekstin e kohës kur janë zbatuar do na mësonin shumë si të realizonim interpretime të sakta. Kjo do na vononte shumë dhe do na detyronte të bëjmë hapa më të ngadalshëm, meqenëse jemi të detyruar të rrisim masivisht bagazhin tonë me këto vepra të vjetra, që kërkojnë kohë për tu studiuar dhe, meqenëse janë më shumë se një, do kishim edhe opinionet tona më të degëzuara, por do fitonim një ecje më të sigurt dhe pluralizëm mendimesh, që nuk kanë të bëjnë me bazat e fesë, por me probleme të reja, përafrimet ndaj të cilave do ishin aq më pozitive sa më shumë ide të shkëmbehen.

Diskutimi

Po të shikohet literatura për çështjet e hallallit dhe të haramit, në lidhje me ushqimet dhe barnat, vihet re shpejt që është mjaft e fragmentuar pavarësisht impenjimit për ta garantuar hallalin. Librat që qarkullojnë janë për përdorim praktik nga individë dhe zakonisht vendimet janë në formë të fetvave dhe reflektim i tyre në kodifikimet ndërkombëtare për ushqimin. Por nuk ka struktura që merren vazhdimisht me studimin e këtyre

fenomeneve dhe që kanë për qëllim të arrijnë integrimin drejt krijimit të një strukture universale, që të prodhojë vazhdimisht rekomandime ose të japë përgjigje joindividuale për këto çështje. Sidomos, ndarja e ushqimeve nga barnat, është mjaft e dukshme, ku për të parat punohet vazhdimisht dhe të dytat u besohen autoriteteve shkencore. Konkretisht në CODEX Alimentarius jepen standardet në formën e udhëzuesve, gjithsej dy faqe dhe nuk përmenden barnat në veçanti.²⁵ Ndërkohë që propozimet e reja vijnë vetëm nga dy vende, Turqia dhe Egjipti, të cilat janë marrë në konsideratë për ndryshime që nuk kishin ndodhur që nga viti 1997, por nuk përmendin as barnat dhe as implikimet teknologjike.²⁶ Listat me përbërës

të ndaluar janë të pamjaftueshme, sepse nuk marrin në konsideratë as minimalisht efektet e elementeve kimikë në organizmin e njeriut, rasti i barnave, dhe as efektet e teknologjisë në prodhim dhe ruajtje. Iniciativa individuale dhe në formë eksperimentale mund të gjenden si në rastin e ngritjes së platformave të krijimit të parimeve të logjistikës hallall, që kanë të bëjnë me ruajtjen, transportimin dhe veprimet e fundme në shpërndarje, duke ruajtur produktet *hallall* nga kontaminimi me produkte *haram*.²⁷

Duhet të rikthehemi te diskutimi i fillimit që ka të bëjë me pamjaftueshmërinë e zgjidhjes rast pas rasti dhe në formulimin e përgjigjeve komplekse siç janë strukturat dhe prodhimet e kohës sonë. Qytetari kërkon një përgjigje të thjeshtë, përfundimtare nëse produkti është *haram* apo *hallall*. Pjesa tjetër, përgjithësisht për produktet komplekse, e sidomos për barnat, nuk është detyrë e tij. Në

25. CODEX Alimentarius: List of Standards [Internet]. Fao.org. 2017 [cited 29 March 2017]. Available from: <http://www.fao.org/fao-who-codexalimentarius/standards/list-of-standards/en/>

26. CODEX Alimentarius: Search results [Internet]. Fao.org. 2017 [cited 29 March 2017]. Available from: <http://www.fao.org/fao-who-codexalimentarius/search-results/en/?cx=018170620143701104933%3Ai-zresgmxec&cof=FORID%3A11&q=halal&sa.x=0&sa.y=0&sa=search&siteurl=http%3A%2F%2Fwww.fao.org%2Ffao-who-codexalimentarius%2Fen%2F&siteurl=www.fao.org%2Ffao-who-codexalimentarius%2Fabout-codex%2Fen%2F&ref=www.fao.org%2Ffao-who-codexalimentarius%2Fsearch-results%2Fen%2F%3Fcx%3D01817062014370110>

4933%253Ai-zresgmxec%26cof%3DFO
RID%253A11%26q%3Dhalal%26sa.x%
3D7%26sa.y%3D10%26sa%3Dsearch%26
siteurl%3Dhttp%253A%252F%252Fwww.
fao.org%252Ffao-who-codexalimentarius
%252Fen%252F%26siteurl%3Dwww.fao.
org%252Ffao-who-codexalimentarius%25
2Fen%252F%26ref%3Dwww.google.al%2
52F%26ss%3D1737j1154411j6&ss=677j1
22585j5

27. Tieman M. Establishing the principles in halal logistics. Journal of Emerging Economies and Islamic Research. 2013 Oct;1(1):1-3.


ketë realitet nuk mund ti thuhet që produkti është hallall pjesërisht ose që garantojmë vetëm një pjesë të karakteristikave që kërkon hallalli. Përfshirja e fesë në vlerësimin e cilësisë nuk mund të mohohet, si në rastin e hadithit që flet për grurin e lagur dhe as në rastin e masave ku Kur'ani është i qartë për njerëzit që peshojnë dhe masin mangët, ku për analogji mund të përmendet një komponent farmaceutik *hallall* në parim por me sasi të mangët, i cili nuk jep efekt nga sasia e pakët e barit dhe rrezikon jetën ose shkakton vdekjen e pacientit. Në ngjashmëri me klasifikimin që i kemi bërë më sipër ajetit të Kur'anit, ku ndarja e mishit *haram* bëhej sipas karakteristikave *endogjene* apo *ekzogjene* që e bëjnë *haram*, kemi edhe klasifikimin që e ndan në atë që është *haram* në vetvete (*liajnihi*) dhe shkaqe të jashtme, si rasti i përvetësimit të gabuar apo *ligajrihi* ose *bilvasita* (i shkallës së dytë).²⁸ Megjithëse është me të vërtetë e komplikuar, arrijmë të gjejmë disa dimensione të hallallit që, megjithëse nuk mund të garantojen nga një burim i vetëm, mund të realizohet në bashkëpunim. Kjo nuk përjashton kontradiktat e pritshme si në rastin kur, megjithëse mund të

ketë në disa ushqime proteinë nga derri nën vlerën 0.5% dhe nuk raportohen, atëherë përdorimi i tij 'lejohej' dhe diskutimet e ngjashme për birrën dhe birrën pa alkool. E njëjta situatë mund të kërkojë edhe diskutim të ligjeve aktuale që dalin jashtë rrethit të diskutimit ndërmjet shkollarëve të fesë Islame, por për të cilat ata mund të bashkëpunojnë me specialistë të disiplinave të tjera. Konkretisht Ligji për Ushqimin thotë në Kreun X, Neni 36, për vendosjen e etiketave që e kërkon në rastet kur sasia e alkoolit kalon vlerën prej %1.2 të vëllimit.²⁹ Këto kontradikta në pamje të parë, mund të sjellin zhvillim pozitiv nëse kërkohet me sinqeritet bashkëpunimi në favor të konsumatorit, ku të përfshihen, përveç të tjerave, edhe respektimi i preferencave të tij. Në Fig. 3 në mënyrë skematike tregohet se si një bar/ushqim konsiderohet si subjekt vlerësimi njëkohësisht si i lejuar apo jo nga ana fetare dhe gjithashtu si subjekt rregullash dhe rekomandimesh, bashkëpunim investigues që do të ishte në të mirë të konsumatorit.

28. Ekipi i Studimeve Akademike. Udhërrëfytyesi i një myslimani, Ilmihali II (Adhurimet). 1st ed. Tiranë: PRIZMI; 2010. 19-20.

29. Ligji për Ushqimin; Nr. 9863, datë 28.1.2008 [Internet]. Ministria e Shëndetësisë. 2017 [cited 6 June 2017]. Available from: <http://www.shendetesia.gov.al/al/baza-ligjore/legjislacioni/ligje1486633274>

Fig. 3 Një skemë përfitimi nga aspekti fetar dhe ligjor në vlerësimin e lejueshmërisë së barnave dhe ushqimeve



Konkluzione

Etiketa *hallall*, nëse nuk është pjesë e një sistemi administrimi, garanton produktin vetëm në momentin e vendosjes së saj. Më pas produkti mund të mos ruhet si duhet, duke e humbur këtë vlerësim, apo në rastin më të keq, mund të abuzohet duke u përfshirë me komponentë të *haramit*. Prandaj, duhet konsideruar nevoja e ndërtimit të sistemit të *hallallit*, si një sistem informacioni i bazuar në indikatorë me prejardhje nga caktimet fetare. Kjo është subjekt i një vendimmarrje jo vetëm nga shkollarë të fesë, por kërkon

diskutim multidisiplinar, vlerësim të ndërhyrjeve dhe vendimmarrje dinamike e në bashkëpunim me vende të tjera. Të flasësh është më kollaj se të veprosh sidomos sipas parimeve universale si hallalli dhe harami, që duhen zbatuar në situata lokale gjithmonë të ndryshueshme. Megjithatë nuk shikoj se ekziston ndonjë zgjidhje tjetër përveç përafrimit holistik që ofron Islami, duke synuar gjithnjë ruajtjen e caceve të përcaktuara nga feja.

Ndërkohë që këtij problemi nuk mund të mbetet pa ju bashkëngjitur çështja e barnave, e cila nuk lidhet vetëm me aspekte të ngushta të hallallit dhe haramit në konsum, por edhe me adhurime të tjera, si rasti i agjërimit kur marrja e barnave nga mosha të vjetra, gjithnjë duke u shtuar në numër dhe që vuajnë nga sëmundje kronike janë subjekt i kombinimit të marrjes së barnave për të ruajtur shëndetin me agjërimin dhe adhurime të tjera.

Së fundmi duhet të ndryshojë edhe qëndrimi që kërkon vazhdimisht mosgjethjen e kontradiktave në Kur'an me faktet shkencore, në një burim ku shkenca gjen frymëzim, fakte dhe miratim të vetes.

“Drita Islame” - një shkëndijë e dritës së fesë islame në Shqipërinë paskomuniste

*“Duan të shuajnë me gojën e tyre Dritën e Allahut,
por Allahu e plotëson Dritën e Tij edhe pse e urrejnë mohuesit.” (Saff, 8)*

Dr. Qani Nesimi
Myfti i Tetovës, Maqedoni

Abstrakt

“Drita Islame” ka një barrë të rëndë që të edukojë brezin e ri me fenë, e cila aq sa ka potencial të ndikojë pozitivisht, po aq ka të ndikojë edhe negativisht. Ajo, sa mund ti bëjë mirë njeriut, po aq mund ti bëjë edhe keq atij; sa mund të krijojë paqe në një vend, mund të jetë shkak edhe për luftë. Luftërat në Ballkan midis serbëve e boshnjakëve, midis serbëve e shqiptarëve, midis shqiptarëve dhe maqedonasve, midis serbëve e kroatëve, midis grekëve e shqiptarëve, sa mund të jenë me përmasa nacionale, po aq janë edhe me përmasa fetare, në mënyrë direkte ose indirekte, si motivuese e luftës, apo si mbështetëse e saj. E gjithë kjo, varet nga mënyra e përdorimit të fesë, mënyra e trajtimit të saj. Pra, ai që e beson dhe e praktikon fenë varet se si e përdor atë. Kurse ai që dubet të marrë një vendim ose të mbajë një qëndrim ndaj fesë, varet se në çfarë rrethanash dhe me çfarë bindje e ka bërë atë ose, se sa serioz është ai në qëndrimin e tij. Prandaj, për mendimin tim, periodiku “Drita Islame” ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në prezantimin dhe në interpretimin e drejtë të fesë Islame, e cila është kundër dhunës, vrasjes, keqpërdorimit të fesë, keqtrajtimit të tjetrit etj.

Në vitet '90-të në botë, sidomos në Bashkimin Sovjetik dhe në Ballkan, u përjetuan ndryshime të mëdha politike, të cilat ndikuan edhe në fillimin e ndryshimeve në aspekte të tjera në shoqëri. Kjo periudhë, për shumë popuj, shpreh edhe procesin kalimtar nga një sistem në tjetrin. Ndërsa, në anën tjetër, shpreh kalimin nga një botëkuptim lokal e nacional në atë global, pra, nga një sistem komunist, gjegjësisht sistem monist, në një sistem demokratik. Demokracia, në krahasim me komunizmin, është një sistem shumë më i përshtatshëm për jetën fetare. Me një fjalë, në sistemin demokratik u përjetua një rikthim fesë dhe aktiviteteve fetare në përgjithësi. Kurse në aspektin global, kjo është një kohë kur më veç bëhen hapat e para në kalimin prej kohës moderne në atë postmoderne. Prej një kohe kur feja mohohej krejtësisht, në një kohë kur feja luan një rol shumë të rëndësishëm për njeriun dhe për shoqërinë në përgjithësi. Këtë kohë postmoderne e karakterizon edhe një dukuri shumë e rëndësishme që është globalizmi, i cili pretendon dy fakte shumë me rëndësi. I pari, globalizmi pretendon që edhe politikisht, edhe ekonomikisht, edhe në aspektin social të dominojë ndikueshëm në tërë botën. Kurse i dyti, globalizmi pretendon të shtojë ndikimin, varësinë dhe lidhjen reciproke në dhe mes shteteve dhe shoqërive

në tërë botën. Varësia reciproke, e cila ritet bashkë me globalizmin, në mënyrë të vazhdueshme përpiqet që jetën e çdo njeri ta bëjë edhe më të varur ndaj vendimeve dhe lajmeve që vijnë aq larg sa që njeriu nuk ka mundësi që në një mënyrë tjetër t'i posedojë ato pranë vetes.

Madje, në fillim të shekullit XXI, edhe shtetet më të përparuara dhe më të fuqishme kanë qenë të detyruara të ballafaqohen me nevojën e varësisë reciproke. Shtetet nacionale, që në bazë janë shtete me kufij të caktuar, janë të detyruara të ballafaqohen me ndikimin pa kufij të teknologjisë së komunikimit, të qarkullimit të banorëve, të acarimeve dhe të konflikteve rajonale, shoqatave/organizatave multinacionale dhe të problemeve të tjera ekonomike.

Kështu që, në Shqipëri një rikthim dhe një rizgjim i këtillë filloi me shkatërrimin e regjimit komunist të Enver Hoxhës. Kështu ato pak xhami dhe kisha që kishin mbijetuar në atë sistem barbar iu kthyen përsëri jetës, gjallërisë dhe aktiviteteve fetare, ashtu si edhe ato pak klerikë fetarë që kishin mundur të mbijetonin në atë periudhë të vështirë, iu kthyen përsëri obligimit të tyre fetar, nëpër xhami dhe nëpër kisha (qofshin ato kisha ortodokse ose kisha katolike). Përsëri filluan të dalin në dritë librat, broshurat, fletushkat, revistat, gazetatat dhe shkrimet e tjera fetare, të cilat gjatë sistemit monist ishin të burgosura nëpër arkiva, biblioteka

shtetërore apo private. Sidomos, në fillim u punua për restaurimin dhe për ndërtimin e tempujve të ri. U hapën edhe shkolla të mesme dhe fakultete (akademi) fetare. Kështu jeta fetare filloi në çdo aspekt të riorganizohet dhe zhvillohet. Këtij zhvillimi i ndihmuan jo vetëm populli fetar i Shqipërisë, ndihmën e tyre u munduan që ta japin edhe fetarët, pa marrë parasysh se cilës fe i takonin, e shteteve ku feja më parë ka qenë e lejuar për veprim. Prej ndihmave që vinin në Shqipëri, krahas atyre që ishin me qëllim të pastër fetar, kishte edhe të atilla që kishin prapavijë politike dhe kulturë asimiluese. Pra, pas lëkundjeve të themeleve të totalitarizmit në përgjithësi në Ballkan, madje shembjes së tërësishme në Shqipëri, edhe organet periodike, këtu mund të përmendim edhe revistën *Drita Islame*, jepnin shpresë se po ringjallet jeta fetare dhe se me demokratizimin e jetës politike do të përmirësohet edhe jeta fetare në përgjithësi, e ajo islame në veçanti.

Ballkani është një botë më vete. Ai nuk mund të mendohet pa disa gjuhë, disa fe/religjione, disa kultura etj. Dhe të gjitha këto kanë luajtur rolin e tyre në këtë vend, në krijimin e identitetit të këtij vendi, qoftë pozitiv apo negativ. Pa një islam, krishterizëm, gjegjësisht katolicizëm e ortodoksizëm, pa hebraizëm, paganizëm e dualizëm (Maniheizëm), edhe pa ateizëm definimi i Ballkanit do të ishte i mangët. Me një fjalë, ky

vend gjeografik i ka përjetuar gati të gjitha llojet e sistemeve politike e administrative, kurse ky sistem ateist i llojit të veçantë, që u instalua në Shqipëri, është i pakrahasueshëm. Kështu që, pas rrënimit të këtij regjimi totalitar fillojnë të rilindin vlerat kombëtare e fetare që kanë qenë të ndaluara gati një çerek shekulli. Në këtë periudhë rilind edhe periodiku islam i titulluar **“Drita Islame”**, për të cilin mendoj se kuptimisht është vazhdimësi e periodikëve që botoheshin në botën shqiptare para ndalimit të fesë si **“Zani i Naltë”**, **“Kultura Islame”**, **“Njeriu”**, etj.

Drita Islame ka një barrë të rëndë që të edukojë brezin e ri me fenë, e cila aq sa ka potencial të ndikojë pozitivisht, po aq ka të ndikojë edhe negativisht. Ajo, sa mund ti bëjë mirë njeriut, po aq mund ti bëjë edhe keq atij; sa mund të krijojë paqe në një vend, mund të jetë shkak edhe për luftë. Luftërat në Ballkan midis serbëve e boshnjakëve, midis serbëve e shqiptarëve, midis shqiptarëve dhe maqedonasve, midis serbëve e kroatëve, midis grekëve e shqiptarëve, sa mund të jenë me përmasa nacionale, po aq janë edhe me përmasa fetare, në mënyrë direkte ose indirekte, si motivuese e luftës, apo si mbështetëse e saj. E gjithë kjo, për mendimin tim, varet nga mënyra e përdorimit të fesë, mënyra e trajtimit të saj. Pra, ai që e beson dhe e praktikon fenë varet se si e përdor atë. Kurse ai që

duhet të marrë një vendim ose të mbajë një qëndrim ndaj fesë, varet se në çfarë rrethanash dhe me çfarë bindje e ka bërë atë ose, se sa serioz është ai në qëndrimin e tij. Prandaj, për mendimin tim, periodiku **Drita Islame** ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në prezantimin dhe në interpretimin e drejtë të fesë Islame, e cila është kundër dhunës, vrasjes, keqpërdorimit të fesë, keqtrajtimit të tjetrit etj.

Pikërisht për këtë, feja është një koncept që zhvillohet brenda kornizave të shpalljes hyjnore dhe përcjelljes profetike. Tradita konstituive e Islamit, e njëkohësisht edhe e feve të tjera qiellore, e quan fenë dhuratë të jashtëzakonshme hyjnore, dobiprurëse dhe liridhënëse. Feja është sistem hyjnor, i cili njerëzve të arsyeshëm u mundëson t'i kahëzojnë ndjenjat e tyre dhe të bëjnë vepra të mira. Duke e përfaqësuar themelin e jetës kuptimore të njeriut dhe shoqërisë, feja është tejet funksionale në aspektet sociale dhe psikologjike të jetës. Pikërisht për këtë paraqet edhe një dukuri, e cila nuk mund të lihet pas dore. Historia, në çdo epokë, flet për marrëdhëniet e ngushta mes fesë, njeriut dhe shoqërisë. Dukuria e fesë ka ekzistuar në çdo shoqëri njerëzore dhe ka ndikuar dukshëm në formimin dhe ndryshimin e sistemeve mendore dhe shoqërore. Pikërisht për këtë edhe u tregua si i pabazë dhe joreal pohimi se me zhvillimin e shkencave pozitive do të mënjanohej nevoja

për fetë tradicionale dhe se njerëzit do ta marginalizojë idenë fetare. Një situatë e ngjashme është duke u përjetuar edhe me globalizimin dhe sfidat që njerëzimi po përjeton me të.

Kështu që, **“Drita Islame”**, edhe pse në fillim përbëhej prej disa faqeve dhe disa shkrimeve, ajo simbolikisht përfaqësonte zërin e fesë. Duke u nisur nga kjo, mund të themi se:

-**“Drita islame”** e vitit ‘92 të shekullit të kaluar ka qenë zëri i parë zyrtar i shkruar për shqiptarët myslimanë të Shqipërisë, pas shkatërrimit të sistemit totalitar komunist;

-Ajo u ka dhënë mundësi njerëzve të edukuar fetarisht më herët, të cilët kanë arritur të mbijetojnë në sistemin komunist, që ti shprehin mendimet e tyre fetare lirshëm dhe të njëjtat t’ua kumtojnë të tjerëve;

-Ajo e ka mbrojtur dimensionin sunit dhe hanefit fetar të fesë islame, dimension ky që në Shqipërinë parakomuniste ka qenë dominant;

-Ajo ka qenë diga e parë që shqiptarët i ka mbrojtur nga ndikimet e fraksioneve të ndryshme të botës islame.

Sot, si gjithmonë, janë tre premisa bazë pa të cilat nuk mund të bashkëjetohet dhe nuk mund të formohet një shoqëri tolerante e të thuhet se jemi një vend pluralist. E para premisë është pranimi i tjetrit. Të pranohet kultura, besimi,

tradita folklori i grupit tjetër etnik e religjioz, gjegjësisht të gjithë duhet të pajtohen me diversitetin kulturor, fetar e tradicional në vend. E dyta ka të bëjë me njohjen e tyre, pra nuk mund të bisedojmë vetëm për një pranim verbal dhe të thatë pa praktikë. Por pranimi duhet të pasohet nga njohja e asaj që i takon tjetrit. Kurse premisa e tretë, ka të bëjë me shpëtimin nga vetizolimi, gjegjësisht të jemi të hapur ndaj njëri tjetrit, çështje kjo të cilën e kërkon edhe procesi i globalizimit sot. Vetizolimi e bën njeriun, kulturën, fenë, grupin më të ashpër dhe më të rrezikshëm për veten dhe për të tjerët. E nëse e kemi parasysh se një njeri, një kulturë, një fe është e pamundur që të jetë i vetizoluar deri në fund, atëherë kuptohet se nëse vetë ai ose ajo nuk çlirohet nga ai vetizolim, më vonë kur të kuptohet realiteti që deri në atë moment ka qenë i izoluar, do të dalë në pah e vërteta, që në atë rast do të jetë edhe faqja e zezë e asaj apo atij.

Prandaj është e një rëndësie të veçantë që shteti dhe të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare, secili në formën e vet, të kontribuojnë singlerisht dhe realisht në këtë drejtim. Pra të mundësojnë që njerëzit, kulturat, fetë etj., të pranojnë njëra tjetrën. Institucionet këtë mund ta bëjnë vetëm duke u dhënë atyre mundësi më të mëdha, që ata ta njohin njëra tjetrën më mirë dhe më së afërmi, dhe në fund të shpëtojnë nga vetizolimi, i cili sjell

vetëm mundësi të mbjellë urrejtje.

Për këtë, çdo udhëheqës, qoftë shtetëror apo joqeveritar, në lidhje me periodikun në përgjithësi, e me **“Dritën Islame”**, në veçanti, duhet të ketë parasysh sa vijon:

1-Vetëdijësimin për periudhën postmoderne që na ndan nga periudha moderne, kurse Ballkanin edhe nga periudha komuniste;

2-Duhet mbjellë ndjenja e rëndësisë së fesë në riparimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore, dialogut, tolerancës etj;

3-Duhet dhënë shumë rëndësi njohjes së historisë, kulturës, fesë së vet, po edhe të historisë, kulturës e fesë së tjetrit, me të cilën jepet mundësia e njohjes së tjetrit, sa më tepër njohje aq edhe më tepër respekt reciprok.

4-Duhet zhdukur ndjenja e urrejtjes ndaj njëri tjetrit, që është mbjellë gjatë historisë. Këtë duhet ta bëjnë institucionet shtetërore, bashkësitë fetare, shkollat fillore, shkollat e mesme si dhe universitetet. Ende, për fat të keq, në Ballkan, për të cilën mendoj se është një sëmundje e trashëguar nga periudha komuniste, ka problem midis “intelektualëve fetarë” dhe “intelektualëve laikë”, pa dallim kombësie dhe feje. As të parët nuk i pranojnë si duhet të dytët, e as të dytët s’i pranojnë si duhet të parët. Ata as nuk dinë por as që duan të dinë singlerisht për njëri tjetrin. Ende është gjallë ajo ndjenja antitjetër në kombësi, kulturë, gjuhë dhe fe.

5-Për ta arritur këtë duhet shkruar dhe lexuar për njëri tjetrin si dhe duhet takuar sa më shumë njëri me tjetrin, duke biseduar dhe qarë halle në këtë drejtim.

Këtu do të përmend mendimtarin dhe intelektualin e njohur gjerman, Hans Kung, i cili merret me çështjen e dialogut dhe të bashkëjetesës. Ai në thënien e tij të njohur: *“Pa paqe ndëreligjioze, nuk ka paqe ndërnacionale; pa dialog ndëreligjioz, nuk ka paqe ndëreligjioze; pa njohjen dhe hulumtimin e themeleve fetare, nuk mund të ketë dialog ndëreligjioz”*, thekson se paqja ndërnacionale dhe ndërjetare janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Por në fund potencon se ato varen prej një njohjeje reciproke të themeleve të njëra tjetrës.

Dua të përmend edhe dy gjëra me rëndësi që më kanë lënë përshtypje shumë të madhe nga një trajnim i realizuar në ShBA.

E para, ishte mosekzistimi i kompleksitetit të njerëzit, madje edhe nëpër institucionet edhe më të mëdha dhe të nivelit më të lartë shkencor si universitete etj., se kanë të bëjnë me një njeri që është tjetër etnitet, racë, religjion apo ndonjë bindjeje tjetër çfarëdo qoftë ajo.

Mendoj se ne që jetojmë, sidomos në Gadishullin Ballkanik, kemi më së tepërmi nevojë për ta zhdukur ndjenjën, edhe atë shumë të theksuar, të ekskomunikimit të tjetrit nga rrethet tona, pse nuk është si ne, nuk mendon si ne, nuk beson si ne, etj.

Kurse e dyta, ishte sistemi sekular i shtetit, i cili ishte shtet i ndarë nga kisha, por vetë shteti ishte “fetar”, dhe askund nuk pashë ose të paktën nuk dëgjova për ndonjë vendim që ishte antifetar. Kryetari i shtetit sekular amerikan, bën betimin në librin e shenjtë, kurse dollari amerikan përmban fjalë religjioze. E njëjta gjë shihet edhe në fjalët, bisedat, debatet parazgjedhore të kandidatëve për president të ShBA-ve. Kështu, do të pajtohesh me idenë e papës, Benedikti XVI, i cili në vizitën e tij në ShBA (prill-2008), ndër të tjera tha se, Evropa duhet të marrë për model sistemin sekular amerikan.

Në fund dua të theksoj se periodikët islamë, konkretisht **“Drita Islame”**, duhet të mundësojë që të gjitha institucionet relevante në vend dhe më gjerë të kuptojnë peshën e fesë, pasi për fenë duhet të mendojnë të gjitha instancat shoqërore e shtetërore në vend. Këtu nuk mendoj se të gjithë duhet patjetër të besojnë. Besimi është çështje individuale. Por që ta shfrytëzojnë fenë pozitivisht, që ajo të jetë në shërbim të shoqërisë, ajo duhet trajtuar si shumë serioze, e jo si diçka me të cilën merren njerëzit e prapambetur, naivë, primitivë e të pashkolluar. Ky lloj mendimi, sipas meje, është rezultat i një qasje shumë naivë dhe injorante ndaj fesë.

Dhe si rezultat i kësaj, ajo mund të dalë prej kontrolli, jo për arsyen se feja është diçka e keqe, por sepse feja

është diçka e madhe dhe nuk mund të mbahet e mbyllur. Shtetet në Ballkan, nuk duhet që fenë ta shfrytëzojnë për qëllimet e tyre politike, por ata duhet të investojnë në këtë drejtim në mënyrë të barabartë. Vetëm në këtë formë krijohet stabilitet në vend. Në të kundërtën komunitetet fetare edhe kur heshtin ndaj padrejtësisë

shtetërore është rrezik e jo më të bëjnë ndonjë veprim të hapur në atë drejtim. Vetëm në këtë formë ka mundësi që të ruhet shoqëria nga paraqitja e grupeve radikale dhe shqetësuese për mesin tonë.

Urime “Drita Islame”!

Urime botuesve të saj!

Haxhi Ibrahim Kaduku (1869-1949)

I dekoruar me urdhrin “Naim Frashëri të Klasit I” me motivacionin: “Klerik që iu kushtua tërë jetën çështjes së lartë të edukimit fetar dhe atdhetar të popullit, i devotshmërisë së lartë, i formimit intelektual, mësues dhe edukator i nderuar”, 1995, “Qytetar Nderi” në Shkodër dhe Kavajë, 2012.

Abstrakt

Haxhi Ibrahim Kaduku me formimin e tij intelektual, bëri që fama e tij të kapërcente kufijtë e Shqipërisë, duke u bërë i njohur në tre kontinente, Evropë, Azi dhe Afrikë. Haxhi Ibrahim kreu studimet fillimisht në qytetin e lindjes, në Shkodër, duke u evidentuar si nxënës i zellsbëm, me prirje të veçanta, sidomos në mësimin e gjuhëve të huaja dhe të lëndëve shoqërore. I ati, i cili ishte tregtar e merrte shpesh në dyqan për ta ndihmuar, por një ditë duke bërë llogaritë e shitjes, shëb se të ardhurat ishin më të pakta nga ato që ishin shitur. Kur e pyet të birin Ibrahimin, ai i përgjigjet, se ia ka shitur më lirë, atyre që ishin në nevojë. Atëherë i ati, duke parë shpirtin dhe humanizmin e tij, vendos ta shkëpusë nga dyqani dhe ta dërgojë për studime në Stamboll, në Medresenë dhe Universitetin e famshëm Fatih, për shkencat islame, studime të cilat i përfundoi me rezultate të shkëlqyera në vitin 1893. Për rezultatet shembullore, për opinionin pozitiv të formuar në personelin pedagogjik e në drejtuesit e fakultetit, për aftësitë intelektuale që manifestoi gjatë shkollimit, u ndal atje si pedagog në universitet për të dhënë gjuhën osmane dhe arabe. Ky ishte një rast i rrallë në praktikën e universiteteve botërore. Kjo tregonte qartë përgatitjen e tij të thellë në linguistikë dhe teologji. Pas sukseseve në mësimdhënien e këtyre lëndëve, ai u caktua që t'i jepte këto lëndë në Akademinë Ushtarake të Stambollit.



H. Ibrahim Kaduku

Ibrahim Kaduku, djali i dytë i Ismailit, nga pesë djemtë që kishte, ka lindur në Shkodër më 5.08.1869 në një familje të njohur dhe të nderuar qytetare, në një mjedis fisnor me interesa arsimore, profesionale e intelektuale, me vetëdije kombëtare e me pikëpamje përparimtare.

Haxhi Ibrahim Kaduku me formimin e tij intelektual, bëri që fama e tij të kapërcente kufijtë e Shqipërisë, duke u bërë i njohur në tre kontinente, Evropë, Azi dhe Afrikë. Haxhi Ibrahim kreu studimet fillimisht në qytetin e lindjes, në Shkodër, duke u evidentuar si nxënës i zellshëm, me prirje të veçanta, sidomos në mësimin e gjuhëve të

huaja dhe të lëndëve shoqërore. I ati, i cili ishte tregtar e merrte shpesh në dyqan për ta ndihmuar, por një ditë duke bërë llogaritë e shitjes, sheh se të ardhurat ishin më të pakta nga ato që ishin shitur. Kur e pyet të birin Ibrahimin, ai i përgjigjet, se ia ka shitur më lirë, atyre që ishin në nevojë. Atëherë i ati, duke parë shpirtin dhe humanizmin e tij, vendos ta shkëpusë nga dyqani dhe ta dërgojë për studime në Stamboll, në Medresenë dhe Universitetin e famshëm Fatih, për shkencat islame, studime të cilat i përfundoi me rezultate të shkëlqyera në vitin 1893. Për rezultatet shembullore, për opinionin pozitiv të formuar në personelin pedagogjik e në drejtuesit e fakultetit, për aftësitë intelektuale që manifestoi gjatë shkollimit, u ndal atje si pedagog në universitet për të dhënë gjuhën osmane dhe arabe. Ky ishte një rast i rrallë në praktikën e universiteteve botërore. Kjo tregonte qartë përgatitjen e tij të thellë në lingvistikë dhe teologji. Pas sukseseve në mësimdhënien e këtyre lëndëve, ai u caktua që t'i jepte këto lëndë në Akademinë Ushtarake të Stambollit.

Haxhi Ibrahim, krahas osmanishtes (turqishtes së vjetër), persishtes dhe arabishtes, zotëronte edhe gjuhët perëndimore, si frëngjishten dhe italishten. Njohja e gjuhëve perëndimore dhe orientale e bëri atë një personalitet me kulturë të dyfishtë.

Në vitin 1905 kthehet në Shkodër, ku martohet dhe ushtron detyrën e imamit, të mësuesit të besimit në mejtepe (mektebe) dhe në shkollat shtetërore si në atë Ruzhdije. Kurse në vitet 1913-1914 ishte mësues në shkollën e Parrucës, e cila drejtohej nga personaliteti i kohës, Hafiz Abaz Golemi.¹ Këtu Haxhi Ibrahim Kaduku bëri një punë kolosale për nxitjen e rritjes së numrit të nxënësve, duke komunikuar direkt me popullin, e duke thënë se kjo shkollë duhet ndjekur se i shërben përparimit të vendit, duke bashkuar dijet e fesë me ato të shkencave.

Në këtë veprimtari Haxhi Ibrahim u radhit në anën e popullit arsimdashës, që vlerësonte shkollën dhe mësuesin, që dëshiron zhvillim e përparim. Nga viti 1914-1924, për një periudhë afro 10 vjeçare shkoi përsëri në Turqi, ku punoi gjithnjë si pedagog në shkolla të ndryshme, si për lëndët e gjuhës turke, ashtu edhe për lëndët teologjike në Edirne dhe Stamboll. Me një punë të kujdesshme autoriteti i rritej gjithnjë e më dukshëm, ai shfaqte përsëri aftësitë e tij shkencore, pedagogjike, teologjike e metodike.²

Në Shkodër flitej, diskutohej dhe kërkohej hapja e një medreseje të re, si një domosdoshmëri për

të plotësuar kërkesat e kohës dhe nevojat e së ardhmes. Kjo medrese u hap në vitin shkollor 1925-1926 nga Haxhi Ibrahim Kaduku, i cili qe drejtori i parë i saj. Medreseja e Re ishte vazhdimi i traditës për shkollat e këtij profili në Shkodër, i asaj të lagjes Qafë të Bushatllinjve që në shekullin XVIII e pastaj të pasardhësës së saj, të asaj të Pazarit, që u quajt edhe Medreseja e Epërme.

Medreseja e Re u konceptua, u organizua, u administrua dhe u drejtua si shkollë moderne, me programe, me tekste e mësues shqiptarë. Dokumentacioni i kësaj shkolle qe tepër i rregullt, amzë, regjistra, orar, dëftesa e karakteristika nxënësish. Kjo shkollë punonte me një plan mësimor të studiuar, që përmbante mbi 20 lëndë. Nga analiza e këtij plani mësimor rezulton se lëndët e kulturës së përgjithshme përfshinin shkenca shoqërore, si: këndim, gramatikë, hartim, drejtshkrim, bukurshkrim. histori-gjeografi e logjikë, ndërsa shkencat natyrore, lëndë si: aritmetikë, gjeometri, botanikë, shkencë (kimi, fizikë). Përveç këtyre, në planin mësimor si lëndë fetare mësoheshin, Kur'an, besim e moral dhe si gjuhë të huaja mësoheshin arabishtja e frëngjishtja. Në dëftesat e nxënësve ishte nota edhe për sjellje e zell.

Në veprimtarinë e tij si drejtor shkolle, Haxhi Ibrahim u ndikua nga teoria pedagogjike e didaktike e njohur e Gazaliut, të cilën ia përshtati kushteve të shkollës.

1. Lista emërore e mësuesve të besimit islam në shkollat shtetërore në Shkodër, mësues në shkollën e Parrucës në vitin 1913-1916, f. 1.

2. Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, "Në kujtim të brezave", Rozafat, 1997: 193.

Më pas Medreseja e Epërme u bashkua në Medresenë e Re, ku në vitet shkollore 1926-27 deri në fund të vitit shkollor 1928-29, Haxhi Ibrahim Kaduku qe mësues i lëndëve fetare dhe i gjuhës arabe në Medresenë e Re, ku gjithnjë dha ndihmesën e vet të papërtuar për konsolidimin e shkollës dhe për përgatitjen e duhur të nxënësve.

Më 1929 të gjitha medresetë e qarqeve të Shqipërisë u mbyllën në bazë të vendimit të Kongresit III Mysliman të Shqipërisë, ku në Statutin e miratuar në këtë kongres, në kreun X, në nenet 55-57 thuhej se “do të ketë një institut në qendrën e Komunitetit me emër “Medrese e Përgjithshme” (në Tiranë), e cila përfshin kategoritë e mësimave fillore e të mesme... “Medresetë e qarqeve suprimohen dhe vakfet e tyne bahen t’ardhuna të Komunitetit”.³

Pas kësaj Haxhi Ibrahim emërohet me dekret të Kryesisë së Këshillit të Naltë të Sheriatit, myfti në Kavajë. Myftiu i përgjithshëm në dekretin në fjalë shprehej: “Pres prej Z. s’Uej besnikri dhe zell në detyrë, shërbime të drejta, me ndërgjegje të pastër fetare e kombëtare për xhemaati Islamijen në Shqypni”. Në këtë detyrë të rëndësishme ai punoi derisa ndërroi jetë. Ndërkohë, me të njëjtin funksion për një kohë të shkurtër punoi edhe në Vlorë. Për një periudhë gati 20-vjeçare ai u shqua si

drejtues, si organizator, si teolog, si studiues, si përkthyes e si punonjës shkencor, krahas detyrës si myfti.

Në radhë të parë ai u mor me plotësimin e organikave të imamëve e të myezinëve, me caktimin e nëpunësve, me inventarizimin e pasurisë së Vakëfit, me administrimin e mirë të buxhetit, me thirrjen e popullit për të kryer ritet fetare e për të zbatuar detyrimet bazë të fesë, me caktimin e mësuesve të besimit për nxënësit e shkollave fillore shtetërore, në realizimin e bursave etj. Me përkushtimin që e karakterizonte, ai shpejt e përmirësoi gjendjen, xhamitë tërhiqnin gjithnjë e më shumë besimtarë. Ai u bë shumë popullor me predikimet e tij ditët e xhuma e me rastin e festave. Duke njohur mirë psikologjinë e popullit, duke qenë një teolog i përgatitur, duke pasur një horizont të gjerë kulturor, e duke pasur përvojë në komunikimin me njerëzit, trajtonte tema interesante të ditës, shqetësuese, për të cilat njerëzit bënë pyetje e kërkonin përgjigje. Haxhi Ibrahim punonte me popullin tema të tilla si: “Shtyllat e besimit”, “E mira dhe e keqja”, “Dituria e injoranca”, “Fjala dhe vepra”, “Prindërit dhe fëmijët”, “Veset dhe virtytet”, “Feja dhe ateizmi”, “Liria dhe robëria”, etj. Këto tema me karakter të përhershëm e të përjetshëm mbushnin boshllëkun e edukimit shpirtëror të masave. Bisedat me popullin e rininë Haxhi Ibrahim

3. Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Tiranë, shtypshkronja “Tirana”, 1929: 13.

i bënte tërheqëse, me material të bollshëm, me citime Kur'ani e hadithe profetike, me fakte të ilustruara nga jeta e përditshme, me një metodikë të qartë, në formë tregimi, të cilat bënin shumë efekt te dëgjuesit.

Në vitin 1940, për autoritetin e erudicionin e tij u zgjodh nënkryetar i Këshillit të Ulemave të Shqipërisë dhe kryetar i komisionit të përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe. Në të bënin pjesë studiues të njohur të kohës, si: Haki Sharofi, Hasan Tahsini e Junuz Bulej. Ky komision kreu një punë tepër të dobishme për besimtarët islamë.⁴

Haxhi Ibrahim gjithnjë qe profesor, myderriz. Statuti i Komunitetit Mysliman lejonte që vazhët, myderrizët e funksionarët e tjerë të njohur prej Komunitetit mund t'u jepnin mësim fetare atyre që dëshironin, pas pëlqimit të marrë prej superiorit të qarkut të vet. Në këtë mënyrë, ai mësonte të rinjtë për t'u përgatitur si kuadro të ardhshëm fetarë.

H. Ibrahim Kaduku, si fetar nuk u mor asnjëherë drejtpërdrejt me politikë, por pavarësisht nga kjo, ai shquhej edhe për vetëdije kombëtare. Edhe në këtë drejtim qe vazhdues i traditës familjare. Në vitin 1925, para se të kthehej në Shqipëri i propozuan që të qëndronte në Arabinë Saudite, Turqi dhe në Egjipt, por ai zgjodhi t'i shërbente vendit të tij.

Një gjest tjetër atdhetar i tij u shfaq më 7 prill 1939, ku u ftua për të marrë pjesë në pritjen e italianëve. Ai këtë e kundërshtoi me këmbëngulje, duke i shprehur që pushtuesi nuk pritej me lule e brohoritje. Si gjatë pushtimit, ashtu edhe më vonë pas çlirimit, gjatë monizmit nuk bëri asnjë deklaratë në favor të tyre. Ai me ndërgjegje ishte në opozitë të plotë me ta, ishte për Shqipërinë e lirë nga pushtuesit, ishte për lirinë e besimit në një shtet demokratik shqiptar.

Nëpërmjet predikimeve ai fliste haptas, qartë e prerë për dashurinë ndaj atdheut, për vlerën e lirisë, për të drejtat e detyrat e qytetarit e të besimtarit, demaskonte pushtuesit e çdo ngjyre, dënonte sundimtarët antipopullorë, kritikonte qëndrimet antifetare, nuk pajtohej me asnjë lloj padrejtësie në kurriz të njerëzve, të popullit e të vendit.

Edhe në rrethanat e frenimit të veprimtarive fetare nga ana e shtetit ateist, H. Ibrahim nuk e pushoi kurrë punën e tij të devotshme për prezantimin e Fesë islame, për kryerjen e riteve në faltore, në shtëpi, etj. Ai me fjalën dhe veprën e tij qe një shembull i bukur i njeriut të përkushtuar ndaj problemeve të fesë, qe një model i kujtuar me nderim e vlerësim të veçantë.

Në këtë kuadër duhet vënë në dukje bindja, qëndrimi dhe veprimtaria e tij e pandërprerë për harmoninë ndërfitare. Ai nuk linte

4. Luli, Faik, gazeta "Drita Islame", nr. (16) 77, 1995: 3-4.



Foto nga vizita e hoxhallarëve shqiptarë në Universitetin El Ez'her - Kajro, 1941.

Në rreshtin e parë majtas:


H. Sulejman Gavoci, H. Ibrahim Kaduku, Mustafa el Meragi (Rektori i Universitetit), H. Ismail Durrësi.

rast pa shfrytëzuar për të folur me njerëzit, me të rinjtë, që ata të shoqëroheshin, të bashkëpunonin, të miqësoheshin, të duheshin dhe të jetonin së bashku me mirëkuptim dhe tolerancë, si njerëz të një gjaku, të një gjuhe, të një vendi, si njerëz me interesa, histori dhe me perspektiva të përbashkëta.

H. Ibrahim ka punuar jo vetëm në qytete të ndryshme të Shqipërisë, por ka jetuar e punuar edhe në vende të huaja, si: në Turqi, në Arabinë Saudite e në Egjipt. Në këto vende ai ka mësuar, është ngritur në pikëpamje kulturore dhe fetare, ka fituar përvojë, të cilën e ka sjellë dhe e ka përdorur në

Shqipëri, duke ia përshtatur kushteve e rrethanave të vendit, por në të njëjtën kohë ka krijuar në ato vende një opinion të mirë për vendin tonë, ka bërë miq të Shqipërisë, me cilësitë e tij të bukura ka paraqitur veçoritë pozitive të popullit tonë.

H. Ibrahim Kaduku ka qenë 7 herë në Haxh. Gjatë këtyre udhëtimeve, ai është ndalur në Kajro të Egjiptit, ku ka pasur takime pune me rektorin e Universitetit të "El-Ez'herit, Muhamed Mustafa el Meragi. H. Ibrahim, herë vetëm e herë me delegacione nga Shqipëria ka shkëmbyer mendime për punën mësimore e teologjike, ka përfutur



**Libri i H. Ibrahim Kadukut
“Standardet e gjurmëve të të
përzgjedhurve dhe ndryshimet me
të huajt dhe të tjerët”, botuar në
Aleksandri, Egjipt, 1939.**

nga përvoja shekullore e këtij universiteti dhe nga drejtuesit e tij, ka siguruar ndihmë për literaturë, për bursa, për organizim e drejtim të punës etj. Takimeve të H. Hafiz Ibrahim Kadukut me rektorin e Universitetit u bën jehonë vlerësuese edhe shtypi arab me shkrime nderuese, me fotografi, ku shprehte ndjenja miqësie e bashkëpunimi për mysafirët nga Shqipëria. Kulmi i vlerësimit të tij në këtë universitet ka qenë ftesa për të mbajtur ligjërata në fakultetin teologjik, ku Haxhi Ibrahim paraqiste me kompetencë erudicionin e tij teologjik, kulturor e gjuhësor.

Gjatë qëndrimit të tij në Egjipt ai ishte vizitor i përhershëm i bibliotekave të pasura të këtij vendi, ku gjente materiale të nevojshme shkencore, teologjike, kulturore, gjuhësore, që ishin ushqim i vazhdueshëm për të si njeri i dijes e i fesë.

Në Egjipt Haxhi Ibrahim ka qëndruar në vitet 1937, 1939 e 1941 për periudha të caktuara. Këto qëndrime, përveç takimeve i shfrytëzoi edhe për të bërë botime. Këtu ai botoi një libër me përmbajtje filozofike-fetare në gjuhën arabe, të titulluar “Standardet e gjurmëve të të përzgjedhurve dhe ndryshimet me të huajt dhe të tjerët”, i cili u recensionua nga Muhamed el Tahir bin Ashuri, Myfti i Tunizit, që e çmoi lart për përmbajtjen e për vlerat edukative si një dijetar me famë botërore. Libri shtë botuar në Aleksandri, Egjipt, më 1939. Edhe djali i dytë i tij, Thabiti, mbaroi studimet e larta në Ez’herin e famshëm dhe me këshillën e të atit vazhdoi të jetonte dhe punonte derisa vdiq në Egjipt.⁵

Vlerësime të larta për H. Ibrahim Kadukun bëri nëpunësi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Egjiptit, Abdulhafidh Mahmud Besjuni, i cili shkroi për të një broshurë te veçantë të titulluar “I nderuari, bujari, zotëria ynë dijetar Ibrahim Kaduku, myftiu

5. Kjo për arsye se në Shqipëri më 1944 kishte hyrë komunizmi dhe ishte krijuar një atmosferë përjashtuese për të gjithë të shkolluarit jashtë.

i Shqipërisë”. Në hyrje të kësaj broshure autori thekson se e shkroi këtë libër në kujtim të humbjes së dijetarit Ibrahim Kaduku. Ai vë në dukje se takimi e njohja me të në vitin 1939 ishte “prej kohërave më të mira të jetës sime”, e çmon atë si pasqyrë për shokët, që me formimin, sjelljet e veprimet është model për t’u ndjekur. Në vazhdim ai paraqet disa nga cilësitë më kryesore të tij, të cilat i shprehu kështu: “Ishte bashkuar tek ai madhështia, mundi fetar, ishte i shprehur nga dituritë logjike, kulturore dhe gjuhësore”.⁶ Në përshkrimin e karakteristikave të tij ai vazhdoi: “Ishte dijetar, veprimtar. Ligjërimet i kishte ndikuese, fjalimet të kuptueshme, thirrës i singertë, myfti i ndershëm, kishte njohuri të shkëlqyeshme, ishte i singertë, praktikonte diturinë në vepra... Emri i tij u bë i përhershëm nëpër fletët e historisë. E meritoi një respekt të ndershëm, të naltë dhe një vend të lavdërueshëm prej Allahut, Zotit të botëve”.⁷

Vdekja e Haxhi Ibrahim Kadukut më 23 maj 1949, krijoi një boshllëk të ndjeshëm në kuadrot intelektualë islamë shqiptarë, sepse ai qe një figurë shumëplanëshe, me potencial të fuqishëm filozofik, kulturor e shpirtëror, një mësues i përgatitur, një drejtues i aftë, me

përvojë të madhe e me autoritet të merituar, një personalitet i njohur në gjithë vendin e jashtë tij.

Një tregues i qartë i dhimbjes që krijoi vdekja e H. Ibrahim Kadukut është paraqitja e ndjenjave miqësore të studiuesit egjiptian, që me këtë rast në broshurën kushtuar atij shprehet në mënyrë mallëngjyese: “Nuk e di në këtë çast kujt me ia dërgue ngushëllimet, a myslimanëve të Shqipërisë, të Ballkanit, apo të Lindjes. Qoshe më qoshe? E vërteta unë ia dërgoj ngushëllimet gjithë botës islame. Vërtetë thirrja e tij ishte e fortë, humbja është shumë e madhe dhe ngushëllimi shumë i rëndë”.

Në kujtesën e qytetarëve të Shkodrës, Kavajës, Vlorës e Tiranës, ku ai jetoi e punoi duke kryer detyra të ndryshme arsimore e fetare, është gjithmonë i pranishëm me nderim të veçantë. Ish-nxënësit e mejtepeve, të shkollave fillore shtetërore dhe të medresesë që e kanë pasur mësues, profesor e drejtor, tregonin për të episode të paharruara. Ata nuk gjenin fjalë për të shprehur përshtypjet, mbresat e kujtimet pozitive për të. Ata, në vend që të thonin kam mësuar në Medresenë e Re, shpreheshin “Kam mësuar në Medresenë e Kadukut”, “Kam pasur drejtor të parë të famshmin Ibrahim Kadukun”. “Babai im ka pasur myderiz për gjuhën arabe e për mësimet fetare të nderuarin H.

6. Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, “Në kujtim të brezave”, Rozafat, 201 :1997.

7. Po aty.

Ibrahim Kadukun”, etj.⁸

H. Ibrahim Kaduku ka meritë të veçantë për propagandimin e fesë në qytetin e Kavajës, ku për një kohë të gjatë ushtroi detyrën e myftiut. Ai këtu fitoi një popullaritet të gjerë, një dashuri të veçantë, një nderim të rrallë, një autoritet të madh. Një tregues i këtij vlerësimi është korrespondenca në revistën “Kultura Islame” me titullin “Si u festua Mevludi në Kavajë” (maj, 1944).⁹

Edhe Hafiz Sabri Koçi ka qenë një nga ata studentë, që gjatë praktikës nëpër xhami, nxiteshin që të kërkonin ndihmën e dijetarëve më kompetentë. Kështu p.sh., ai shkonte për t’u këshilluar me profesorin e nderuar, Haxhi Ibrahim Kadukun. Tek ai gjente një pritje të veçantë. Profesori jo vetëm i jepte shpjegimet e duhura, por edhe libra për të studiuar.

Vitet e fundit Haxhi Ibrahim Kaduku ka pasur nderime dhe vlerësime të shumta të merituar. Kështu në vitin 1995, një grup dijetarësh, edukatorësh dhe hoxhallarësh të famshëm të Shkodrës, e një ndër ta edhe Haxhi Ibrahim Kaduku, një intelektual i

shquar arsimor, fetar dhe kulturor është dekoruar nga Presidenti i atëhershëm Sali Berisha, me urdhrin “Naim Frashëri të Klasit I” me këtë motivacion: “Klerik që iu kushtua tërë jetën çështjes së lartë të edukimit fetar dhe atdhetar të popullit, i devotshmërisë së lartë, i formimit intelektual, mësues dhe edukator i nderuar”.

Ndërsa në vitin 2012 me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë me propozim të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, shpallet “Qytetar Nderi” nga Këshillat e Bashkive Shkodër dhe Kavajë me këto moticacione:

“Prijës i shquar Islam, myfti, drejtor i parë i Medresesë Shkodër, klerik që ia kushtoi tërë jetën çështjes së lartë të edukimit fetar dhe atdhetar të popullit, i devotshmërisë së lartë, i forcimit intelektual, mësues dhe edukator i nderuar.”

Këshilli i Bashkisë Shkodër

“Për kontributin e shquar në themelimin, ngritjen dhe konsolidimin, kontributin për gjuhën shqipe, arsimin dhe teologjinë në qytetin e Kavajës.”

Këshilli i Bashkisë Kavajë

8. Po aty.

9. Revista “Kultura Islame”, Maj 1944: 261.

Mëshira Hyjnore ka mbulue çdo gjâ

«وسعت رحمتي كل شيء»

Mirësia triumgon mbi keqësin.

«من جاء بالحسنة فله عشر أمثالها و من جاء بالسيئة فلا يجزى إلا مثلها و هم لا يظلمون».

Hysni Hoxha

Po thuej të gjithë, pa përjashtim e pohojnë me fjalë, qi Mëshira Perendijore është e madhe dhe e pákufizuese, mirëpo të pakë janë ata qi e dinë realitetin asaj dhe fort pak kanë konviksjon për Mëshirën e Amshueme qi ká ndërhye kudo, por ká edhe asijsh qi dëshirojnë të marrin vesh e të kuptojnë Mirësin Perendijore.

Prandaj un për t'i ardhë në ndihmë e në rreth klasës së fundit qi thamë mâ sipër e qi s'ka pasë fatin me vazhdue mësimet Theologjike në ndonji Medrese a po qi s'ka pasë rastë me ndenjë e me ndígjue fjalë e këshilla të dobishme prej ndonji dijetari fetár – pse edhe këjo është një dije në vedi – e pásh t'arsyeshme qi propozitën e natë Hyjnore, me të cilën

u stolis kryet e këtij artikulli, t'a shkoqis pak në bazë të mësimave qi kam marrë nga ky Institut i Shejtë, abolla qi të ja u zbus një fije zemren atyne qi kanë rebelue kundra logjikës e arsyes e janë shmangë nga rrug' e drejtë.

Libri Hyjnor në versetin e naltë:

«من جاء بالحسنة فله عشر أمثالها» إلى آخره...

urdhënon tekstualisht këto fjalë:

«Kush ushtron një vepër të mirë shpërblehet dhet fish dhe ay qi ushtron një vepër të keqe ndeshkohet një per një pá pësue ndo një pá drejtësi – qi të shtohet ndeshkimi e të pakësohet shpërblimi.» Ky verset përnjiherësh është edhe mëshirë Hyjnore, pse Perendija i Plot-Pushtetshëm tregohet i kënaqun, n'është se bájme një mirësi, për të cilën na dhuron mjaftë shpërblime si dhetë fish e mâ të tjera e m'anë tjetër çfaqet i dhimbshëm, po qe se ushtrojmë një

veper të keqe, mbassi për të nuk na .denon mâ vetëm se një fish

Mbassi të bâjmë një interpretim indirekt në rastin e parë kuptojmë dhe marrim vesh se Perendija, na shtyen të rrokim veprat e mira dhe në rastin e dytë na ndalon nga e keqja.

Nga ky verset mësojmë qi Perendija kundrejt njeriut paska kujdes dhe dashuri, prandaj gjendjes s'onë kritike duhet t'i apim një drejtim të mbarë dhe të prekemi thellësisht në zemër.

Po edhe Profet' i Shejtë, frymzue nga verset' i Shejtë qi shënuëm sipër urdhënon:

من هم بحسنة فلم يعملها كتبها الله حسنة كاملة وإن هم بها فعلها كتبها الله عنده عشر حسنات إلى سبع مئة ضعف على أضعاف كثيرة. وإن هم بسيئة فلم يعملها كتبها الله عنده حسنة كاملة وإن هم بها فعلها كتبت سيئة.

Qi d.m.th. kush vendos me ba një të mirë e s'e bân i shkruhet dhe ay qi ká qellim të bâjë një të keqe e nuk e vepron, nuk i shkruhet:

T'a shpjegojmë mâ gjatë:

Si mbas Fës Islame rrymat mendore qi paraqiten në trunin e atij njeriu, i cili ushqen realizimin e veprës së ligë, ndahen në pesë kategori.

1-ra Së parit këtij lloj njeriut i përshkon në mendje qellimi për me krye vepren e ligë, por nuk qëndron as pak.

2-ta Kuër qellimi për veprimin e së keqes qëndron pak, por e shumëta e mendjes voton për të larmen e sáj atëherë ky lloj mendimi hyn në kategorinë e dytë.

3-ta Asht të paraqitunit e një ideje në trû, ku ngulet deri sá shkakton barazimi e peshimit të mendjes, e cila për vendimin e gjâs immorale ashtu dhe për lanëjen e sajë asht e barabartë d.m.th. nuk priret n'asnjë anë; as për të mirë as për të keqe.

4-ta Asht të qindruemit e kujtimit

të së keqes, deri sá efekton mjanimin e mendjes mâ tepër për të bâmit e veprës së ligë, d.m.th. mendja e jonë ká peshue mâ teper për ushtrimin e asaj veprë.

5-ta Në radhën e pestë kemi atë idé, e cila tue u ngulë krejtësisht në mëndje t'onë, diftohet përjashta me anë të Shqisave, por me konditë qi mos të shkaktojë vepren e ligë im-morale.

Prá, të ndershëm lexues, të pesë korrentet mendore të sipër-spjegueshme qi qarkullojnë në trurin t'onë formojnë atë qëllim qi ushqen realizimin e vepres së dobët e qellimi kësodore asht falë nga i madhi Perendi «qoftë falënderue qi na ká dhanë këtë mirësi»

Nga shpjegimi i deri-këtueshëm – kurse qellim' i keq, i cili merrte faza të ndryshme në mendjen t'onë, deri sa nuk u kryente një veper e tillë, s'u numëronte delikt dhe nuk shkruhesh, ndërsa qellimi i vepres së mirë ndonëse nuk asht realizue numëroresh një mirësi dhe rregjistrohesh një shpërblim – kuptohet çiltas mirësija dhe mëshir' e Perendis. Pastaj kuër njeriu vepronte një të keqe i shkruhesh vetem një ndeshkim, në sá qi kuër bajshim një veper të mirë u rregjistroheshin 10 shpërblime. Nga këjo rezulton se mirësija triumfon mbí të keqen. Pra mjerim i madh asht për atë njeri qi të këqijat i kalojnë të mirat e tij. Këjo periudhë e fundit nuk asht gjá tjetër veç se kuptimi i një hadithi Sherifi:

«ويل لمن غلبت آحاده عشرائه»

Të ndershëm lexues me versetin e naltë shenuem nuk kemi qellim të kufizojmë mirësin Hyjnore se mundet për një, ká 100 shpërblime a po 1000 e tjera, sikur e verteton këjo propozitë Hyjnore:

«مثل الذين ينفقون أموالهم في سبيل الله كمثل حبة أنبتت سبع سنابل في كل سنبلة مئة حبة» إلى آخره...
e cila na ep të kuptojmë se për

nji të mirë ká 100, por se ky caktim jo me dhjetë, jo me një qind ká ardhë mâ tepër për me ju përshtatë mendjeve t'ona, shumica e të cilave s'kanë kompetencë me përfshí mirësin e mëshiren Prenedíjore qi ká mbulue gjithësinë tansisht tue mos lanë jashta as një atom (thermie) pa ndërhy, gjâ këjo të cilin e vërteton Ajeti qi kemi marrë për subjekt. Edhe me të vërtetë po të hedhim një sý në Natyrë, shohim se çdo gjâ është krijuar për të miren t'onë si: shtazët, bimët, toka me minerale e ç'ka brenda, Qielli me Hyj të shkëlqyeshem, në krye të të cilve zen vend Dielli qi me rrezet e dritës së tij mban gjallë çdo gjâ në jetë e tjera, qi të gjitha këto nuk janë gjâ tjetër veçse një begatí hyjnore. Gjithashtu edhe njerzit shofin mâ teper mirësi: Bje fjala mâ shumë ká njerëz, të shëndoshë se të smundë, mâ shumë ká njerz të plotsuem n'organe e në gjymtyrë, se sá ká të verbët e të çalët, memecë e shurdhë; ashtu edhe sasiya e të mendshëmëve është mâ e madhe se e të marrve.

Të gjithë këto shembulla janë fakte të gjalla për me vertetue se Mëshira Hyjnore është e madhe dhe pá kufi. Prandaj një njeri qi ká mend e gjykon ato qi u thënë sipër natyrisht do të bindet e do t'i shtrohet Perendís, se kah do qi të hapë sytë, shef: mirësin Perendíjore e do t'ulë kryet para Fuqís Supreme qi e kreu. Ky konviksjon do t'i api me kuptue qi vetem te Fuqija Hyjnore mund të gjejë një mburojë për të shpetue nga smundjet morale e matreiale, qi shpartallojnë pa një pá dy naltësin e njeriut, i cili është krijuar në formen mâ të bukur e n'organizmin

mâ të plotë. Prandaj kësaj kreatore i ká hije morali, virtyti, karakteri e ndërgjegja e pastër. Po qe se njeriu i shkretë i shtëmanget kësaj rrugë, atëherë është bafaktor i vetes së tij dhe nesër kuër do të dalim n' Audijencat Hyjnore, do të jetë përgjegjës i shpirtit të tij, të cilin Perendija ja ká lanë në dorëzim.

Çdo gjâ në gjithsi i shtrohet Fuqís s' Amshueme vetem e vetem me ju falndrue për të mirat qi ká shpërdá ku do: Shpezërija sipër në shtresat ajrore qi mbyllin dhe hapin krahët, pendët qi herë e stolisin dhe e zbukurojnë natyren me bulzimin e tyne e herë thahen, Dielli qi lenë nga një pikë e horizontit dhe perëndon n'anë tjetër, ernat qi mbushin hapsinën me zhurmë, rrëfeja qi mbushë qiellin me krisma të tmerrshme, deti qi përpinë me dallgat e tij barkat, malet qi shumë herë çelen copa copa tue u rrokullisë, temperaturat qi shkakton ndryshimin e çdo gjaje në natër e tjera; të gjitha këto objekte veprojnë mbas urdhënit t'Efektuesit qi është vetë Zoti (xh. xh.) bashkë me këtë dëshmojnë dhe Unitetin e Tijë, por njeriu qi ká këtë titull të naltë, i cili vetem atij i meriton, pse është krye në sistemin mâ të mbaruem dhe i pajuem me arsye e gjykim, si mos të lëkundet e të tronditet nga Mirësija Hyjnore? Pra duhet të mjerohemi e të pikëllohemi thellsisht në zemer, të qajmë e të vajtojmë hallin t'onë, se vetem atëherë mund të gjejmë rrugën e shpëtimit e do të dalim faqe bardhë në të dy jetët.

Perendija na plotësoftë qëllimin.¹

1. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 2, viti XI, 1936, f. 45 – 50.

Abstracts in English

STUDIES

1. Learning the Civil Norms in the Madrassas of Albania II

Prof. Asoc. Dr. Gentiana Skura, University of Tirana

Dr. Robert Gjedia, “Marin Barleti” University

Dr. Genti Kruja, “Bedër” University

Abstract

The curriculum of civic education in pre-university educational system includes the subjects of “Education for Society” and “Citizenship” and aims at the formation of students’ knowledge, skills, attitudes and civic values in this educational cycle, relying heavily on philosophies, good practices and citizenship models of the democratic world in general and that of Western European countries in particular, where in essence individual rights and responsibilities, law enforcement, environmental protection, employment rights, human security and coexistence in the community remain as core values. However, the content of the aforementioned subjects does not provide any information or educational practice related to matters regarding the religious instruction and education. This kind of education also has a special place in the curriculum that is sufficient to achieve the desired goals and competencies for the students, considering the number of lessons, the specific weight of the curriculum area, as well as the actual subjects of civic formation being taught in all three pre-university education cycles, compared to the curricula of European education systems.

Madrassas develop the official curriculum of pre-university education cycles, but they also include a part of the curriculum that has a religious orientation, which is also approved by the Ministry of Education.

Religious subjects are integrated into the official curricula of the madrasas in such a way as to support the topics covered by civic education subjects. Since the people living in the democratic system are very much in line with the believers (regardless of religious affiliation), the common themes of these subjects are numerous.

2. Call in Islam among Albanian people in the actual geocultural, geopolitical and postmodernist environment

Dr. Milazim Krasniqi, University of Pristina, Kosovo

Abstract

A highly selfish, alienated, nihilistic and hermit man must be offered a presentation and interpretation of Islamic religious belief, which has to be a powerful consoling and saving offer - an offer that does not ignore its real state of affairs; an attractive and benevolent offer that gently attires the attention; that helps not sinking into the mire of disappointment and which is offered as a lifeboat.

However, the postmodern perspective on the world has already been imposed and it is becoming dominant even among the new generations of Albanian people. Therefore, it must be recognized by Muslim pilgrims and scholars as a separate worldview and state, in the totality of its values and controversies, in order to be effective in communicating with the public (jamaat) originating in this sphere. By contrast, even their religious life will be increasingly involved in improvisations, spontaneity, obscurity, and finally in indifference. This would also open a new opportunity for the de-Islamization of Albanians, but in this case not in the circumstances of totalitarian terror - as was the case of the communist regime - but in the circumstances of freedom, where religious elites have abolished communication with people because of their inability to orient themselves in the new geopolitical, cultural and social realities.

3. Sciencism – The modern Trojan Horse

Fatos A. Kopliku, M.S.

Washington DC, USA

Abstract

Sincerity and good intentions in themselves are not a guarantee of useful communication, so the protection of the words of the divine books and prophets from materialistic and agnostic background attacks cannot be done through science of technology - such is the case of the modern West - rather, adopting a philosophical background that in principle does not reject or even contradict God as the Source of everything that gets existence and life. Today's scientific knowledge can be integrated and interpreted in a Divinity-centered worldview; something that has happened with success even in the past - not only of Islam - but of other authentic religious traditions. Scientism - the philosophical background of modern science - is really a Trojan Horse, which, when brought within the walls of the stronghold of faith, ultimately becomes the cause of its weakness, if not of its destruction. If you occasionally notice an alarm tone between the rows of this article, it is worth remembering that even Cassandra did not warn the trojans whispering about the horse Trojan would bring but

loudly. When there is a fire, nobody complains about the alarm sounds or firefighting loud voice. However, comparisons stop here, because this is neither the first nor the last writing that draws attention to the risk of penetrating the scienticism in religion and - unlike Cassandra, whose words the Trojans didn't take into consideration and called her crazy - already there is a considerable number of Muslim authors - and not only - that have begun the criticism of the scientific worldview from a traditional intellectual and spiritual perspective.

HISTORY

4. Corps of Ottoman graffitti in Tepelena and Delvina

Dr. Mehmet Tütüncü

**World Research Center for Turkish and Arab Languages,
Haarlem, The Netherlands**

Abstract

This is a study and publication about Ottoman graffitti in southern Albania, defined as the area between Vlora and the Greek border. Over the past few years, many new graffitti (mainly gravestones) have been discovered by foreign and local scholars. Many graffitti mentioned in some writings of well-known authors (Evliya Çelebi and others) have been added to these new ones. 25 graffiti from this area, dating back to 1542 to 1897, are published here as part of the Corps of Ottoman graffitti in Albania. These graffitti are studied in their historical and cultural context. They contain information on activities in the field of construction, life and culture of that area during the centuries of Ottoman rule in Albania.

Keywords: Ottoman, graffitti, Albania.

5. An Historical view on the book

**“History of Albanian Pashaliks in the Ottoman Empire”
of Syrja bej Vlora Part I**

Dr. Hasan Bello

Institute of History, Center of Albanological Studies

Abstract

The book “History of Albanian Pashaliks in the Ottoman Empire” of Syrja bej Vlora is a modest attempt to shed light on a number of personalities who have lived, worked and contributed for an imperial state, part of which were also Albanians during five centuries.

In this book, data of general character are given, which for the sake of truth can now

be considered as outdated from those scholars who want to deal with a profound research of the Ottoman period. As for passionate readers of history, they are a valuable contribution, with little or no previously known information. The author discloses interesting data for familiar and unknown names from Albanian historiography, perhaps for the fact that for these personalities, prejudice instead of sound reasoning did prevail.

This book in manuscript was written in the Ottoman language and now it can be found at the State Central Archive of Tirana together with the translation into Albanian. It has in total 144 pages in Ottoman and 52 pages in Albanian translated by the orientalist Jonuz Tafilaj. In the inventory compiled by the orientalist Haki Sharofi, the manager of the Turkish manuscript section in the historical archive, the date of receipt of this translation June 26, 1963 appears. As for the time when it was written by Syrja bey Vlora, we still have no data.

Although this manuscript translation is in the northern dialect and contains a considerable amount of errors, we have intervened only where it was indispensably necessary. This because dialects along with translations made in a given period are a tremendous asset and bear the stamp of the time.

But on the other hand, in order to help the readers, we converted the years of lunar calendar to the solar calendar by placing them in parenthesis without changing the original text. In the sections in which an Ottoman historical term appears we tried to explain it with the sign () in the subtext. As for some personalities - whose birthdays, the year of death and the time they served as prime ministers is shown - we have placed them in brackets.*

GEOGRAPHY

6. Contribution of Al-Khwarism and Ibn Fadlan to the development of the science of geography

M.sc. Artan S. Mehmeti, Prizren, Kosovo

Abstract

He was born in the Persian region called Chorasnia. Nowadays this region belongs to Uzbekistan. Al-Khwarizmi was a mathematician, astronomer, astrologer, geographer, etc. As a scientist, academically he made a huge progress during the period he worked at the House of Wisdom in Baghdad. This house was a scientific center that dealt with the translation and research of scientific and philosophical theories, and in particular the Greek ones.

In this center, research in various scientific and religious fields was also carried out as well as teaching the young students.

The contribution of al-Khwarism, in the field of geography during the medieval era, was enormous. He corrected and systematized Ptolemy's research using the findings found during his research.

Ibn Fadlan was born in 877 AD. He was an X-th century traveler, who was sent as secretary of the Embassy of Abbasid Caliphate from Baghdad to the Kingdom of the Bulgarian Volga. He is also known as a writer, historian, traveler and geographer.

LINGUISTICS

7. Satirical poem reading for semantical, language, stylist, artistic and letter values

Associate Prof. Dr. Rahim Ombashi, BEDER University College

Abstract

Recently, as a result of professional research, it was discovered in the State Archives in Tirana, another satirical poem of the creator (publicist) of this city, Hafiz Ibrahim Dalliu. The prominent poet of the 1930s is being offered to contemporary readers, thanks to the interest of the researcher Genti Kruja, because communication with the author had been, for reasons beyond the borders, after the end of World War II. The poem written in 1922 (?) is titled "A dream of mine".

The satirical poem of Hafiz Ibrahim Dalliu (1878-1952) has a total of 681 verses, written in one column, with triple but inseparable verses.

Triple verse is inseparable from one colon, with a string of dotted lines, with rhymed AA for the two beginning strings, while the third verse B, which is tetrocrosis, reinserts with the third row B of the following and then the following.

The typing is done in 16 sheets with the letter "e" instead of letter "ë", but especially the gaps in the placement of the punctuation marks and the poor quality of typing presents difficulties in reading the original, but not in the evaluation of the work. The object of the philological method will be the discovery of linguistic values that realize contextual and local communication and as a real documentation of linguistic extremism that originated those times.

Keywords: semantics, stylistics, environmental language, gnomics, comic discourse

MEDICINE

8. Foods and drugs - permissible and forbidden - in front of the XXI-th century developments

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.

University Hospital Center, "Mother Teresa", Statistics Department

Abstract

A vast body of literature speaks about halal and haram in relation to food and drugs. Despite of all similarities in regard to modern structures which define regulations and offer recommendations Islam preserves the everlasting singularity of reference to Qur'an. That's why the necessity of the everlasting translation of these transcending rules second the metrics of time we live becomes a mandatory duty to Muslim scholars. They put themselves between Qur'an and the obligation to interpret in real time. Two levels of interpretation become necessary. In the highest level Qur'an's rules about the permissible and the forbidden are understood by them remaining to abstract and requiring a second practical level of interpretation characterized of easiness to understand and utilize from the lay people. This duty in reality doesn't bring nothing new to the source this rules derive but their interpretation is always a challenge times bring anew. Among the most important changes result to be the increase of drug quantity and time of consummation and foods of a complex nature where technology interferes. New demographic and technological developments, unknown before our age brought lots of novelties compared to the simple life of our ancestors. In this situation we can't negate the shortcomings of an organized response, although continuous efforts are present, but hoping that possessing a treasure of invaluable assistance as the Qur'an is, will guide us toward disclosure of knowledge and practice. Irreplaceable contributions remain to the classical schools of Islamic thought. Although some of their decisions have to change in ours times context we must preserve their models of thought as part of our identity preservation confirming to be their historical continuity.

Keywords: Halal, haram, drugs, food, technology, demography, tabaco, meat

COMMUNICATION SCIENCE

9. “Drita Islame” - a spark of Islam’s light in post-communist Albania

Dr. Qani Nesimi

Mufti of Tetovo, Mcedonia

Abstract

“Drita Islame” has a heavy burden to educate the new generation on religion, which can either have the potential to positively influence or it can have a negative and destructive impact at the same extent. It can either help the humanity or cause harm to it; can either create peace in one place or can also be a cause for war. Balkan wars between Serbs and Bosnians, between Serbs and Albanians, between Albanians and Macedonians, between Serbs and Croats, between Greeks and Albanians, can be at the same extent of national proportions as well as of religious ones, either directly or indirectly, as motivators of war or as its supporters. All this depends on the way we use religion; the way it is handled. So, one who believes and practices religion has a great responsibility on how he uses it. But one who has to make a decision or hold an attitude on religion is strongly influenced on what circumstances and beliefs he has experienced or how serious he is in his attitude. Therefore, in my opinion, the periodical magazine “Drita Islame” has played a very important role in the presentation and the correct interpretation of the Islamic religion, which is against violence, murder, abuse of religion, mistreatment of others, etc.

PERSONALITY

10. Haji Ibrahim Kaduku (1869-1949)

Abstract

Haji Ibrahim Kaduku through his intellectual background made his fame cross over the borders of Albania, becoming known on three continents, Europe, Asia and Africa. Haji Ibrahim originally studied in his hometown of Shkodra, being evidenced as a zealous students with particular skills especially in the teaching of foreign languages and social subjects. His father who was a trader often took Ibrahim to the family store for helping him in trade but one day while making the sales accounts, he noticed that the income was less than the articles that were sold. When he asked his son Ibrahim, the later replies that he sold the stuff at a low price to those in need. Then his father, seeing his altruistic soul and humanity, decided to take him out of the store and sent him to study in Istanbul Madrassa and the famous Fatih University for Islamic sciences, where he graduated with excellent

results in 1893. Because of his exemplary results and of positive opinion created on him among the pedagogical staff and faculty leaders and because of the intellectual abilities he manifested during schooling, he managed being employed as a lecturer at the university where he taught the subject of the Ottoman and Arabic language. This was a rare case in the practice of world universities. This clearly demonstrated his profound preparation in linguistics and theology. After succeeding in teaching these subjects, he was assigned to give these courses at the Istanbul Military Academy.

RETROSPECTIVE

11. Divine Mercy has covered everything

«وسعت رحمتي كل شيء»

Kindness triumphs over the evil.

«من جاء بالحسنة فله عشر أمثالها و من جاء بالسيئة فلا يجزى إلا مثلها و هم لا يظلمون».

Hysni Hoxha

Abstract

Almost everyone - without exception - affirm that Divine Mercy is great and infinite, but only a few people who know its reality and again, a very small number of them believe in the Eternal Mercy that has intervened everywhere. But there are also those who want to grasp and understand the Divine Mercy.

So, in order to help the last category mentioned above, who did not have the chance to attend the theological lessons in any madrassa, or did not have the opportunity to hear useful words and advice from any religious scholar - because this also constitutes a knowledge on itself - I saw as reasonable that the divine supreme proposition - by which I adorned the head of this article – to explain and elaborate based on the lessons I received from this Holy Institute, so that to soften the heart of those who have rebelled against logic and reason and who have been diverted from the right path

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikulli duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.